

Bordi Editorial

PROF. DR ROMEO GURAKUQI, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PHD. FATOS TARIFA, *Universiteti European i Tiranës (UET)*

PROF. DR ERLETA MATO *Universiteti European i Tiranës (UET)*

DR. ENIS SULSTAROVA, *Universiteti i Tiranës*

BLENDI KAJSIU, *Dokt. (Essex University, Britani e Madhe)*

STEPHANIE SCHWANDNER-SIEVERS (*University of Roehampton, Britani e Madhe*)

PROF. ASOC. ÇAPAJEV GJOKUTAJ *Universiteti European i Tiranës (UET)*

Dr. Nathaniel Copey *Aston University, Britani e Madhe*

Kryeredaktore

ODETA BARBULLUSHI, PHD

Universiteti European i Tiranës (UET)

Redaktorë

PROF. ASOC. DR TONIN GJURAJ

Universiteti European i Tiranës (UET)

PROF. DR PËRPARIM FUGA

Universiteti European i Tiranës (UET)

PROF. ASOC. DR ALEKSANDËR DHIMA

Universiteti European i Tiranës (UET)

Redaktore Gjuhësore

BESA VILA

BOTIM I FAKULTETIT TË SHKENCAVE SOCIALE,

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS (UET)

Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70 H.1, Tiranë, Albania

<http://www.uet.edu.al> / info@uet.edu.al



Përmbajtja

“Ky tranzicion që s’mbaron kurrë”: një kritikë shumëplanëshe e tranzicionit shqiptar nga shkencat sociale në tranzicion5
ODETA BARBULLUSHI

*Tranzicioni dhe riprodhimi i elitës në Shqipëri:
Hipoteza të testueshme për një sintezë teorike9*
FATOS TARIFA

*Elita politike dhe shoqëria civile në Shqipërinë postkomuniste:
Një marrëdhënie problematike27*
TONIN GJURAJ

Demokratizimi dhe sociologjia publike në Shqipërinë postkomuniste43
EMILIANO LLAZO & ENEDA TARIFA

Deskriptivizmi materialist historicist vis-à-vis qasjes kritike analitike në shkencat sociale shqiptare: Tranzicioni i munguar63
ENIKA ABAZI

Për një antropologji të modernitetit shqiptar77
NEBI BARDHOSHI

Ligji dhe shoqëria: Tranzicioni i ligjit shqiptar dhe ligji i tranzicionit89
ARBËR GJETA

Dilemat e munguara të procesit të integritimit evropian109
KLEMENTIN MILE

*Kultura dhe pjesëmarrja politike e të rinjve:
Të jesh i majtë ose i djathtë, kjo është çështja123*
ERMIRA DANAJ, KLEJDI KËLLIÇI

ABSTRACT141

“Ky tranzicion që s’mbaron kurrë”: një kritikë shumëplanëshe e tranzicionit shqiptar nga shkencat sociale në tranzicion _____

_____ Odeta BARBULLUSHI* _____

Shënim redaksional

Për mëse dy dekada tashmë, “tranzicioni” është kthyer në term kyç të studimeve të shoqërive të vendeve ish-komuniste. Me “tranzicion” është kuptuar shumëçka, fillimisht kalimi –me gjithë transformimet që e shoqërojnë—nga sistemet politike njëpartiake dhe autoritare drejt sistemeve demokratike, nga ekonomi të centralizuara në ekonomi tregu, nga shoqëri dhe tregje të mbyllura në shoqëri dhe tregje të hapura, e më së fundmi termi ka filluar të përdoret për t’iu referuar edhe procesit të integritimit të vendeve të Europës Juglindore/Ballkanit Perëndimor. Kështu, tranzicioni i referohet një numri të madh procesesh politike, shoqërore, ekonomike e madje dhe kulturore, duke u bërë kështu sinonim për “ndryshim” dhe “reformë”. Nga ana teorike, literatura mbi tranzicionin dhe demokratizimin ka nxjerrë një numër hipotezash, tashmë të pranuar gjerësisht, që e lidhin procesin e tranzicionit me faktorët e brendshëm shoqërorë, si kultura politike, trashëgimia historike, formësimi i elitave, zhvillimi ekonomik dhe industrial etj. Ky numër i revistës e drejton shikimin te një

* Odeta Barbullushi ka fituar gradën PhD në Studime Ruse dhe të Europës Lindore/Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti i Birminghamit, Britani e Madhe. Ka një Master në Studime Bashkëkohore Evropiane nga Universiteti i Sussex, Britani e Madhe dhe një tjetër në Marrëdhënie Ndërkombëtare nga Universiteti i Europës Qendrore (CEU), Hungari. Interesat e saj shkencore shtrihen në fushat e Analizës së Politikës së Jashtme; Nacionalizmi dhe ideologjitë e tjera politike në Europën Juglindore; Qasjet Kritike dhe poststrukturaliste në Marrëdhëniet Ndërkombëtare; Politika e BE-së në Ballkan dhe Mesdhe; Metodat e Kërkimit në Shkencat Sociale etj. Aktualisht është Përgjegjëse Departamenti e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Europian të Tiranës si dhe kryeredaktore e revistës *Polis*.

aspekt jo fort i diskutuar dhe aq më pak i teorizuar, të tranzicionit: të ndryshimet që transformimet e dy dekadave të fundit kanë sjellë në shkencat sociale shqiptare.

Shkencat sociale shqiptare po kalojnë një tranzicion të shumëfishtë, që ka të bëjë me të paktën tri zhvillime kyçe: së pari, çideologjizimi i teksteve të mësimdhënies dhe të procesit të mësimt. Kjo do të thotë, rrjedhimisht, dhe një ndarje mes politikës dhe arsimit/edukimit, ndarje e cila ishte e paimagjinueshme për sistemin arsimor të para viteve '90. Së dyti, ndryshimin radikal të kurriculave dhe metodave të mësimdhënies, ndryshim i cili bazohet në një të kuptuar të ndryshëm të funksioneve të mësimdhënies dhe me gjerësisht, universitetit. Së fundmi, reforma në kuadër të procesit të Bolonjës dhe hapja e universiteteve private e cila përkon me liberalizimin më të thellë ekonomik. Këto transformime, sa institucionale aq dhe përmbajtësore, kanë ndikuar pashmangshmërisht dhe mënyrën e studimit dhe të analizimit të tranzicionit, të zhvillimeve politike dhe sociale të dy dekadave të fundit, e deri dhe rolin e punonjësit shkencor ose pedagogut. Ky numër i *Polis* pasqyron pikërisht këtë shkallë më të madhe reflektiviteti ndaj lidhjes mes dijes akademike dhe praktikave politike, sociale e juridike të tranzicionit.

Në diskutimin e tij teorik, Fatos Tarifa, shqyrton hipotezat e ndryshme të gjeneruara nga tri modelet teorike, të bazuara në eksperiencat e vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore: të kapitalizmit politik, të tranzicionit të tregut, si dhe e klasës teknokratike-menaxheriale. Të tri këto modele janë shqyrtuar në mënyrë kritike, duke nxjerrë në pah kufizimet metodologjike dhe empirike të këtyre modeleve. Artikulli i Tonin Gjuraj është një kritikë e mprehtë dhe e mirinformuar e një lidhjeje, që për shumë studiues të tranzicionit dhe demokratizimit, merret si e mirëqenë: lidhja pozitive mes forcimit dhe konsolidimit të shoqërisë civile dhe konsolidimit të demokracisë së një vendi. Gjuraj argumenton bindshëm se në nivelin empirik kjo lidhje është problematike. Kështu, ndërsa funksioni i shoqërisë civile në shoqëritë demokratike—ose në proces të tranzicionit demokratik—është të kritikuarit dhe të “kontrolluarit” e elitës politike, ky funksion është përmbysur në rastin e Shqipërisë postkomuniste. Gjuraj sugjeron që shoqëria civile jo vetëm që ka përvetësuar logjikën dhe praktikën e “politikës”, por është bërë pjese e “klasës politike”. Rrjedhimisht, funksioni kritik i saj ka humbur. Po ashtu, një tjetër hipotezë bazë e studimeve të tranzicionit dhe demokratizimit, siç është lidhja mes pjesëmarrjes së të rinjve në politikë dhe konsolidimit të demokracisë, është testuar dhe problematizuar në shkrimin e Ermira Danajt dhe Klejd Këlliçit. Danaj dhe Këlliçi sugjerojnë që për të rinjtë shqiptarë, pjesëmarrja në politikë do të thotë ngushtësisht “vota e hedhur” dhe nuk përfshin forma të tjera të angazhimit civil.

Tri kontribute mbi debatet aktuale të disiplinave të ndryshme të shkencave sociale shqiptare vijnë nga Enika Abazi, Eneida Tarifa & Emiljano Llazo dhe Nebi Bardhoshi. Shkrimi i Enika Abazit ngre shqetësimin në lidhje me

çideologjizimin dhe ngritjen e nivelit shkencor si të teksteve shkollore ashtu dhe punimeve kërkimore shqiptare të pas viteve 90. Abazi argumenton se me gjithë depolitizimin e punës kërkimore, metoda përshkruese dhe historiciste vazhdon të mbizotërojë mbi atë analitike. Shkrimi i Eneida Tarifës dhe Emiljano Llazos është një analizë e rolit të sociologjisë publike për të zgjidhur probleme sociale. Tarifa dhe Llazo argumentojnë se sociologjia publike ka fuqinë dhe mundësinë për të qenë dhe shkencore dhe sociale në të njëjtën kohë. Kështu, roli i sociologut publik do të mund të ishte jo vetëm mësimdhënia dhe edukimi, por dhe ndikimi në zgjidhje të problemeve sociale, por pa kompromentuar autonominë shkencore. Kontributi i Nebi Bardhoshit është një reflektim kritik mbi debatin aktual të disiplinës së antropologjisë sociale në Shqipëri. Bardhoshi përvijëzon pozicionet kryesore teorike të antropologjisë shqiptare. Ai sugjeron që antropologët shqiptarë ta hedhin shikimin përtej së kaluarës dhe punës kërkimore mbi origjinalen kombëtare apo tradicionalen, dhe ta zhvendosin vëmendjen mbi pasojat që ka lënë moderniteti shqiptar, ose thënë ndryshe, efektet e krijimit të shtetit-komb dhe të politikave të tij.

Pikërisht, mbi efektet e shtetformimit dhe të modernizimit e demokratizimit të tij fokusohen dhe shkrimet e Arbër Gjetës dhe Klementin Miles. Punimi i Gjetës hulumton modelet dhe format e ndryshme juridike që ka adoptuar shteti shqiptar që në momentin e krijimit e deri më tash, duke nxjerrë kështu në pah tranzicionin e vazhdueshëm të ngrehinës juridike të shtetit shqiptar. Megjithëse vjen nga shkencat juridike, ky punim na drejton vëmendjen për nga implikimet më të gjera politike e sociale të kësaj mbivendosjeje, përplasjeje e transformim të vazhdueshëm të modeleve juridike të shtetit shqiptar. Shkrimi i Klementin Miles nxjerr në pah mungesën e debatit që ekziston në Shqipëri në lidhje me integrimin europian. Mile sugjeron që integrimi është kthyer në një lloj ideologjie të re shtetërore, të padiskutuar dhe të pakundërshtueshme. Ai rekomandon që disa nga aspektet e integritimit, siç është “transplantimi” i normave, ligjeve dhe institucioneve t’i nënshtrohet një debati të gjerë kritik, fillimisht brenda shkencave sociale e më gjerë.

Ky vëllim ka tri kontribute të vyera: Pikësëpari, ai duhet parë si një prodhim i brendshëm (lokal) akademik dhe intelektual i shkencave sociale në vendet e Europës Lindore dhe Perëndimore. Shumica e kontributeve, në një formë ose në një tjetër testojnë hipoteza të bazuara në eksperiencën joshqiptare, mbi rastin shqiptar. Kështu, vëllimi mund të shihet si provë që në të ardhmen e afërt, studentët shqiptarë apo ata të vendeve të Europës Juglindore nuk do të mësojnë mbi tranzicionin e shoqërive të tyre vetëm nëpërmjet punimeve të autorëve nga universitetet e Europës Perëndimore/Veriore.

Së dyti, kjo përmbledhje problematizon marrëdhënien mes prodhimit akademik, dijes dhe nxënies në universitet, në njërën anë, dhe transformimeve politike e sociale të dy dekadave të fundit, në anën tjetër. Në këtë kuptim, autorët këtu nuk

marrin përsipër të reflektojnë vetëm mbi gjendjen aktuale të tranzicionit shqiptar, por gjithashtu—dhe në të vërtetë, kryesisht—mbi gjendjen aktuale të disiplinave të shkencave sociale.

Së fundmi, por jo me më pak vlerë është dhe bashkëkohësia e botimit të këtij numri. Kjo përmbledhje artikujsh vjen në kohën e duhur për dy arsye kryesore: pikësëpari, nga ana simbolike, vjeshta 2010 përbën për shqiptarët dhe një përvjetor të rëndësishëm të ndërrimit të sistemeve dhe fillimit të rrugës së gjatë të demokratizimit. Në një rrafsh tjetër, Shqipëria është bërë tashmë anëtare e NATO-s, ka institucionalizuar ngushtë marrëdhënien me BE-në dhe ka bërë hapa të rëndësishëm në konsolidimin e institucioneve dhe liberalizimin e tregut. Në këtë kuptim, ky mund të jetë momenti më i mirë për të pyetur: *A mbaroi (më në fund) tranzicioni?*

Tranzicioni dhe riprodhimi i elitës në Shqipëri: Hipoteza të testueshme për një sintezë teorike^{**}

Fatos Tarifa^{*}

Abstrakt

Me shembjen e socializmit shtetëror në Europën Qendrore dhe Lindore dhe në ish-Bashkimin Sovjetik nisi një debat i gjallë teorik mbi atë se cilët individë dhe grupe shoqërore do të dilnin të fituar nga tranzicioni prej socializmit në kapitalizëm si edhe mbi fatin e elitës së vjetër komuniste. Në këtë artikull analizojmë tri ndër teoritë kryesore që u ofruan në këtë debat: teorinë e kapitalizmit politik, teorinë e tranzicionit të tregut dhe teorinë e klasës teknokratike-menaxheriale. Ne argumentojmë se të trija këto teori niseshin nga hipoteza se kapitalizmi ishte destinacioni i vetëm i të gjitha vendeve ish-socialiste dhe se të gjitha këto vende do të ndiqnin një rrugë të vetme për të arritur në këtë destinacion. Hipoteza të tilla nuk kanë gjetur mbështetje empirike. Ne përpigemi të zhvillojmë një sintezë të të trija teorigjive të sipërpërmendura në një teori të menaxherializmit postkomunist si një alternativë të mundshme, duke sugjeruar se në vend të një teorie të vetme të tranzicionit dhe të riprodhimit të elitës në shoqëritë postkomuniste, do të ishte më e dobishme të flitej për një teori të tranzicioneve të krabasuar, e cila të sintetizojë teorikisht përvojat e të gjitha vendeve në tranzicion.

^{*} Fatos Tarifa është Drejtor i Institutit të Studimeve Sociale dhe të Politikave pranë Universitetit European të Tiranës. Ai ka fituar një doktoratë në shkencat politike nga Universiteti i Tiranës dhe një PhD në sociologji nga Universiteti i Karolinës së Veriut në Chapel Hill (SHBA). Tarifa është autor i 30 librave dhe i mbi 70 artikujve studimorë, 50 prej të cilëve të botuar në revista akademike amerikane dhe europiane. Ai është, gjithashtu, themeluesi dhe kryeredaktor i revistës *Sociological Analysis*.

^{**} Ky punim është referuar në Konferencën Kombëtare “Shkencat Sociale dhe Shoqëria Shqiptare në Tranzicion”, organizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Politikave dhe Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin European të Tiranës (UET), më 19 nëntor 2010.

Shembja e komunizmit në Bashkimin Sovjetik dhe në Europën Lindore shënoi një dukuri unike në historinë e qytetërimit modern: për të parën herë kapitalizmi filloi të krijohej *pa kapitalistë* (Szelenyi & Glass 2003: 75). Në fund të viteve 1980 dhe në fillim të viteve 1990, shumë sociologë dhe studiues të tranzicionit demokratik filluan të argumentojnë se cili do të ishte fati i elitës komuniste pas shembjes së sistemit dhe cila shtresë shoqërore do ta zëvendësonte atë si elita e shoqërisë postkomuniste. Tri teori kanë dominuar në tregun e ideve, të cilat mund t'i quajmë: (1) *teoria e kapitalizmit politik*; (2) *teoria e tranzicionit të tregut* dhe (3) *teoria e klasës teknokratike-menaxheriale*.

E para sugjeron se shoqëritë postkomuniste do të zhvilloheshin (ose janë zhvilluar) si një formë e kapitalizmit politik, në të cilën nomenklatura e dikurshme komuniste do t'u përshtatej kushteve të reja për t'u bërë *borgjezia e re* e këtyre vendeve. Sipas kësaj teorie, ata individë, të cilët, në socializëm, zotëronin formën më të çmuar të kapitalit—kapitalin politik—do të mund ta shndërronin lehtësisht atë në *kapital ekonomik* gjatë periudhës së tranzicionit.

Teoria e dytë sugjeron se me krijimin dhe zgjerimin e tregut të lirë, pushteti i *nomenklaturës komuniste* do të binte, për t'u zëvendësuar nga pushteti i një grupi të ri aktorësh në jetën ekonomike dhe politike të shoqërisë, të cilët, së bashku, do të krijonin *elitën postkomuniste*. Sipas kësaj teorie, tranzicioni në ekonominë e tregut do ta zhvlerësonte kapitalin politik dhe, në vend të tij, rëndësi më të madhe do të merrte *kapitali njerëzor*, si burim për akumulimin e kapitalit ekonomik.

Teoria e tretë, e zhvilluar kryesisht në fillim të viteve 1990, mund të konsiderohet si një version i teorisë së kapitalizmit politik. Sipas saj, elita e dikurshme komuniste, në tërësi, *nuk* u transformua në borgjezinë e re. Një pjesë e saj, duke shfrytëzuar pozitën menaxheriale, arriti ta shndërrojë pronën publike në pronë private të kontrolluar prej tyre. Me fjalë të tjera, nomenklatura e dikurshme komuniste u përpoq—dhe në rrethana të caktuara arriti—që *kapitalin politik* ta shndërrojë në burim të *kapitalit ekonomik*.

Këto tri teori janë testuar empirikisht në disa prej vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore si, në Poloni, në Hungari, në Republikën Çeke, në Sllovaki, në Bullgari dhe në Rusinë e sotme (Treiman & Szelenyi 1993; Szelenyi, Lipinski & Treiman 1995; Hanley & Treiman 2003; 2004; Szelenyi & Kostello 1996). Ndërkaq, në Shqipëri, ende deri më sot nuk është kryer ndonjë studim mbi zëvendësimin e elitës komuniste ose mbi krijimin e elitës së re. Në këtë esë, pa marrë përsipër të studiojmë fenomenin në fjalë, ne propozojmë si një hipotezë të mundshme dhe të verifikueshme empirikisht atë, sipas të cilës, në kushtet e Shqipërisë, ashtu si edhe në disa vende të tjera postkomuniste, është e mundur—dhe e dobishme—të formulohet një sintezë e teorisë të mësipërme, si një alternativë më e mirë për të shpjeguar se:

(a) Tranzicioni në ekonominë e tregut nuk ka qenë thjesht transformim i pronës publike në pronë private;

(b) Pushteti i elitës postkomuniste buron nga—dhe konsiston—jo vetëm në kapitalin ekonomik, por edhe në një kombinim të kapitalit kulturor dhe atij social;

(c) Galeria e borgjezisë së re postkomuniste përbëhet jo vetëm nga “kleptokracia” e *nouveaux riches*, por edhe nga një grup i gjerë menaxherësh jopronarë dhe biznesmenësh të mesëm.

Çdonjëra prej teorive të sipërpërmendura ofron një numër hipotezash interesante lidhur me çështjen e transformimit të *strukturës sociale* dhe të riprodhimit ose të krijimit të elitave drejtuese në shoqëritë postkomuniste. Sidoqoftë, siç përpiqemi të argumentojmë më poshtë, asnjëra prej hipotezave që ato ofrojnë nuk përbën, në vetvete, një mënyrë koherente për të shpjeguar fenomenet në fjalë. Në këtë ese analizojmë, në vija të përgjithshme, përmbajtjen e çdonjërës prej teorive të sipërpërmendura, si edhe përpiqemi të argumentojmë pse, për të evituar mangësitë e këtyre teorive, një sintezë e tyre në një teori të vetme mund të ishte më e dobishme.

Teoria e kapitalizmit politik

Në fillim të viteve 1990, dy sociologë të njohur, Elemer Hankiss (1990), në Hungari, dhe Jadwiga Staniszkis (1991a, 1991b), në Poloni, në mënyrë të pavarur prej njëri-tjetrit argumentuan se, në fillimet e tranzicionit postkomunist në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, nomenklatura komuniste do ta përdorte pushtetin politik për ta shndërruar një pjesë të madhe të pronës *publike* në pronë *private* në duart e anëtarëve të saj, duke formuar, në këtë mënyrë, klasën e borgjezisë së re në të gjitha këto vende. Ky argument ngjalli në ato vite një interesim të madh dhe eventualisht u bë i njohur si *teoria e kapitalizmit politik*.

Hankiss dhe Staniszkis evidentuan se, qysh në vitet 1980, në Hungari dhe në Poloni, nomenklatura komuniste kishte filluar të krijonte ura lidhëse me ekonominë private. Ky proces kishte nisur të realizohej në disa mënyra, por, kryesisht, përmes akumulimit të kapitalit në sferën e konsumit, në tregun e pronësisë mbi tokën dhe mbi banesat (*real estate*), i cili në vitet 1970 dhe 1980, kishte njohur një bum të madh. Anëtarë të nomenklaturës komuniste nisën të blejnë me çmime shumë të ulëta tokë për të ndërtuar shtëpi luksoze për familjet e tyre. Kur sistemi komunist u shemb, në sferën joproduktive të ekonomisë ishte akumuluar tashmë një kapital potencial (i konvertueshëm) shumë i madh, pjesa kryesore e të cilit ishte në duart e nomenklaturës së dikurshme. Po kështu, një pjesë e madhe e fëmijëve të kuadrove të larta të Partisë dhe të shtetit komunist kishin nisur me kohë aktivitete biznesi privat në të ashtuquajturën “second economy”.¹ Në këtë mënyrë, një pjesë e konsiderueshme e pasurisë kombëtare në Hungari dhe në Poloni ishte *rishpërndarë* jashtë sferës produktive *përpara* shembjes së komunizmit.

Në gjysmën e dytë të viteve 1980, sociologët hungarezë Robert Machin dhe Ivan Szelenyi (1987) kishin argumentuar se reformimi i ekonomisë hungareze si një ekonomi e tregut të lirë do të ishte një proces nga i cili më shumë do të përfitonin kuadrot dhe intelektualët komunistë, sesa qytetarët e thjeshtë. Ata vunë re se qysh në fillim të viteve 1980, një pjesë e kuadrove të Partisë dhe të shtetit kishin filluar

¹ Për një informacion dhe trajtim interesant mbi akumulimin e kapitalit nga ana e nomenklaturës komuniste në periudhën para dhe gjatë tranzicionit shih, gjithashtu, Windolf (1988).

t'i largoheshin sferës politike për të krijuar mundësi për biznese private (Manxhin & Szelenyi 1987; Kryshtanovskaya & White 1996: 716-721; Tarifa 1998). Deri në vitin 1988, në ekonominë hungareze dhe në atë polake nuk ishte tipike krijimi i firmave private *per se*, por ngritja e “ndërmarrjeve publike”, bazuar në ligje të paqarta mbi të drejtën e pronësisë mbi to. Reforma e vërtetë ekonomike në Hungari nisi në vitin 1988, me fillimin e “privatizimit” të ndërmarrjeve publike (Windolf 1998: 344-350). Ky proces “privatizimi spontan” u parapri dhe u ndihmua nga një legjislacion i hartuar në mënyrë të tillë, që t’u mundësonte nomenklaturës dhe, veçanërisht drejtuesve të ndërmarrjeve publike, t’i shndërronin ato në pronë private. Këtë proces privatizimi “nga brenda”, Frydman *et al* (1996) e kanë quajtur “capitalism with a comrade’s face”.

Teoria e kapitalizmit politik parashtron dy hipoteza bazë:

Hipoteza 1: Ata individë që kishin pozita të rëndësishme në hierarkinë politike në sistemin komunist kishin më shumë të ngjarë të bëheshin pjesë e borgjezisë së re që u pasurua me reformën ekonomike;

Hipoteza 2: Kapitali i tyre politik do të konvertohej në kapital ekonomik pa hasur shumë pengesa; me fjalë të tjera, fakti i të qenit anëtar i Partisë Komuniste do ishte një tregues i rëndësishëm për të parashikuar nëse dikush do të zinte një pozitë të rëndësishme në sistemin e ri ekonomik.

Teoria e tranzicionit të tregut

Në vitin 1989, sociologu Victor Nee, profesor në Cornell University, botoi në *American Sociological Review* (Nee 1989), një artikull shumë të rëndësishëm mbi dinamikën dhe pasojat sociale të tranzicionit nga socializmi në tregun kapitalist.² Nee sugjeroi se tranzicioni nga një ekonomi e centralizuar në ekonominë e tregut do të rriste vlerën e kapitalit *njerëzor*, ndërkohë që privilegjet, të cilat buronin nga zotërimi i kapitalit politik, do të humbitnin rëndësinë e tyre. Shkurt, kjo teori parashtron tri hipoteza bazë:

Hipoteza 3: Individët që kishin qenë pjesë e elitës përpara shembjes së komunizmit kishin më shumë të ngjarë të zbrisnin (jo të ngjiteshin) në piramidën e stratifikimit social në periudhën postkomuniste;

Hipoteza 4: Individët që nuk kishin qenë anëtarë të elitës në periudhën komuniste kishin më shumë mundësi të bëheshin pjesë e klasës së pronarëve dhe e elitës së re ekonomike në periudhën postkomuniste;

Hipoteza 5: Anëtarësia e dikurshme në Partinë Komuniste do të shndërrohej në një faktor pengues për t’u bërë pjesë e elitës së re, ndërsa, përkundrazi, *niveli arsimor* do të ishte një faktor suksesi—sidomos në fushën e ekonomisë—pothuajse në të gjitha vendet që hynë në rugën e transformimit postkomunist.

² Për një trajtim më të zgjeruar të teorisë së tranzicionit të tregut, parashtruar në këtë artikull nga Victor Nee, shih Szelenyi & Kostello (1996).

Teoria e klasës teknokratike-menaxheriale

Zhvillimet e dekadës së parë të tranzicionit postkomunist evidentuan, pothuajse në të gjitha vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, se *teoria e kapitalizmit politik* i kishte ekzagjeruar përfitimet që do të kishte nomenklatura komuniste, në tërësi, nga tranzicioni në ekonominë e tregut. Po kështu, edhe *teoria e tranzicionit të tregut* nuk kishte arritur të parashikonte avantazhet që do krijonte tregu kapitalist në këto vende për shtresën e re teknokratike-menaxheriale, e cila është bërë kudo pjesë e elitës postkomuniste. Si përgjigje ndaj kufizimeve të këtyre teorive, në vitet 1990 nisi të formulohej—dhe gjeti mbështetje empirike—një tjetër teori, e cila mund të quhet *teoria e klasës teknokratike-menaxheriale*. Kjo teori, e formuluar kryesisht nga sociologu anglez David Lane, i kushton më shumë vëmendje *diferencimit të brendshëm* në radhët e nomenklaturës komuniste dhe argumenton se, ajo shtresë shoqërore që ka përfituar më shumë nga tranzicioni postkomunist është elita menaxheriale-teknokratike (Lane 1997, 2000; Lane & Ross 1999).

Sipas kësaj teorie, gjatë periudhës së tranzicionit, pjesa *burokratike* e nomenklaturës së dikurshme komuniste do të humbiste pozitën e privilegjuar të saj, ndërkohë që elita *teknokratike-menaxheriale* do të përfitonte më shumë nga privatizimi i ekonomisë publike, duke u shndërruar në borgjezinë e madhe në periudhën postkomuniste. Një numër autorësh (si Frydman et al. 1993, 1996; Rona-Tas 1998; Walder 1995, 1996, etj), e argumentuan dhe e zhvilluan më tej teorinë e klasës teknokratike-menaxheriale në vitet 1990. Sipas tyre, drejtuesit e ndërmarrjeve publike dhe anëtarët e tjerë të shtresës së teknokratëve do të përdornin *lidhjet shoqërore* dhe *kapitalin politik* të tyre për ta shndërruar pronën publike në pronë private për ata vetë dhe për familjet e tyre (shih Kryshstanovskaya & White 1996: 716-721).

Në mënyrë të përmbledhur, kjo teori parashtron dy hipoteza bazë:

Hipoteza 6: Në shoqërinë postkomuniste ishin teknokratët dhe menaxherët e dikurshëm ata që do të bëheshin klasa e re e pronarëve dhe që do të kishin pozita dominuese në rendin e ri ekonomik;

Hipoteza 7: Kjo shtresë njerëzish do të përdornin më shumë lidhjet e tyre shoqërore dhe kapitalin politik të akumuluar në saje të pozitës së tyre të privilegjuar, sesa kapitalin e tyre njerëzor për të fituar pozitën e tyre në shoqërinë e re të tregut. Me fjalë të tjera, ndërveprimi midis pozitës së dikurshme të kuadrove teknokrate me faktin e të qenit anëtarë të Partisë Komuniste do të ishte tepër *pozitiv* dhe *shumë i rëndësishëm*.

Mbështetja empirike për teoritë e mësipërme

Për të provuar empirikisht hipotezat që rezultojnë nga tri teoritë e mësipërme, të cilat, në fund të viteve 1980 dhe në fillim të viteve 1990 kishin bërë vend gjerësisht në literaturën mbi tranzicionin postkomunist, të prodhuar si në Perëndim, ashtu edhe në Lindje, autorë të ndryshëm kanë ndërmarrë studime empirike në disa prej vendeve ish-komuniste, si Rusia, Polonia, Hungaria, Republika

Çeke dhe Bullgaria (shih Aslund 1994; Atkinson & Micklewright 1992; Webster 1992; Treiman & Szelenyi 1993; Szelenyi et al. 1995; Hanley & Treiman 2003; 2004; Domański & Heyns 1995; Heyns 1998), madje edhe në Kinë (Jefferson & Rawski 1994; Karmel 1994; Keister 1998; Naughton 1995).

Metodologjia e përdorur në këto studime ka qenë *tipikisht sociologjike* dhe mund të përdoret deri diku me efikasitet edhe në kushtet e Shqipërisë, në një studim që planifikon të ndërmarrë Instituti i Studimeve Sociale dhe të Politikave në Universitetin Europian të Tiranës. Në disa prej studimeve të përmendura më sipër (shih veçanërisht Treiman & Szelenyi 1993; Szelenyi et al. 1995; Hanley & Treiman 2003; 2004), për çdonjërin nga vendet në shqyrtim janë hartuar lista me emrat e atyre individëve, të cilët, në vitin 1988 (për Shqipërinë ky vit mund të ishte viti 1990), bënë pjesë në “nomenklaturën qendrore”, pra, kishin një pozitë që kërkonte miratimin e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste. Lista analoge u krijuan prej tyre edhe në vitin 1993. Nga të dy listat është zgjedhur një “sample” rastësor, i cili, për çdo vend të veçantë, përfshinte afërsisht 1,000 respondentë nga radhët e elitës së vjetër dhe të re (shifër kjo, e cila përfaqësonte afërsisht 10 deri 30 për qind të të gjithë atyre që në të kaluarën zinin pozita të larta në çdo vend). Në këtë mënyrë, autorët e këtyre studimeve kanë mundur të krijojnë një ide pak a shumë të qartë, nga njëra anë, mbi *fatet* profesionale dhe *pozitën* e ardhshme sociale të atyre që kishin pasur pozita drejtuese në radhët e nomenklaturës komuniste në vitin 1988 dhe, nga ana tjetër, mbi *origjinën* shoqërore dhe profesionale të atyre që u bënë pjesë e elitës postkomuniste në vitin 1993. Mbështetur në këtë data-base, Szelenyi, Treiman, Hanley dhe sociologë të tjerë, janë përpjekur t’u japin përgjigje një vargu çështjesh që kanë të bëjnë me *qarkullimin* dhe *riprodhimin* e elitave gjatë tranzicionit në ekonominë e tregut (shih, ndër të tjera, Szelenyi et al. 1995; Eyal et al. 1998; Hanley & Szelenyi 2001). Sidoqoftë, të dhëna për të gjitha këto vende, të marra së bashku, janë publikuar për herë të parë nga Szelenyi dhe Glass (2003), duke mundësuar kështu një analizë krahasuese.

Gjetjet kryesore të këtyre studimeve mbi *destinimin* profesional, më 1993, të individëve që ishin pjesë e nomenklaturës në vitin 1988, në çdonjërin nga vendet e studiuara, jepen në mënyrë të përmbledhur në tabelat 1-5. Gjetjet kryesore të këtyre studimeve mbi *origjinën* profesionale, më 1988, të anëtarëve të elitës së re ekonomike dhe politike më 1993, në çdonjërin nga vendet e studiuara, jepen në mënyrë sistematike dhe të përmbledhur në tabelat 6-10.³

³ Të dhënat e pasqyruara në tabelat 1-5 dhe 6-10 janë marrë nga Szelenyi & Glass (2003).

Tabela 1

Destinimi profesional më 1993 i individëve që bënin pjesë në nomenklaturën ekonomike dhe politike në vitin 1988 në *Bullgari*

Pozita më 1988			
Pozita më 1993	Elitë ekonomike, 1988	Elitë politike, 1988	Tjetër, 1988
Elitë ekonomike	73.17	25.62	26.95
Elitë politike	5.50	26.74	17.68
Tjetër	21.33	47.64	55.38
Total	100% (600)	100% (445)	100% (809)

Tabela 2

Destinimi profesional më 1993 i individëve që bënin pjesë në nomenklaturën ekonomike dhe politike në vitin 1988 në *Republikën Çeke*

Pozita më 1988			
Pozita më 1993	Elitë ekonomike, 1988	Elitë politike, 1988	Tjetër, 1988
Elitë ekonomike	85.85	22.15	61.93
Elitë politike	4.52	25.32	16.43
Tjetër	9.63	52.53	21.64
Total	100% (1,173)	100% (158)	100% (633)

Tabela 3

Destinimi profesional më 1993 i individëve që bënin pjesë në nomenklaturën ekonomike dhe politike në vitin 1988 në *Hungari*

Pozita më 1988			
Pozita më 1993	Elitë ekonomike, 1988	Elitë politike, 1988	Tjetër, 1988
Elitë ekonomike	74.61	20.09	30.47
Elitë politike	3.77	35.90	12.68
Tjetër	21.63	44.02	56.85
Total	100% (823)	100% (234)	100% (686)

Tabela 4

Destinimi profesional më 1993 i individëve që bënin pjesë në nomenklaturën ekonomike dhe politike në vitin 1988 në *Poloni*

Pozita më 1988			
Pozita më 1993	Elitë ekonomike, 1988	Elitë politike, 1988	Tjetër, 1988
Elitë ekonomike	79.07	23.50	23.24
Elitë politike	5.17	27.82	25.59
Tjetër	15.76	48.68	51.17
Total	100% (793)	100% (417)	100% (555)

Tabela 5

Destinimi profesional më 1993 i individëve që bënë pjesë në nomenklaturën ekonomike dhe politike në vitin 1988 në *Rusi*

Pozita më 1988			
Pozita më 1993	Elitë ekonomike, 1988	Elitë politike, 1988	Tjetër, 1988
Elitë ekonomike	83.83	36.94	30.74
Elitë politike	9.41	48.95	15.37
Tjetër	6.77	14.11	53.89
Total	100% (606)	100% (666)	100% (540)

Tabela 6

Origjina profesionale më 1988 e anëtarëve të elitës së re ekonomike dhe politike në vitin 1993 në *Bullgari*

Pozita më 1993			
Pozita më 1988	Elitë e re ekonomike	Elitë e re politike	Tjetër
Elitë ekonomike	56.94	11.19	16.24
Elitë politike	14.69	40.34	26.90
Tjetër	28.27	48.47	56.85
Total	100% (771)	100% (295)	100% (788)

Tabela 7

Origjina profesionale më 1988 e anëtarëve të elitës së re ekonomike dhe politike në vitin 1993 në *Republikën Çeke*

Pozita më 1993			
Pozita më 1988	Elitë e re ekonomike	Elitë e re politike	Tjetër
Elitë ekonomike	70.22	26.90	33.93
Elitë politike	2.44	20.30	24.92
Tjetër	27.34	52.79	41.14
Total	100% (1,434)	100% (197)	100% (333)

Tabela 8

Origjina profesionale më 1988 e anëtarëve të elitës së re ekonomike dhe politike në vitin 1993 në *Hungari*

Pozita më 1993			
Pozita më 1988	Elitë e re ekonomike	Elitë e re politike	Tjetër
Elitë ekonomike	70.57	15.35	26.53
Elitë politike	5.40	41.59	15.35
Tjetër	24.02	43.07	58.12
Total	100% (870)	100% (202)	100% (671)

Tabela 9

Origjina profesionale më 1988 e anëtarëve të elitës së re ekonomike dhe politike në vitin 1993 në *Poloni*

Pozita më 1993			
Pozita më 1988	Elitë e re ekonomike	Elitë e re politike	Tjetër
Elitë ekonomike	73.42	13.71	20.42
Elitë politike	11.48	38.80	33.17
Tjetër	15.11	47.49	46.41
Total	100% (854)	100% (299)	100% (612)

Tabela 10

Origjina profesionale më 1988 e anëtarëve të elitës së re ekonomike dhe politike në vitin 1993 në *Rusi*

Pozita më 1993			
Pozita më 1988	Elitë e re ekonomike	Elitë e re politike	Tjetër
Elitë ekonomike	55.22	12.23	9.62
Elitë politike	26.74	69.96	22.07
Tjetër	18.04	17.81	68.31
Total	100% (920)	100% (466)	100% (426)

Të dhënat e përmbledhura në tabelat e mësipërme janë analizuar më tej nga Szelenyi & Glass (2003) në bazë të modelit të regresionit logjistik multinominal⁴ për të treguar sesa e mundur ka qenë mbijetesa për anëtarët e nomenklaturës komuniste në kushtet e shoqërisë postkomuniste. Të dhënat e analizuar në këto studime bëjnë të mundur të *testohet* teoria e kapitalizmit politik, si edhe të krahasohet kapaciteti shpjegues i saj në raport me teorinë e tranzicionit të tregut dhe me teorinë e klasës teknokratike-menaxheriale. Analiza e të dhënave të pasqyruara në tabelat 1-10, provon se Elemer Hankiss (1990) dhe Jadwiga Staniszkis (1991a; 1991b) kishin zbuluar një tendencë *reale* në fillim të viteve 1990, si në Hungari, ashtu edhe në Poloni, pikërisht atë se, pavarësisht ngjarjeve dramatike të vitit 1989 në të gjitha vendet postkomuniste, individët që kishin qenë pjesë e nomenklaturës deri në atë kohë kishin më shumë të ngjarë të mbeteshin pjesë e elitës së re në vitin 1993, sesa të mos ishin pjesë e saj.

Regresioni logjistik multinominal i të dhënave të mbledhura dhe të përpunuara nga Szelenyi dhe Glass (2003) konfirmon Hipotezën 1 të teorisë së kapitalizmit politik, duke ofruar evidencë empirike të konsiderueshme që provon se *në vitet e para të tranzicionit postkomunist elita e dikurshme vazhdoi të riprodhonte vetveten*. Duke mos marrë në konsideratë dallimet midis vendeve të ndryshme postkomuniste, si edhe dallimet midis segmenteve të ndryshme të elitës, rezulton se pjesa më e madhe e individëve që ishin pjesë e elitës në shoqërinë komuniste i ruajtën jo pa

⁴ Rezultatet në fjalë nuk i japim të detajuara në këtë ese.

sukses pozitat e tyre edhe pas përmbysjes së komunizmit (Szelenyi & Glass 2003). Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Hipoteza 1 e teorisë së kapitalizmit politik është krejtësisht e vërtetë pasi, sipas kësaj hipoteze, do të ishin aparatçikët komunistë ata që do të dilnin më të fituarit nga reformat e tranzicionit postkomunist, gjë që nuk ka rezultuar e vërtetë. Për më tepër, kjo teori parashikonte se mekanizmi përmes të cilit elita e shoqërisë komuniste do të arrinte të mbetej, ose të bëhej elitë edhe e shoqërisë postkomuniste, do të ishte aftësia e saj për ta përdorur pushtetin politik për të akumuluar pasuri private, si edhe aftësia e saj për ta konvertuar kapitalin politik të saj në kapital ekonomik (shih Hipotezën 2).

Teoria e kapitalizmit politik nuk arrin të japë një shpjegim të saktë mbi procesin e krijimit të elitave në vendet postkomuniste. Së pari, për vende të tilla si Bullgaria, Hungaria dhe Polonia (unë do të shtoja këtu edhe Shqipërinë dhe Rumaninë, gjë që mbetet të provohet empirikisht), të dhënat dëshmojnë se në krye të hierarkisë shoqërore në këto vende ka pasur turbulenca të theksuara, veçanërisht në radhët e elitës politike, gjë që kundërshton Hipotezën 1 të kësaj teorie. Madje, në dritën e të dhënave empirike mbi të cilat mbështet kjo ese, teoria e kapitalizmit politik rezulton se ka pak aftësi shpjeguese.

Në kundërshtim me atë çfarë përpiqet të shpjegojë kjo teori, të dhënat empirike nga vendet ku është studiuar dukuria e transformimit të elitave dëshmojnë se, me përjashtim të Rusisë, në të gjitha vendet e tjera të Europës Lindore, *pjesa më e madhe e elitës komuniste të dikurshme i ka humbur statusin elitar dhe pozitën e saj të privilegjuar* (shih Higley & Pakulski 1995; Higley et al. 1996). Pothuajse gjysma e atyre që kishin pasur pozita të rëndësishme në organet dhe në institucionet më të larta të Partisë dhe të shtetit komunist në vitin 1988, nuk ishin më në pozita drejtuese dhe nuk gëzonin më status elitar në vitin 1993 (Baylis 1998: 276–280). Shumë prej tyre dolën, ose u nxorën në pension, të tjerë filluan të merren me një profesion ose punë tjetër çfarëdo, ndërsa ata që mundën të ruajnë një status dhe pozitë shoqërore elitare u ndanë përgjithësisht në mënyrë të barabartë në radhët e elitës ekonomike dhe të elitës politike. Në fakt, siç argumentojnë Szelenyi dhe Glass (2003), për dikë që kishte qenë një kuadër i lartë i Partisë ose i shtetit komunist në ish-vendet socialiste të Europës Qendrore dhe Lindore, mbijetesa në kushtet e shoqërisë postkomuniste nuk ka qenë një gjë e lehtë. Shkalla në të cilën një pjesë e madhe e nomenklaturës komuniste u nxor jashtë pozitës elitare në strukturën e re sociale që krijoi periudha e tranzicionit postkomunist, në të gjitha këto vende, provon më shumë Hipotezën 3 të teorisë së tranzicionit të tregut, sesa Hipotezën 1 të teorisë së kapitalizmit politik.

Pavarësisht mangësive që përmban teoria e kapitalizmit politik, hipotezat që rrjedhin prej saj nuk janë krejtësisht pa vlerë dhe, në ato vende ku tranzicioni nga socializmi shtetëror në kapitalizëm ka qenë, ose vazhdon të jetë relativisht i ngadaltë, si në Rusi, në Moldavi, në Gjeorgji ose gjetkë, kjo teori mund të ketë më shumë forcë shpjeguese. Në Rusi, për shembull, vetëm 14 për qind e atyre që bënë pjesë në elitën politike më 1988 nuk ishin më pjesë e elitës së re postkomuniste më 1993 (Lane 1997, 2000; Lane & Ross 1999: 143–166).

Teoria e kapitalizmit politik ofron *një farë* shpjegimi mbi tranzicionin dhe riprodhimin e elitës në postkomunizëm, por supozimet e saj mbi destinacionin

e anëtarëve të nomenklaturës së vjetër janë të ekzagjeruara në tri drejtime: Së pari, riprodhimi i elitës në periudhën e tranzicionit nuk ka qenë uniform; në radhët e elitës ekonomike riprodhimi ishte më i gjerë sesa në radhët e elitës politike, gjë që nuk parashikohet nga teoria në fjalë. Kjo gjetje mbështet Hipotezën 6 të teorisë së klasës teknokratike-menaxheriale më shumë sesa Hipotezën 1 të teorisë së kapitalizmit politik.

Së dyti, të dhënat e përmbledhura në tabelat 1-5 tregojnë një mobilitet social në rënie të anëtarëve të nomenklaturës komuniste, sidomos të kuadrove të larta politike (jo të atyre në pozita menaxheriale në fushën e ekonomisë), fakt ky që, gjithashtu, është inkonsistent me teorinë e kapitalizmit politik dhe mbështet më shumë Hipotezën 3 të teorisë së tranzicionit të tregut.

Së treti, të dhënat tregojnë se *procesi i tranzicionit dhe i riprodhimit të elitave ka variuar dukshëm nga njëri vend postkomunist në tjetrin*. Në Rusi, fjala vjen, elita politike e periudhës komuniste pati më shumë shanse që të mbijetonte në procesin e tranzicionit dhe të zinte pozita kyçe në ekonomi, sesa në vendet e tjera, çka do të thotë se elita komuniste në këtë vend ishte në gjendje të riprodhonte vetveten në një shkallë më të madhe se në vendet e tjera postkomuniste. Kjo gjetje mbështet Hipotezën 1 të teorisë së kapitalizmit politik për rastin e Rusisë, por që ajo të gjejë mbështetje edhe në rastet e vendeve të tjera, në të cilat ky fenomen është studiuar, duhet kombinuar me Hipotezën 3 të teorisë së tranzicionit të tregut dhe me Hipotezën 6 të teorisë së klasës teknokratike-menaxheriale.

Për të kuptuar destinacionin e anëtarëve të elitës së dikurshme komuniste, teoria e tranzicionit të tregut dhe ajo e klasës teknokratike-menaxheriale duket se japin një shpjegim më bindës. Sidoqoftë, edhe këto të fundit kanë si meritat e tyre, ashtu edhe mangësi të dukshme. Teoria e tranzicionit të tregut është kritikuar gjerësisht për disa arsye. Një ndër arsyet është se ajo nuk i kushton rëndësinë e duhur vazhdimësisë së karrierës të individëve në pozitën më të larta të hierarkisë shoqërore nga komunizmi në postkomunizëm (Rona-Tas 1994; Walder 1995, 1996). Andrew Walder (1996), për shembull, në artikullin “Tregu dhe pabarazia në ekonomitë në tranzicion”, botuar në *American Journal of Sociology*, argumenton se *nomenklatura komuniste nuk ka qenë një fenomen i njëtrajtsbëm ose një grup shoqëror me një identitet të vetëm*, çka shpjegon edhe faktin që, në periudhën postkomuniste, anëtarët e saj u gjendën përballë dy trajektoreve të mundshme të mobilitetit social: ata që më parë zinin pozita burokratike në aparatit e Partisë ose të shtetit komunist, pra “të kuqtë”, e humbën statusin e tyre elitë me tranzicionin në kapitalizëm, ndërsa ata që kishin qenë “ekspertë”, mundën të mbijetojnë dhe të bëhen pjesë e elitës së re më shumë se “të kuqtë”.

Pavarësisht kritikave që i janë bërë teorisë së tranzicionit të tregut, të dhënat mbi të cilat jemi mbështetur në trajtimin që i bëjmë kësaj çështjeje e mbështesin në një farë mase këtë teori. Së pari, nga të tri teoritë që kemi marrë në shqyrtim, vetëm teoria e tranzicionit të tregut ofron një shpjegim mbi mobilitetin social në rënie të kuadrove politike gjatë kalimit nga komunizmi në postkomunizëm (shih Hipotezën 3).

Së dyti, si teoria e kapitalizmit politik, ashtu edhe ajo e klasës teknokratike-menaxheriale, e vënë theksin në *konvertueshmërinë* e kapitalit politik dhe i japin një rëndësi shumë të madhe kapitalit social dhe lidhjeve shoqërore në procesin e

akumulimit të kapitalit. Vetëm teoria e tranzicionit të tregut mundi të parashikojë se kapitali *kulturor* do të merrte një rëndësi më të madhe sesa kapitali *politik* dhe ai *social* në periudhën e tranzicionit (shih Hipotezën 5). Të dhënat empirike nuk e mbështesin hipotezën se kapitali politik i dikurshëm do të bëhej një pengesë serioze për një pjesë të madhe të nomenklaturës komuniste që ajo të mbijetonte në kushtet e tranzicionit, pasi, në fakt, *korrelacioni midis të qenit anëtar Partie në vitin 1988 dhe të qenit pjesë e elitës postkomuniste në vitin 1993 rezulton pozitiv dhe i rëndësishëm*. Është me interes të provojmë empirikisht nëse ky përfundim vlen ose jo në rastin e Shqipërisë. Studime të tjera, gjithashtu, vijjnë në të njëjtin përfundim, duke provuar se kapitali kulturor ishte më i rëndësishëm sesa kapitali politik, së paku për sa i përket rekrutimit të individit në pozita elitare ekonomike (Hanley & Szelenyi 2001; Gimpelson 2003).⁵

Së fundi, studime të tjera (Hanley 1997) kanë ofruar mbështetje empirike për Hipotezën 4 të teorisë së tranzicionit të tregut. Për shembull, është evidentuar se pasja e një historie familjare në fushën e prodhimit zejtar ose tjetër dhe ushtrimi i një biznesi privat në ekonominë informale, ose në atë që mund të quhet “second economy”, gjatë periudhës së komunizmit, janë faktorë të rëndësishëm të suksesit ekonomik në periudhën postkomuniste. Edhe pse kjo nuk ka qenë dhe s’mund të ishte e mjaftueshme për t’i bërë individë ose segmente të tilla të shoqërisë pjesë të borgjezisë së madhe që u krijua pas shembjes së komunizmit, një eksperiencë e tillë e ka lehtësuar dhe ndihmuar krijimin e një borgjezie të vogël, pothuajse në të gjitha vendet postkomuniste (Piirainen 2003).

Të dhënat empirike, të cilave u jemi referuar në këtë ese (shih sidomos tabelat 6-10), mbështesin më së shumti hipotezat e formuluar nga teoria e klasës teknokratike-menaxheriale, veçanërisht Hipotezën 6. Gjetja më e rëndësishme nga analiza e të dhënave të prezantuara nga Szelenyi dhe Glass (2003) është se, ata individë, të cilët në vitin 1988 ishin pjesë e elitës ekonomike, kishin një mundësi *17 herë më të madhe* që të bëheshin pjesë e elitës ekonomike në vitin 1993 (ibid). Përveç kësaj, teoria e klasës teknokratike-menaxheriale duket se parashikoi saktë se ajo pjesë e inteligjencies teknokratike, e cila në vitin 1988 i përkiste moshës së mesme, do të ishte shtresa që do të përfitonte më shumë nga tranzicioni postkomunist (Steen 1997: 107-111).

Teoria e klasës teknokratike-menaxheriale duket se i eviton mangësitë e dy teorive të tjera, por as kjo teori nuk është pa probleme. Për shembull, me përjashtim të Rusisë, në të gjitha vendet e tjera postkomuniste, gati gjysma e individëve që përbënin elitën politike në këto shoqëri në vitin 1988 e kishin humbur përfundimisht pozitën e privilegjuar politike të tyre në vitin 1993. Kjo nuk është njëlloj e vërtetë për ata individë, të cilët, në vitin 1988 kishin pozita drejtuese menaxheriale. Në Bullgari dhe në Hungari, për shembull, vetëm 20 për qind e tyre e humbën, 5 vjet më vonë, pozitën që kishin pasur; në Poloni afro 15 për qind, në Republikën Çeke dhe në Rusi më pak se 10 për qind (Szelenyi & Glass 2003; Lane 1999: 167-182). Për më tepër, në të gjitha vendet e marra në shqyrtim, gati një e katërta e atyre që formuan

⁵ Për një trajtim më të zgjeruar mbi rëndësinë e arsimit në riprodhimin dhe qarkullimin e elitës gjatë tranzicionit shih, gjithashtu, Baylis (1998: 287-282), Kryshtanovskaya & White (1996: 726-727) dhe Lengyel (1998: 203-204).

elitën e re ekonomike postkomuniste nuk kishin pasur ndonjë pozitë drejtuese në ekonomi para vitit 1988. Në radhët e elitës së re ekonomike hynë edhe shumë individë të rinj në moshë, të cilët, pikërisht për shkak të moshës së tyre, nuk kishin qenë pjesë e elitës ekonomike në komunizëm (Baylis 1994: 319). Në radhët e kësaj elite u përfshinë, gjithashtu, edhe shumë individë me profesione të ndryshme, të cilët krijuan bizneset e tyre private pas vitit 1989, ashtu si edhe individë të tjerë, të cilët, në periudhën para këtij viti, kishin ushtruar biznese të vogla private në ekonominë informale, por që e zgjeruan aktivitetin e tyre ekonomik gjatë tranzicionit. Të dhënat dëshmojnë se struktura sociale e shoqërive postkomuniste nuk u riprodhuan në atë mënyrë që parashikonte teoria e klasës teknokratike-menaxheriale, çka lë vend për ta korrigjuar atë.

Së fundi, si teoria e tranzicionit të tregut, ashtu edhe teoria e klasës teknokratike-menaxheriale presupozojnë se elita e vjetër komuniste do të kishte një destinacion të vetëm, madje edhe se mënyra për të riprodhuar vetveten në kushtet e postkomunizmit do të ishte e njëjtë. Përvoja e këtyre 20 vjetëve tregon se, pavarësisht ngjashmërive që ka tranzicioni postkomunist në të gjitha vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, këto vende kanë ecur dhe vazhdojnë të zhvillohen në rrugë të ndryshme (Brzezinski 1993; Tarifa 1998; White 2003; Cerami 2009; Susanu 2011). Për shembull, kapitalizmi që është krijuar në Rusi, të cilin qysh në mes të viteve 1990, poeti i shquar rus Yevtushenko (1996: 8) e konsideronte një “formë të kamufluar të carizmit”, është, pa dyshim, një tjetër lloj kapitalizmi nga ai që është krijuar në vendet e Europës Qendrore (shih, gjithashtu, Lane 2000).

Përfundime

Të dhënat mbi të cilat është mbështetur ky punim *nuk* e konfirmojnë *teorinë e kapitalizmit politik* për vendet e Europës Qendrore dhe Juglindore, edhe pse kjo teori mund të jetë e dobishme për të shpjeguar rastin e Rosisë. *Teoria e tranzicionit të tregut*, krahas meritave që vumë në dukje më sipër, ka edhe mangësi, të cilat evidentohen qartë nga ballafaqimi i hipotezave të saj me të dhënat empirike. *Teoria e klasës teknokratike-menaxheriale* ka forcë shpjeguese më të madhe, sidomos kur bëhet fjalë për elitën ekonomike. Megjithatë, edhe kjo teori ka mangësitë e saj, të cilat u përpoqëm t’i vëmë në dukje më sipër. Për më tepër, të tria këto teori parashikonin se rruga drejt vendosjes së sistemit kapitalist do të ishte *e njëjtë* për të gjitha vendet në tranzicion, skenar ky i cili nuk është materializuar.

Nga analiza e mësipërme mund të konkludojmë se ndoshta është *e pamundur*—dhe *e gabuar*—të flisnim për një teori të vetme të tranzicionit postkomunist dhe, në këtë kuadër, edhe për një teori të vetme të tranzicionit dhe të riprodhimit të elitës në postkomunizëm. Në vend të saj mund të flitet për një teori të *tranzicioneve të krahasuara*, e cila të sintetizojë teorikisht përvojat e të gjitha vendeve në tranzicion.

Teoritë që kemi shqyrtuar më sipër janë modifikuar dhe ndryshuar ashtu siç ka ndryshuar edhe vetë historia e socializmit shtetëror, ose ajo e tranzicionit postkomunist. Para viteve 1980, vështirë se mund të besohej që komunizmi do të shembej një ditë. Asnjë nga ekspertët sovjetologë, në Perëndim ose në Lindje, nuk

mundi të parashikonte përmbysjen e atij sistemi dhe, sidomos, mënyrën paqësore të shembjes së tij, jo vetëm në fillim të viteve 1980, por as në fund të asaj dekade (Tarifa 2006). Madje edhe një ndër akademikët nga më të shquar amerikanë, si historiani Richard Pipes në Harvard, e quajti shembjen e komunizmit dhe dizintegrimin e Bllokut Sovjetik një ngjarje “të papritur”. Martin Malia, një ndër ekspertët amerikanë më të njohur mbi Bashkimin Sovjetik dhe autor i librit të famshëm *Tragjedia sovjetike* (*The Soviet Tragedy*), gjithashtu e konsideroi “befasinë dhe tërësinë” e shembjes së sistemit sovjetik si “surprizën më të madhe të fundit të shekullit të 20-të” (Malia 1993). Edhe nëse kishte njerëz që besonin se eventualisht sistemi komunist do të binte një ditë, nuk dihej nëse Bashkimi Sovjetik ose shoqëritë e tjera komuniste në Europën Qendrore dhe Lindore do të ktheheshin përsëri në kapitalizëm. Edhe pse ata mund të mendonin se këto vende do të reformoheshin si ekonomi të tregut të lirë, shumë prej tyre as që e merrnin me mend se vende të tilla do të zgjidhnin modelin kapitalist Perëndimor. Sidoqoftë, kur socializmi shtetëror filloi të dezintegrohej dhe, më në fund, u shemb, u bë e qartë se vendet postkomuniste do përpiqeshin të krijonin, siç shprehet Claus Offe (1991), një “capitalism by design”. Shumë shpejt këto vende u përpoqën të krijojnë një kapitalizëm që ngjan si një “carbon copy” me kapitalizmin Perëndimor, siç e gjejmë atë në Shtetet e Bashkuara dhe në Europën Perëndimore.

Mbështetur në idenë e shprehur nga David Stark (1992) se në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore kapitalizmi do të ndërtohej jo *mbi* gjëmadhat e socializmit, por *me* gjëmadhat e socializmit, Ivan Szelenyi dhe Christy Glass (2003) sugjerojnë një *sindezë* të teorive të sipërpërmendura për të krijuar një perspektivë të re teorike mbi tranzicionin dhe riprodhimin e elitës në postkomunizëm, të cilën, këta autorë, e quajnë *teori e menaxherializmit postkomunist*. Një teori e tillë presupozon se, në shoqëritë postkomuniste, prona private dhe një klasë borgjeze që mbështet mbi të, janë ende në formim e sipër. Për rrjedhojë, *përbërja* e kësaj klase dominante si edhe *legjitimiteti* i pushtetit të saj mbeten të kontestueshme.⁶

Studimet e kryera mbi tranzicionin dhe riprodhimin e elitës në vendet postkomuniste të sipërpërmendura mundësojnë studimin e të njëjtës dukuri edhe në Shqipëri dhe në vende të tjera të Europës Juglindore, në të cilat studimet në këtë fushë kanë munguar. Një përvojë e dobishme tashmë ekziston; po kështu ekzistojnë edhe metodologjitë e studimit dhe disa perspektiva teorike, të cilat janë provuar pak a shumë të dobishme në studimin e tranzicionit postkomunist dhe, veçanërisht, në studimin e procesit të riprodhimit, të formimit dhe të fizionomisë së elitës postkomuniste.

Bibliografia

- Aslund, Anders. 1994. “Lessons of the First Four Years in Systemic Change in Eastern Europe”, *Journal of Comparative Economics* 19, 1: 22-38.
- Atkinson, Anthony B. & John Micklewright. 1992. *Economic Transformation in Eastern Europe and the Distribution of Income*. Cambridge : Cambridge University Press.

⁶ Për më gjerë shih Tarifa dhe Gaay Fortman (1998).

- Baylis, Thomas A. 1994. "Plus ça Change? Transformation and Continuity among East European Elites", *Communist and Post-Communist Studies* 27, 3: 315-328.
- Baylis, Thomas A. 1998. "Elite Change After Communism: Eastern Germany, the Czech Republic and Slovakia", *East European Politics and Society* 12, 2: 265-299.
- Brzezinski, Zbigniew. 1993. "The Great Transformation", *The National Interest* 33: 3-13.
- Cerami, Alfio. 2009. "Socio-Economic Transformations in Post-Communist Countries: Central and Eastern Europe and Russia Compared", *Romanian Journal of Political Science* 9, 1.
- Domański, Henryk & Barbara Heyns. 1995. "Toward a Theory of the Role of the State in Market Transition: From Bargaining to Markets in Post-Communism", *European Journal of Sociology* 39, 1: 32-51.
- Eyal, Gil, Ivan Szelenyi & Eleanor Townsely. 1998. *Making Capitalism without Capitalists: The New Ruling Elites in Eastern Europe*. London: Verso.
- Frydman, Roman, Andrzej Rapaczynski & John S. Earle. 1993. *The Privatization Process in Central Europe*. Budapest: Central European University Press.
- Frydman, Roman, Kenneth Murphy & Andrzej Rapaczynski. 1996. "Capitalism with a Comrade's Face", *Transitions* 2, 2: 5-11.
- Gimpelson, Vladimir. 2003. "The Impact of Labor Markets: Social Mobility, Segmentation, and Re-Ranking", në Vladimir Mikhalev (ed.), *Inequality and Social Structure during the Transition*. New York: Palgrave Macmillan Press.
- Hankiss, Elemér. 1990. *East European Alternatives*. Oxford: Clarendon Press.
- Hanley, Eric. 1997. *Privatization and Marketization in Eastern Europe*. PhD dissertation, University of California at Los Angeles.
- Hanley Eric & Ivan Szelenyi. 2001. "Changing Social Structure during Market Transition: The Case of Central Europe", ff. 101-148, në Fatos Tarifa (ed.), *The Breakdown of State Socialism and the Emerging Post-Socialist Order*. The Hague: The Institute of Social Studies.
- Hanley, Eric & Donald J. Treiman. 2003. "Recruitment into the Eastern European Communist Elite: Dual Career Paths", On-Line Working Paper Series, California Center for Population Research, University of California Los Angeles (burimi online: <http://www.escholarship.org/uc/item/75c0z2z1?display=all#page-1>).
- Hanley, Eric & Donald J. Treiman. 2004. "Did the Transformation to Post-Communism in Eastern Europe Restore Pre-Communist Property Relations?", *European Sociological Review* 20, 3: 237-252.
- Heyns, Barbara. 1998. "Meaning and Measurement in the Post-Communist Labor Force: Employment and Unemployment in Poland, 1992-1996", *Sociological Analysis* 1, 1: 41-59.
- Higley, John & Jan Pakulski. 1995. "Elite Transformation in Central and Eastern Europe", *Australian Journal of Political Science* 30: 415-435.
- Higley, John, Judith S. Kullberg & Jan Pakulski. 1996. "The Persistence of Postcommunist Elites", *Journal of Democracy* 7, 2: 133-147.
- Jefferson, Gary H. & Thomas G. Rawski. 1994. "Enterprise Reform in Chinese Industry", *Journal of Economic Perspectives* 8: 47-70.
- Karmel, Solomon M. 1994. "Emerging Securities Markets in China: Capitalism with Chinese Characteristics", *China Quarterly* 140: 1105-1120.

- Keister, Lisa A. 1998. "Social Ties and the Formation of Chinese Business Groups", *Sociological Analysis* 1, 2: 99-117.
- Kryshatanovskaya, Olga & Stephen White. 1996. "From Soviet Nomenklatura to Russian Elite", *Europe-Asia Studies* 48, 5: 711-733.
- Lane, David. 1997. "Transition under Yeltsin: The Nomenklatura and Political Elite Circulation", *Political Studies* 45: 855-874.
- Lane, David. 2000. "What Kind of Capitalism for Russia? A Comparative Analysis", *Communist and Post-communist Studies* 33, 4: 485-504.
- Lane, David and Cameron Ross. 1999. *The Transition from Communism to Capitalism: Ruling Elites from Gorbachev to Yeltsin*. New York: St. Martin's Press.
- Lengyel, György. 1998. "The Hungarian Economic Elite in the First Half of the 1990s", ff. 203-212, në John Higley, Jan Pakulski & Włodzimierz Wesolowski (eds.), *Postcommunist Elites and Democracy in Eastern Europe*. New York: St. Martin's Press.
- Malia, Martin. 1993. "A Fatal Logic: Sovietologists and the Collapse of Communism in the Former USSR", *The National Interest* 31: 80.
- Manchin, Robert & Ivan Szelenyi. 1987. "Social Policy under State Socialism", ff. 102-139, në Gosta Aspin Anderson, Lee Rainwater & Marty Rein (eds.), *Stagnation and Renewal in Social Policy*. White Plains, NY: Sharpe.
- Naughton, Barry. 1995. *Growing Out of the Plan: Chinese Economic Reform, 1978-1993*. New York: Cambridge University Press.
- Nee, Victor. 1989. "A Theory of Market Transition: From Redistribution to Markets in State Socialism", *American Sociological Review* 54, 5: 663-683.
- Offe, Claus. 1991. "Capitalism by Design? Democratic Theory Facing the Triple Transition in East Central Europe", *Social Research* 58, 4: 865-892.
- Piirainen, Timo. 2003. "Transition and Social Structures: General Determinants of the Change", në Vladimir Mikhalev (ed.), *Inequality and Social Structure during the Transition*. New York: Palgrave Macmillan Press.
- Rona-Tas, Akos. 1994. "The First Shall be the Last? Entrepreneurship and Communist Cadres in the Transition from Socialism", *American Journal of Sociology* 100, 1: 40-69.
- Rona-Tas, Akos. 1998. "Path Dependence and Capital Theory: Sociology of the Post-Communist Economic Transformation", *East European Politics and Societies* 12, 1: 107-131.
- Staniszki, Jadwiga. 1991a. *The Dynamics of the Breakthrough in Eastern Europe: The Polish Experience*. Berkeley: University of California Press.
- Staniszki, Jadwiga. 1991b. "Political Capitalism in Poland", *East European Politics and Societies* 5, 1: 127-141.
- Stark, David. 1992. "Path Dependence and Privatization Strategies in East Central Europe", *East European Politics and Societies* 6, 1: 17-51.
- Stark, David. 1996. "Recombinant Property in East European Capitalism", *American Journal of Sociology* 101, 4: 993-1027.
- Steen, Anton. 1997. "The New Elites in the Baltic States: Re-Circulation and Change", *Scandinavian Political Studies* 20, 1: 91-112.
- Susanu, Cristina Gabriela. 2011. "The Capitalist Development Pathway of Eastern Europe:

- A Comparative Study between Eastern Europe, Southeast Asia and Latin America”, *Romanian Economic Journal* 14, 39: 175-200.
- Szelenyi, Ivan & Eric Kostello. 1996. “The Market Transition Debate: Toward a Synthesis”, *American Journal of Sociology* 101, 4: 1082-1096.
- Szelenyi, Ivan & Christy Glass. 2003. “Winners of the Reforms: The New Economic and Political Elite”, ff. 75-98, në Vladimir Mikhalev (ed.), *Inequality and Social Structure during the Transition*. New York: Palgrave Macmillan Press.
- Szelenyi, Ivan, Edmund Wnuk Lipinski & Donald J. Treiman (eds.). 1995. “Circulation of Elites? Old and New Elites in Post-Communist Societies”, Special Issue of *Theory and Society* 24: 615-800.
- Tarifa, Fatos. 1998. “Disparities and Uncertainties: Reflections on Communist and Post-Communist Eastern Europe”, *Journal of Social Sciences* 2, 2-3: 91-103.
- Tarifa, Fatos (ed.). 2001 *The Breakdown of State Socialism and the Emerging Post-Socialist Order*. The Hague: The Institute of Social Studies.
- Tarifa, Fatos. 2006. “Facing Tomorrow’s Global Challenges: What Role for Social Science?”, *Journal of Applied Sociology* 23, 2: 1-19.
- Tarifa, Fatos & Bas de Gaary Fortman. 1998. “Vulnerable Democracies: Legitimation Challenges to Postcommunist Systems”, *Journal of Social Sciences* 2, 2-3: 211-219.
- Treiman, Donald J. & Ivan Szelenyi. 1993. “Social Stratification in Eastern Europe after 1989”, ff. 163-78 në *Transformation Processes in Eastern Europe* (Proceedings of a Workshop held at the Dutch National Science Foundation [NWO], 3-4 December 1992). The Hague: NWO.
- Yevtushenko, Yevgeny. 1996. “Please, Don’t Panic (Capitalism in Russia)”, *New Perspectives Quarterly* 13, 2: 8.
- Walder, Andrew. 1995. “Career Mobility and the Post-Communist Political Order”, *American Sociological Review* 60, 3: 309-328.
- Walder, Andrew. 1996. “Market and Inequality in Transitional Economies: Toward Testable Hypotheses”, *American Journal of Sociology* 101, 4: 1060-1073.
- Webster, Laila. 1992. *Survey of Private Firms in Poland*. Washington, D.C.: The World Bank.
- White, Stephen. 2003. “Rethinking Postcommunist Transition”, *Government and Opposition* 38, 4: 417-435.
- Windolf, Paul. 1998. “Privatization and Elite Reproduction in Eastern Europe”, *Archiv Européenne de Sociologie* 39, 2: 335-376.

*Elita politike dhe shoqëria civile në Shqipërinë postkomuniste: Një marrëdhënie problematike***

*Tonin Gjuraj**

Abstrakt

Koncepti më pak i trajtuar në shkencat shoqërore në Shqipëri është, ndoshta, ai i “shoqërisë civile”.¹ Arsyeja kryesore duket të jetë jo vetëm tradita e varfër në organizimin e shoqërisë civile në vendin tonë, por dhe mungesa, për dekada me radhë, e një shkolle shqiptare të konsoliduar në fushën e sociologjisë dhe të shkencës politike. Në fakt, koncepti i “shoqërisë civile” daton shumë herët, por ai ka ardhur duke u modifikuar e rafinuar, si rezultat i trajtimeve të ndryshme në periudha dhe kontekste të ndryshme. Zhvillimet në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore pas vitit 1990 dhe ndryshimet demokratike në këto vende e rinxorën në skenë konceptin mbi shoqërinë civile, duke e kuptuar atë si një sferë sociale të pavarur përkundrejt autoritetit politik të shtetit. Këndvështrimet mbi shoqërinë civile kanë qenë dhe janë të ndryshme, ashtu sikurse edhe vetë zhvillimi i shoqërisë civile në këtë rajon

* Profesor i Asociuar, Rektor i Universitetit Europian të Tiranës si edhe ish-Ambasador i Shqipërisë në Shtetin e Izraelit (2007-2009), Tonin Gjuraj ka një përvojë shumë të pasur akademike dhe administrative. Ai ka fituar gradën Master of Arts në Shkencat Sociale (i fokusuar në problemet e organizimit dhe të drejtimit politik të shoqërisë) nga Universiteti i Europës Qendrore (Central European University) në Pragë, gradën Doktor në Sociologji në Universitetin e Tiranës, si edhe ka kryer studime postdoktorale në Kolegjin St Anthony (St Anthony’s College) të Universitetit të Oxfordit. Fushat e tij të ekspertizës janë: sociologjia politike, tranzicioni dhe zhvillimi demokratik, problemet shoqërore, shoqëria civile, feja dhe marrëdhëniet ndërfaqetare. Prof. Gjuraj është autor (ose bashkëautor) i katër monografive dhe teksteve për shkollat e larta, si edhe autor i më shumë se dhjetë artikujve shkencorë të botuar brenda dhe jashtë vendit

** Ky punim është referuar në Konferencën Kombëtare “Shkencat Sociale dhe Shoqëria Shqiptare në Tranzicion”, organizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Politikave dhe Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin Europian të Tiranës (UET), më 19 nëntor 2010.

¹ Rreth këtij koncepti janë botuar disa artikuj në shtypin e përditshëm shqiptar, si edhe disa libra nga autorë të tillë si: Sinani (2000), Shkullaku (2000) dhe Krasniqi (2004).

ka pasur veçoritë e veta. Në këtë ese përpigemi të argumentojmë se në shoqërinë shqiptare ka ekzistuar, përgjithësisht, një marrëdhënie problematike midis elitës politike dhe shtetit, nga njëra anë, dhe shoqërisë civile, nga ana tjetër. Në këtë punim parashtrojmë një kombinacion të problematikës së vetë konceptit të shoqërisë civile me disa trajtimeve teorike klasike dhe bashkëkohore të tij. Më tej, kjo kombinohet me gjetje empirike në kontekstin shqiptar, me analiza mbi zhvillimin e këtij koncepti pas vitit 1990. Në mbyllje të punimit përpigemi të formulojmë shkurtimisht disa përfundime dhe rekomandime, të cilat nënvizojnë nevojën për të përmirësuar punën, rolin, gamën e veprimtarive të shoqërisë civile, në funksion të vendosjes së një raporti më të drejtë dhe të një bashkëpunimi më të natyrshëm midis shoqërisë civile dhe politikës.

“Probleme” me konceptin e shoqërisë civile?

I deja mbi shoqërinë civile mund të thuhet se ka lindur në fund të shekullit të 17-të dhe në fillim të shekullit të 18-të, si rezultat i një krize në rendin shoqëror të asaj kohe, si dhe i thyerjes së paradigmeve ekzistuese të idesë së këtij rendi (Seligman 1992: 15). Edhe pse ky koncept ka qenë i neglizhuar, “shekulli i 21-të”, siç ka vënë në dukje Don Eberly (2000: 3), “duket se do të përfaqësojë një periudhë të restaurimit të tij”. Gjatë shekullit të 18-të dhe pas tij, Europa njohu një ridimensionim të mendimit të saj social e politik. Mendimtarët më të shquar të saj formuluan ide dhe parime të reja, krijuan modele të reja të rendit shoqëror, rinovuan traditën intelektuale ekzistuese dhe sollën një kuptim të ri mbi idenë e shoqërisë civile. Sipas sociologut Adam Seligman (1992: 16), kjo ide zë fill me filozofin John Locke, me Rilindjen skoceze² dhe me filozofët e shquar gjermanë Immanuel Kant, G.W.F. Hegel dhe Karl Marx. Thelbi i saj, sipas tij, konsiston në paraqitjen e shoqërisë civile si një “vizion moral ose etik, ose si përfaqësuese e jetës sociale” (ibid, 16). Në tërësi, mund të thuhet se, këta filozofë dhe të tjerë (veçanërisht Montesquieu dhe Rousseau), përpunuan idenë moderne të shoqërisë civile, edhe pse ajo ndryshonte në mënyrë të konsiderueshme prej kuptimit që kemi ne sot për të, veçanërisht në vendet ish-komuniste në tranzicion.

Modeli më i efektshëm i zhvillimit të shoqërisë civile mbeten Shtetet e Bashkuara të Amerikës, vend ky, në të cilin janë mishëruar më mirë se kudo tjetër një kompleks elementesh: organizata, qendra, institute dhe shoqata vullnetare, dhe ku janë formuluar në formën më të qartë koncepti federalist mbi organizimin e shtetit, koncepti i lirisë individuale, ai i ndarjes së qartë të pushteteve, i ndarjes së kishës nga shteti etj. Amerikanët preferuan t’i referohen shoqërisë civile si *sektori vullnetar, sfera publike ose sociale*, në të cilën përfshijnë edhe familjen, fqinjësinë dhe asosacionet vullnetare. Kjo ka qenë dhe mbetet “një pjesë thelbësore dhe e pazëvendësueshme e eksperimentit demokratik amerikan” (Eberly 2000: 3). Individu njerëzor është në qendër të zhvillimit të këtij koncepti, ndërsa idetë kristiane, veçanërisht individualizmi protestant, duken se kanë pasur një ndikim të madh në zhvillimin e shoqërinë amerikane. Max Weber ia dedikon këtë sukses traditës protestante dhe, veçanërisht, asaj kalviniste.

Më pas, ide mjaft përparimtare në zhvillimin e konceptit të shoqërisë civile hasen brenda Rilindjes Skoceze. Për mendimtarët e Rilindjes skoceze ideja e shoqëri-

² Me këtë Rilindje shoqërohen kryesisht traditat e filozofisë morale.

së civile nënkuptonte pikësëpari “një hapësirë solidariteti që mbahet së bashku nga forca e sentimenteve morale dhe afeksionet natyrale” (ibid, 33). Në mendimin e tyre, kundërshtitë individual/social dhe publik/privat kapërcehen pikërisht nga ideja e shoqërisë civile, si model i rendit shoqëror (ibid, 31). Ndërkaq, mendimtarët skocezë të kësaj kohe formuluan, gjithashtu, konceptin e “së mirës publike” (*public good*), në analogji me konceptin më të hershëm të “interesit të përgjithshëm”, koncept i cili nënkupton faktin se ekzistenca individuale sigurohet në hapësirat publike.

Marrëdhëniet mes pikëpamjeve të kundërta të përmendura më sipër filluan të trajtohen në një dritë të re nga filozofi gjerman Immanuel Kant. Kanti e shihte idenë e shoqërisë civile si një vizion përfaqësues dhe etik të rendit social, duke theksuar rëndësinë e lirisë dhe të barazisë, si dy nocione qendrore të filozofisë së tij. Nocioni i *publikes* dhe i *sferës publike* u bënë pjesë e debatit të asaj kohe mbi shoqërinë civile. Ndryshe nga moralistët skocezë, Kant u përpoq të kapërcente dallimin ndërmjet *interesit individual* dhe *të mirës sociale*. “Vetëm përmes pjesëmarrjes në strukturat civile të veprimtarisë politike mund të garantohet autonomia e njeriut dhe, bashkë me të, edhe ajo e arsyes” (Seligman 1992: 43). Problemin e integritetit të etikës në sferën publike ka qenë një preokupim teorik edhe për mendimtarë të tillë si Karl Marx dhe Max Weber. Por, ndërsa Marx e përfytyronte këtë në mënyrë utopike, Hegeli e vinte theksin në mënyrë të drejtpërdrejtë te reciprociteti, si një element thelbësor i shoqërisë civile.

Shoqëria civile përfaqëson, në logjikën e saj zhvillimore, të dy elementet, të veçantën dhe universalen, të cilat Hegeli shpresonte që nëpërmjet bashkimit përfundimtar të tyre të kapërcenin dallimin kantian midis së drejtës publike dhe moralitetit privat (Seligman 1992: 47).

Me Hegelin mund të thuhet se fillon një fazë e re në diskutimin mbi shoqërinë civile, si objekt i zhvillimit historike, larg qenies thjesht një entitet etik, siç ishte konsideruar që prej fundit të shekullit të 18-të deri në këtë kohë. Nga ana tjetër, Karl Marx hodhi poshtë të gjitha “mitet” dhe “fantazitë” e shekullit të 18-të që kanë të bëjnë me origjinën natyrore të shoqërisë civile” (ibid, 52). Për të, shekulli i 18-të, ose “epoka e shoqërisë civile, prodhoi si individin e izoluar, ashtu edhe format më të zhvilluara të marrëdhënieve sociale” (ibid.). Marx besonte se, në të ardhmen, do të bëhej e mundur ribashkimi i shoqërisë civile dhe asaj politike, duke mënjanuar kështu modelet e ndryshme të përfaqësimit social në shoqëri.

Bazuar në këtë ide marksiste mbi shoqërinë civile, ish-vendet socialiste në Europën Qendrore dhe Lindore, përfshirë edhe Shqipërinë, përqafuan idenë se kontraktat e shoqërisë civile mund të kapërcehen vetëm në rast bashkimi të jetës sociale dhe asaj politike. Zhvillimet në Shqipëri gjatë periudhës së socializmit shtetëror provuan se ky “bashkim i ri”, i imponuar nga lart dhe me mjete dhune, jo vetëm që nuk funksionoi, por zhduku edhe traditën më të vogël të shoqërisë civile që mund të kishte ekzistuar në vendin tonë para Luftës së Dytë Botërore. Partia-shtet, si dhe disa “leva” të saj, mbeten të vetmit aktorë veprues në shoqëri, duke ndrydhur dhe duke e mos lejuar ndërmarrjen e iniciativave jashtë sferës politike.

Pas formulimeve që Hegel dhe Marx i bënë konceptit të shoqërisë civile, ideja klasike mbi shoqërinë civile more një përmbajtje më konkrete dhe nisi të analizohet si një tërësi praktikash institucionale, që përcaktojnë marrëdhëniet sociale në botën e sotme. Në mendimin shoqëror dhe politik evropian të shekullit të 20-të, të bie në sy rëndësia që (ri)merr nocioni i individit, ai i barazisë së individëve në shoqëri, si edhe pjesëmarrja në rritje e qytetarëve në jetën politike e shoqërore. Pavarësisht nga kjo, nuk kanë munguar dhe nuk mungojnë këndvështrimet e skajshme lidhur me të kuptuarin dhe trajtimin e konceptit të shoqërisë civile. Gertrude Himmelfarb (2000: 95), fjala vjen, mban një qëndrim disi “unik” ndaj konceptit të shoqërisë civile. Ajo vlerëson se ideja origjinale e shoqërisë civile ishte shumë e thjeshtë, për sa kohë që ajo përfshinte ato “institucione ndërmjetësuese” siç janë familja, lagjja, komuniteti, kisha, organizatat qytetare, si edhe institucionet jozyrtare, të cilat ndërhyjnë ndërmjet individit dhe shtetit duke korrigjuar, si të thuash, edhe individualizmin e tepërt, edhe ndërhyrjen e tepëruar të shtetit në jetën e individit. Sipas saj, fatkeqësisht, tani kjo ide nuk është më kaq e thjeshtë. Për shkak se liria përbën thelbin e shoqërisë civile, Himmelfarb, duke iu referuar “asociacioneve vullnetare” për të cilat fliste Alexis de Tocqueville, argumenton se institucionet e shoqërisë civile karakterizohen nga *vullnetarizmi* dhe *liria*, ndryshe nga institucionet e shtetit, të cilat janë shtërëguese dhe të detyrueshme.

Tabloja që paraqet Himmelfarb (2000) është, në fakt, pesimiste dhe aspak ndërvepruese midis institucioneve të shoqërisë civile dhe shtetit, madje, sipas saj, të dyja këto sfera të jetë shoqërore duken të *demoralizuar*. Sipas kësaj autoreje, është detyrë e shtetit dhe e ligjeve të tij që ta *rigjallërojë* shoqërinë civile. Në fakt, rrugëzgjdhja që propozon Himmelfarb nuk duket të jetë bindëse, për sa kohë që aktivizimi ose jo i elementeve të shoqërisë civile mbeten në dorën e shtetit, ndërkohë që një qeverisje e efektshme ka *gjithmonë* nevojë për të gjitha resurset qytetare, qeveritare, publike dhe private. Rasti i shoqërisë shqiptare, siç do e shohim në vijim të kësaj eseje, ka qenë i ndryshëm. Në Shqipëri kanë munguar përpjekjet e ndershme nga ana e çdo qeverie, të majtë ose të djathtë, për rigjallërimin dhe zhvillimin e shoqërisë civile.

Filozofja e njohur amerikane, Jean Bethke Elshtain (2000), nga ana e saj, argumenton se demokracia e sotme kërkon edhe disa “dispozicione demokratike”, si përgatitja për të punuar me të tjerë që janë të ndryshëm prej nesh, por që ndajnë të njëjtat qëllime; gatishmëria për të bërë kompromise mes nevojave, dëshirave dhe mundësive; përkushtimi ndaj të mirave qytetare, të cilat nuk janë në zotërim të një personi, ose të grupi të vetëm. Mungesa e tyre, sipas kësaj autoreje, ka bërë që “eksperimenti amerikan” të manifestojë shenja lodhjeje, cinizmi, oportunizmi, dëshpërimi, izolimi dhe mërzie; me fjalë të tjera, shenja dobësimi të asaj që njihet si “shoqëria civile demokratike” (Elshtain 2000: 101-102). “Eksperimenti amerikan” mbetet, pa dyshim, një eksperiment i suksesshëm, një model i funksionimit të shoqërisë civile, por ai është kritik, sepse kërkon përmirësim e perfeksionim të vazhdueshëm. Shteti, shoqëria civile dhe qytetari, secili në sferën e vet, janë gjithnjë në kërkim të formave të larmishme të gjallërimit të jetës qytetare.

Në shoqërinë shqiptare, në fakt, dëshpërimi, oportunizmi, lodhja etj., janë jo vetëm pasojë e së kaluarës por, në një masë të madhe, edhe e mënyrës sesi është zh-

villuar tranzicioni postkomunist në vendin tonë, gjë që ka krijuar një “kulturë mosbesimit” në radhët e qytetarëve. Për shembull, nuk kanë munguar skandalet, vonesat në procesin integruar, lufta e paprincipitë për pushtet e lidershipit politik, demagogjia, probleme me demokracinë e brendshme të partive, të cilat, së bashku, krijojnë një distancë të madhe midis nevojave dhe mundësive për përmbushjen e tyre, çka e bën të vështirë, dhe pothuajse të paarrtshëm, kompromisin mes tyre si një prej *dispozicioneve* demokratike.

Sociologu i shquar amerikan Amitai Etzioni (2000: 130-133), shkon edhe më tej në analizën e tij mbi shoqërinë civile, duke propozuar konceptin e “shoqërisë së mirë”, term ky i përdorur për herë të parë nga Walter Lippman (1937), në librin e tij *Shoqëria e mirë* (*The Good Society*). Koncepti i “shoqërisë së mirë” nuk presupozon thjesht një shoqëri pluraliste, por mirëkuptimin moral, pra një shoqëri, në të cilën “e mira” kërkon të arrijë në sferën private, në sferën e individit, kur shoqëria vetë përcjell besim, jo vetëm ndaj anëtarëve të saj dhe ndaj qeverisë por, sidomos, ndaj asaj që është “më e mirë” si, për shembull, kujdesi ndaj grupeve vulnerabël, kujdesi i veçantë ndaj të rinjve dhe njerëzve në moshë të vjetër, si edhe “të mira” të tjera më specifike.

“Shoqëria e mirë”, argumenton Etzioni (2000: 129), ofron një gamë më të gjerë të mirash specifike në krahasim me shoqërinë civile. Sipas tij, një ndër instrumentet kryesore të “shoqërisë së mirë” janë *institucionet sociale*. Ndërsa “e mira”, si diçka e moralshme, është e integruar te personaliteti i individit dhe në format e ndërveprimit të tij me individë të tjerë, institucionet sociale janë zyrtare, të strukturuar dhe “modele që mishërojnë vlerat e shoqërisë, ose të një komuniteti të caktuar” (ibid, 130; shih, gjithashtu, Bellah et al. 1991). Me këtë nuk kemi parasysh vetëm institucionet zyrtare shtetërore, por të gjitha institucionet sociale si, familja, shkolla, feja, masmedia, ekonomia etj. “Shoqëria e mirë” dhe “shoqëria civile” nuk janë antagonistë ndaj njëra-tjetrës. Dallimi i vetëm midis tyre, argumenton Etzioni, është se, e para është një koncept më i gjerë, përfshin virtyte shtesë përtej genies “civile”. Etzioni pranon se nuk ka një përcaktim të vetëm, të pranueshëm nga të gjithë, mbi konceptin e “shoqërisë civile” përveç faktit të njohur të përfshirjes në të, të një rrjeti shoqatash vullnetare, të cilat kultivojnë te qytetari shprehite dhe praktikata që kërkon një qeveri demokratike.

John Rawls, një ndër figurat më të njohura në filozofinë amerikane në gjysmën e dytë të shekullit të 20-të, argumenton se tërësia e shoqërisë civile, jo thjesht shteti liberal, është pak më shumë se një zonë neutrale ku mund të konkurrojnë virtyte të ndryshme. Sipas tij, janë pikërisht institucionet demokratike ato, në të cilat formësohen dhe marrin jetë kriteret klasike të “shoqërisë së mirë” si, paqja, prosperiteti, liria dhe drejtësia (Rawls 1996: 282-283). Institucionet kanë nevojë të ndryshohen, të përmirësohen dhe të reformohen vazhdimisht, dhe nënkupton jo vetëm statusin e tyre ligjor, por edhe praktikata dhe zakone jozyrtare. Në këtë kontekst, shoqëria shqiptare ka rastin më të favorshëm që, bazuar në përvojat e suksesshme perëndimore dhe në kritikata ndaj tyre, të ngrrejë institucione të virtytshme në shërbim të *të gjithë* qytetarëve, dhe vetëm jo të një grupi njerëzish, ose të elitës me pushtet, të cilët, siç argumenton C. Wright Mills (1956), në librin e tij të famshëm *Elita e pushtetit* (*The Power Elite*), përpiqen t’i modelojnë institucionet sipas interesave të tyre.

Shoqëria civile dhe shteti

Marrëdhëniet e shtetit me shoqërinë civile përbëjnë një prej çështjeve qendrore të shkencave sociale e politike në përgjithësi, dhe të sociologjisë politike në veçanti. Këto marrëdhënie, në regjime të ndryshme politike marrin trajta të ndryshme. Në regjimet totalitariste ndarja që ekziston mes shtetit dhe shoqërisë civile zhduket, pasi shteti dominon në çdo sektor të shoqërisë. Në regjimet demokratike liberale, përkundrazi, kjo ndarja midis shtetit dhe shoqërisë civile është e qartë. Madje vetë shteti favorizon një ndarje të tillë me shoqërinë civile, e cila karakterizohet nga liria e veprimit, nga konkurrenca në treg dhe nga diversiteti social.

Teoria marksiste nuk duket të jetë konsistente në përcaktimin e marrëdhënieve midis shtetit dhe shoqërisë civile. Karl Marx argumentonte, fjala vjen, se “shteti është në mënyrë përfundimtare një shërbëtor i interesave dominuese në shoqërinë civile, sado që të duket se ai ka interesat e veta, ose se i shërben ‘interesave universale’ të shoqërisë” (cituar në Faulks 2000: 33). Më vonë, Antonio Gramsci (1971) mbrojti të njëjtin pozicion, duke nënvizuar faktin që shtetin dhe shoqërinë civile i dallon vetëm monopoli i forcës fizike që disponon shteti. Marksistët, të cilët të gjithë procesin politik e reduktojnë te çështja e zotërimit të mjeteve të prodhimit, mbrojnë idenë se shteti dhe shoqëria civile dominohen vetëm nga një pakicë njerëzish, ndërsa teoricienët të cilët, si Gaetano Mosca dhe Vilfredo Pareto, të cilët zhvilluan teorinë elitiste të marrëdhënieve mes shtetit e shoqërisë civile, e reduktojnë këtë proces te shpërndarja e pabarabartë e karakteristikave psikologjike, ose shprehive organizative te njerëzit dhe shoqëria (shih Faulks 2000: 44).

Ndryshe prej tyre, teoricienët e pluralizmit përshkruajnë shpërndarjen e pushtetit në shoqërinë civile si të tërë. Në shoqëritë demokratike pluraliste, individët dhe grupet karakterizohen nga liria për t’u organizuar, jo vetëm mbi bazën e interesave politike, por edhe të interesave të tjera jopolitike. “Pluralizmi gjithashtu ndan me liberalizmin pikëpamjen se shoqëria civile duhet të jetë e çliruar nga ndërhyrjet e tepruara të shtetit, i cili, gjatë gjithë kohës, duhet t’u përgjigjet nevoja dhe kërkesave që lindin brenda shoqërisë civile” (ibid, 45). Siç del nga të tria teoritë e sipërpërmendura—teoria marksiste, teoria elitiste dhe ajo—pluraliste,³ çështja e marrëdhënieve të shtetit me shoqërinë civile paraqitet komplekse dhe, herë-herë, e paqartë. Të dy ose “integrohen” te njëra tjetra, duke mos qenë në gjendje të jepet një përcaktim i saktë për to, për pozicionin, për peshën dhe për forcën e tyre në shoqëri, ose injorohet mundësia e vlerësimit të autonomisë së ndërsjellë që i karakterizon si njëri, ashtu edhe tjetri. Mendimi i përgjithshëm është se marrëdhëniet midis shoqërisë civile dhe shtetit historikisht “nuk kanë qenë aq të shëndetshme” (shih Schambra 2000: 318).

Ndryshimet e mëdha sociale dhe politike që përfshinë Europën Qendrore e Lindore në vitin 1990, risollën në skenën politike e mediatike, veç të tjerash, edhe çështjen problematike—dhe herë-herë kontradiktore—të marrëdhënieve midis

³ Këta përbëjnë teoritë klasike të shtetit dhe shoqërisë civile, të cilat me ndryshimet sociale që kanë ndodhur dekadat e fundit janë sfiduar mjaft nga teoritë bashkëkohore. Një ndikim të madh kanë pasur lëvizjet e reja sociale, globalizimi, neo-liberalizmi, etj.

shoqërisë politike (shtetit) dhe *shoqërinë civile*. Analizat janë përqendruar kryesisht te raportet e këtyre dy sferave të shoqërisë dhe mundësive për demokratizimin e secilës prej tyre në rrethanat e një shoqërie të re pluraliste dhe të tregut të ri. Anthony Giddens (1994), ndërsa flet për rolin e politikës për të ndërtuar institucione që ushqejnë autonominë individuale dhe përgjegjësinë personale të individit për veten e tij dhe për shoqërinë, nënvizon idenë e krijimit të asaj që ai e quan “demokraci e dialogut”. Kjo demokraci, shihet prej tij si një proces, i cili inkurajon “besimin aktiv”, tolerancën, diversitetin me anë të diskutimeve kolektive për probleme të qeverisjes. Pikërisht këto shprehje qytetare demokratike, të cilat ndihmojnë procesin demokratik, nuk mund të kufizohen vetëm brenda kuadrit të veprimtarisë së institucioneve politike (p.sh. të partive politike, ose institucioneve të tjera shtetërore), por mund të promovohen nga lëvizje sociale, nga grupe të pavarura, dhe nga qendra autonome të veprimit shoqëror. Siç shprehet Ulrich Beck, “Një shpirt demokratik është i pranishëm në veprimet e lëvizjeve sociale” (cituar në Faulks 2000: 172). Miliband, nga ana e tij, argumenton se të demokratizosh shoqërinë civile do të thotë “të përfshish të gjitha institucionet ku ushtrohet pushteti, si: fabrikat, sindikatat dhe shkollat” (shih ibid, 176). Duke trajtuar marrëdhëniet e shtetit me shoqërinë civile, Paul Hirst (1994) në librin *Demokracia Asociative (Associative Democracy)*, përpiqet të pajtojë shtetin me shoqërinë civile, duke bërë realitet vlera të tilla reale si: autonominë individuale, lirinë dhe diversitetin dhe duke paralajmëruar rrezikun e ndërhyrjes së shtetit për zgjidhjen e të gjitha çështjeve në shoqëri, përfshirë edhe reduktimin e varfërinë. Hirst ofron nocionin e *asocializmit*, si të rëndësishëm për politikën në tërësi. Sipas tij:

Asosacionet në shoqërinë civile duhet të jenë mjeti i vetëm për vendimet demokratike dhe furnizueset kyç të mirëqenies. Kjo domosdoshmërisht përfshin një shtet federal dhe të decentralizuar që jep fonde publike për këto asosacione (cituar në Faulks 2000: 184).

Përvoja dhe praktika asociacionale në politikën dhe shoqërinë shqiptare shkon disi kundër me analizën që bën Hirst. Rregullat dhe standardet e përgjithshme që ka vendosur shteti shqiptar nuk kanë përfshirë sa duhet shoqërinë civile në vendimet që merren, veçanërisht kur është fjala për shpërndarjen e fondeve ose financimin e projekteve të ndryshme.

Shoqëria civile shqiptare dhe tranzicioni demokratik

Le të përqendrohemi tani më konkretisht në debatin nëse Shqipëria ka ndjekur rrugë të njëjta ose të ndryshme me përvojën perëndimore për zhvillimin e shoqërisë civile gjatë periudhës së tranzicionit postkomunist, si edhe për imazhin e saj në opinionin publik dhe rolin e elitës politike në formimin e këtij imazhi. Siç dihet, shumë tranzitologë (shih sidomos Linz & Stepan 1996), e konsiderojnë shoqërinë civile si një “arenë të politikës”, në të cilën, grupe, individë dhe lëvizje shoqërore vetëorganizuese, relativisht të pavarura nga shteti, përpiqen të artikulojnë dhe të avancojnë parime, vlera dhe shprehje demokratike, interesa të caktuara,

të krijojnë asosacione dhe të promovojnë një sens solidariteti mes qytetarëve. Për të qenë e tillë, shoqëria civile duhet të jetë në gjendje të mobilizojë ide, opinione, mendime, qëndrime dhe veprime në të ndryshme ose të kundërta nga ato të pushtetit, të klaneve politike, institucioneve të korruptuara dhe autoritariste, të cilat nuk i përfillin grupimet më të vogla që s'kanë pushtet.

Pas vitit 1990, ashtu si vendet e tjera të Europës Qendrore e Lindore, edhe Shqipëria ka dëshmuar një interes në rritje për ngritjen dhe funksionimin e institucioneve të ndryshme sociale, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre jashtë sferës shtetërore dhe jashtë tregut. Të çliruar tashmë nga kufizimet ideologjike të periudhës së sundimit komunist, njerëzit shfaqën dhe vazhdojnë të shfaqin prirje drejt një pjesëmarrje më të gjerë në çështjet publike dhe një roli më të dukshëm në zgjidhjen e problemeve jetësore. Kjo, mund të thuhet, ka ndodhur edhe nën ndikimin e atij që Lester Salamon (1994) e ka quajtur shpërthim i një “revolucionit asosacional global”.

Në Shqipëri, përpjekjet e para për të krijuar një shoqëri civile janë bërë nga disidenca antikomuniste shqiptare gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Për arsye që njihen, ato rezultuan krejt të pasuksesshme. Më pas, shoqëria shqiptare u “strukturua” sipas interesave të regjimit komunist. Në tërësi, shqiptarët nuk arritën të zhvillonin *klasën liberale borgjeze* të qytetarëve të vet, e cila përbën një parakusht të për zhvillimin e shoqërisë civile. Lëvizjet e klasës punëtore në Shqipëri kanë qenë të tilla, që nuk kanë ndryshuar shumë prej vendeve me traditë të dobët e të shkurtër të marrëdhënieve kapitaliste në prodhim. Lëvizjet punëtore nuk janë shfaqur kurrë si lëvizje të grupeve të presionit, ose të grupeve të interesit, që të mund të ndikonin mbi shoqërinë. Në analogji me këtë, Seymour Martin Lipset ka argumentuar se mungesa e traditës feudale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Kanada, në Australi dhe në Zelandën e Re i ka diferencuar shumë lëvizjet e klasës punëtore në këto vende në krahasim me ato pjesë të tjera të botës (shih Seligman 1992: 107).

Viti 1991 do të shënonte fillimin e një faze të re për zhvillimin e shoqërisë civile në Shqipëri. Qytetarët shqiptarë, të çliruar prej frikës nga shteti komunist, nisën të shprehin lirshëm mendimet dhe opinionet e tyre. Në kushtet e reja të krijuara pas përmbysjes së regjimit komunist, shteti nuk kontrollonte më jetën e individit dhe sferën e tij private. Madje, deri në një farë mase, te shqiptarët filloi të kultivohej dëshira dhe kërkesa për privatësi, si një vlerë individuale demokratike. Raportet e individit me shoqërinë dhe shtetin filluan të ndryshojnë ndjeshëm. Krahas lindjes së partive politike, në Shqipëri filluan të krijohen me dhjetëra e qindra organizata, shoqata, qendra, institute ose fondacione të njohura si organizata “joqeveritare”, “jofitimprurëse”, ose, nën termin ombrellë “shoqëri civile”. Këto, nëse huazojmë një formulim nga Robert Putnam (1993), ishin potencialisht “rrjete të angazhimit civik” dhe konsistonin në një shumëllojshmëri asosacionesh vullnetare. Në praktikën perëndimore, këto organizata tradicionalisht janë marrë me veprimtari kulturore, rekreative, me përkujdesje ndaj shëndetit dhe me probleme sociale, ndërsa në Shqipëri, fillimisht, ato u morën dhe vazhdojnë të merren, ndër të tjera, edhe me çështje që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e minoriteteve, etj.

Tradita e dobët e shoqërisë civile në Shqipëri lidhet edhe me statusin e paqartë

të grupeve të interesit në drejtim të organizimit të interesave sociale, me të drejta dhe detyrime të përcaktuara, me një profil jo të lartë të tyre në hartimin e politikave publike dhe me peshën e tyre gati-gati të papërfillshme në sistemin politik. Ajo që mund të konsiderohet si fillimi i veprimit konkret të shoqërisë civile në Shqipërinë postkomuniste ishte lëvizja sindikaliste. Kjo lëvizje, e nxitur kryesisht nga minatorët, organizoi interesat e saj duke krijuar Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH-në). Në fillimet e saj, kjo sindikatë ishte mjaft aktive, mbështeti lëvizjen studentore në Tiranë dhe mbarë vendin, mbrojti të drejtat e punëtorëve, madje radikalizoi kërkesat e saj, duke kërkuar ndryshime më të thella politike në të mirë të vendit, shoqëruar edhe me kërkesën për dorëheqjen e qeverisë komuniste të fundit.

Në fakt, në fillim të viteve 1990, nisur nga natyra e zhvillimeve politike në vend, si edhe nga pozicioni i saj opozitar ndaj qeverisë, BSPSH-ja u mbështet nga Partia Demokratike dhe forcat e tjera të djathta, ndërkaq edhe ajo vetë gjeti mbështetjen e spektrit të djathtë politik në shumicën dërrmuese të kërkesave të saj. Më pas, veprimtaria e saj, si sindikatë dhe grup presioni, vazhdoi të shpалosë, të paktën formalisht, disa standarde që karakterizojnë lëvizjet sindikaliste në vende demokratike të konsoliduara, si marrja në mbrojtje e interesave të punëtorëve, përdorimi i protestave dhe i grevave si veprime kolektive, si dhe pjesëmarrja në komisione të ndryshme së bashku me përfaqësues të qeverisë dhe punëdhënësve. Më kalimin e kohës, sidoqoftë, një mbështetje e tillë e hapur nga e djathta ndryshoi. Në anën tjetër, forcat e majta mbështeten shndërrimin e organizatave të punëtorëve në Konfederatë të Sindikatave të Shqipërisë (KSSH).

Nisur nga mbështetja që gëzonin, të dyja organizatat e sipërpërmendura kishin ngarkesa politike dhe, jo rrallë, komprometuan qëllimin për të cilin ishin ngritur. Në vend të organizimit të interesave të punëtorëve dhe mbrojtjes së tyre, ata filluan të shfaqen se shtojca të partive politike dhe të interesave të caktuara politike. Në këtë kuadër, janë për t'u denoncuar përpjekjet e pandershme të partive politike, veçanërisht pas ardhjes së tyre në pushtet, për të sfumuar lëvizjet sindikale, për t'i vënë nën kontroll drejtuesit e tyre me forma të ndryshme korruptive, duke përdorur edhe oferta financiare. Zëri i lëvizjes sindikaliste filloi të bëhej gjithnjë e më shumë i pafuqishëm dhe vetë kjo lëvizje filloi t'u largohej objektivave të qarta dhe kërkesa legjitime të periudhës së fillimit. Madje, duke njohur dobësinë dhe të metat e lëvizjes sindikaliste, pushteti shtetëror jo rrallë e ka nënvlerësuar ose injoruar rolin e tyre në procesin e hartimit të projektligjeve, qoftë edhe të atyre që lidhen drejtpërsëdrejti me interesat dhe të drejtat e punëtorëve. Është fakt, sidoqoftë, se qysh nga krijimi i tyre, anëtarët e grupeve sindikale dhe drejtuesit e tyre nuk kanë diskutuar në mënyrë institucionale mundësinë e arritjes së përfaqësimit politik përmes krijimit të një partie politike, si për shembull Solidarnosti në Poloni, me rol të dyfishtë ndërmjet viteve 1991- 1993, edhe me përfaqësim parlamentar, edhe si grup presioni.

Përgjithësisht, mund të thuhet se grupet e interesit dhe të presionit në Shqipëri nuk kanë pasur ndonjë peshë të madhe, ose mbështetje të dukshme për politika alternative në zhvillimin ekonomik e social të vendit. Reformat politike dhe ekonomike në Shqipëri janë kryer nga qeveritë e pas vitit 1990. Vendimmarrja dhe politikëbërja

kanë qenë më shumë elitiste, në vend që të ishin pluraliste, ose të paktën korporatiste. Politikëbërja nuk përfshin vetëm politikanët e zgjedhur, punonjësit civilë, por dhe përfaqësues të grupimeve me interesa të caktuara. Elita politike nuk duhet të jetë i vetmi aktor në politikëbërje, pra ku angazhohen vetëm grupe elitare kryesore; ajo, përkundrazi, duhet të karakterizohet nga një shumëllojshmëri aktorësh.

Deri më sot, ka qenë kryesisht administrata shtetërore (ministritë), ajo që ka pasur ndikimin kryesor në hartimin e projektligjeve ose të propozimeve të ndryshme. Edhe ato organizata të interesit që vinin nga e kaluara (bashkimet profesionale) pësuan ndryshime në organizim, në strukturë dhe në anëtarësinë e tyre, dhe gradualisht e humbën besimin e opinionit publik në to, kurse grupet e reja të interesit, në fillimet e tyre, u morën më shumë me konstituimin e organizatave të tyre dhe me vendosjen e kontakteve të para me administratën shtetërore dhe me parlamentit shqiptar, pra me *shtetin*. Në veprimtarinë e tyre ata u përfshinë më tepër në disa kërkesa sociale të ditës, duke ndërhyrë pranë ministrave për disa vendime që ndikonin mbi anëtarësinë, për ndryshime të vogla, sesa duke ndërmarrë hapa që të kërkonin një veprim legjislativ afatgjatë.

Attila Ágh (1996: 79-91), drejtor i Qendrës Hungareze për Studimet e Demokracisë, argumenton se, si rregull, ka *katër lloje* kanalesh, ose kontaktesh institucionale midis *makro-politikës* dhe *meso-politikës*⁴ në demokracitë e zhvilluara. *Së pari*, pjesëmarrja e përfaqësuesve të grupeve të interesit në komisionet parlamentare dhe në komitetet shtetërore, përfshirë bordet e agjencive të ndryshme shtetërore, qendrore dhe rajonale; *së dyti*, konsultime të rregullta të grupeve të interesit me parti qeveritare dhe të opozitës para se të merren vendime ekonomike të rëndësishme; *së treti*, konsultime paraprake mbi projektligje nga grupe të interesit të interesuara, para se ato formalisht të paraqiten në parlament; *së katërti*, kontakte të ndryshme informale të përfaqësuesve të grupeve të interesit me deputetë, komisione të përhershme parlamentare, parti politike dhe drejtorë të agjencive shtetërore. Edhe pse Kuvendi i Republikës së Shqipërisë i lejon organizatat e shoqërisë civile të ndjekin seancat parlamentare, mund të thuhet se, deri më sot, shumë pak është bërë nga *makro-politika* shqiptare për të institucionalizuar katër llojet e kontakteve institucionale të sprovuara si të suksesshme. Madje, vullneti politik rrallë vjen nga kjo sferë e shoqërisë, si një veprim i natyrshëm dhe si pjesë e rregullave të lojës demokratike dhe të funksionimit demokratik të shoqërisë. Edhe nëse ka ndodhur, kjo ka ardhur si pasojë e presionit mediatik që kanë bërë grupet e interesit, dhe jo si ftesë e sinqertë e elitës pushtetare. Ágh shkruan se:

Nuk mund të ketë konsolidim të demokracisë në Europën Lindore dhe Qendrore pa një pakt social që sjell së bashku të gjithë aktorët politikë dhe socialë kryesorë në vendosjen e rregullave të lojës për një demokraci të konsoliduar (1996: 79).

Philippe Schmitter, nga ana e tij, argumenton se demokracia moderne duhet të konceptohet jo si një “regjim i vetëm”, por si përbërje e “regjimeve të pjesshme”

⁴ Me makro-politikë ky autor ka parasysh veprimtarinë e parlamentit, të qeverisë dhe të partitë politike, kurse me meso-politikë kupton veprimtarinë e grupeve të interesit, të shoqatave profesionale, dhe të organizatave të tjera, që konsiderohen pjesë e shoqërisë civile.

(shih ibid, 79). Krijimi dhe institucionalizimi i grupeve të interesit dhe i organizatave të tjera nuk mund të kuptohet si përfitim i një “nënprodukti”, i dalë nga partitë politike dhe nga parlamenti, pra i makropolitikës, por si një zhvillim i barabartë dhe i njëkohshëm institucional me të, me fjalë të tjera, si rrjedhojë e vet konsolidimit demokratik të shoqërisë. Vonesat në konsolidimin e shoqërisë civile vonojnë vetë procesin e konsolidimit të demokracisë në Shqipëri. Shfaqjet e herëpashershme të *partitokracisë*⁵ e kanë frenuar demokratizimin e gjithanshëm të shoqërisë shqiptare. Prandaj, pakti social midis partive politike dhe parlamentit, nga njëra anë, dhe aktorëve të ndryshëm socialë dhe politikë, nga ana tjetër, mund të rezultojë i vlefshëm nëse institucionalizohet dhe legjitimohet një pjesëmarrje sa më e gjerë e këtyre të fundit në procesin politikëbërës.

Në shkencën politike, grupet e presionit vlerësohen një produkt i procesit të modernizimit (Rush 1990). Studiuesja sllovene Danica Fink-Hafner (1996: 231), vë në dukje se “prijja drejt numrit dhe formave në rritje të grupeve të interesit dhe presioneve të tyre mbi politikëbërësit janë një aspekt i paevitueshëm i procesit të modernizimit”. Këtu nuk kemi parasysh vetëm grupet e interesit ekonomik. Po kështu, ndryshe nga përvoja e vendeve të Perëndimit, ku njerëz të rëndësishëm publik përfshihen në veprimtari të organizatave jofitimprurëse, ose drejtojnë disa prej tyre pas largimit nga posti publik ose politik që kanë mbajtur, në Shqipëri nuk janë të pakta rastet kur persona publik, zyrtarë të niveleve të ndryshme, politikanë, madje edhe deputetë, administrojnë, krahas postit publik, edhe interesat e ndonjë organizate joqeveritare. Ekziston mendimi se shumë prej këtyre organizatave joqeveritare janë, drejtpërsëdrejti ose tërthorazi, “krijesa” të pushtetarëve, ose të politikanëve të ndryshëm, që i mbajnë në këmbë me burimet të ndryshme financiare që ata sigurojnë si rezultat i lidhjeve që kanë me faktorë të ndryshëm kombëtar e ndërkombëtar.

Gjatë tranzicionit, nga shumë politikanë shqiptarë koncepti i shoqërisë civile u keqpërdor dhe u deformua, deri në atë shkallë sa, një pjesë e mirë e individëve dhe e grupeve që lipset të ishin shprehje e gjallë e kësaj shoqërie, u bënë një me pushtetin shtetëror, ose me sferën e veprimtarisë shtetërore në përgjithësi, madje duke u vënë edhe në shërbim të tyre. Në faqet e shtypit të përditshëm dhe në prononcime të ndryshme të udhëheqësve partiakë, veçanërisht atyre të majtë, pas vitit 1997 janë dëgjuar rëndom fjalët “shoqëri civile”, “individë të pavarur”, “alternativa dhe kandidatë të shoqërisë civile” etj. Një qëndrim i tillë, pas vitit 2004, u vërejt edhe në diskurin politik të së djathtës shqiptare, megjithëse kjo e fundit inkurajoi një debat më të lirë me aktorë të rëndësishëm të shoqërisë civile për të përfutur nga ekspertiza që ajo ofronte. Në gjykim, e djathta shqiptare tregoi më shumë kujdes në institucionalizimin e partneritetit aktorë të ndryshëm të shoqërisë civile, duke mos mbetur në nivelin e kontakteve individuale dhe sporadike. Duhet thënë se, veçanërisht pas zgjedhjeve lokale të vitit 2000, opinionit publik iu servir një terminologji konfuze kur ishte fjala për të emëruar në poste shtetërore kyçe njerëz që gjoja nuk mishin politikisht në shërbim të pushtetit shtetëror. Për opinionin e gjerë publik kjo krijoi një lloj konfuzioni në përpjekjet e tyre për të kuptuar realisht konceptin e “shoqërisë civile”.

⁵ Lloj i sistemit politik ku partitë përpiqen të monopolizojnë gjithë jetën politike të vendit, duke përfshirë aktorët e tjerë.

Hapja ndaj shoqërisë civile nuk mund të bëhet me fushata dhe në mënyrë spontane, për interesa elektorale të çastit, duke rekrutuar në detyra të rëndësishme shtetërore njerëz “jopolitikë”, dhe që nuk njihen për kontribute në shoqërinë civile. Një teprim i tillë në kooptimin në detyra shtetërore të individëve të paangazhuar politikisht bie në sy veçanërisht në veprimtarinë e Partisë Socialiste (Pëllumbi 2002: 96-102; shih, gjithashtu, Shkullaku 2000). Shumë prej OJF-ve u mungon legjitimiteti i funksionimit të tyre në mënyrë autonome nga pushteti shtetëror. Një funksionim i tillë i segmenteve të shoqërisë civile shqiptare, e cila bëhet pjesë a pandashme e veprimeve shtetërore nën varësinë e plotë të ekzekutivit, shfaq rrezikshëm shenjat e një “demokracie të deleguar”, homogenizim të imponuar qëndrimesh dhe veprimesh politike, që nuk sjellin asgjë tjetër veçse mbylljen, atomizimin dhe “strukturimin” e shoqërisë shqiptare, sipas interesave të caktuara politike.

Përpjekjet për të vendosur një lidhje të pjesëve përbërëse të shoqërisë civile me *të majtën* nuk janë karakteristikë vetëm e politikës shqiptare. Duke shfrytëzuar rënien e regjimeve komuniste në Europën Qendrore e Lindore, Hilary Wainwright (1994) tregon sesi lëvizjet sociale në shoqërinë civile dështuan në organizimin e partive politike për të mbushur vakumin e pushtetit të lënë nga komunistët, me çka kjo autore nënkupton vonesën në kuptimin e nevojës për reforma të shtetit dhe shoqërisë civile në kuadrin e një organizimi dhe orientimi të ri partiak të spektrit të majtë.

Në rastin e Shqipërisë, qëllimi i “bashkërendimit” të veprimeve të pushtetarëve me elementë të “shoqërisë civile” ka krijuar, në fakt, një lloj sistemi oligarkist të rrezikshëm, që trashëgohet nga e kaluara dhe synon të sigurojë “ushtrimin e kontrollit” në shoqërinë shqiptare. Kjo shpjegon, deri diku, mendimin që mbizotëron sot për shumë drejtues të OJF-ve si njerëz servilë, të korrumpuar, shërbëtorë të verbër të pushtetit etj. Dykuptimësia në qëndrime nuk ka munguar. Duke u bërë një me pushtetin, njerëz të tillë cenojnë dy elemente të rëndësishme të funksionimit të tyre: pavarësinë dhe paanshmërinë. Kjo nuk do të thotë se shoqëria civile duhet të jetë kundërshtarë me shtetin, por kurrsesi nuk duhet të njësohet me të⁶. Po ashtu, ajo nuk mund të jetë identike as me opozitën politike.

Përfundime

Tranzicioni demokratik në Shqipëri ka njohur zhvillime problematike, jo vetëm të karakterit politik, ekonomik e institucional, por dhe një mungesë të kulturës politike dhe të edukatës qytetare demokratike. Për kultivimin e kësaj të fundit, roli i shoqërisë civile është i pazëvendësueshëm, edhe pse përvoja shqiptare flet për një koncept ende

⁶ Lidhur me këtë pozicion të shoqërisë civile ka pasur mjaft debate në shtypin shqiptar. Për më tepër, lexo: Mustafa Nano (2004). Ky autor polemizon me publicistin e njohur Fatos Lubonja, i cili në një artikull të tij botuar në gazetën *Korrieri*, hedh një vështrim kritik ndaj lëvizjes “Mjaft”, si shembull aktiv i shoqërisë civile për pozicionin e saj kundërshtues ose komplementar me shtetin. Lubonja i referohet filozofit anglez të shekullit të 17-të, John Locke, për të shpjeguar funksionet dhe natyrën e shoqërisë civile, ndërsa Nano u referohet autorëve të tjerë, më të vonshëm, si Ralf Dahrendorf. Sipas këtij të fundit, shoqëria civile nuk është një grumbull OJQ-sh, por një shoqëri e kultivuar me qytetarë të kultivuar.

të paqartë dhe të paqëndrueshëm të shoqërisë civile. Debatet mbi kuptimin shkencor të shoqërisë civile kanë qenë dhe janë të shumta, duke nisur prej shpjegimeve që e identifikojnë atë me shtetin dhe me shoqërinë politike, deri te pozicionet e sotme që e ndajnë atë prej të tyre.

Në Shqipëri nuk kanë ekzistuar kushtet për lindjen e një shoqërisë civile sipas modelit liberal perëndimor. Individit, në këtë vend, nuk gëzoi statusin e një aktori të pavarur social. Çdo strukturë në Shqipëri ka qenë detyrimisht pjesë e strukturave politike të regjimit në fuqi. Tradita e pakët dhe e pazhvilluar e shoqërisë civile, para vendosjes së regjimit komunist, u pasua me shuarjen e plotë të saj nën këtë regjim dhe, pas vitit 1991, me përpjekje për të ringritur dhe formësuar një koncept të tillë, sipas kuptimit modern e demokratik. Megjithatë ky koncept u bë kryefjala e shumë artikujve, e konferencave dhe e debateve politike e publike gjatë gjithë periudhës së tranzicionit, përsëri ai është përdorur më shumë si një “slogan politik”, veçanërisht nga partitë në pushtet, gjë që, siç pohon Seligman (1992: 200), ka ndodhur edhe në vende të tjera ish-komuniste të Europës Lindore.⁷ Një (keq)përdorim i tillë ka bërë që aktorët e shoqërisë civile ose segmente të caktuara të saj të mos konkretizojnë dot lëvizje të rëndësishme sociale, si dhe të lëkunden në kritikën e tyre ndaj politikave qeveritare.⁸

Interesi ynë, sidoqoftë, mbetet përdorimi i këtij koncepti si koncept *analitik*⁹, sepse nëpërmjet tij mund të arrijmë të përshkruajmë dhe të shpjegojmë forma të caktuara të fenomeneve shoqërore, të organizimit social në të gjitha nivelet dhe, në tërësi, të lidhjes dhe ndërveprimit të tyre në funksion të analizës shoqërore. Siç argumenton Keith Faulks (2000: 143), “Një vullnet në emër të qytetarëve për të marrë pjesë plotësisht në qeverisjen e jetës së tyre është qendror për lulëzimin e shoqërisë civile”. Pjesëmarrja në politikë është një shprehje e qytetarisë demokratike. Kjo nuk nënkupton thjesht të qenit anëtar i një force të caktuar politike, ose i një grupi presioni, por të qenit aktiv në organizatë. Pjesëmarrja politike është një proces aktiv dhe një angazhim i vazhdueshëm i individëve ose i grupeve të caktuara në procesin politikëbërës që ndikon mbi jetën tonë. Kjo përfshin si proceset vendimmarrëse, ashtu edhe veprimet opozitare ndaj qeverisjes. Veprimet politike mund të jenë brenda

⁷ Afrim Krasniqi (2004) argumenton se, pas vitit 1990, koncepti i shoqërisë civile në Shqipëri është përdorur më shumë në kuptimin utopik sesa në një kuptim realist të fjalës.

⁸ Duhet pranuar, megjithatë, se përgjatë viteve janë shënuar zhvillime pozitive. Për shembull, Zyra e Mbrojtjes së Qytetarëve, Lëvizja “Mjaft” dhe Zyra “Antikorrupsion” kanë bërë kritika të ashpra dhe të argumentuara ndaj politikave qeveritare në ndërmarrjen e disa reformave të dyshimta dhe jokonsensuale. Kritikën e tyre kanë shkaktuar pakënaqësi te qytetarët dhe kanë gjetur simpatinë dhe mbështetjen e publikut. Ato kanë denoncuar, në veçanti, rastet e korrupsionit, dhunimin e disa të drejtave të qytetarit, veprimet dhe vendimet abuzive të KESH-it (Korporatës Energjetike Shqiptare) dhe të TELEKOM-it. Po ashtu, në fillim të qershorit 2004, përfaqësues të shoqërisë civile i bënë thirrje kryeministrit Fatos Nano që të hedhë poshtë Marrëveshjen me shoqërinë italiane “Albaniabeg Ambinet”, e cila do të ndërtonte një impiant për trajtimin e mbetjeve dhe importimin e plehrave nga Italia. Ndër to ishin përfaqësues të Lëvizjes “Mjaft”, Këshilli Rinor Shqiptar, Fondacioni i Shoqërisë së Hapur, REC, SEDA, Instituti i Politikave Sociale, Shoqata e Bujqësisë Organike, iSiS, QSKOM, CoPlan, Klubi Studentor Ambientalist Shqiptar, përfaqësues të biznesit, etj. (Gazeta *Shekulli* Online, 2 qershor 2004).

⁹ Përdorimi si koncept *normativ* lidhet me tensionet që lindin mes individualizmit dhe komunitetit, interesave të veçanta dhe atyre universale, të cilat janë trajtuar nga Seligman (1992: 205).

dhe jashtë partive politike. *Pjesëmarrja*, siç argumente Alexis de Tocqueville, është një parakusht i domosdoshëm për lirinë tonë.

Me ndryshimet sociale dhe politike që janë realizuar në Shqipëri pas vitit 1990, pjesëmarrja politike si nocion demokratik është zgjeruar dukshëm dhe janë shtuar format shprehëse të saj, por me kalimin e kohës ka ndodhur zbehja e disa aspekteve të tyre, si rezultat i zhvillimeve komplekse të tranzicionit demokratik. Vendi ynë pritet të ballafaqohet me disa tendenca negative, të cilat reduktojnë pjesëmarrjen politike efektive të qytetarëve në qeverisje. Vihet re një rënie e besimit të qytetarëve ndaj institucioneve shtetërore dhe ndaj elitës politike. Shoqëria shqiptare mbetet, në përgjithësi, një shoqëri me besim të ulët dhe kjo reflektohet kudo, jo vetëm në tregues të sjelljes dhe në disa tregues të tjerë verbalë, por edhe në aspekte të drejtimit të organizatave të ndryshme, të vogla ose të mëdha. Për arsye të mungesës së besimit, ka hezitim të delegimit të përgjegjësive në nivele më të ulëta të organizatave.

Shumëfishimi i elementeve kulturorë të shoqërisë civile pa rritur shkallën e demokratizimit të atyre ekzistuese nuk do mund të ndikonte në rritjen e besueshmërisë së shoqërisë civile. Demokratizim do të thotë praktikim procedurash demokratike në mënyrë periodike në të gjithë jetën e asociuar për zgjedhjen e drejtuesve, të bordeve, ose të kryesive të organizatave ose shoqatave të ndryshme, sipas rregullave statutores, aplikim i demokracisë së tyre të brendshme, që ato që të bëhen, siç thoshte Tocqueville, “në shkollë për demokracisë”. Kjo do ta ndihmonte shoqërinë civile të rriste mbështetjen dhe simpatinë e publikut, të aktorëve të ndryshëm socialë e politikë dhe, kësaj, të ndikonte më shumë në procesin politikëbërës dhe në atë vendimmarrës, duke demonstruar rolin dhe peshën e vërtetë të saj.

Është e rëndësishme të kuptohet se pushteti ekzekutiv, prej vetë natyrë së tij, është vetpërforsues. Nëse nuk do të ekzistonin format e tjera të pushtetit, rreziku që pushteti ekzekutiv të forcohej pa kufi do të rritej. Pikërisht për këtë arsye, pushtetet e tjera janë të nevojshme për të balancuar të parin, si edhe për të krijuar një sistem normal të funksionimit të sistemit politik. Sa më shumë qendra pushtetesh të ketë në një shoqëri të hapur, aq më efektiv është mekanizmi i kontrollit mbi to dhe i balancës ndërmjet tyre. Ky përbën një element të qenësishëm të funksionimit normal të një sistemi demokratik.

Shoqëria civile shqiptare lipset të kuptojë më qartë këtë mënyrë funksionimi të pushteteve, duke kultivuar dhe mbrojtur vazhdimisht ekzistencën e disa grupeve me interesa të caktuara, por që kundërshtojnë çdo lloj pushteti dominant. Një funksion domethënës i asaj që *realisht* quhet shoqëri civile duhet të jetë rregullimi i balancës pozitive/opozitive, dhe jo njësimi me më të pushtetshmin. Vetëm pavarësia dhe paanshmëria i japin gjallëri dhe besueshmëri shoqërisë civile. Kjo fillon me pavarësinë dhe iniciativën e lirë të individit dhe me veprimtarinë e asociuar të tij. Zhvillimi i shoqërisë civile mund të jetë i suksesshëm nëse arrihet të kuptohet se janë lëvizjet sociale qytetare, dhe jo vetëm ato të partive politike, ato që mund të artikulojnë kërkesa për ndryshime pozitive në jetën e shoqërisë, si kundërpërgjigje ndaj krizave të ndryshme që mund të përfshijnë vendin. Demokracia nuk është pronë e partive politike dhe e njerëzve të përfshirë në to, por një proces i hapur, në të cilin qytetarët

dhe lidhshimet politike mund dhe duhet të ndërveprojnë në forma të ndryshme.

Shoqëria civile në Shqipëri vazhdon të jetë një sektor me probleme në strukturë, në përbërje, burime financimi, kontribute ekonomike etj., edhe pse vihet re një rigjallërim i këtij sektori, nxitje e debateve publike për çështje delikate, si media, ruajtja e mjedisit, jeta politike etj. Sidoqoftë, ky sektor, në Shqipëri, rrezikohet nga mungesa e qëndrueshmërisë, si rezultat i tërheqjes së donatorëve të huaj për arsye të ndryshme, i skarcitetit të burimeve financiare lokale, i mungesës së koordinimit dhe i një infrastrukture të dobët të rrjetit të OJF-ve, i nënvlerësimit të rolit që ka trajnimi i drejtuesve të tyre për të rritur kapacitetet ndërtuese dhe krijuese etj.

Në analizë të fundit, qytetarët shqiptarë, grupet dhe organizatat e interesit, madje edhe elita e re politike, po mësojnë si të sillen ndryshe, duke u risocializuar në rrethana të reja. Është e rëndësishme që partitë politike, kuvendi, ligjvënësit, të mbajnë një qëndrim pozitiv ndaj grupeve të interesit, duke i konsideruar ato si elemente thelbësore të demokracisë parlamentare, të njohin ndikimin e tyre politik dhe të vlerësojnë kontaktet e afërta dhe të shpeshta me to si të domosdoshme.

Në përfundim, mund të thuhet se shoqëria civile shqiptare lipset të ridimensionojë rolin dhe misionin e saj në kushtet e sotme, të demokratizojë strukturat e saj civile për ta marrë më seriozisht programin e modernizimit rrënjësor të shoqërisë shqiptare, si e vetmja rrugë për t'u integruar në Europë dhe për të përmbushur shpresat e qytetarëve shqiptarë për një shtet demokratik të konsoliduar.

Bibliografia

- Ágh, Attila. 1996. "The Europeanization of the ECE: Business Interest Associations: The Models in Western Europe and the European Union", ff. 79-91, në Attila Ágh & Gabriella Ilionszki (eds.), *Parliaments and Organized Interests: The Second Steps*. Budapest: Centre for Democracy Studies.
- Bellah, Robert N., Richard Madsen, William M. Sullivan, Ann Swidler & Steven M. Tipton. 1991. *The Good Society*. New York: Knopf.
- Eberly, Don E. (ed.). 2000. *The Essential Civil Society Reader. The Classic Essays in the American Civil Society Debate*. Lanham, MD: Rowman & Littlefield Publishers.
- Etzioni, Amitai. 2000. "Communitarianism and the Moral Dimension", ff. 123-139, në Don E. Eberly (ed.), *The Essential Civil Society Reader. The Classic Essays in the American Civil Society Debate*. Lanham, MD: Rowman & Littlefield Publishers.
- Faulks, Kaith. 2000. *Political Sociology A Critical Introduction*. New York: New York University Press.
- Jean Bethke Elshain (2000). "Democracy on Trial: The Role of Civil Society in Sustaining Democratic Values", ff. 101-122, në Don E. Eberly (ed.), *The Essential Civil Society Reader. The Classic Essays in the American Civil Society Debate*. Lanham, MD: Rowman & Littlefield Publishers.
- Faulks, Keith. 2000. *Political Sociology: A Critical Introduction*. New York: New York University Press.

- Fink-Hafner, Danica. 1996. "Organized Interests as Policy Actors in Slovenia", ff. 222–240 në Attila Ágh & Gabriella Ilonszki (eds.), *Parliaments and Organized Interests: The Second Step*. Budapest: Hungarian Centre for Democracy Studies.
- Giddens, Anthony. 1994. *Beyond Left and Right*. Cambridge: Polity Press.
- Gramsci, Antonio. 1971. *Selections from the Prison Notebooks*. London: Lawrence & Wishart.
- Himmelfarb, Gertrude. 2000. "The Demoralization of Society: What's Wrong with Civil Society", në Don E. Eberly (ed.), *The Essential Civil Society Reader. The Classic Essays in the American Civil Society Debate*. Lanham, MD: Rowman & Littlefield Publishers.
- Hirst, Paul. 1994. *Associative Democracy: New Forms of Economic and Social Governance*. Cambridge: Polity Press.
- Krasniqi, Afrim. 2004. *Shoqëria civile shqiptare: Historia e lindjes, zhvillimit dhe sfidat e saj*. Tiranë: Geer.
- Linz, Juan J. & Alfred Stepan. 1996. *Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America and Post-Communist Europe*. Baltimore: The John Hopkins University Press.
- Lippmann, Walter. 1937. *The Good Society*. Boston, MA: Little, Brown & Co.
- Mills, C. Wright. 1956. *The Power Elite*. New York: Oxford University Press.
- Nano, Mustafa. 2004. "Shoqëria civile nuk është kundër shtetit", *Shekulli*, 22 janar 2004.
- Pëllumbi, Servet. 2002. *Sprova në sociologjinë politike*. Tiranë: Botimet DUDAJ.
- Putnam, Robert. 1993. *Making Democracy Work: Civic Traditions in Modern Italy*. Princeton: Princeton University Press.
- Rawls, John. 1996. *Political Liberalism*. New York: Columbia University Press.
- Rush, Michael (ed.). 1990. *Parliament and Pressure Politics*. Oxford: Clarendon Press.
- Salamon, Lester M. 1994. "The Rise of the Nonprofit Sector", *Foreign Affairs* 74, 3: 109-122.
- Schambra, William A. 2000. "The Progressive Assault of Civic Community", ff. 317-351, në: Don E. Eberly (ed.), *The Essential Civil Society Reader. The Classic Essays in the American Civil Society Debate*. Lanham, MD: Rowman & Littlefield Publishers.
- Seligman, Adam B. 1992. *The Idea of Civil Society*. New York: Free Press.
- Sinani, Gjergj. 2000. *Shoqëria civile*. Tiranë.
- Shkullaku, Armand. 2000. *Debati për shoqërinë civile*. Tiranë: AIM Press.
- Tismaneanu, Vladimir. 2001. "Civil Society, Pluralism, and the Future of East and Central Europe", *Social Research* 68, 4: 977-991.
- Wainwright, Hilary. 1994. *Arguments for a New Left: Answering the Free Market Right*. Oxford: Blackwell.

*Demokratizimi dhe sociologjia publike në Shqipërinë postkomuniste***

Emiliano Llazo & Eneda Tarifa*

Abstrakt

Në këtë ese trajtohet roli i sociologjisë publike si pjesë e panoramës së sotme të shkencave sociale lidhur me pozicionin e saj të mundshëm për zhvillimin e disiplinës së sociologjisë dhe premisat teorike mbi të cilat ajo mund të ngrihet. Qëllimi i këtij trajtimi është për të përpunuar konceptin e një sociologjie publike njëkohësisht shkencore dhe efektive në zgjidhjen e problemeve sociale. Me këtë kombinim ne shpresojmë që sociologjia publike të mund ta pasurojë traditën profesionale dhe kritike të disiplinës, duke reflektuar karakteristikat dhe nevojat e një shoqërie në tranzicion. Premisa bazë e qasjes sonë ka të bëjë me idenë se sociologjia publike mund të fokusohet në problemet lokale që hasin shoqëritë njerëzore sot, probleme të cilat janë të fshehura ose të paparaqitura në diskutimin publik profesional. Synimi kryesor i këtij fokusi është kalimi nga horizonti i ngushtë i sociologjisë akademike në konsultimin me parashtrimin e lirë të qytetarëve mbi problemet që nuk janë të përfaqësuara në debatin publik, përfshi atë akademik.

* Eneda Tarifa kreu studimet në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës në degën Filozofi-Sociologji (2000-2004), dhe është diplomuar në Masterin e Nivelit të Dytë për Sociologji / Politika, Shoqëria dhe Demokratizimi (2008-2010). Është bashkë-autore e disa artikujve. Emiliano Llazo ka kryer studimet 4-vjeçare në Fakultetin e Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës, në degën Filozofi-Sociologji (1997-2001), dhe është diplomuar në Universitetin European të Tiranës në Masterin e Nivelit të Dytë për Sociologji (2008-2010).

** Ky punim është referuar në Konferencën Kombëtare “Shkencat Sociale dhe Shoqëria Shqiptare në Tranzicion”, organizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Politikave dhe Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin European të Tiranës (UET), më 19 nëntor 2010.

Hyrje

Shoqëria shqiptare vijon të jetojë tranzicionin e saj, qoftë drejt një shoqërie më të mirë ose më demokratike, e me një harmoni më të madhe shoqërore ose politike, qoftë ky i kuptuar edhe si tranzicion drejt integritimit në BE. Tranzicioni ka natyrën e tij deri diku të papërcaktueshme, megjithatë, përpjekja për ta kapërcyer atë konsiston në një rend më të strukturuar shoqëror, ku pritshmëritë e qytetarëve përputhen më shumë me praktikatat konkrete që zbatohen në jetën e përditshme.

Sociologjia, si çdo fushë tjetër e studimi dje angazhimi shoqëror, po e përjeton këtë tranzicion duke ecur drejt një konfigurimi më të plotë, më shkencor dhe më në përputhje me kërkesat e kohës. Por, a mund të kontribuojë sociologjia në procesin e tranzicionit, pra a mund të ndihmojë ajo në zhvillimet demokratike, përveçse të jetë pjesë e saj? Ne mendojmë se po. Sociologjia mund të kontribuojë në zhvillimin pozitiv të tranzicionit, dhe një prej mënyrave me anë të së cilës ajo mund ta bëjë këtë, është përmes *rolit publik* të saj, pra, duke u zhvilluar edhe si *sociologji publike*.

Pavarësisht zanafillës amerikane të debatit mbi sociologjinë publike, kjo e fundit ka marrë sot rëndësi jo vetëm në Shtetet e Bashkuara, por edhe në vende të tjera të Europës. Përfaqësuesi më i rëndësishëm i saj, Michael Burawoy, i cili e formuloi konceptin e sociologjisë publike (*public sociology*) në mes të viteve 2000, shkruan për të me entuziazëm, duke pohuar se “flakët e saj janë përhapur edhe në vende të tjera” (Burawoy 2009: 450). Kësisoj, Shqipëria nuk ka pse të mungojë në këtë debat. Ne dëshirojmë të bëhemi pjesë e diskutimit mbi rolin e sociologjisë publike, duke ua përshtatur konceptet dhe idetë e saj kontekstit dhe karakteristikave lokale, si edhe specifikave tipike të një shoqërie në tranzicion. Në këtë mënyrë, sociologjia publike mund të ofrojë edhe një *feedback* të përvojave të saj, duke ekspozuar sidomos vështirësitë dhe problemet që mund të hasë aplikimi konkret i saj.

Sociologjia publike është një sociologji që i drejtohet *publikut*. Ajo ndërtohet me qëllimin e thjeshtë që dija sociologjike të komunikohet në grupe të ndryshme të shoqërisë; rrjedhimisht gjuha e saj është një gjuhë e thjeshtë dhe e kuptueshme. Në këtë esë, fillimisht trajtojmë disa çështje të aspektit dhe të problemeve teorike të saj, sidomos të natyrës së marrëdhënieve mes sociologjisë dhe publikut, të raporteve mes fushave të ndryshme brenda vetë disiplinës, për të vijuar me disa probleme specifike që hasen në kontekstin e shoqërive në tranzicion, si edhe për të sugjeruar sesi sociologjia publike mund të kontribuojë në këto shoqëri.

Lindja e një profili të ri sociologjik

Një rol i ri për sociologun

Në fjalën e tij, mbajtur përpara Shoqatës Sociologjike Amerikane (*American Sociological Association—ASA*) në vitin 2005, të titulluar “Për sociologjinë publike”, Michael Burawoy prezantoi një vizion të ri mbi raportin e fushave

të ndryshme të sociologjisë. Sipas këtij vizioni, dija sociologjike ndahet në katër tipa të ndryshëm, ose specializime, të cilat janë: sociologjia *profesionale*, sociologjia *e politikave*, sociologjia *kritike* dhe sociologjia *publike*. Marrëdhënia mes tyre është komplementare, pavarësisht se ato përfaqësojnë mënyra të ndryshme të formulimit të dijes dhe, rrjedhimisht, prodhojnë qëndrime kritike për njëra-tjetrën.

Burawoy vlerëson se, në qendër të sociologjisë publike, ndryshe nga tre format e tjera të sociologjisë, qëndron interesi i hyrjes në dialog me publikun. Kjo marrëdhënie e sociologut me publikun e bën sociologjinë publike të veçantë nga format e tjera të sociologjisë edhe në përmbajtje dhe i jep asaj mundësinë të prodhojë ide të reja mbi formulimin dhe përdorimin e dijes sociologjike, si dhe të ngrejë një sërë pikëpyetjesh, debatesh dhe kundërshtish dhe, në këtë kuptim, të nxisë edhe debatin mbi rolin e sociologjisë në jetën e shoqërisë.

Ideja e një sociologjie publike ka nxitur me të drejtë entuziazmin te shumë sociologë të rinj, sepse ajo hap shtigje të reja për të motivuar punën e sociologut, duke u bërë një vlerë e shtuar ndaj nxitjeve standarde dhe dijes konvencionale që ai përdor. Në një farë mënyre, sociologu tashmë mund të frymëzohet edhe nga vetë publiku, pasi duke aplikuar sociologjinë publike, ai kombinon dijet dhe ekspertizën e tij me interesat dhe nevojat e komunitetit, i cili, në ndërveprim me sociologun, kthehet në *publik me një zë të veçantë në shoqëri*. Pra, sociologjia publike ka meritën se bashkon, siç shkruan Craig Calhoun (2005: 355), “inkurajimin për të qenë aktivë në sferën profesionale, me vetëvlerësimin e sociologëve për punën e tyre”.

Entuziazmi lind edhe nga ideja tjetër shoqëruese e sociologjisë publike, sipas të cilës, dija akademike ka tendencën të krijojë një lloj përshtatjeje me status-quonë, duke shmangur, siç shprehet Calhoun, frymën kritike dhe atë të “eksplorimit të plotë dhe të vërtetë të botës” (ibid, 430). Me fjalë të tjera, sociologjia publike, përballet me ndryshimin social dhe e përcjell atë në fushën e mendimit, duke informuar për kushtet e reja që hasen në jetën e përditshme. Në këtë mënyrë, përveç komunikimit të drejtpërdrejtë me publikun, ajo bëhet nxitëse e rinovimeve edhe në aspektin teorik të dijes.

Por, përse duhet të flasim për një rol të ri të sociologut, krahas roleve të tjera të mirënjohura tradicionale? Çfarë janë këto role të tjera, dhe cili është dallimi mes tyre? Përse, në fund të fundit, kemi një antagonizëm mes rëndësisë që i jepet njëres ose tjetrës sociologji, në raport me të tjerat? Burawoy shpjegon se *sociologjia publike* dallon nga *sociologjia e politikave* sepse, ndërsa kjo e fundit ka si specifike faktin se ajo është “në shërbim të një qëllimi të përcaktuar nga një klient” (Burawoy 2007: 31), sociologjia publike thekson një “marrëdhënie dialoguese mes sociologut dhe publikut, ku prezantohet agjenda e secilit dhe ku secila palë korrigjon tjetrën”. Së dyti, sociologjia publike dallon nga *sociologjia profesionale*, të cilën Burawoy e konsideron një “sine qua non” të sociologjisë publike dhe asaj të politikave. Karakteristikë e sociologjisë profesionale, sipas tij, është se në përpjekjen e saj legjitime për të zgjidhur çështje të kërkimit shkencor përmes programeve të ndryshme si, për shembull, përmes teorive të organizatave, sociologjisë së kulturës, sociologjisë politike, sociologjisë së familjes, sociologjisë ekonomike etj, ajo krijon natyrshëm çështje dhe pikëpyetje të reja, të cilat sociologët profesionistë mund të përpiqen t’i shmangin, siç thotë ai, për të shpëtuar “faqen” e tyre (ibid, 33).

Këtë problem, argumenton Burawoy, e trajton lloji i tretë i sociologjisë, *sociologjia kritike*, e cila “ekzaminon themelet e dukshme dhe të padukshme, normative dhe deskriptive, të programeve të kërkimit të sociologjisë profesionale” (ibid). Sociologjia kritike, sipas tij, parashtron dy pyetje të rëndësishme për sociologjinë publike: “Për kë bëjmë sociologji?”—pra kujt i drejtohem kur përpunojmë dije sociologjike—dhe “Për çfarë bëjmë sociologji?”—pra, a duhet të merremi me qëllimet e shoqërisë ose vetëm me “mjetet për t’i arritur këto qëllime”? Sociologjia publike i përgjigjet kësaj pyetje duke e çuar mendimin sociologjik te publikët e interesuar, për të mbrojtur interesat dhe vlerat e tyre bazë. Pra, sociologjia bëhet për një publik konkret, dhe në mbrojtje të qëllimeve konkrete të këtij publiku.

Interesat e publikut mund të shihen si probleme që lindin si nga *pabarazia e theksuar sociale*, ashtu dhe si çështje të të mirave publike, pra të atyre të mirave që janë në shërbim të të gjithëve, përkundrejt të mirave që ofron tregu, pra të mirave private. Mes këtyre dy aspekteve, duhet ruajtur një ekuilibër i drejtë, për të cilin një rol të rëndësishëm duhet të ketë edhe sociologu publik. Në veprën e tij tashmë klasike *Turma e vetmuar* (*The Lonely Crowd*), David Riesman shkruan se, ndonjëherë, shoqëritë (në rastin e tij ajo amerikane), nuk kanë nevojë për më tepër prodhim ose bollëk, por “për më tepër të mira publike, si për shembull ajër, rrugë dhe ujë më të pastër” (Riesman [1950] 1961: xvii). Sigurisht që pamja e kundërt me këtë, pra të mirat publike kundrejt një varfërie të tregut, nuk është e preferueshme. Për këtë arsye, flasim për një ekuilibër mes të dy aspekteve.

Por, edhe në këndvështrimin e pabarazive sociale, parë si pabarazi të publikëve, ose si gjendje e vështirë e një publiku të zhvlerësuar, sociologjia publike gjendet sërisht në mbrojtje të një komuniteti. Në këtë rast, ajo nuk mbron publikun në përgjithësi, por atë publik të veçantë, i cili është i përjashtuar nga të mirat publike, për shkak të një pozicioni të margjinalizuar të tij. Shembulli më tipik i këtij rasti janë të përjashtuarit socialë, të cilët duket se jetojnë të paintegruar organikisht në shoqëri. Një përfaqësuese e një sociologjie publike të tillë është Patricia Hill Collins, e cila e kupton angazhimin e sociologut si një përpjekje “për të lidhur vizionet për një shoqëri më të mirë me strategjitë pragmatike sesi t’i kthesh këto vizione në realitet” (Collins 2007: 105).

Në mënyrë të përmbledhur, sociologjinë publike mund ta shohim si sociologji që (a) hyn në *dialog* me publikët; (b) që përdor dije *refleksive* për të bërë të mundur reagimin ndaj gjendjes së publikëve të ndryshëm; (c) që ka si vlera bazë *humanizmin* dhe të drejtat e njeriut; dhe që, siç shprehet Burawoy, (d) ka nevojë edhe për një përshtatje në sistemim universitar, ku sociologjia publike të ketë vendin e saj të veçantë *akademik* (shih Land 2008). Për këtë çështje do të flasim më poshtë.

Kufizimet dhe vështirësitë e sociologjisë publike

Vështirësia me konceptin e sociologjisë publike dhe rolin e sociologut në shoqëri ka të bëjë me faktin se, nga njëra anë, sociologu nuk mund ta shmangë subjektivitetin e tij në punën shkencore, dhe së dyti, se angazhimi i tij në publik mund ta largojë

atë nga shkenca dhe ta kthejë në instrument të interesave të tjera ekstra-akademike. Rrjedhimisht, ndërsa angazhimi i sociologut në çështjet publike është një akt për t'u respektuar, ky pozicion nuk mund të ketë rol qendror, pasi ai e implikon sociologjinë qoftë në probleme morale, si ato të privacisë ose të mbajtjes së anëve në debate të ndryshme joshkencore, ashtu dhe në probleme politike, të cilat në fund mund të rezultojnë si përdorime të sociologut nga pushteti. Këtu nuk duhet harruar as problemi qendror i saktësisë së vetë dijes, e cila nuk mund t'i ofrohet publikut si një dije definitive dhe e saktë. Arthur Stinchcombe mendon se dija sociologjike nuk është aq e përpunuar sa të mund të sugjerojë veprimet në fusha jashtë saj. Sipas tij, “ne nuk kemi shumë të vërteta për të ofruar, për t'i dhënë formë diskutimit [politik], aq sa ai të përmirësojë politikat ose kuptimin e publikut për situatën ku ndodhet” (Stinchcombe 2007: 135). Ndaj, që të mund të sugjerojë diçka edhe në fushën e politikave, studimet dhe reflektimet sociologjike duhet të fokusohen në të ardhmen, ose në të kuptuarit e atyre faktorëve që ndikojnë tek ajo.

Edhe vetë Burawoy vlerëson se sociologjia publike përmban disa rreziqe. Në aplikimin e saj, duke qenë një sociologji që komunikon me publikët dhe zëri i së cilës dëgjohet përtej katedrave akademike dhe debateve profesionale, sociologjia publike është e rrezikuar nga tendenca për t'i shërbyer popullaritetit të sociologut si qëllim në vetvete, të cilën mund ta bëjë duke “kënaqur dhe ledhatuar publikët e saj” (Burawoy 2007: 44). Pra, rreziku i parë është se sociologu vihet thjesht në funksion të suksesit të tij në publik. Por jo më pak i madh është një rrezik tjetër, të cilin Burawoy e quan “avangardizëm intelektual”. Këtu mund të jetë fjala për kuptimin e statusit jopërfundimtar të dijes sociologjike, gjë e cila, nëse nuk mbahet parasysh, mund të prodhojë qëndrime jo të përshtatshme të sociologut në publik.

Sidoqoftë, Burawoy shmang, ose lë pa përmendur, një rrezik të tretë, atë se sociologët duhet ta shohin veten si publik dhe “të bëhen pjesë e jetës politike kombëtare”. Këtu, shqetësimi lind kur analizojmë kuptimin e përcaktimit të një publiku të caktuar si të tillë. Nëse publikun e konceptojmë si një grup njerëzish, të cilët i bashkon një problem ose një interes i përbashkët, për sociologët problemi i angazhimit politik nuk ekziston (për sa i përket veprimtarisë *si sociologë*), përderisa kjo nuk bën pjesë në punën e tyre, ndërsa interesi i përbashkët i sociologëve është dhe duhet të jetë zbulimi dhe përpunimi i dijes mbi shoqërinë, dhe jo angazhimi politik (Burawoy 2007: 30).

Immanuel Wallerstein (2007: 169), nga ana e tij, shprehet kundër asocimit të intelektualit me një lëvizje politike ose sociale, pasi në këtë rast ai do të duhet t'u shërbejë manovrave dhe ndryshimeve të detyruara të lëvizjes në të cilën ai aderon. Për këtë arsye, Wallerstein propozon një rrugëtim të sociologut nëpër tre faza, që përbëjnë tre funksione të pashmangshme të punës së tij. Këto funksione janë: (a) të përpiqet të *analizojë* në mënyrë sa më të argumentuar çështjen që shqyrton, (b) të *vlerësojë* me seriozitet implikimet morale të realiteteve që studion, dhe të aplikojë një zgjidhje racionale për to dhe, (c) të *sugjerojë* mënyrën më të mirë për të realizuar të mirën morale, siç i ka rezultuar nga analiza e tij. Në këtë mënyrë sociologu, sipas tij, me analizën që u bën fenomeneve sociale, shton një rekomandim dhe një alternativë

në mënyrat sesi politika mund t'i trajtojë çështjet që ka përpara saj. Kjo bëhet e nevojshme edhe për shkak se zgjedhjet dhe veprimtaria politike, duke mos qenë individuale, por të një grupi të caktuar politik, nuk janë asnjëherë më të mirat e mundshme, dhe *ipso facto*, kontributi i intelektualit këtu gjithnjë ka vend (Wallerstein 2007: 173-174).

Në këtë kontekst të problemeve dhe të nevojave të sociologjisë publike, aspekti më i kontestuar i propozimeve që bën Burawoy është ai i *institucionalizimit* të sociologjisë publike, pra e dhënies së një statusi të barabartë me sociologjinë profesionale dhe, rrjedhimisht, edhe të fondeve dhe të vendeve akademike në të njëjtën mënyrë. Vështirësitë e sociologjisë publike qëndrojnë në natyrën e saj. Ato nuk shmangen dot. Sidoqoftë, Burawoy vë në dukje se rrënjët e ndarjes mes sociologjisë publike dhe asaj profesionale vijnë nga rangu akademik. Kjo sepse “sociologët me pozicione të larta kanë tendencën të mbrojnë një konceptim të ngushtë shkencor të sociologjisë”, ndërsa të tjerët, në pozicione më të ulëta, “mbrojnë një përkufizim më të gjerë të fushës, pra si një disiplinë që përfshin sociologjinë kritike, të politikave dhe atë publike si dije të veçanta” (Burawoy 2009: 453). Prej këtu vjen edhe konceptimi bordjean i “luftës për sociologjinë publike” brenda vetë botës akademike.

Skema katërpërmasore që sugjeron Burawoy nuk është gjë tjetër veçse ndarja e aspektit instrumental dhe reflektiv të mendimit sociologjik, ku kjo e fundit ndahet në mendim reflektiv mbi sociologjinë profesionale dhe mendim reflektiv mbi sociologjinë e politikave. Skema paraqitet si më poshtë (Burawoy 2009: 454):

	<i>Audienca akademike</i>	<i>Audienca jashtë-akademike</i>
Dija instrumentale	Profesionale	E politikave
Dija refleksive	Kritike	Publike

Në këndvështrimin tonë, kjo skemë është e kontestueshme për disa arsye. Së pari, mendimi reflektiv nuk është ekskluzivitet i sociologjisë kritike. Edhe vetë sociologjia profesionale, që të zhvillohet, duhet të ketë antagonizmat e veta, debatet e veta teorike dhe përpjekjet e saj për t'u përmirësuar. Së dyti, në natyrën e saj, sociologjia publike është ndërgegjësim i publikëve si reagim kryesisht ndaj problemeve të politikës. Në rast se vetë shteti, ose agjenci të tjera, do të mbështesin financiarisht këtë aktivitet, roli i sociologut publik mund të kthehet njëlloj si ai i sociologut të politikave, pra si një klient në duart e një sipërmarrësi. Për këtë arsye, në kërkesën që shpreh Burawoy ka një paradoks: kthimi i sociologjisë publike, si aktivitet relativisht i lirë i sociologut në shoqëri, në një sociologji politikash, këtë radhë e supozuar se mbron interesin e publikëve të papërfaqësuar.

Në dëshirojmë të ofrojmë një skemë tjetër për të organizuar pjesët përbërëse të sociologjisë. Në bazë të saj është modeli qendër/periferi, i aplikuar nga Niklas Luhmann, bazuar në logjikën e diferencimit social (shih, për shembull *Teoria e Shoqërisë*). Sipas këtij modeli, periferia realizon kontaktet e sistemit me elementet e

tjera jashtë tij, ndërsa qendra është më e veçuar dhe merret kryesisht me riprodhimin e sistemit. Skema paraqitet si më poshtë:

Sociologjia e politikave	<i>(funksion kontakti)</i>
Sociologjia profesionale	<i>(funksion riprodhimi)</i>
Sociologjia kritike	<i>(funksion riprodhimi)</i>
Sociologjia publike	<i>(funksion kontakti)</i>

Në kuptimin e mësipërm, sociologjia publike vërtet frymëzohet kryesisht nga ajo kritike, por funksioni i saj është që të jetë në kontakt me publikët dhe jo që të prodhojë dije ose veprim social *per se*. Në fund të fundit, pa një korpus teorik dhe profesional, sociologjia publike nuk do të kishte kuptim, ndërsa pa një sociologji kritike, e cila vë në pikëpyetje format e organizimit social dhe reflekton një lloj ndërgjegjeje të shoqërisë, sociologjia e politikave nuk do të kishte arsye të vihej në veprim si instrument i shtetit ose i biznesit.

Kuptimi periferik i publikëve si forma komunikimi dhe ndikimi të sociologut, mund të shihet edhe në rolin legjitimues që mund të kryejë një publik për një tezë sociologjike. Një ide e rëndësishme mbi këtë është se publikët, në fakt, nuk legjitimojnë dot më vete një qëndrim sociologjik. Për shembull, në një debat mbi lejimin ose jo të abortit, sociologu është i detyruar të mbajë një qëndrim neutral dhe të jetë në favor të dialogut mes palëve, të cilët përfaqësojnë dy publikë të ndryshëm. Ndërsa në rastin e një publiku racist, ose me bindje politike ekstreme, sociologu është e qartë se nuk e mbron dot atë si një publik me të drejtat e tij (Smith-Lovin 2007: 130-131).

Një reagim ndaj problemit sesi mund të bëhet sociologji publike, pra një sociologji në mbështetje të publikëve që kanë nevojë për një zë reagues ndaj gjendjes së tyre, është shembulli i sociologes Patricia Hill Collins. Përvoja e kësaj autoreje afro-amerikane tregon se dikush vepron si sociolog publik kur përjeton vështirësitë e jetës së publikut për të cilin interesohet dhe mbron. Sociolog publik, sipas saj, nuk bëhesh në rrugë akademike, ose nisur thjesht nga ambiciet profesionale për të vajtur te publiku ose publikët, por e kundërta. Sipas saj, të qenit njëkohësisht pjesë e publikut për të cilin interesohesh dhe je i angazhuar sociologjikisht, mund të quhet një situatë, në të cilën sociologu publik mund të jetë më i specializuar dhe më i informuar (Collins 2007).

Sociologjia publike, si angazhim i sociologut me publikët, ka ekzistuar dhe do të vijojë të ekzistojë. Ajo madje mund edhe të institucionalizohet, bashkë me të gjitha problemet që mund ta shoqërojnë atë. Por, sociologu publik duhet të ruhet gjithnjë nga apatia ose mospjesëmarrja e duhur në jetën publike të cilën trajton, si dhe nga tundimi për ta manipuluar publikun në favor të interesave të tjera jashtë tij. Këto dy rreziqe duhen pasur gjithnjë parasysh, por nuk duhen bërë shkak për mosangazhimin e tij.

Si mund ta konsiderojmë aktivitetin e sociologut publik në kuadrin më të gjerë teorik të punës së tij? Nisur nga përfytyrimi që kishte C. Wright Mills për rolin e sociologjisë, sociologun publik mund ta mendojmë si të pozicionuar ndërmjet *institucioneve*, nga njëra anë, dhe *publikëve* të ndryshëm, nga ana tjetër. Kjo nënkupton që sociologu nuk është thjesht një anëtar pasiv i një publiku, pasi ai ka një dije të specializuar, të cilën e vë në shërbim të tij; por nuk është as një anëtar indiferent i shoqërisë, ose, siç shprehet Craig Calhoun (1997: 430), një “flistin” i kënaqur me pozitën e tij. Atij i duhet të japë dhe të marrë me publikun, si dhe me ato aspekte të shoqërisë që mund të kenë peshë në gjendjen dhe trajtimin e problemeve të këtij publiku.

C. Wright Mills mendonte se ka një ndërveprim të vazhdueshëm midis individit dhe shoqërisë, për të cilin kërkohet një lloj i veçantë dijeje, të cilën njerëzit e zakonshëm nuk e zotërojnë (Mills 1959: 4). Për këtë arsye, sociologu merr një lloj rëndësie për ta, për t’u përcjellë një lloj dijeje të caktuar dhe profesionale. Ai mund t’i ndihmojë ata që të interpretojnë më mirë si botën në të cilën jetojnë, ashtu edhe vetveten. Kjo bëhet akoma më e rëndësishme në kushtet kur shoqëria është e ekspozuar ndaj ndryshimeve të shpejta, karakteristikë kjo e shoqërisë moderne.

Premisat teorike të kushteve të modernitetit dhe të vlerave në të cilat mund të bazohemi nisur nga këto premisa, mund t’i gjejmë në teorinë e formuluar nga Anthony Giddens mbi modernitetin. Sipas tij, në shoqëritë moderne, njerëzit janë më shumë të varur ndaj atyre që ai i quan “sisteme abstrakte”, sesa ndaj individëve në jetën e përditshme. Për shembull, për të udhëtuar në rrugë ajrore, ajo që kërkohet është besimi te “sistemi” që bën të mundur fluturimin ajror, dhe jo te ndonjë person i veçantë, i njohur drejtpërdrejt nga udhëtari (Giddens 2002: 244). Në këtë kuptim, sociologjia publike mund të përpiqet të komunikojë si mbi nevojat për komunikim personal në nivel ndërveprimi, për të kompensuar boshllëqet që krijojnë sistemet abstrakte, ashtu dhe mbi nevojat për dije dhe integrim në format institucionale të shoqërisë, për të qenë pjesë e saj. Këtë mund ta kuptojmë edhe përmes nocionit të vetërealizimit. Në nivel personal, shkruan Giddens, njerëzit kanë nevojë për t’u vetërealizuar, dhe kjo arrihet përmes integritetit dhe pjesëmarrjes së suksesshme në sistemet sociale globale. Në të njëjtën kohë, njerëzit duhet edhe të mbrohen nga efektet negative të globalizimit, duke prodhuar një formë të caktuar identiteti, i cili kërkon pjesëmarrje në jetën publike të shoqërisë.

Një tjetër mënyrë e konceptualizimit të punës së sociologut publik është ajo e një “karakterit social”, për të cilin flet David Riesman, me çka ai kupton një karakteristikë tipike të shoqërisë në një kohë ose pjesë të caktuar të saj. Karakterin social, të cilin mund ta hetojmë te publikët e shumtë, e shohim si “organizim të nxitjeve dhe kënaqësive të kushtëzuara shoqërisht dhe historikisht”; ai pra, ka të bëjë me mënyrën me anë të së cilës “një individ i qaset botës dhe njerëzve” (Riesman [1950] 1961: 4). Këtu është e nevojshme që individi të kontrollojë impulset që merr nga përkatësia e tij sociale, nga prirjet ose nga ky “karakter social” i grupit në të cilin bën pjesë, duke “pasur aftësinë që të shohë drejt, pavarësisht nëse e ka kurajën ose fuqinë për të vepruar në bazë të perceptimeve të tij” (ibid, xx). Prej këtij rrjedh se, ajo që mund të

komunikohet në publik, duhet të përmbajë si të vërtetën mbi realitetin social, ashtu dhe ndërgjegjen mbi përgjegjësitë ose kufizimet e individit për të zbatuar potencialet e tij.

Në fund të fundit, sociologu mund të thuhet se përcjell te publiku ekspertizën profesionale sociologjike, pasi në të kundërt, ai nuk do të mund të ofronte ndonjë gjë të re dhe, duke bërë këtë, ai detyrimisht merr një rol emancipues, siç e përshkruan Jurgen Habermas (2002), pra si një emancipim përmes diskutimit publik në një komunikim të vazhdueshëm dhe reflektiv.

Disa Tipare te Sociologjisë Publike

Koncepti pluralist i publikëve

Në qendër të vëmendjes të sociologjisë publike është kuadri i vlerave në të cilat ai bazohet për të orientuar afrimin e saj me publikët. Këtu orientimi bazë mund të merret nga kushtet ose kërkesat e një shoqërie demokratike, në të cilën nxitet pjesëmarrja, pluraliteti, liria dhe demokracia. Në radhë të parë, lind çështja e marrëdhënies së publikëve mes tyre, si edhe ajo e konceptimit të raportit të këtyre publikëve me reflektimin teorik të sociologut.

Në pikëpamjen tonë, qasja që e sheh shoqërinë si një publik të vetëm është jo vetëm e gabuar, por edhe e pamundur. Ajo prodhon analiza jo të përshtatshme mbi kontributin e sociologjisë si një sociologji publike dhe, për më tepër, e ekspozon atë ndaj rrezikut të politizimit. Craig Calhoun vë në dukje se angazhimi publik, i parë nga perspektiva e një publiku të vetëm, nxit një situatë ku “privilegjohej disa çështje të caktuara, disa forma të caktuara ligjërimiti, dhe disa folës të caktuar” (Calhoun 1997: 457). Ky këndvështrim i sociologjisë publike është, pra, larg së qeni demokratik.

Megjithatë, pavarësisht domosdoshmërisë për t’i parë publikët *në shumës*, demokracia kërkon edhe pjesëmarrje në jetën publike. Për këtë arsye, është e rëndësishme që publikët jo vetëm të shihen në shumës, por edhe që ata të komunikojnë dhe të ndërveprojnë mes tyre, pra një lloj pjesëmarrjeje dhe njohjeje reciproke e interesave dhe qasjeve të ndryshme të tyre në shoqëri. Amitai Etzioni argumenton se komunitetet janë gjithnjë të shumtë, të larmishëm dhe të niveleve të ndryshme. Komunitetet e niveleve më të larta, si ato kombëtare ose ndërkombëtare (p.sh. Bashkimi Europian), nuk duhet t’i absorbojnë komunitetet më të vogla, por të koordinohen duke ruajtur pozicionin reciprok (Etzioni 2000). Parë nga perspektiva e publikëve, ato i përkasin çështjeve të ndryshme dhe niveleve të ndryshme të interesit, mes të cilave sociologu duhet të praktikojë një lloj tolerance në favor të publikëve më të rrezikuar ose të marginalizuar.

Burawoy (2007: 55) këtu mund të ketë vështirësinë se, në përpjekjen për ta universalizuar konceptin dhe misionin e sociologjisë publike, nuk i jep rëndësinë e duhur kësaj diference në larmi dhe në nivele të publikëve të ndryshëm. Ai bën dallimin mes publikëve më konkretë ose më abstraktë, por duke i dhënë prioritet konceptit të “humanizmit”, pra, në një farë mënyre, duke e parë njerëzimin si një publik të madh me interesat e tij bazë, ai zhvlerëson atë që mund të jetë thelbi i

sociologjisë publike, mbrojtja e larmisë së interesave të publikëve të ndryshëm.

Niklas Luhmann, nga ana e tij, mendon se përdorimi i konceptit të publikëve në shumë do të lejonte vëzhgimin e sa më shumë fenomeneve, si edhe të marrëdhënieve mes tyre (shih Moeller 2006: 266). Kjo do ta ruante në një farë mase sociologun publik nga politizimi, i cili vepron më shpesh në nivel kombëtar dhe gjithëpërfshirës. Madje, misioni i sociologut në funksion dhe në nxitje të demokracisë, do të ishte pikërisht lufta ndaj kësaj kulture politike gjithëpërfshirëse, që lind nga nënvlerësimi i këtyre diferencave¹.

Pluralizmi i formave të sociologjisë publike

Nisur nga vlerat bazë të një shoqërie demokratike, nga respektimi i konceptit të pluralitetit të publikëve dhe nga përfundimet që mund të nxjerrë sociologu bazuar në konceptimin e tij mbi të vërtetën, mund të konturojmë disa qasje dhe perspektiva mbi mënyrën e komunikimit me publikët. Në këtë ese përiqemi të elaborojmë disa ide fillestare, nisur nga parimi se një publik i veçantë, i cili përfaqëson një problem specifik, mund të kërkojë një qasje të ndryshme në krahasim me publikët e tjerë. Burawoy bën dallimin midis sociologjisë publike *tradicionale* dhe sociologjisë publike *organike*. Sociologjia tradicionale, sipas tij, ka si veçori të saj përgjithësimin e çështjeve, të cilat adresojnë një publik më të gjerë dhe, rrjedhimisht, ajo mbron ose trajton çështjet e përgjithshme të gjendjes së shoqërisë dhe të problemeve të organizimit të saj. Burawoy argumenton se sociologët publikë tradicionalë “lexohen përtej akademisë dhe bëhen instrumenti i diskutimit publik mbi natyrën e shoqërisë...të vlerave të saj, të hendekut mes premtimeve dhe realitetit, mbi sëmundjet dhe tendencat e saj”. Ata u drejtohen publikëve, të cilët “janë përgjithësisht të padukshëm...nuk prodhojnë shumë ndërveprim, dhe që janë pasivë, sepse nuk janë pjesë e ndonjë lëvizjeje ose organizate” (Burawoy 2007: 28). Në dallim prej tyre, ata sociologë që bëjnë pjesë në sociologjinë publike organike vihen në kontakt të drejtpërdrejtë me publikun, duke nisur kështu një dialog dhe shkëmbim pikëpamjesh. Këtu, thotë Burawoy, përfshihen lëvizjet sociale, grupet e të drejtave, organizatat, komunitetet, shoqatat, pra ata publikë, të cilët janë konkretë, aktivë dhe lokalë.

Duke pranuar këtë ndarje, mund të ngremë disa pyetje mbi funksionin e secilës qasje dhe mbi specifikat e saj. Patterson argumenton me të drejtë se sociologjia publike duhet të jetë demokratike edhe në aplikimin e saj, ku influenca mes sociologut dhe publikut duhet të jetë reciproke. “Publiku, [për më tepër], mund të jetë ndërkombëtar, ose kombi në tërësi, ose ai mund të jetë më i specializuar dhe lokal—komuniteti i qytetit, i komunës ose i fermës ku banon, një grup interesi ose një komunitet etnik” (Patterson 2007: 177). Kësisoj, kushti i komunikimit demokratik

¹ Në këndvështrimin politik universalizues, një kriminel, për shembull, nuk është kriminel, por thjesht dikush që kategorizohet si i tillë për t'u përshtatur me kulturën dominuese dhe në rendin social të prodhuar nga pushteti. Një përshkrim të detajuar të kësaj situatë e gjejmë në filmin e Stanley Kubrick, të titulluar *Portokalli Mekanik* (*Clockwork Orange*), ku një person devijant, por karizmatik, futet në një seri trajtimesh kuruese, me qëllim që të homogjenizohej me shoqërinë dhe të jetonte në përputhje me specifikat e kulturës së saj dominante.

midis sociologut dhe publikut është më i vështirë në rastin e publikëve të mëdhenj, ose siç thotë Burawoy, të publikëve “të padukshëm”. Këtu, kriteri i punës nuk është më shkëmbimi reciprok i pikëpamjeve, por përcjellja e një analize të përgjithshme sociologjike, të shprehur në gjuhë të thjeshtë nga sociologu, i cili bazohet më së shumti në sociologjinë profesionale, pra në premisa teorike.

Në sociologjinë publike organike ka vërtet një influencë reciproke mes sociologut dhe publikut. Këtu, sociologu ka rastin të përjetojë të qenurit pjesë e publikut, pra të kuptojë perspektivat e tij dhe t’i përkthejë ato në të dhëna për punën sociologjike. Collins e shpreh qartë këtë specifikë kur flet për përvojat e saj me publikët në terren. Ajo thotë se të shkruash ose të flasësh për publikë të ndryshëm kërkon stile të ndryshme formulimi. Kjo sepse audienca brenda një vendi të caktuar është e larmishme, pasi ajo përmban një sërë kulturash dhe përvojash njerëzore (Collins 2007: 102).

Por, kujt ia përkthen përvojat e tij sociologu, dhe si mund të bëhen ato të vlefshme për publikun në fjalë? Së pari, komunikimi me publikun i shërben sociologjisë në tërësi, duke transmetuar në formë të dhënash gjetjet e sociologut në terren. Pikërisht nga sociologjia profesionale sociologu merr edhe ide ose orientime mbi kontributin e tij në dialogun me publikun. Këto të dhëna të inkuadruara në punën sociologjike shërbejnë për një njohje më të mirë të shoqërisë dhe, indirekt, të rregullimit të brendshëm të saj, për aq sa gjetjet shkencore ndikojnë tek aktorët e ndryshëm. Së dyti, gjetjet sociologjike mund të komunikohen te publikët e ndryshëm që janë elektorat, pra kanë peshë politike, në raste zgjedhjesh, ose në debatin politik në të cilin publiku merr pjesë. Frances Fox Piven shkruan se sociologët publikë përqendrohen në trajtimin e “problemeve publike si një pjesë e rëndësishme e agjendës së kërkimit”, për t’i komunikuar gjetjet e tyre “tek zgjedhësit e zonave që preken nga këto probleme dhe për të cilat mund të reagohet politikisht” (Piven 2007: 159).

Qasjet problemore dhe publikët (audiencat)

Problemet sociale janë një mënyrë efikase për të krijuar perspektiva mbi publikët e mundshëm në një shoqëri. Një mënyrë sesi mund t’i identifikojmë këto probleme është ajo e të hetuarit të fushave kryesore të aktivitetit shoqëror, siç janë fusha e politikës, ajo e ekonomisë, e arsimit, e shëndetit, e artit etj. Nisur nga problemet potenciale të hasura në këto fusha, mund të kërkohen edhe publikët (audiencat) përkatës, si dhe dialogu për t’u informuar më mirë për problemet sociale që ekzistojnë si edhe për të përcjellë reflektimin sociologjik te grupet e interesuara.

Problemet sociale, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, siç shprehet për to Habermas, lindin kur veprimtaria e asaj çka ai e quan “kompleks monetar-burokratik” ndikon në fushat e veprimit që nuk integrohen dot në shoqëri pa efekte anësore “patologjike” (Habermas 2002: 377). Problemet sociale lindin pra, nga kufizimi i veprimeve të individit që vjen prej sistemeve të racionalizuara sociale. Duke u marrë me publikët, sociologjia publike gjen çështje për të trajtuar nisur pikërisht nga këto kufizime që prodhojnë sistemet sociale. Këtu mund të propozojmë shkurtimisht disa perspektiva të përgjithshme, ku sociologu publik mund të hetojë si problemet sociale, ashtu dhe publikët potencialë të tij. Problemet e kategorizuara sipas këtyre fushave janë:

(1) *Problemet politike.* Këtu, siç kemi vënë në dukje më parë, publiku (në kuptimin e elektoratit të përgjithshëm) është pasiv dhe problemet mund të zbulohen duke u orientuar nga vlerat dhe nga mënyra sesi sistemi politik duhet të funksionojë *idealisht*. Sociologu publik mund të orientohet, së pari, nga roli i opozitës si alternativë dhe instrument kontrolli ndaj qeverisë, për të shmangur sa më shumë, siç shprehet Robert Dahl (2005), situatën e oligarkisë konkurruese dhe, së dyti, nga nevoja që publiku të kuptojë problemet afatgjata të praktikave të korrupsionit në të cilat ai merr pjesë. Kështu, në një sistem politik me opozitë efektive, sociologu publik duhet të ofrojë një panoramë sa më të detajuar strukturore të mekanizmit që mundëson ose krijon problemet që has shoqëria, si varfëria e skajshme, mospjesëmarrja në vendimmarrje, mungesa e jetës kulturore, edukimi jo i plotë, problemet në familje, etj. Në këtë mënyrë, ai ofron informacion mbi të cilin politika mund të hartojë programet e saj në kuadrin e shtetit të mirëqenies sociale. Në lidhje me marrëdhënien e publikut me shtetin, i rëndësishëm është diskutimi mbi vlerat tek të cilat bazohet organizimi politik i shoqërisë, me qëllim që të rritet ndërgjegjja dhe kultura mbi praktikat demokratike dhe rregullat e ndërtimit të shtetit ligjor.

(2) *Problemet ekonomike.* Në fushën e ekonomisë, sociologu publik mund të analizojë fenomenet e rritjes së komodifikimit të mallrave, pra zgjerimit të madh të tregut dhe të problemeve që krijohen në organizimin e jetës individuale në raport me tregun. Këtu ndodh sidomos fenomeni i rritjes së rëndësisë së parasë dhe të nevojës për të komunikuar vlerat personale gjithashtu përmes nxjerrjes, ose prezantimit të tyre në treg. Nga ana tjetër, ekonomia krijon probleme për konsumatorin, i cili duhet të jetë sa më i mbrojtur nga pasojat negative të mallrave që ai konsumon dhe sa më i informuar për këto efekte. Këtu, puna e sociologut mund të vlejë për të informuar edhe shoqatat në mbrojtje të konsumatorit.

(3) *Problemet e shëndetit.* Në fushën e shëndetësisë analiza sociologjike mund të shtrihet tek efektet negative të ekonomisë në shëndetin e publikut, sidomos në perspektivën afatgjatë që i shkakton pasojat përmes ndotjes së ambientit.

(4) *Problemet e arsimit.* Publiku studentor mund të ketë nevojën e përhershme për të njohur marrëdhëniet midis fushës së studimit dhe trajektore së jetës së tyre, sidomos asaj të karrierës profesionale. Në Shqipëri, kultura e këtij raporti midis arsimimit dhe punësimit është e ulët, duke prodhuar mospërputhje të studimeve me tregun e punës.

Sociologjia Publike e Tranzicionit

Një vështrim mbi publikun shqiptar

Sociologjia publike në Shqipëri mund të trajtojë kryesisht problemet që vijnë si rezultat i tranzicionit drejt një rendi të konsoliduar demokratik. Asaj, në thelb, i duhet të përballet me një problematikë të dyfishtë, pasi duhet të merret si me probleme të trashëguara, ashtu dhe me probleme të reja sociale (Tarifa 2008). Për këtë arsye, në reflektimin sociologjik për rastin e Shqipërisë mund të ketë rëndësi

njohja e organizimit social në regjimin e kaluar komunist, si dhe gjendja e publikëve në atë periudhë.

Si çdo regjim autoritar, Shqipëria komuniste karakterizohej nga një organizim tejet i centralizuar dhe hierarkik. Planifikimi politik ndërhynte deri në detajet më të imëta të jetës sociale, përfshi edhe shumicën dërrmuese të veprimtarive ekonomike, ndërsa jeta publike përmbledhej në komunikimin politik mbi orientimin e këtij planifikimi, si në nivelin ideologjik dhe të propagandës, ashtu dhe në atë të organizmit dhe të programimit të punëve sipas objektivave të paracaktuara. Nën këtë influencë planifikimi viheshin mediet, arsimit, aktivitetet kulturore dhe artistike, jeta familjare, madje edhe koha e lirë.

Në kushte të tilla, publiku shqiptar nuk mund të ekzistojë si një publik i diversifikuar dhe pluralist, e aq më pak si një publik aktiv dhe vendimmarrës në çështjet kryesore të vendit. Në fakt, një situatë e tillë ekzistoi për një kohë të gjatë. Kjo solli, së pari, reagimin ekstrem të shoqërisë gjatë proceseve demokratizuese. Ajo që dominonte ishte thjesht ideja e çlirimit nga trysnia e sundimit politik. Fillimi i tranzicionit ishte *më tepër revolucionar dhe më pak gradual* ose i mirëmenduar. Ajo që pritej dhe që mund të merrej lehtë me mend ishte revolta ndaj autoritarizmit dhe besimi i verbër te një shoqëri e lirë dhe demokratike. Publiku ishte kundër homogjenizimit që kish njohur për dekada me radhë, por, në fakt, ai nuk arriti dot të prodhojë një larmi idesh dhe grupesh të ndryshme interesi, të cilat të mund të komunikonin forma dhe bindje të ndryshme mbi mënyrën e organizimit të punëve dhe të funksionimit të shoqërisë.

Ky fenomen mund të shihet sidomos në dy fusha kryesore, pasi edhe tranzicioni postkomunist në Shqipëri ishte që nga fillimi një tranzicion i dyfishtë, që kryhej njëherësh si në sferën ekonomike, ashtu dhe në atë politike (Tarifa & Tarifa 2009: 47). Liria ekonomike, nga njëra anë, dhe balancimi i pushteteve që shoqëria i kërkon politikës, nga ana tjetër, janë dy kushtet thelbësore të një rendi shoqëror demokratik. Por, çfarë ndodh me publikun në një proces të tillë tranzicioni të dyfishtë?

Kultura e munguar ekonomike, për shkak të zhvillimit të planifikuar e të centralizimit të saj në regjimin e socializmit shtetëror, shfaq dy fenomene tipike. Së pari, puna si aktivitet u zhvlerësua, pasi ajo mori kuptimin pezhorativ të bindjes ndaj një urdhri që vjen nga lart. Për këtë arsye, ekonomia shkoi drejt një degradimi dhe shkatërrimi të ngadaltë, ku motoja kryesore ishte zhvatja dhe përfitimi i shpejtë ekonomik (Tarifa 1993, 1995). Së dyti, liria e tregut u mbivlerësua deri në adhurim. Aktiviteti më i preferuar ekonomik u bë dhe vazhdon të mbetet ai i shitjes dhe i blerjes në treg, duke prodhuar një komodifikim të gjithçkaje.

Publiku e gjen vetveten, si në fushën politike, ashtu dhe në atë ekonomike, kryesisht te promovimi i lirisë, pra i mungesës së kufizimeve, si dhe te promovimi i vlerave të individualizimit dhe të refuzimit të kulturës dhe të vlerave komunitare. Në kushtet e tranzicionit drejt ekonomisë kapitaliste, tregtia është kryesisht tregti e vogël familjare, ndërsa fabrikat që u privatizuan shkuan thuajse të gjitha drejt shkatërrimit të tyre. Ligjërimi më dominues politik ka qenë dhe mbetet ai i çlirimit nga të këqijat e kundërshtarit, pa ndërtuar ndonjë kuptim të ri mbi format e aktivitetit ose të politikëbërjes.

Në këtë atmosferë, kuptimi i fushës së publike, nga dominimi absolut në regjimin e kaluar, shndërrohet në një sferë të së *përçmuarës* ose të *neglizhencës*. Sektori publik, si një sektor i administruar nga shteti, mbart vulën e të qenit i korruptuar, joeficient dhe pronë e askujt (Tarifa 1995). Një degradim kaq i shpejtë i nocionit të publike dallohet qartë edhe kur shqyrtojmë ndryshimin midis mirëmbajtjes së ambienteve private të banimit, dhe braktisjes deri në shkatërrim të ambienteve publike, qofshin këto mjediset publike të lagjeve, institucionet e rëndësishme ose vepra publike kombëtare. Ligjërimi i tepruar mbi lirinë dhe stigmatizimi i tjetrit si kundërshtar prodhojnë një situatë, në të cilën qytetarët nuk pranojnë më të identifikohen me asgjë në sferën publike. Prej këtij vjen edhe një farë prirjeje përçmuese ndaj kulturës vendase dhe adhurimi i asaj të huaj.

Akoma dhe sot, fryma komunitare në Shqipëri është e dobët dhe jo në nivelin e duhur për të plotësuar ose bashkëshoqëruar zhvillimin e tregut dhe futjen e kapitalit si faktor ndikues në organizimin e jetës shoqërore. *Besimi te publikja*, qoftë duke marrë pjesë si audiencë, qoftë duke kontribuar me ide, mbetet akoma i ulët. Sociologjia publike, në këtë rast, mund të gjejë hapësira për të prodhuar *publikë të rinj* dhe për të nxitur aktivizimin ose informimin e atyre ekzistues. Mbi të gjitha, mund të kontribuohet për të zbehur mendimin sipas të cilit, nëse bëhesh pjesë e një publiku, mund të stereotipizohesh ose stigmatizohesh si i paaftë, ose të konsiderohesh si një person pasiv, përkundrajt imazhit të individit të pavarur si njeri i vetmuar, por i fuqishëm dhe aktiv.

Pavarësisht mungesës së ndërgjegjes dhe të imazhit negativ mbi publikën, shoqëria shqiptare po kalon një transformim të shpejtë dhe të thellë ekonomik dhe shoqëror. Kudo ka një rritje të çështjeve për t'u trajtuar, të cilat mund të përballen, ndër të tjera, edhe nga sociologjia publike. Tabloja e përgjithshme, në të cilën shfaqen këto probleme të tranzicionit, duket e lidhur përgjithësisht me problemet që vijnë nga mungesa e kulturës së nevojshme demokratike.

Sociologjia shqiptare drejt diferencimit të brendshëm

Të njëjtën rrugë të vështirë transformimesh të shpejta ka kaluar edhe sociologjia në Shqipëri, si një disiplinë e re që premtonte të kontribuojë shumëçka në zhvillimin demokratik të vendit. Mbi të gjitha, kjo disiplinë po përjeton një *diversifikim* dhe *profesionalizim* të saj dhe po bëhet gjithnjë e më shumë komplementare në raport me fushat e tjera të studimit dhe të veprimtarisë shoqërore.

Në të kaluarën, sociologjia në Shqipëri ka vuajtur stigmatizimin nga regjimi komunist, i cili e konsideronte atë si një shkencë “borgjeze”, për të cilën nuk kishte vend të tregohesh respekt, madje që duhej denoncuar si e tillë. Paradoksisht, në fillimet e tranzicionit, sociologjia në Shqipëri iu ekspozua rrezikut të kundërt, atij të të konsideruarit si një shkencë “komuniste” (Tarifa 1996, 2008). Nëse tashmë ky hendek mund të duket i kapërcyer dhe sot mund të themi se sociologjia po përvijohet në një masë të madhe si *sociologji profesionale*, e përshtatur me dijet më të njohura teorike të fushës, ajo prapëseprapë është shumë pak *sociologji kritike*, ku do të duhej të vihej theksi mbi mënyrat e ndryshme sesi mund të interpretohet realiteti shqiptar.

Po ashtu, dihet se zhvillimi i *sociologjisë së politikave* është i lidhur më së shumti me institute kërkimore të mirëfillta, ndërkohë që *sociologjia publike* shfaqet herë-herë e aplikuar në masmedia, në mënyrë spontane dhe pa u mbështetur në baza teorike që të mund të reflektojë specifikat e tranzicionit shqiptar.

Sociologjia shqiptare në këtë periudhë tranzicioni vuan, në thelb, nga tri mungesa, ose dobësi të rëndësishme të trashëguara nga e kaluara: (a) mungesa ose dobësia e zhvillimit teorik të saj, për shkak të dogmatizmit marksist të së kaluarës; (b) mungesë e të dhënave empirike, pra e punës në terren, e cila ka qenë gjithnjë e neglizhuar; si edhe (c) mungesa e traditës teorike, si mendim i përpunuar intelektual nga njerëzit e shquar të vendit (Tarifa 1996). Kjo situatë sjell një nivel zhvillimi, i cili e bën të vështirë specializimin e brendshëm të sociologjisë.

Një ndarje e vlefshme për të matur zhvillimet në sociologjinë shqiptare, sidomos në lidhje me diferencimin e brendshëm të saj, mund të jetë ajo midis dijeve të përgjithshme teorike dhe dijeve të aplikuara në terren. Edhe këtu, sërish, në tregun e studimeve mbizotërojnë dijet e përgjithshme, të cilat gjejnë pak forcë për të shpjeguar specifikat e një vendi në tranzicion. Kjo situatë duket qartë edhe për faktin se në çështjet e përgjithshme, për të cilat preokupohet opinioni publik, shteti nuk influencohet—dhe as interesohet të dëgjojë—mendimin sociologjik të studiuesve dhe ekspertëve tanë më të mirë në fushën e shkencave sociale. Rrjedhimisht, debatet publike më tepër karakterizohen nga përplasjet mes tyre të politikanëve dhe të atyre që quhen “analistë”, sesa nga mendimi i informuar shkencor, ose nga alternativa që mund të vijë nga jashtë politikës. Kjo tregon se kultura e komunikimit të sociologjisë, pra zhvillimi i sociologjisë publike, duhet zhvilluar dhe inkurajuar në sa më shumë mënyra, me qëllim që ajo të zhvillojë protagonizmin e saj në shoqëri.

Nëse flasim për format me të cilat sociologët, në profesionin e tyre, mund të angazhohen publikisht, ato mund t'i përmbledhim sipas një modeli të krijuar nga Orlando Patterson. Ndarja e sociologjisë publike që propozon Patterson përfshin “të angazhuarin *profesionalisht*, të angazhuarin në *diskurse* dhe të angazhuarin aktivisht ose *civil*” (Patterson 2007: 181). Sipas këtij autori, në kategorinë e parë, në atë të sociologjisë publike të angazhuar profesionalisht, për fat të keq janë të paktë sociologët “që angazhohen publikisht me çështjet për të cilat kanë kaluar tërë jetën e tyre profesionale duke i studiuar” (ibid, 181). Kjo vjen sepse, siç ka ndodhur tradicionalisht, shumica e tyre preferojnë të flasin vetëm me kolegët e tyre. Për kategorinë e dytë, atë të angazhuarit diskursiv, si përfaqësues tipik mund të konsiderohet Jürgen Habermas. Këtu veprimet komunikative të iniciuara nga sociologu i drejtohen një publiku të caktuar, dhe audienca duhet të ketë mundësinë e pjesëmarrjes në diskutim. Ndërsa mbi sociologun e angazhuar civil, është e qartë se ai duhet të ketë kontakt të drejtpërdrejtë me aktorët e shoqërisë civile dhe me organizatat joqeveritare, pra me ata faktorë civilë që përpiqen të ndikojnë me veprimtarinë e tyre në mbarëvajtjen e shoqërisë, sidomos për sa i përket raporteve të publikut me qeverisjen.

Sociologjia publike dhe kultura e një vendi

Kultura luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin politik dhe shoqëror të një vendi. Kjo ndodh jo vetëm sepse praktikata e jetës së përditshme njerëzore ndikojnë në aspektet sociale të organizimit të përgjithshëm të shoqërisë, por edhe sepse fushat kryesore të aktivitetit social, si politika, ekonomia ose arsimit, kërkojnë një lloj kulture të tyre, pra zbatimin e disa normave, ose rregullave të pashkuara, të cilat janë pjesë e kulturës së një vendi.

Kultura, në kuptimin e përgjithshëm të fjalës, shpjegon sjelljen sociale dhe karakteristikat e një shoqërie të caktuar. Frensis Fukuyama dallon katër nivele organizimit shoqëror, ku *kultura* është ajo që ndikon (a) mbi *shoqërinë civile* dhe shkallën e aktivizimit të saj, (b) mbi *institucionet* e vendit dhe konfigurimet e tyre, si dhe (c) në *ideologjinë* mbi të cilën mbështetet sistemi politik. Nivelin e katërt, atë *kulturor*, Fukuyama e konsideron si “më të thellin” krahasuar me tre nivelet e përmendura më sipër, duke përfshirë në të “strukturën familjare, fenë, vlerat morale, ndërgjegjen etnike, qëndrimin civil dhe traditat historike partikulariste” (Fukuyama 1996: 321). Për më tepër, sipas tij, demokracia nuk ka të bëjë vetëm me vlerat e individit. Në fillimet e saj, demokracia në Amerikë ka qenë njafte e influencuar nga presionet që vinin nga grupe të ndryshme sociale, pra nga fryma komunitariane (ibid, 326). Kësisoj, nxitja, krijimi dhe promovimi i dialogut të publikët e rinj, si dialog që i referohet një komuniteti, është një premisë pozitive për zhvillimet e ardhshme të demokracisë.

Privatizimi i shërbimeve të trashëguara shtetërore është një zhvillim që nuk prodhon detyrimisht një situatë më të vështirë publike, pasi edhe aktivitetet private mund të krijojnë fusha diskursi dhe publikët e tyre përkatës, por një fenomen që mund të vijë nga kultura individualiste është ai i veshjes së publikes me një konotacion negativ, e cila duhet shmangur sa më shumë që është e mundur. Në fakt, një tendencë e tillë ka shoqëruar zgjerimin e të drejtave dhe të lirive të komuniteteve të marginalizuara që në fillimet e veta. Për shembull, në vitin 1954, kur ekstrakomunitarët në Shtetet e Bashkuara fituan të drejta publike, të bardhët themeluan, si reagim ndaj kësaj, shkollat e tyre private (Collins 2007: 107). Sot, në të njëjtën mënyrë, shkollat, rrugët, transporti publik, shërbimet shëndetësore mund të privatizohen, në mënyrë që, siç shkruan Collins, “klasa e mesme” të shpëtojë nga “bërrylat” dhe telashet e publikut (ibid). Këtu merr rëndësi jo thjesht logjika pragmatike e asaj që “funksionon”, por edhe një lloj këndvështrimi më kulturor mbi vlerën e publikes, pavarësisht se të mirat e saj nuk shihen qartazi.

Në kushtet e tranzicionit shqiptar, mund të themi se ndër dy llojet e sociologjive publike që parashtron Burawoy, sociologjia publike tradicionale ka më tepër peshë në trajtimin e problemeve të përgjithshme kulturore. Kjo sepse vendet në tranzicion kanë si nevojë primare rritjen e kulturës mbi praktikata demokratike dhe institucionale, mbi ndarjen e pushtetit dhe mbi rolin e dialogut publik për trajtimin e çështjeve. Këtu, komunikimi sociologjik në nivel vlerash dhe për njohjen e praktikave të komunikimit dhe veprimit demokratik, trajtohet nga përgjithësimet me gjuhë të thjeshtë që i drejtohen një publiku të gjerë. Në një farë mënyre, siç shkruan edhe

Burawoy, “sociologjia publike tradicionale konturon sociologjinë publike organike, ndërsa kjo e fundit disiplinon, i jep baza dhe drejton të parën” (Burawoy 2007: 29). Sociologjia publike tradicionale mund ta bëjë këtë duke trajtuar çështjet dhe këndvështrimet kulturore të shoqërisë. Në instancë të fundit, kultura dhe kryesisht kultura politike është ajo që ndikon në vijueshmërinë afatgjatë të demokracisë së një vendi (Lipset 1996: 52-53). Sociologu publik mund të evidentojë ato aspekte kulturore pozitive, si toleranca, bashkëjetesa dhe pjesëmarrja, për t’i përcjellë ato si shembuj ose modele organizimi në pjesët e shoqërisë ku evidentohen më së shumti probleme dhe vështirësi sociale.

Mbi të gjitha, në aspektin kulturor të vëzhgimit, sociologu publik mund të ketë kujdes në pagën e rreme të publikut, ose në atë që Alexis de Tocqueville e quan “shoqëria e qetë”, si dhe në debatin e ashpër, por shterp, i cili zhvillohet kryesisht si debat politik mes dy kaheve konkurruese (Tocqueville 2002: 12). Shoqëria e qetë, thotë Tocqueville, nuk është domosdo një shoqëri në mirëqenie, ose e fuqishme. Ajo vjen kur mirëqenia aspirohet me forcë brenda shoqërisë, pra kur përbën një element kulturor të saj. Ndërsa debati shterp mund të mbysë, siç është karakteristike për periudhat e tranzicionit, zërin e specialistëve dhe, për më tepër, mund të shërbejë si fasadë për të fshehur qëllime që nuk janë krejtësisht në funksion të publikut.

Në përfundim, theksojmë se *qytetaria* është një koncept, i cili përmbledh zhvillimin e duhur kulturor, që gjendet i shprehur, ose i evidentuar te një individ i veçantë, sidomos për sa i përket angazhimit politik të tij. Në këtë perspektivë, në fillimet e tranzicionit postkomunist në Shqipëri, qytetaria si formë aktive kuptohej vetëm si trysni e organizatave joqeveritare mbi shtetin (Biberaj 2001: 328). Ndonëse sot këto organizata janë bërë më të larmishme, aktiviteti qytetar vijon të mbetet i kufizuar vetëm në këtë formë veprimi (Tarifa & Sokoli 2006). Sociologu publik mund të gjejë terren për të promovuar komunikimin si ndërmjet komuniteteve të ndryshme, ashtu dhe ndërmjet tyre dhe shoqërisë civile. Ai mund të jetë një zë përfaqësues në media, ku publiku i përcjell politikës drejtpërdrejt gjykimet e tij. E kuptuar në këtë mënyrë, qytetaria duhet të nxitet për të qenë gjithnjë aktive dhe në zhvillim të vazhdueshëm.

Bibliografia

- Biberaj, Elez. 2001. *Shqipëria në Tranzicion: Rruga e Vështirë drejt Demokracisë*. Tiranë: Ora.
- Burawoy, Michael. 2006. “Introduction: A Public Sociology for Human Rights”, ff. 1-18 në Judith Blau & Keri E. Iyall Smith (eds.), *Public Sociologies Reader*. Lanham, MD: Rowman & Littlefield.
- Burawoy, Michael. 2007. “For Public Sociology”, ff. 23-64 në Dan Clawson et al. (eds.), *Public Sociology: Fifteen Eminent Sociologists Debate Politics and the Profession in the Twenty-First Century*. Berkeley & Los Angeles: University of California Press.
- Burawoy, Michael. 2009. “Public Sociology Wars”, ff. 449-473 në Vincent Jeffries (ed.), *Handbook of Public Sociology*. Lanham, MD: Rowman & Littlefield Publishers.
- Calhoun, Craig. 1997. “Social Theory and the Public Sphere”, ff. 429-470 në Bryan S. Turner

- (ed.), *The Blackwell Companion of Social Theory*. Oxford & Malden, MA: Blackwell.
- Calhoun, Craig. 2005. "The Promise of Public Sociology", *The British Journal of Sociology* 56, 3: 355-363.
- Collins, Patricia Hill. 2007. "Going Public: Doing the Sociology that Had No Name", ff. 101-115 në Dan Clawson et al. (eds.), *Public Sociology: Fifteen Eminent Sociologists Debate Politics and the Profession in the Twenty-First Century*. Berkeley & Los Angeles: University of California Press.
- Dahl, Robert. 2005. *Poliarkia*. Tiranë: Pegi.
- Etzioni, Amitai. 2000. *The Third Way to a Good Society*. London: Demos.
- Fukuyama, Francis. 1996. "The Primacy of Culture", ff. 320-335, në Larry Diamond & Marc F. Plattner (eds.), *The Global Resurgence of Democracy*. Second edition. Baltimore: The John Hopkins University Press.
- Giddens, Anthony. 2002. "The Consequences of Modernity", ff. 244-256, në Craig Calhoun et al. (eds.), *Contemporary Sociological Theory*. Oxford & Malden, MA: Blackwell.
- Habermas, Jurgen. 2002. "The Tasks of a Critical Theory of Society", ff. 377-400, në Craig Calhoun et al. (eds.), *Contemporary Sociological Theory*. Oxford & Malden, MA: Blackwell.
- Kubrick, Stanley. 1971. *A Clockwork Orange* (film). Warner Bros. Pictures.
- Land, Kenneth C. 2008. "Whither Public Sociology?", *Contemporary Sociology* 37, 6: 507-511.
- Lipset, Seymour Martin. 1996. "The Centrality of Political Culture", ff. 150-154, në Larry Diamond & Marc F. Plattner (eds.), *The Global Resurgence of Democracy*. Second edition. Baltimore: The John Hopkins University Press.
- Luhmann, Niklas & Rafaele De Giorgi. 1991 *Teoria della Societa*. Milano: Franco Angeli.
- Mills, Wright C. 1959. *The Sociological Imagination*. New York: Oxford University Press.
- Moeller, Hand-Georg. 2006. *Luhmann Explained: From Souls to Systems*. Chicago: Open Court.
- Patterson, Orlando. 2007. "About Public Sociology", ff. 176-194, në Dan Clawson et al. (eds.), *Public Sociology: Fifteen Eminent Sociologists Debate Politics and the Profession in the Twenty-First Century*. Berkeley & Los Angeles: University of California Press.
- Piven, Frances Fox. 2007. "From Public Sociology to Politicized Sociologist", ff. 158-167, në Dan Clawson et al. (eds.), *Public Sociology: Fifteen Eminent Sociologists Debate Politics and the Profession in the Twenty-First Century*. Berkeley & Los Angeles: University of California Press.
- Riesman, David. [1950] 1961. *The Lonely Crowd: A Study of the Changing American Character*. With Nathan Glazer and Reuel Denny. New Haven, CT: Yale University Press.
- Schwartz, Pepper. 2008. "The Contested Territory of Public Sociology", *Contemporary Sociology* 37, 6: 512-515.
- Stinchcombe, Arthur L. 2007. "Speaking Truth to the Public, and Indirectly to Power", ff. 135-144, në Dan Clawson et al. (eds.), *Public Sociology: Fifteen Eminent Sociologists Debate Politics and the Profession in the Twenty-First Century*. Berkeley & Los Angeles: University of California Press.
- Smith-Lovin, Lynn. 2007. "Do We Need a Public Sociology: It Depends on What You Mean by Sociology", ff. 124-134, në Dan Clawson et al. (eds.), *Public Sociology: Fifteen Eminent Sociologists Debate Politics and the Profession in the Twenty-First Century*. Berkeley & Los

- Angeles: University of California Press.
- Tocqueville, Alexis de. 2002. *Demokracia në Amerikë*. Tiranë: Kristalina-KH.
- Tarifa, Fatos. 1993. "Albania's Post-Communist Transition: Can Democracy Thrive?", *Balkan Forum* 1, 5: 123-133.
- Tarifa, Fatos. 2005. "Albania's Road from Communism: Political and Social Change, 1990-1993", *Development and Change* 26, 1: 133-162.
- Tarifa, Fatos. 1996. "Neither 'Bourgeois' nor 'Communist' Science: Sociology in Communist and Post-Communist Albania", *Communist and Post-Communist Studies* 29, 1: 103-113.
- Tarifa, Fatos. 2008. *Ftesë në Sociologji: Imagjinata sociologjike dhe jeta e përditshme*. Tiranë: Ombra GVG.
- Tarifa, Fatos. 2009. "Ç'të bëjmë me një të kaluar të vështirë?", ff. 123-132, në Fatos Tarifa, Ksenofon Krisafi & Enea Tarifa. *Paradigma e Tranzicionit Demokratik*. Tiranë: Ombra GVG.
- Tarifa, Fatos & Lekë Sokoli. 2006. "Applying Sociology to the Construction of a Democratic Public Sphere in Albania", *Journal of Applied Sociology* 23, 1: 83-90.
- Tarifa, Fatos; Ksenofon Krisafi & Enea Tarifa. 2009. *Paradigma e Tranzicionit Demokratik*. Tiranë: Ombra GVG.
- Tarifa, Fatos & Enea Tarifa. 2009. "Fundit i tranzicionit ose një tranzicion pa 'fund'?", ff. 47-79, në Fatos Tarifa, Ksenofon Krisafi & Enea Tarifa. *Paradigma e Tranzicionit Demokratik*. Tiranë: Ombra GVG.
- Touraine, Alain. 2007. "Public Sociology and the End of Society", ff. 67-78, në Dan Clawson et al. (eds.), *Public Sociology: Fifteen Eminent Sociologists Debate Politics and the Profession in the Twenty-First Century*. Berkeley & Los Angeles: University of California Press.
- Wallerstein, Immanuel. 2007. "The Sociologist and the Public Sphere", ff. 169-175, në Dan Clawson et al. (eds.), *Public Sociology: Fifteen Eminent Sociologists Debate Politics and the Profession in the Twenty-First Century*. Berkeley & Los Angeles: University of California Press.

*Tranzicioni i munguar:
Deskriptivizmi empiriko-historicist
kundrejt qasjes kritiko-analitike në
shkencat sociale shqiptare***

Enika Abazi*

Abstrakt

Punimi fokusohet kryesisht në influencën, gjatë periudhës së diktaturës komuniste, të qasjeve materialiste dhe empiriciste të përdorura si metode për të legjitimuar Socializmin në Shqipëri. Trashëgimi i kësaj metode studimi edhe në vitet e tranzicionit shënon një oportunitet të munguar të adoptimit të mendimit kritik në shkencat sociale. Adoptimi i një qasjeje të tillë që do t'u kishte shërbyer shkencave sociale si një mënyrë për transformimin e tyre dhe të realitetit shoqëror shqiptar drejt niveleve bashkëkohore.

* Enika Abazi është pedagoge e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin European të Tiranës. Ka fituar Ph.D-ne në Marrëdhëniet Ndërkombëtare (2005) nga Universiteti i Bilkentit, Ankara, Turqi. Mban titullin Profesor i Asociuar nga Komisioni Kombëtar i Kualifikimit Shkencor (Shqipëri) dhe Këshilli Kombëtar i Universiteteve (France). Interesat e saj shkencore janë Studimet Ballkanike dhe ato Europiane, kryesisht lidhur me çështje të konflikteve, të sigurisë, rendit dhe integritimit në marrëdhëniet ndërkombëtare.

** Ky punim është referuar në Konferencën Kombëtare “Shkencat Sociale dhe Shoqëria Shqiptare në Tranzicion”, organizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Politikave dhe Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin European të Tiranës (UET), më 19 nëntor 2010.

Hyrje

Kanë kaluar njëzet vjet nga përmbyjsja e komunizmit në Shqipëri dhe duket se ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur në transformimin e pronës (nga shoqërore në private), të kushtetutës (nga komuniste në demokratike), të diktaturës së proletariatit në shtet të së drejtës, të izolimit ndërkombëtar në atë të integritimit me botën e lirë etj. Megjithatë, edhe pas njëzet vjetësh, Shqipëria duket se vazhdon ende transformimin e saj politik, ekonomik dhe shoqëror. Ndërkohë, efektet sociale, politike dhe ato të daljes nga izolimi intelektual të këtyre transformimeve janë sa të gjera dhe të thella, aq sa dhe të pakuptuara dhe të shpjeguara sa duhet.

Shembja e sistemit të socializmit shtetëror dhe heqja dorë prej ideologjisë marksiste-leniniste rezultuan me mohimin e teorisë sociale të regjimit. Transformimet ekonomike, politike dhe ato sociale, të kryera pas rrëzimit të komunizmit në Shqipëri, e detyruan komunitetin akademik dhe intelektual shqiptar t'u gjejë përgjigje sfidave urgjente të imponuara nga ndryshimi i menjëhershëm. Sidoqoftë, mbetet e rëndësishme të reflektohet se sa dhe si është plotësuar vakumi i krijuar sa hap e mbyll sytë në këtë drejtim pas përmbyjsjes së komunizmit. Sa janë në gjendje shkencat sociale shqiptare të shpjegojnë proceset që po ndodhin, të informojnë politikëbërjen dhe t'u paraprijnë zhvillimeve të reja? Si kanë ndryshuar metodat dhe përmbajtja e shkencave sociale dhe deri në çfarë mase studiuesit shqiptarë të këtyre shkencave janë sot në gjendje të komunikojnë dhe të debatojnë përtej kontekstit shqiptar? Kjo ese synon t'u japë përgjigje pyetjeve të tilla duke reflektuar kryesisht mbi çështje metodologjike të shkencave sociale në Shqipëri gjatë këtyre njëzet vjetëve të fundit. Kjo ka një rëndësi jo vetëm akademike, por edhe, madje para së gjithash, rëndësi praktike, pasi të kuptuarit e institucioneve dhe interpretimi i proceseve të transformimit politik, ekonomik dhe shoqëror mbeten një parakusht i domosdoshëm për mirëfunksionimin e tyre, si edhe për konsolidimin e rendit demokratik.

Postkomunizmi, në vetvete, ka një dimension historik dhe studiuesit e shkencave sociale duhet të përdorin të gjitha metodat në dispozicion për ta përfshirë atë në konsideratat e tyre. Duke u ndalur në veçanti në analizën e shkaqeve të asaj çka unë do ta quaja një *tranzicion i munguar* në shkencat sociale shqiptare, ky punim nis me një trajtim të shkurtër të traditës shkencore shqiptare në të kaluarën, pasi metodologjia e mbështetur në një sistem të unifikuar të shkencës dhe të edukimit, si edhe mendësia e krijuar gjatë sistemit komunist, duket se ende vazhdojnë të ndikojnë mbi zhvillimin e shkencave sociale në periudhën postkomuniste, të cilat duket se sillen në një rreth vicioz që riprodhon në përmbajtje të njëjtin realitet, të njëjtat marrëdhënie sociale dhe mentalitete, ndonëse në forma të ndryshme. Pa një reflektim të tillë mbi çështjet metodologjike, studimet postkomuniste në fushën e shkencave sociale kanë mbetur ende, në pjesën më të madhe të tyre, në batakun e studimeve të periudhës komuniste, pasi ndryshimet e pritura nuk mund të ndodhin pa qartësuar defektet e së kaluarës dhe pa adoptuar perspektiva të reja teorike dhe qasje të reja metodologjike për të krijuar një produkt shkencor të ndryshëm. Në veçanti, unë ndalem në influencën e empiricizmit materialist, të deskriptivizmit dhe të dogmatizmit ideologjik në shkencat sociale shqiptare në të kaluarën, si edhe në pasojat e tyre sot.

Studimet e komunizmit dhe tradita e trashëguar shkencore

Mungesa e studimeve të mirëfillta për periudhën komuniste e bën të vështirë studimin e ndikimit të institucioneve dhe të mentaliteteve të së kaluarës në periudhën postkomuniste. Një studim serioz i periudhës komuniste kërkon një përqendrim të vëmendjes sidomos në çështjet metodologjike. Nevoja e një metode shkencore në shkencat sociale diktohet nga një sërë arsyesh. Realiteti social është tepër kompleks dhe nuk mund të interpretohet vetëm nëpërmjet vëzhgimeve të thjeshta pasi, shpesh here, rezultatet e këtyre të fundit janë iluzive (Little 1998). Zgjedhja dhe përdorimi i metodës së duhur është thelbësore për gjenerimin e dijes shkencore dhe përgjithësimin e saj. Për më tepër, studimi i realitetit nëpërmjet një metode shkencore i shërben jo vetëm interpretimit apo parashikimit të dukurive dhe të ngjarjeve, por edhe parashtrimit të mundësive njerëzore për veprim dhe ndërhyrje në realitetin social. Përveç përcaktimit të aftësive tona shpjeguese, metoda e zgjedhur përcakton edhe horizontin tonë etik dhe politik.

Regjimi komunist propagandonte nevojën që gjithçka, dhe për më tepër kërkimi shkencor, të karakterizohej nga kërkesat për objektivitet, për realizëm dhe, paradoksalisht, për çlirim nga paragjykimet dhe për përkushtim ndaj barazisë dhe drejtësisë, me qëllim emancipimin e shoqërisë. Paradoksi qëndron në atë se pasqyrimi me objektivitet i realitetit në një shoqëri socialiste jo domosdoshmërisht çon në promovimin e vlerave dhe në progres shoqëror, pasi kjo varet nga mënyra se si kuptohet dhe pasqyrohet “objektiviteti”, “realizmi” apo “emancipimi” në trajtimin e realitetit shoqëror. Kërkimi në shkencat sociale komuniste huazonte nga marksizmi observimin e një realiteti objektiv, që konsiston në mbledhjen e fakteve empirike dhe në “evidentimin” e përvojës së punës të burrave dhe të grave punëtore dhe kooperativiste në ndërtimin e komunizmit. Një aspekt tjetër i huazuar nga marksizmi ishte dogmatizmi, i cili e vlerëson “vërtetësinë” e studimeve nga këndvështrimi i ideologjisë së elitës në pushtet, duke u mbështetur në një teori dhe në një metodë të vetme, në teorinë marksist-leniniste dhe në metodologjinë e saj. Kjo metodologji garantonte natyrën politike të interpretimeve dhe të shpjegimeve të fenomeneve sociale, të cilat synonin legjitimimin e regjimit komunist që fetishizohej dhe propagandohej si faza më e lartë dhe e fundit e zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

Aplikimi i marksizmit solli një sërë pasojash negative, të cilat mund të identifikohen lehtësisht në teorinë dhe në praktikën e shkencave sociale shqiptare, dhe që vlen të përmenden këtu pasi duket se ato vazhdojnë të ndikojnë edhe në studimet sociale të periudhës postkomuniste. Adaptimi i empiricizmit i shërbeu instalimit të dogmatizmit në shkencat sociale. Siç vë në dukje Steve Smith (1996), empiricizmi nuk është gjë tjetër veçse një qasje dogmatike ndaj realitetit, së cilës i mungon pikënisja dhe metoda e duhur për verifikimin e hipotezave dhe përgënjeshttrimin e teorieve. Kështu, riprodhimi ose rivlerësimi i së shkuarës u bënë nën optikën e ideologjisë marksiste dhe përmes metodologjisë së realizmit socialist, ku duhej të mbizotëronte lufta e klasave dhe triumfi i heronjve të saj, si pjesë e papërgënjeshtreshme e realitetit social. U inkurajuan studime që krijonin pseudoheronj, si Haxhi Qamili,

të stisur si luftëtarë të vegjëlisë, ose që vlerësonin Kryengritjen e Fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme të vitit 1914 si luftë klasash kundër bejlerëve dhe agallarëve.¹ Në të njëjtën mënyrë dhe për të njëjtat qëllime “deklasheshin” studime, të cilat ishin në kundërshti me ideologjinë marksiste dhe me politikën e regjimit në fuqi.

Empiricizmi dhe ideologjia marksiste kontribuan në instrumentalizimin e dijes mbi shoqërinë, shpesh herë nëpërmjet trukimit të realitetit, ose të “folklorizimit të traditave kulturore” (Doja 1998), në funksion të legjitimitimit të sistemit politik, të strukturave mbizotëruese të pushtetit komunist, siç do të thoshte Michel Foucault (1986), dhe në formësimin e një realiteti të gënjeshtërt, i cili glorifikonte “njeriun e ri”, duke e paraqitur atë si arritjen e regjimit komunist, “prosperitetin” dhe “begatinë ekonomike”, “qendresën ngadhënjimtare” mbi të gjithë “armiqtë” e brendshëm dhe të jashtëm të socializmit, të qenurit “fanar ndriçues” për të gjithë botën dhe për gjithçka. Të gjitha këto i shërbenin efektivisht indoktrinimit të njerëzve dhe të vetë studimeve sociale. Një sërë punimesh “shkencore” të së kaluarës iu nënshtruan manipulimit, pasi ato thjesht nuk përmbushnin kriterin ideologjik. Vlen të përmendet retushimi i dokumentit të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, ose i Kongresit të Lushnjës, ku protagonistët e këtyre ngjarjeve të rëndësishme, të konsideruar si “tradhtarë” të kombit, u zëvendësuan mjeshhtërisht nga individë, të cilët politikisht plotësonin “standartet” dhe, mbi këto “standarde” u shkrua historia për këto ngjarje.

Në shumë raste, në fushën e historisë, të letërsisë, të studimeve mbi kulturën popullore, të arkeologjisë etj., instrumentalizimi u materializua nëpërmjet glorifikimit të partikularizmit apo karakterit specifik historik, social dhe kulturor të popullit shqiptar dhe të heronjve të tij popullorë gjë që, në mënyrë të natyrshme, kulmonte me vendosjen e socializmit dhe legjitimitimin e lidërshit të tij. Nga një vëzhgim i shpejtë i studimeve në shkencat sociale dhe në disiplinat humane në Shqipëri gjatë periudhës së socializmit shtetëror, mund të thuhet se si edhe në vendet e tjera komuniste (Kuper, 1996), studimet e periudhës së komunizmit kanë një prirje të theksuar drejt krijimit të një shkence kombëtare, ku preokupimi kryesor mbetet rivlerësimi i traditës popullore apo i historisë kombëtare të popullit, kryesisht nëpërmjet inventarizimit të vlerave pozitive, të lavdishme, të veçanta, ndërkohë që në to mungon thujtë fare trajtimi teorik ose ai krahasues.

Shkencave sociale “kombëtare” të krijuara gjatë periudhës së komunizmit, të cilat unë do t’i quaja “shkenca shqiptare për shqiptarët”, u mungonte dialogu me studiues të shkencave sociale jashtë vendit dhe, për rrjedhojë, dhe botimet e rezultateve të tyre në revista shkencore jashtë vendit, gjë që solli vetizolim intelektual të studiuesve shqiptarë në këto shkenca dhe kjo ndikoi jo pak në nivelin e cilësisë së punimeve të botuar dhe të problematikave të trajtuara. Një zhvillim i tillë inkurajohej jo vetëm nga adaptimi i një metodologjie kufizuese në studimin e realitetit social, por edhe nga një sërë pengesash të tjera si, mungesa dhe ndalimi në Shqipëri i literaturës bashkëkohore perëndimore dhe, më vonë, edhe e asaj lindore, apo ndalimi i pjesëmarrjes së studiuesve shqiptarë të shkencave sociale në konferenca dhe forume ndërkombëtare (Tarifa 1996).

¹ Për debatin mbi këtë çështje shih Kaloçi (2003).

Ideologjia marksiste, duke u konsideruar empirikisht sa natyrale, aq edhe e pazëvendësueshme, zhvlerësoi çdo qasje tjetër, duke kushtëzuar atë që Clifford Geertz ([1964] 1973) e ka cilësuar si një instalim të “hartës së realiteteve sociale problematike dhe matricën për krijimin e ndërgegjes shoqërore”. Ndërkohë që nocioni i legjitimitetit mbetet problematik, ideologjia merr një rol të rëndësishëm në legjitimin e pushtetit nëpërmjet inkurajimit të mendimit dhe të ligjërimit që natyralizon regjimin politik, duke e bërë atë, në mënyrë të pakundërshtueshme, të përshtatshëm, *bona fide*, dhe të denjë për respekt.

Më shumë se çdo gjë tjetër, botimet divulgative në shërbim të masivizimit të shkencës si edhe të apologjisë së politikës zyrtare ishin me pasoja serioze për nivelin shkencor dhe metodologjik të punimeve akademike (Egro 2007). Pa u ndalur gjatë në gazetatat dhe revistat e kohës, shkrimet e të cilave nuk trajtojnë veçse probleme të anti-amerikanizmit apo të “kotësisë” së ideologjisë borgjeze-imperialiste, shembullin më tipik e përbëjnë veprat e liderit komunist, “analizat” e të cilit mbi sistemin e vetë-administrimit jugosllav, mbi politikën dhe zhvillimet në Bashkimin Sovjetik, në Lindjen e Mesme apo Kinën e largët, jo vetëm që duhet të gjendeshin në bibliotekat e gjithsekujt, por edhe ishin literatura referuese kryesore për studiuesit e mirëfilltë të marrëdhënieve ndërkombëtare, për pedagogët dhe për studentët, madje dhe për punëtorët dhe kooperativistët e thjeshtë, kurdo që këtyre t’u duhej të demaskonin në mbledhjet e kolektivit revizionistët titistë, hrushovianë, kinezë, eurokomunistë dhe tradhtarët e radhës të doktrinës marksiste.

Duhet thënë se në Shqipëri mungon ende tradita për shumë disiplina të shkencave sociale, si edhe shkolla të mendimit shoqëror. Duke iu referuar fatit të sociologjisë gjatë periudhës së socializmit e cila konsiderohej “e panevojshme”, ose “borgjeze dhe e dëmshme” (Tarifa 1996), unë do të shtoja këtu edhe fatin e disiplinave të tjera, si shkencat politike, marrëdhëniet ndërkombëtare, antropologjia sociale, etj. Shkencat sociale gjatë periudhës komuniste ekzistonin (në nivel kërkimor dhe institucional) vetëm për filozofinë marksiste-leniniste dhe për ekonominë politike (kryesisht atë të socializmit), gjë që kushtëzoi edhe programet e studimit në universitetin shqiptar dhe në ato pak qendra dhe institute kërkimore. Mungesa e studimeve mbi realitetin shoqëror në nivele të ndryshme (individit, grupit, shoqërisë) krijonte përshtypjen e një realiteti pa kontradiktë dhe pa probleme, duke i shndërruar në spekulative shumë studime të aspekteve sociale dhe ekonomike të shoqërisë shqiptare. Të tilla ishin raportet e kongreseve të Partisë së Punës, të cilat analizonin të gjitha aspektet e jetës në Shqipëri, e cila përgjithësisht paraqitej si e mbushur me suksese dhe me realizime spektakolare, si sigurimi i bukës në vend, plotësimi i nevojave të vendit me energji elektrike dhe me çelik etj., dhe vetë shoqëria shqiptare si një shoqëri e emancipuar që nuk e njihte kthimin mbrapa.

Vlen të përmendet se, marksizmi shkencor, si teori, në ndryshim nga marksizmi utopist, nga ideologjia marksiste dhe praktika e asociuar me të, ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në mënyrën sesi duhen analizuar dhe shpjeguar proceset shoqërore në një këndvështrim historik dhe mbi rolin që luajnë forca të ndryshme sociale në zhvillimin historik. Metodologjia e marksizmit shkencor në shpjegimin e një procesi,

të një fenomeni ose të një ngjarjeje shoqërore kërkon zbulimin e shkakësisë së tyre duke evituar asocimin “realist” dhe empiricist të variablave të observuara. Kjo perspektivë lejon ngritjen e hipotezave të verifikueshme. Në nivel ndërkombëtar, teoria e marksizmit shkencor ka pasur një ndikim të padiskutueshëm në shkencat sociale (ashtu si edhe idetë që formuloi Max Weber). Shkolla e Frankfurtit për shembull, e cila lindi në periudhën midis dy luftërave botërore si një përpjekje për adoptimin e qasjeve kritike në shkencat sociale, me përfaqësuesit e saj më të shquar Max Horkheimer dhe Theodor Adorno, për të arritur, në periudhën e fundit të saj, tek filozofi Jürgen Habermas (1984), i cili solli një kuptim joinstrumentalist të arsyes dhe në metodën jopozitiviste në shkencat sociale (Held 1980; Raymond 1981). Gjithashtu, Michel Foucault (1970, 1986) solli në vëmendje se dija është kontingjent i kushteve specifike historike, i marrëdhënieve i dhe strukturave përkatëse të pushtetit, ndërsa Emmanuel Wallerstein (1974, 1980, 1989) “rizbuloi” ndërvarësinë e sistemit ekonomik sot dhe tjetërsimin si kategori dhe fenomene reale sociale, që duhet të korrigjohen me qëllim emancipimin e shoqërisë njerëzore.

Paradoksisht, pikënisja e qasjeve kritike buron nga qasjet neomarksiste, për të vijuar me tej me qasjet konstruktiviste dhe strukturaliste në shkencat sociale. Këto ndikime të marksizmit shkencor në plan ndërkombëtar kanë pasur një jehonë të papërfillshme në shkencat sociale shqiptare gjatë periudhës komuniste, ndonëse ironikisht ato kanë qenë të mbizotëruara dhe të drejtuara nga metoda e “realizmit socialist” dhe nga ideologjia marksiste. Adaptimi verbërisht i metodës së “realizmit socialist” në artet dhe në shkencat sociale dhe i “materializmit historik” si qasja e vetme teorike dhe metodologjike për studimin e shoqërisë në shkencat sociale shqiptare inkurajoi në to një deskriptivizëm të kotësive empirike, që s’ishte në gjendje të dallonte lidhjen e vërtetë dialektik midis konkretes dhe abstraktes, të përgjithshmes dhe të veçantës që qëndron në themel të organizimit shoqëror. Me këtë “zgjedhje”, nga njëra anë, shkencat sociale komuniste në Shqipëri, i mohuan vetes kuptimin e shkakësisë së vërtetë të strukturave, të proceseve dhe të dukurive sociale, gjithsesi jo gjithnjë të observueshme, të cilat vënë në lëvizje apo kufizojnë veprimet individuale si edhe iniciojnë procese sociale që nuk drejtohen nga ligjësi të caktuara. Nga ana tjetër, studiuesit shqiptarë nuk kanë qenë në gjendje të kuptonin se strukturat dhe proceset sociale gjenerojnë marrëdhënie të pushtetit, të dominimit, të shfrytëzimit dhe të rezistencës, të cilat, nga ana e tyre, favorizojnë disa ndërkohë, që disfavorizojnë disa të tjerë, dhe që vlerësimi kritik i tyre qëndron në bazë të emancipimit të shoqërisë. Me fjalë të tjera, realiteti është tepër kompleks; ai rezulton nga marrëdhënia e ndërsjellët e agjentëve të ndryshëm socialë dhe e strukturës së shoqërisë, që ndikojnë reciprokisht te njëri-tjetrit dhe në vetë mjedisin social. Për këtë arsye, kuptimi dhe interpretimi i fenomeneve sociale mbetet sa i rëndësishëm, aq edhe i vështirë pa përdorimin e metodologjisë së duhur.

Qasjet empiriciste të adoptuara nga shkencat sociale shqiptare rezultojnë problematike për shkallën e njohjes dhe të vetë objektivitetit që ofrojnë studimet në këto fusha. Rëndësia e të dhënave empirike në shkencat sociale nuk mund të mohohet, Lieberson (1989) do të insistonte në rëndësinë e një të menduari që mban

parasysh shkakësinë dhe që, në të njëjtën kohë, nuk refuzon arsyetimin sasior. Ky autor argumenton se të kuptuarit e shkaqeve të ngjarjeve dhe të dukurive shoqërore mund të arrihen duke u thelluar në studimin e tyre. Një studim rigorozisht shkencor kërkon të mbahet parasysh ajo që Alexander George dhe Andrew Bennett (2005) e quajnë “ndjekje e procesit” (*process-tracing*). Një metodë e tillë ka për qëllim zbulimin e lidhjes ndërmjet shkaqeve të mundshme dhe rezultateve të observimit. Ndjekja e procesit nënkupton shqyrtimin dhe interpretimin e fakteve historike, të dokumenteve arkivore, të transkripteve të intervistave dhe të burimeve të tjera që duket se kanë lidhje me ngjarjen në vëmendje, krahas rezultateve të observimeve, për të parë nëse shkakësia e observuar çon në formulimin e një hipoteze teorike, ose është thjesht një ngjarje e radhës, pa ndonjë rëndësi të veçantë (ibid, 6). Shumë studiues kanë argumentuar se është e mundur që të ofrohet evidencë në favor të—apo kundër—qoftë edhe të një pretendimi të vetëm shkakësor, duke bërë të mundur kështu gjenerimin e arsytimeve rigorozë për çështje të rëndësishme të transformimeve sociale në një periudhë të ndryshimit të sistemeve.

Trashëgimi nga e kaluara i një tradite shkencore (kryesisht i empiricizmit dhe i dogmatizmit) të mbarsur me probleme, e bën sot më të vështirë zhvillimin e mendimit racional kritik dhe të alternativave teorike, aq të domosdoshme për studimin e shoqërisë postkomuniste në Shqipëri. Realiteti i ri politik dhe social-ekonomik në vendin tonë, sidoqoftë, krijon mundësi të shumta për zhvillimin e shkencave sociale si edhe fusha të reja studimi për to.

Tranzicioni dhe studimet e tij

Tranzicioni shqiptar i ngjan një procesi sizifian që nuk i duket as fillimi as fundi. Ndërkohë që transformimet sociale janë tepër komplekse, lidhjet shkakësore të ndryshimeve që ndodhin dhe pasojat e tyre mbeten ende të errëta. Në vetvete, transformimet sociale nënkuptojnë një zhvillim social të ndërthurur me shumë faktorë të panjohur, pra edhe me shumë rrjedhoja të panjohura, përfshirë edhe mundësinë e kthimeve të përkohshme mbrapa. Këto transformime kanë të bëjnë me shpërbërjen e institucioneve, të mentaliteteve dhe të praktikave të vjetra politike, ekonomike dhe shoqërore dhe me krijimin e institucioneve, të mentaliteteve dhe të praktikave të reja; ato kërkojnë ndryshime në strukturat dhe politikat e partive politike dhe të shtetit, strategji të reja të grupeve të ndryshme sociale dhe të interesit dhe realizohen përmes proceseve të shumanshme dhe të ndërvarura sociale. Ndryshime të tilla bëjnë të domosdoshme zhvillimin e një paradigme të re në shkencat sociale me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të përshtatshme për problemet e transformimit shoqëror dhe përbalimin e sfidave të vështira me të cilat përballet shoqëria shqiptare në rrugën e saj të zhvillimit e të modernizimit dhe të konsolidimit të rendit demokratik. Tranzicioni shqiptar ka nevojë për studime të mbështetura mirë në teoritë dhe metodologjitë shkencore më të përparuara. Ndërkohë që idetë e vjetra në disiplinat tona sociale janë zhvleftësuar, shumë ide të reja ende nuk kanë marrë një formë të qartë dhe nuk janë konsoliduar.

Duket se studimi i një periudhe jo shumë të largët në kohë, siç është ajo e socializmit shtetëror, ka mbetur kryesisht në kuadrin e kujtimeve, botimit të dorëshkrimeve të atyre që deri pak kohë më parë quheshin të deklasuar, apo evokimit të ngjarjeve të së kaluarës në faqet e të përditshmeve kombëtare dhe lokale, kryesisht të atyre që kanë të bëjnë me marrëdhëniet brenda ish-partisë në pushtet dhe me mënyrën e ushtrimit në praktikë të diktaturës së proletariatit dhe të luftës së klasave. Dobia e evokimit të së kaluarës në mënyrë thjesht fotografike, kataloguese, si dhe ajo e rivlerësimit dhe rishkrimit të së kaluarës, mbetet e dyshimtë nëse nuk shoqërohet me interpretimin e proceseve dhe të marrëdhënieve sociale që kanë të bëjnë me legjitimitetin e pushtetit, si edhe me shfaqjet dhe pasojat e tyre në shoqërinë komuniste, ose me mënyrën sesi ato përthihen në shoqërinë postkomuniste shqiptare. Reflektimi mbi të kaluarën, mbi historinë e institucioneve dhe të organizimit politik të shoqërisë komuniste, si edhe mbi mënyrën dhe shkallën e legjitimitetit të tyre do t'i shërbente kuptimit më të mirë të faktit sesi institucionet shoqërore krijohen dhe funksionojnë në ditët tona dhe sesi ato favorizojnë, kushtëzojnë apo pengojnë zhvillimet sociale në periudhën e transformimit demokratik të shoqërisë shqiptare.

Janë të pakta studimet që i referohen periudhës komuniste për identifikimin e pasojave të komunizmit në metodologjinë e shkencave humane dhe sociale shqiptare (Tarifa 1996; Doja 1998; Hoti 2003; Egro 2007). Ndërkohë, mungesa e një reflektimi serioz mbi studimet shoqërore të periudhës së komunizmit dhe mbi metodologjinë e përdorur prej studiuesve në atë periudhë, rezulton të ketë lënë pasojat të cilat, në forma të ndryshme, ndihen edhe në studimet bashkëkohore, në fusha të ndryshme të shkencave humane dhe sociale. Studimet të cilat evokojnë periudhën që lamë pas, në pjesën më të madhe të tyre synojnë rivlerësimin dhe rishkrimin e historisë, të studimeve të kulturës popullore, të ligjit zakonor apo të gjuhës shqipe, proces ky i cili duket se mbart një dozë të lartë të asociimit me politikën dhe ideologjinë e elitës në pushtet. Për shembull, debati mbi ditën e çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazistë ka vënë përballë historianët e vendit, të cilët në diskutimet dhe shkrimet e tyre duket se frymëzohen nga nevoja për t'u distancuar nga e kaluara komuniste, ose për t'u asociuar në grup.² Sigurisht që në një proces të tillë rëndësi ka marrë dhe rivlerësimi i shumë fakteve dhe ngjarjeve historike, të cilat sot paraqiten si versioni legjitim i të kaluarës, ndërkohë që të tjera kanë kaluar në një pozicion të marginalizuar. Kështu mund të kujtojmë rivlerësimin e luftës të quajtur nacionalçlirimtare e cila nuk është më vetëm çlirimtare, por është bërë dhe një luftë civile midis forcave komuniste e nacionaliste për pushtet. Kështu, post-komunizmi në shkencat sociale, ashtu si edhe në rastin e vendeve të tjera lindore (p.sh. Kanef 2004; Appadurai 1981), është konceptuar si ndeshje e interpretimeve konfliktuale mbi të kaluarën komuniste ku historia, kultura, gjuha, e drejta zakonore shihen si entitete

² Një sërë debatesh janë pasqyruar në shtypin ditor në lidhje me ditën e çlirimit të vendit (Frashëri, 2009); Baruti 2009), paraprirë nga botime pro dhe kundër të historianëve të ndryshëm Gjeçovi (2004), Biçoku (2001). Çështja është bërë objekt debati edhe në Konferencën Shkencore "Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore", organizuar nga Akademia e Shkencave me rastin e 65-vjetorit të çlirimit të vendit. Ndërsa në Librin e *Historisë së Shqipërisë*, Klasa 12 (Meta, Dezhgiu dhe Lleshi, 2010: 282) shkruhet se dita e çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazi-fashistë është 28 nëntori, por për arsye politike të asaj kohe u vendos data 29 nëntor.

të negociueshme, pjesë e rivalizimit, kundërshtimit dhe debatit politik midis grupeve të ndryshme politike dhe aspekt i rëndësishëm për justifikimin e reformave gjatë këtyre njëzet viteve të transformimit të regjimit. Vërtetësia e studimeve, si dhe në të kaluarën, bëhet në funksion të preferencave politike të elitës së radhës në pushtet duke ruajtur kështu dogmatizmin në përmbajtje.

Një problem themelor i studimeve sociale të periudhës post-komuniste është metodologjia që ato përdorin. Kjo metodologji ndikohet në një masë të madhe nga tradita shkencore komuniste, që do të thotë se trashëgon empiricizmin dhe deskriptivizmin me karakter dogmatik dhe instrumentalist. Kështu, nëse i referohemi një sërë studimesh të kryera në Shqipëri pas rrëzimit të komunizmit ato mbështeten kryesisht në vëzhgime të drejtpërdrejta dhe anketime të ndryshme ku mbizotëron fetishizmi i faktit empirik dhe mungesa e analizës kritike. Qasja empirike, në mënyrë të thjeshtuar, përqendrohet në vërtetime të sjelljes së aktorëve të ndryshëm në shoqëri, matjes dhe numërimit të variabëlve në kuadrin e popullsisë, përdorimin e metodave sasore statistikore në zbulimin e korrelacioneve dhe asocimeve ndërmjet variabëlve socialë. Në fund të fundit një qasje e tillë synon të zbulojë shkakësinë në shoqërinë njerëzore duke përllogaritur koeficientet e regresionit për një grup të variabëlve të pavarur të cilët shikohen si shpjegues të sjelljes së variabëlve të varur, apo korrelacionin ndërmjet disa variabëlve, apo evidentimin e rregullshmërisë së asocimit midis një grup të variabëlve. Një qasje të tillë Andrew Abbot do ta quante “paradigma e variabëlve”, sipas së cilës puna kryesore qëndron tek zbulimi i variabëlve sociale dhe përcaktimi i marrëdhënieve ndërmjet tyre (Abbott 1999: 222). Të tilla janë në pjesën më të madhe studimet e kryera nga “think tanket” shqiptare për probleme që kanë të bëjnë me çështje nga më të ndryshme, si për shembull integrimi i Shqipërisë në strukturat Euro-Atlantike, decentralizimi, liritë dhe të drejtat njerëzore e të minoriteteve, fenomene si gjakmarrja apo çështjet e pronësisë. Në studimet që trajtojnë çështjen e integritimit Euro-Atlantik, rezultojnë se në masën 94-96 për qind shqiptarët janë pro integritimit në këto struktura, sigurisht lëvizja e lirë apo niveli i lartë i korrupsionit shtetëror janë disa nga arsyet e preferuar në shpjegim të situatës (AIIS, 2008, 2009, 2010), ndërkohë pothuajse në asnjë studim nuk ndalet në arsyet e mungesës së mendimit ndryshe apo në kundërshtim të shqiptarëve dhe organizimeve të tyre politike, ekonomike apo dhe civile. Në themel një paradigme empiriciste sjell kufizime epistemologjike dhe ontologjike dhe është e destinuar të mbetet pa një metodologji të mirëfilltë kërkimore që do ta pajiste kërkimin me instrumentet e nevojshme për zbulimin e shkakësisë.

Një karakteristikë tjetër e studimeve shqiptare të periudhës post-socialiste është rendja mbas ngjarjeve sensoriale, që po t’i nënshtroheshin ndjekjes së procesit (process tracing) do të rezultojnë të zakonshme dhe pa ndonjë rëndësi të veçantë. Mjafton, të kujtojmë debatet e shumta për tri çështje tashmë të mirënjohura edhe nga publiku mbarë shqiptar: historia e Skënderbeut e Oliver Schmitit (Puto, 2009; Lleshi, 2009; Ndreca, 2008)³, identiteti European apo oriental i shqiptarëve

³ Në Librin e tij Ndreca (2008) ndërmerr një pozicion kritik duke vlerësuar referencat e burimeve dokumentare të Schmitit dhe akuracinë e tyre.

ndërtuar mbi debatin Qosja-Kadare (Tirana Observer, 2006)⁴ apo standardi i gjuhës shqipe dhe vendi i dialekteve. Debatet kanë pasur të përbashkët ndjeshmërinë dhe përkushtimin për mbrojtjen e vlerave dhe të simbolikës kombëtare, duke mbetur në thelb emocionale, ku reflektohet njëanshmëri, sektarizëm, e madje ideologjizim i çështjeve të diskutuara, ndërkohë që pak ose aspak është diskutuar mbi natyrën dhe rëndësinë e referencave të përdorura, mbi metodologjinë e vlerësimit dhe të kontekstualizimit të këtyre referencave, rëndësinë e pluralitetit të metodave dhe teorive në studimin e proceseve sociale apo historike.

Për rrjedhojë, njëlloj si artikujt në gazetat e përditshme dhe punimet shkencore janë të dobëta, të karakterit politiko-publicistik, dhe për më tepër të paafta për të parashtruar një dialog konstruktiv e kritik në nivel ndërkombëtar. Në shumë studime, kryesisht atyre historike, gjuhësore, por jo vetëm, duket se ideologjia marksiste është zëvendësuar nga ajo kombëtare apo nacionaliste. Çështjet e trajtuara politizohen, dhe studimet nuk janë në gjendje të ofrojnë një kontribut të mirëfilltë shkencor, por në shumë raste krijojnë dasi dhe armiqësi të panevojshme që nuk përbëjnë ndonjë kontribut shkencor. Nëse do t'i referohesha Izber Hotit, "si dhe më parë nuk trajtohet e kaluara për arsye shkencore dhe fisnike, por për para dhe motive të tjera, që nuk ndikonin fare në përparimin tonë kombëtar, por as në përparimin tonë shoqëror në përgjithësi" (2003: 272). Studimet divulgative duket se janë trashëguar edhe në ditët tona. Shkenca bëhet në median e shkruar dhe vizive ku debatuesit dinë gjithçka për çdo gjë dhe debatet "shkencore" mbeten të politizuara dhe të ideologjizura pa qenë të afta të identifikojnë problemet që shqetësojnë shoqërinë shqiptare në periudhën post-komuniste, le më pastaj t'i analizojnë ato në mënyrë shkencore e të ofrojnë zgjidhje për to (Hoti 2003; Egro 2007). Jo në pak raste studimet e periudhës post-komuniste në Shqipëri trashëgojnë empiricizmin sociologjik apo deskriptivizmin historik dhe një logjikë konformiste qoftë politike qoftë ideologjike për marrëdhëniet institucionale, ekonomike, politike, sociale apo kulturore deri edhe gjuhësore dhe produktin e tyre social. Një qasje e tillë shoqërohet me pasoja jo vetëm etike, por edhe politike, të shprehura rëndom në qëndrime autoritative, unilaterale apo stigmatizuese, në interes të dikujt apo të një ideologjie të caktuar, që në thelb i shërbejnë konsolidimit të një pushteti të cilësuar. Adoptimi i qasjes refleksive e cila tërheq vëmendje me mënyrën sesi duhet kuptuar formësimi i interesave politike, përdorimi i kontekstit historik dhe i vlerave mbizotëruese, të projektuara nga elitat në formate dijësore të formalizuara, dhe që nënvleftësojnë alternativa të tjera, që nuk i interesojnë politikës në pushtet, apo që kërkon sanksionim prej pushtetit, janë të papërfillshme në studimet bashkëkohore shqiptare ndonëse njëzet vjet kanë kaluar nga shembja e izolimit shkencor.

Adoptimi i një analize sistematike kritike mund të na surprizojë. Si shembull, ndër të paktët, përballja nëpërmjet një analize sistematike kritike me të dhëna demografike, burime historike dhe etnografike në lidhje me moshën mesatare të martesës dhe normat e përgjithshme të fertilitetit në Shqipëri, dimensionin ideologjik i mitit se shqiptarët bëjnë shumë fëmijë brenda familjes së ashtuquajtur patriarkale, që përcillet dhe projektohet zakonisht në shkrimet akademike, shtyp

⁴ Shih gjithashtu: [http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=64263 &page=14](http://www.forumishqiptar.com/showthread.php?t=64263&page=14)

dhe mendimet stereotipa, bëhen të pavlefshme pasi rezulton se ajo që është paraqitur si fakt empirik nuk është asgjë tjetër, por një aktivizëm i fortë kulturor (Doja 2010). Kështu, adoptimi i një qasje kritike do t'u mundësonte shkencave sociale sot jo vetëm shpjegimin, por edhe parashikimin e produktit social të tranzicionit ndërkohë që do t'i kishte shërbyer edhe politikbërjes për të evituar debatet stigmatizuese dhe përjashtuese.

Tranzicioni si fenomen është kompleks dhe i ndërthurur me shumë procese të tjera sociale dhe si i tillë nuk mund të shpjegohet vetëm mbështetur në një vëzhgim të thjeshtë të realitetit. Fenomenologjia e tranzicionit sikundër edhe ajo sociale në përgjithësi nuk janë krejt të rastësishme sikundër dhe nuk qeverisen nga ligjësi objektive në nivelin që kjo është e vërtetë për fenomenet e natyrës (Little 1993). Për të kuptuar sistemet, strukturat dhe proceset në brendësi të realitetit social që formësojnë tranzicionin dhe në të njëjtën kohë kushtëzojnë individin dhe sjelljen e tij, nuk mjafton konsensusi apo gjykimi i përbashkët për çka është “politikisht korrekt”, apo përdorimi i metodave pozitiviste karakteristike për shkencat e natyrës mbështetur thjesht në observime empirike dhe anketime gjerësisht të përdoruar në studimin e fenomenologjisë së tranzicionit. Me interes është identifikimi i mekanizmave socialë shkakësore që më pas do të na shërbenin për të shpjeguar proceset dhe fenomenet sociale të cilat mund të identifikohen nëpërmjet studimeve krahasimore apo dhe përdorimit të teorive të ndryshme sociale.

Përfundime

Shkencat shqiptare nuk kanë kohë për të humbur madje janë tepër të vonuara. Sot shkencat sociale po kalojnë një transformim historik i cili qëndron në njohjen e rëndësisë së historikut të proceseve dhe institucioneve sociale në kuptimin e funksionimit të tyre në të tashmen. Në një nivel më abstrakt, ne mund të përcaktojmë një seri pohimesh ontologjike që kanë lindur si rezultat i këtyre debateve: në lidhje me qenësinë e ligjeve universale midis fenomeneve sociale; për qenësinë e rrugëve të ndryshme dhe alternativave strukturale që qëndrojnë në bazë të transformimeve të rëndësishme historike; ndërgjegjësimi për ekzistencën e heterogjenitetit të thellë të proceseve dhe të influencave në kohë dhe hapësirë; vëmendje në ndikimin e thellë të të papriturave në ndryshimet historike; vëmendje tek fleksibiliteti i organizatave dhe institucioneve sociale; dhe përpjekjeve për të kapërcyer ndarjen midis proceseve sociale në nivelin mikro dhe makro.

Të gjitha këto çështje janë në themel të transformimit rrënjësor të qasjeve empiriciste. Skepticizmi tashmë i pranuar gjerësisht nga komuniteti akademik rreth mungesës së rregullshmërive sociale përbën një sfidë të rëndësishme ndaj qasjeve empiriciste që hasen rëndom në shkencat sociale shqiptare. Theksi që vihet në mekanizmat shkakësorë vë në dukje rëndësinë e qasjeve analitike, reflektive apo kritike në disfavor të atyre empiriciste të mbështetura në observime apo anketime simpliste.

Bibliografia

- AIS 2008, 2009, 2010. *Shqipëria dhe Bashkimi Europian. Perceptime dhe realitete*, Tiranë.
- Abbot, Andrew. 1999. *Department & Discipline: Chicago Sociology at One Hundred*. Chicago, IL: University of Chicago Press.
- Appadurai, Arjun. 1981. "The Past as a Scarce Resource", *Man* 16, 2: 201-219.
- Baruti, Vasfi 2009. « 28 Nëntori, faktet dhe dokumentet e çlirimit », *Gazeta Metropol*, 1 dhjetor.
- Biçoku, Kasem. 2001. *28 Nëntor 1944 dita e çlirimit të Shqipërisë*, Tiranë, Rilindja Demokratike.
- Cox, Robert. 1981. "Social Forces, States and the World Order: Beyond International Relations Theory", *Millennium: Journal of International Studies* 10, 2: 126-155.
- Cox, Robert. 1987. *Production, Power and World Order: Social Forces in the Making of History*. New York: Columbia University Press.
- Doja, Albert. 1998. "Évolution et folklorisation des traditions culturelles", *East European Quarterly* 32, 1: 95-126.
- Doja, Albert. 2010. "Fertility Trends, Marriage Patterns and Savant Typologies in Albanian Context", *Journal of Family History* 35, 4: 346-367.
- Egro, Dritan. 2007. *Historia dhe ideologjia. Një qasje kritike studimeve osmane në historiografinë moderne shqiptare*. Tiranë: Maluka.
- Foucault, Michel. 1970. *The Order of Things. An Archaeology of the Human Sciences*. London: Tavistock Publications.
- Foucault, Michel. 1986. "The Use of Pleasure" in *The History of Sexuality*, Volume 2. London: Viking.
- Frashëri, Kristo. 2009. "Ju rrëfej 29 nëntorin 1944", *Gazeta Shqip*, 28-29 nëntor
- Geertz, Clifford. [1964] 1973. "Ideology as a Cultural System", ff. 47-76 në David Apter (ed.), *Ideology and Discontent*. New York: Free Press.
- Geuss, Raymond. 1981. *The Idea of a Critical Theory: Habermas and the Frankfurt School*. Cambridge University Press.
- George, Alexander L., & Andrew Bennett. 2005. *Case Studies and Theory Development in the Social Sciences, BCSLA Studies in International Security*. Cambridge, MA: MIT Press.
- Gjeçovi, Xhelal. 2004. *Pushtimi Gjerman në Shqipëri, 8 shtator 1943-29 nëntor 1944*, Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë.
- Kaloçi, Dashnor. 2003. "Ja studimet e Enverit dhe Mithat Frashërit për Haxhi Qamilin", *Gazeta Shqiptare* 22 Prill.
- Kanëff, Deema. 2004. *Who Owns the Past? : The Politics of Time in a 'Model' Bulgarian Village*. New York: Berghahn Books.
- "Kaskada e opinioneve." 2006. *Tirana Observer*, 26 prill.
- Kuper, Adam. 1996. *Anthropology and Anthropologists: The Modern British School*. Third revised and enlarged edition. London: Routledge.
- Habermas, Jürgen. 1984. *The Theory of Communicative Action. Translated by Thomas McCarthy*. Cambridge: Polity Press.
- Habermas, Jürgen. 1987. *Knowledge and Human Interest*. Cambridge: Polity Press.

- Held, David. 1980. *Introduction to Critical Theory: From Horkheimer to Habermas*. Berkeley, CA: University of California Press.
- Hoti, Izber. 2003. *Në udhëkryqet e historisë dhe të historiografisë shqiptare*. Prishtinë: Instituti i Historisë.
- Lleshi, Preng C. 2009. "S'është mitik, por historik", gazeta *Shekulli*, 15 mars.
- Liebersohn, Stanley. 1987. *Making It Count: The Improvement of Social Research and Theory*. Berkeley, CA: University of California Press.
- Little, Daniel. 1998. *Microfoundations, Method and Causation: On the Philosophy of the Social Sciences*. New Brunswick, NJ: Transaction Publishers.
- Meta, Beqir, Dezhgiu, Muharrem dhe Lleshi, Xhevahir. 2010. *Historisë së Shqipërisë, Klasa 12*, Tirane.
- Ndreca, Adrian. 2008. *Kur "Skënderbeu" nuk asht Historia e Skënderbeut*. Tiranë: Onufri.
- Puto, Artan. 2009. "Nga Skënderbeu mitik në atë historik", gazeta *Shekulli*, 18 janar.
- Smith, Steve. 1996. "Positivism and Beyond", në Steve Smith, Keen Both & Marysia Zalewski (eds.), *International Theory: Positivism and Beyond*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Tarifa, Fatos. 1996. "Neither 'bourgeois' nor 'communist' science: Sociology in Communist and Post-Communist Albania", *Communist and Post-Communist Studies* 29, 1: 103-113.
- Tirana Observer. 2006. "Kaskada e opinionëve", 26 prill.
- Wallerstein, Emmanuel. 1974. *The Modern World-System, Vol. I: Capitalist Agriculture and the Origins of the European World-Economy in the Sixteenth Century*. New York: Academic Press.
- Wallerstein, Emmanuel. 1980. *The Modern World-System, vol. II: Mercantilism and the Consolidation of the European World-Economy, 1600-1750*. New York: Academic Press.
- Wallerstein, Emmanuel. 1989. *The Modern World-System, vol. III: The Second Great Expansion of the Capitalist World-Economy, 1730-1840's*. San Diego: Academic Press.

*Për një antropologji të modernitetit shqiptar***

____ Nebi Bardhoshi* _____

Abstrakt

Ky punim ka për qëllim dhënien e një kontributi për hapjen e debatit rreth nevojës për një antropologji social-kulturore të modernitetit shqiptar. Për të ilustruar pikëpamjen e parashtruar në këtë punim është marrë në shqyrtim miti ose mitet e origjinës, rëndësia sociale e tyre dhe lidhja me morfologjinë sociale në kontekstin e shtetit-komb. Pikëpamja e mbrojtur është se studimet antropologjike shqiptare duhet që, përpos vëmendjes që i kanë kushtuar së kaluarës dhe punës kërkimore mbi origjinalen kombëtare ose tradicionale, ta zbrvendosin vëmendjen mbi pasojat që ka lënë moderniteti shqiptar, ose thënë ndryshe, efektet e krijimit të shtetit-komb dhe të politikave të tij (si në rastin e zbatimit ose moszbatimit të tyre) mbi strukturat dhe institucionet tradicionale sociale dhe kulturore. Kjo do të mundësonte dhe daljen prej kurthit të ndërtuar nga vetë etnografia shqiptare, sipas së cilës etnografia merret me studimin e kulturës tradicionale, traditës, ose së kaluarës. Prej këtej e ka burimin prania

* Dr. Nebi Bardhoshi është studiues dhe lektor në lëmin e antropologjisë socio-kulturore dhe antropologjisë së ligjit pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore, si dhe lektor pranë Fakultetit të Drejtësisë, në Universitetin Europian të Tiranës, në lëmin e antropologjië juridike. Fushat kryesore të interesit të tij shkencor janë ato të lidhura më ligjin, të drejtën zakonore, qytetarinë, pasojat e modernitetit etj. Ai gjithashtu ka shfaqur interes lidhur me debatet teorike mbi antropologjinë socio-kulturore dhe antropologjinë juridike. Lidhur më këtë, në bashkëpunim me kolegë të tjerë, ka konceptuar seminarin permanent “Tabutë e shqiptarëve dhe tabutë e etnografisë shqiptare”, pranë Institutit të Antropologjisë Kulturore, Tiranë. Së fundmi, po punon për publikimin e dy librave, i pari është titulluar “Gurtë e Kufinit: kanuni, pronësia dhe strukturimi social”, që do të botohet nga UET-Press, ndërsa i dyti është “Antropologji e kanunit”

** Një version i këtij shkrimi është prezantuar në Konferencën Shkencore, *Etnokultura dhe Bashkohësia*, mbajtur me dt 2. 06. 2010, në Muzeun Kombëtar, Tiranë, konferencë e organizuar nga Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë.

e një ankthi të shprehur nga studiues të etnografisë dhe folklorit shqiptar rreth zhdukjes së kësaj kulture tradicionale, bashkë me vdekjen e të moshuarve, që janë parë si bartësit e tradicionales dhe unikaes.

Mes antropologjisë social-kulturore dhe etnografisë

Ajo që kryesisht në vendet tashmë në perëndim dhe më gjerë njihet me emrin antropologji socio-kulturore në Shqipëri njihet më tepër me emrin *etnografi* ose *etnologji*. Për emërtimin e kësaj disipline ka pasur dhe ka diskutime. Në këtë punim është përdorur termi antropologji social-kulturore si një emërtim që ka marrë legjitimitetin e tij në bashkësinë e studiuesive. Por dhe kjo sërish nuk është e mbyllur sidomos kur bëhet fjalë për vendet e Lindjes. Por as në Perëndim situata nuk është krejt e qartë. Për shembull, studiues të njohur si Clifford Geertz, Evans-Prichard, Isaac Schapera si një reagim ndaj përcaktimeve në modë si antropologë social preferojnë ta quajnë vetën 'etnograf' duke dashur të theksojnë faktin se kontributi kryesor i kësaj fushe të dijeve humane është puna në terren dhe interpretimi i kulturës (Kuper:1992, f3-4, Kuper:2005, f 62). Ndërsa ideja e promovuar nga Claude-Levi-Strauss, se ka një hierarki që përshkallëzohet në këtë mënyrë, etnografi, etnologji, antropologji duket se nuk ka zënë shumë vend në historinë e antropologjisë socio-kulturore.. Kjo ka ardhur për shumë arsye që nuk mund t'i trajtojmë këtu. Por ajo që ka më shumë rëndësi dhe duhet shtruar për diskutim, është në njërin anë imazhi që ka shoqëria shqiptare për këtë shkencë dhe, së dyti, vetë bashkësia e studiuesve. Duket se të dy pikëvështrimet konvergojnë në pikën që etnografia, përkatësisht antropologjia socio-kulturore, merret me studimin e kulturës tradicionale ose primitive dhe, si rrjedhim edhe etnografia shqiptare duhet që të merret me studimin e kulturën tradicionale e primitive shqiptare. Imazhi i krijuar se antropologjia socio-kulturore është shkencë që merret me studimin e primitives apo ekzotikes gjendet edhe në truallin e lindjes dhe të zhvillimit të saj, në Perëndim (Kottak, 2002, f. 4). Kjo ka ardhur për faktin se shumica e studimeve në lëmin e antropologjisë amerikane, angleze, franceze, hollandeze etj. kanë pasur si objekt parësor studimi një kulturë të huaj për studiuesin dhe, në pjesën më të madhe një kulturë joperëndimore. Kështu, Ogys Konti, do ta vendoste antropologjinë përkundrejt sociologjisë, ku të parën e shikon si shkencën që të merret me tradicionalen, ndërsa të dytën e sheh të lidhur me botën industriale (Eriksen 2001, f. 17). Ndërkaq, Franz Boas e ka ngritur këtë çështje në leksionin përurues në Columbia University në vitin 1908 dhe ai shprehej pro studimit të kulturës pa ndonjë kufi gjeografik, kohor, apo dhe përcaktime të tjera të ndërvarura prej faktit se cili është raporti në mes studiuesit dhe të studiuarit, të zhvillimit të shoqërisë apo dhe kriteret e tjera të kësaj natyre (Matti, 2004). Sipas Boas, antropologu nuk e studion një kulturë të caktuar se është ajo diku larg, por thjeshtë se ajo ekziston. Ndërsa fakti, se antropologjia social-kulturore në kohën e tij ishte fokusuar te *shoqëritë e thjeshta*, vinte ngase studimin e shoqërive komplekse e kishin zaptuar lëmenj të tjerë të dijeve njerëzore.

Në ditët tona kryhen kërkime shkencore, të cilat krahas studimeve të kulturës tradicionale kanë në mënyrë të barasvlershme dukuritë bashkëkohëse objekt të analizës; bile nganjëherë i japin përparësi kësaj të fundit me shume se te parave. Ndër më të spikaturat shfaqen studimet mbi etnicitetin, kombin, shtetin, socializmin dhe post-socializmin. Megjithatë, debati lidhur me objektin specifik të antropologjisë socio-kulturore nuk është i mbyllur. Pra, në të vërtetë projekti antropologjik që në krye të herës ka qenë disaplansh dhe vetë dinamikat lokale për shumë arsye kanë sjellur një larmi variantesh të mënyrës të të bërit të studimeve antropologjike. Dihet se në pak më shumë se një shekull e gjysmë traditë të kësaj shkence lindën shumë shkolla në lëmin e antropologjisë sociale, ku ndër më kryesoret janë ato evolucioniste unilineare, relativizimi kulturor, funksionalizmi dhe struktural-funksionalizmi, difuzionizmi, marksizmi dhe neomarksizmi, strukturalizmi e post-strukturalizmi, interpretivizmi etj (shih Barnard, 2000). Krahas këtyre traditave të mëdha të studimit antropologjik, një variant i antropologjisë, i njohur me emra të ndryshëm si antropologji sociale, etnologji, etnografi, folklor apo studime folklorike vijoi traditën e studimit të kulturës së fshatit dhe të jetës urbane evropiane. Edhe këtu ndikimet e shkollave që u përmendën janë nga më të ndryshmet, porse bie në sy se për periudhën e parë të shekullit XX një dominim i frymës herderiane, e cila kërkon të gjejë në kulturën e fshatit dhe të malësive shpirtin e kombit (*wolgeist*). Më vonë kjo formë e të bërit etnografi do të martohej me shkolla të tjera si ajo hegeliane apo marksiste, duke krijuar tradita të ndryshme kombëtare.

Etnografia shqiptare dhe sfidat e saj

Etnografia shqiptare, e pozicionuar si një disiplinë e dijeve albanologjike është përqendruar te studimi i kulturës shqiptare me fokusin kryesor studimin e kulturës tradicionale dhe gjetjen e kulturës origjinale shqiptare. Kësisoj, edhe me ndërthurjen e teorisë herderiane me atë marksiste apo marksiste-leniniste etnografia shqiptare ka krijuar një profil të vetin, që mund të quhej një 'etnografi apo antropologji albanologjike'. Pra një version i antropologjisë *at home*, i cili ka qenë shpeshherë tejet e ideologjizuar. Ky ideologjizim ka dëmtuar mbi të gjitha mundësinë e mendimit kritik. Për rrjedhojë, studimet më të shumta janë përqendruar në periudhën në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, pa mohuar dhe disa përpjekje për të studiuar socializmin dhe post-socializmin. Herë pas here thuhet se kjo mënyrë e të studiuarit është edhe në vendet e Europës Lindore apo në vendet fqinjë. Për ta kundërshtuar këtë ide mjafton të shikohen botimet në revistën *Etnologica Balcanica* apo edicione dhe revista të tjera dhe duket qartë se kjo tezë nuk qëndron më (shih psh. Hann, 2007., Mihăilescu, et. al. 2008, f. 1-17).

Cilat janë shqetësimet kryesore që dalin përpara kësaj fushe dije? Për shkak të krijimit të imazhit që etnografia merret me doket e zakonet dhe traditën, ka një përballje në opinionin publik, ose, së paku, nëpër ato mikrohapësira publike ku etnografët/antropologët shqiptar përballen shpesh. Reagimet mund të grupohen në mënyrë disi arbitrare në dy grupe. Së pari, një grup i njerëzve të cilët mendojnë

se studiuesit e kësaj fushe janë në të njëjtën kohë dhe promovuesit dhe mbrojtësit e kultures që studiojnë. Dhe për këtë arsye një pjese të njerëzve u pëlqen, ndaj dhe e përkrahin punën e etnografëve. Se dyti, në krahun tjetër përballë të parëve, qëndron një grup skeptikësh apo dhe kritikësh të cilët, duke nënkuptuar dukurinë e sipërpërmendur dhe duke qenë nën influencën e prires bashkëkohase të ‘arratisjes prej së kaluarës’, apo duke mbajtur nganjëherë dhe qëndrime të ashtuquajtura “emancipuese” ndaj shoqërisë, kritikojnë herë haptazi dhe më shpesh jo-publikisht kontributin që jep apo mund të jap etnografia në njohjen e kulturës shqiptare. Në secilin rast, fakti që bëhet antropologji apo etnografi *at home* e bën të vështirë të kërkohet një qëndrim i shkëputur i studiuesit prej fenomenit që ai ose ajo studion. Ndërkohë çështja duhet të ishte shtruar ndryshe. Së pari vet studiuesve do t’iu kërkohet që të rishohin paradigmen e kërkimit në këtë fushë. Për rrjedhojë ky proces parashikohet të kryhet në disa dimensione, duke pasur parasysh metoda të vetë punës në terren, si dhe përpunimn e teorisë së çfarë do të konsiderohet ‘fakt etnografik’. Ankthi i shprehur shpeshherë se me vdekjen e një burri plak vdes një arkiv, sa qëndron aq dhe nuk qëndron. Sigurisht që për disa dije kjo ndodh, por kjo nuk do të thotë se është dëmtuar puna e studiuesit të kulturës, dhe po ashtu specifikisht punat e etnografit. Dikush mund të thotë se është dëmtuara studimi i kulturës tradicionale, pyetja e radhës është e cilës tradicionale? A nuk krijohet prapë tradicionalja? Fare mirë kontributi i etnografit mund jetë për të konstatuar shkaqet transformimit apo të zhdukjes së një dukurie kulturore dhe kësaj të hiqet dorë prej një përfaqje esencialiste të kulturës, sidomos të mënyrës se si është parë kultura tradicionale. Thënë ndryshe, etnografi apo antropologu nuk do të duhej të merrej me studimin e kulturës për faktin se ajo është tradicionale ose jo, por thjesht se ajo egziston.

Kësaj, pa kaluar në paternalizëm, kërkohet që përtej paradigmes tradicionale të etnografisë shqiptare, të shikohet mundësia që vëmendja e studiuesve të përqendrohet në studimin e efekteve të modernitetit shqiptar mbi kulturën shqiptare. Sapo parashtron një kërkesë të tillë, pyetja e parë që të vjen ndërmend është se çfarë kuptohet me ‘modernitet shqiptar’? Dhe, së dyti, a duhet hequr dorë nga studimi i kulturës tradicionale? Në këtë punim, me ‘moderne’ nënkuptohen të gjitha dukuritë kulturore që kanë ardhur si rezultat i “ofertave” apo projekteve të prejardhura në rrugë shtetërore të cilat kanë patur si qëllim të krijojnë apo të transformojnë kulturën shqiptare në tërësi, një dukuri të caktuar apo një sërë dukurish të cilat ishin klasifikuar si të papranueshme apo të papërshtatshme me projektin e modernizimit të shoqërisë shqiptare. Pa harruar se vetë shteti-komb është produkt i logjikës së modernitetit, do të donim të tërhiqim vëmendjen në tri projektet më të mëdha të modernizimit të ndërmarra nga vetë shteti shqiptar: (1) politikat për oksidentalizim, (afërsisht 1920-1939) (2) politikat për “emancipim” me qëllim krijimin e ‘Njeriut të Ri Socialist’ (1944-1992): (3) politika për europianizim (1992 dhe në vijim) . Studimi i pasojave social-kulturore mund të shkojë në disa nivele. Kësodorire mund të merret trajtimi i çështjes si është propaganduar apo paraqitur në mënyrë zyrtare dhe si është zbatuar në praktikë. Si është përhapur kjo dije në disa nivele sociale. Si vijon në ditët e sotme idetë e modernizimit të parashtruara në periudhat e mëparshme etj. Sqarojmë se me

“moderne” nuk nënkupton të *duburën*, përkundrajt *tradicionales*. Me të drejtë dikush mund të thotë se edhe idetë rilindase kombëtare ishin moderne dhe i paraprinë gjithë zbatimit të këtyre politikave që u përmendën më lart. Sigurisht që kjo nuk do të ndalonte që studimi të kryhet edhe për këtë periudhë kohore dhe për të parë se si shumë mite, rrefenja, këngë, idenditete, etj etj, janë krijuar gjatë kësaj kohe dhe më pas. Gjithashtu, ndoshta gabohet kur mendohet se ato kanë qenë të ruajtuara në kujtesën popullore. Por kërkesa që parashtrohet në këtë rast është për të parë *shtetin* si hapësirë dhe agjenci sociale e cila merr përsipër dhe përdor çdo teknikë të mundshme të pushtetit për të *ndryshuar kulturën dhe habitusin individual* (Pickel, 2004). Është pikërisht etnografia në kuptimn e punës në terren, ajo e cila do të ndihmojë për të parë se si kanë operuar këto politika në terren dhe përse kanë pasur ose nuk kanë pasur sukses.

E kaluara, miti ose mitet e origjinës dhe rëndësia sociale

Sa herë që shoqëritë tona të trishtuara, në krizë të përhershme rritjeje, zënë e dyshojnë ndaj vetvetes, ato kërkojnë nëse kanë patur të drejtë të pyesin të kaluarën e tyre ose në e kanë pyetur mirë atë” (Bloch, 1997, f. 13).

“Çfarë kuptimi do të kishin për ne vetë emrat që përdorim për të karakterizuar gjendjet shpirtërore të zhdukura, format shoqërore të fikura, sikur më parë të mos kishim parë njerëzit që jetonin?” (Bloch, 1997, f. 53).

Etnografia shqiptare, e parë shpeshherë si një shkencë ndihmëse e historisë, ka studiuar kulturën tradicionale me qëllim zbulimin e “origjinale kombëtare”. Sipas Zojzit etnografia merret me “studimin e veçorive kulturore të popujve, me specifikën etnike dhe kombëtare, me procesin historik të zhvillimit dhe të perspektivës së tyre” (Zojzi, 1962, f. 3). Edhe në përcaktimet e bëra më vonë nga etnografët shqiptarë nuk është hequr dorë nga ideja që fokusi kryesor i etnografisë është studimi i kulturës tradicionale. Për rrjedhojë të zbatimit të kësaj përqsajeje, u krijua një trajtë e etnografisë albanologjike, e cila kërkonte të dallohej qartazi për nga objekti prej fushave të tjera, sidomos prej studimeve sociologjike. Kjo ndarje kaq hermetike përjashtonte mundësinë që etnografia të merrej së pari me të tashmen e studiuesit. Sigurisht mund dhe duhet të ketë dhe arsye të tjera se përse mungon e ‘tashmja’ si objekt studimi, porse pasojat do të ishin jo të pakta si në metodë ashtu dhe në rezultatet e analizës etnografike. E sotmja përdorej nga studiuesit dhe etnografët vetëm si një shkallë sa për të zbritur dhe depërtuar thellë në kohë, dhe jo si një objekt i mirëfilltë studimi. Për ta ilustruar këtë po citojmë sërish Rrok Zojzin, “etnografia asht një *shkencë induktive*: ajo nëpër një vështrim retrospektiv kalon nga e afërmja tek e largëta, nga e sotshmja tek e lashta edhe ndërton së prapthi *procesin historik* të zhvillimit të popujve” (Zojzi, 1962, f. 3). Mund të argumentohet se një përqsaje e tillë ka ngushtuar pa të drejtë objektin e kërkimit të etnografisë. Gjithsesi, vënia e theksit te bashkëkohorja dhe sidomos tek efektet e prodhuara në shoqëri nga krijimi i shtetit-komb, ku nënvizohet shqyrtimi etnografik i efekteve të politikave modernizuese mbi

realitetet social-kulturore tradicionale, nuk do të thotë se objekti i antropologjisë shqiptare përqendrohet vetëm në këtë periudhë. Përkundrazi, ajo na hap perspektiva të reja studimore, të cilat sinkronizohen me të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen e një komuniteti, kulture a shoqërie. Fjala vjen po të marrim si shembull të tashmen tonë, pra periudhën post-socialiste (Burauey dhe Verdery, 1999, f. 1-16). Në vetvete kjo periudhë na shfaqet si njëfarë trualli i begatë për legjitimimin e traditave lokale, të ringjalljes ose më saktë, të njëfarë zgjatimi të tradicionales/ve drejt publikes. Ky është njëri prej shkaqeve kryesore për legjitimimin e mëtejshëm apo “rikthimin” e besimeve tradicionale (shih psh. Bardhoshi, 2007, f. 19-29). Shpeshherë kjo pasiguri shfaqet në pranimin e ideve të reja religjioze e kulturore nga jashtë, përfshi këtu dhe ideologji politike dhe sisteme ligjore. Periudha post-socialiste, edhe pse do të dominohej prej ideologjisë neoliberalë, sërish është e karakterizuar nga pluraliteti. Kjo vjen për arsye të ndryshme. Nëse do të bënim një klasifikim, mund të flitet për dy lloj pluralitetesh: 1) Njëri është i organizuar ose i inkurajuar nga sistemi neoliberal dhe kjo vjen nga lart-poshtë. Më saktë elita e transplanton sistemin nga jashtë në kuadrin e riformatimit të shoqërisë duke përkrahur dhe mbështetur paradigmen e tregut të lirë dhe pluralizmit politik. Elita e zbaton këtë botëkuptim si të ligjshëm dhe kërkon që gjithashtu të zbatohet në gjithë shoqërinë. 2) Lloj tjetër i pluralizimit është ai që vjen vetiu, që pjesërisht është rezultat i lejimit të *pluralitetit formal*. Ky do të quhej *pluralitet spontan*. Këto dhe faktorë të tjerë do të përbëjnë të sotmen e studiuësitet të cilat do të ishte mirë të merreshin në konsideratë dhe të mos përjashtoheshin nga analiza etnografike me idenë se ato nuk janë origjinale, tradicionale apo për shkak përcaktimesh të tjera. Për ta konkretizuar më në detaje propozimin për një antropologji të modernitetit shqiptar, do të merret në analizë miti i origjinës dhe rëndësia sociale që ai mbart. Është zgjedhur miti i origjinës dhe lidhjet e tij me ligjin, strukturën sociale dhe legjitimitetin për disa arsye. Së pari, se është një temë me sensibilitet të lartë. Së dyti, për të përballur modernitetin me mitin, ku shpeshherë është besuar se moderniteti shpreh të kundërtën e mendimit mitik. Së treti se kjo temë ndërthen disa lëme të dijes antropologjike social-kulturore.

Pluralitet mitesh, pluralitet ligjor, pluralitet social, ose anasjelltas

Siç thekson dhe Noel Malcom, jo vetëm për këtë rast, por dhe për mitin e origjinës fisnore, kur përdoret termi *mit* nuk synohet të thuhet se këto janë besime të pavërteta, por struktura e tyre flet për një strukturë mitike, bazuar më tepër në besime se sa në fakte që vërtetojnë një gjë të tillë (Malcom, 1995, f. 70).

Në kuadrin e shtetit komb, mitet e origjinës rrëfohen duke u bërë pjesë e kurrikulave në arsimin e detyrueshëm. Sipas strategjisë së arsimit shtetëror në bazë të të cilit më shumë rëndësi ka *mësuesi* sesa *plaku*, ose e shprehur ndryshe, *mësuesi* konkurren *plakun*, të gjithë anëtarët e shoqërisë duhet të mësojnë këto mite të origjinës së përkatësisë siç janë parashikuar nëpër programet përkatëse. *Mësuesi* në shoqërinë moderne merr disatribute prindërore aq sa thuhet se mësuesi është prind i dytë. Në kurrikulat tona bëhet një luftë e ashpër, shpeshherë e ‘pashpirt’, mes

miteve jetëdhënëse apo themeluese të vendeve fqinje me mitet nacionale vendase. Të “vdekurit e ringjallur” legjitimojnë ose delegjitimojnë të jetuarit bashkë. Në jo pak raste edhe mitet e origjinës kombëtare kacafyten me njëri-tjetrin. Nganjëherë ndodh që “tërësia e miteve është më e kufizuar se sa kompleksiteti i shoqërisë edhe kur një mit i përshatet botëkuptimeve të një komuniteti për të përjashtuar të tjerët” (Schopflin, 1999, f. 12). Në historinë e Shqipërisë tashmë shumë prej tyre janë bërë pjesë e kulturës sonë, janë shndërruar në terma të thjeshta dhe pjesë e bisedave të përditshme – *thënë thjesht janë shqiptarizuar dhe kanë shqiptarizuar*. Këto mite në nivel kombëtar, si fjala vjen ajo e prejardhjes prej pellazgëve, është një prej temave më të debatuar, sidomos në zonat kufitare në post-socializmin shqiptar (De Rapper, 2009). Kjo temë është shumë e pranishme edhe në diskursin publik. Emisione televizive pa fund janë bërë duke e përthyer në pyetje më bashkëkohore shqetësimin mbi origjinën e shqiptarëve: A jemi europianë? Po kosovarët a janë komb tjetër apo i njëjti komb? Tema mbi Skendërbeun; Skendërbeu mes mitit dhe realitetit... deri te Skënderbeu shqiptar apo jo? Mbi origjinën e Nënë Terezës... Debatimi vijon deri tek origjinaliteti i muzikës, i veshjeve, ushqimit, banesës etj. Ndërkohë, në anën tjetër, përsa u takon botimeve, mjafton të vëzhgohen stendat e librave dhe menjëherë bie në sy se një pjesë e mirë e atyre që ekspozohen janë ata mbi lashtësinë e prejardhjes, pellazge apo ilire. Shpërhapja e këtij debati ka marrë përmasa të gjera në shoqërinë shqiptare, por edhe me domethënie e funksione të ndryshme. Një ditë, duke pyetur një burrë nga zona Verilindore, biseda kaloi nga origjina familjare tek ajo kombëtare dhe me humor ai u përgjigj: “Ne vërtet e kemi prejardhjen prej pellazgëve, sepse jemi të prapambetur dhe ne na duhet shumë kohë për t’u bërë ilirë e lëre më të bëhemi shqiptarë!!”.

Krahas këtyre miteve, që duket se në të shumtën e rasteve ose janë *importuar*, ose janë ‘ringjallur’ apo krijuar krejt prej shkruarit për qëllime politike, ka dhe mite që janë krijuar dhe burojnë nga nivele të ndryshme të shoqërisë kombëtare. Ka shumë njësi sociale, në rastin konkret nënkombëtare, të cilat kanë mitet e tyre të origjinës. Këto janë origjinat e miteve të fiseve, farefisnive, vëllazërive, barqeve dhe familjeve. Kapaciteti autonom apo gjysmë autonom i këtyre njësive sociale varet prej dinamikës së pushteteve nga niveli transnacional deri tek ai lokal. Ka një mori botimesh që kanë për objekt studimi krahina, fshatra apo familje të caktuara (Moore, 1978, f. 270). Të gjitha këto kanë lidhje të drejtpërdrejta me temën e identitetit, por, në të njëjtën kohë, ato na japin të dhëna të shumta edhe për temën e modernitetit, ligjit kanunor, imazhit të shtetit etj. Këto botime kanë shtuar larminë e të dhënave mbi temat e lartpërmendura, por, në anën tjetër, paraqesin domosdoshmërinë e rishikimit të metodës së kërkimit në etnografi dhe vetë të kuptuarit e “faktit etnografik”.

Njëri prej varianteve të krijimit të shoqërisë njerëzore mbledhur gjatë punës në terren, rrëfen se Zoti krijoi një familje, e cila kishte në përbërje të saj babë e nënë dhe fëmijë. Familja kishte gjithsej 12 fëmijë (në disa variante numri i fëmijëve del 24) ku 6 ishin djem dhe 6 ishin vajza. Radha e lindjes së fëmijëve ishte një djalë e një vajzë. Kur u rritën fëmijët, doli që ata deshën që të martoheshin me njëri-tjetrin, por ata donin të martoheshin sipas rendit që kishin lindur. Mirëpo baba dhe nëna ishin të shqetësuar sepse ata ishin vëllezër dhe motra dhe martesat mes tyre do të sillte

fëmijë me të meta mendore, ngaqë ata kishin lidhje gjaku të afërt me njëri-tjetrin. Prandaj ata iu drejtuan Zotit dhe ai bëri mrekullinë duke krijuar gjuhët. Kështu çiftet do të krijoheshin sipas gjuhëve. Pra djali më i madh nuk do të martohet me vajzën më të madhe, por me vajzën më të cilën ai bashkëndante të njëjtën gjuhë. Në këtë mënyrë lindën gjuhët. Në variantin me 12 fëmijë lindin 6 gjuhë, në variantin me 24 fëmijë lindin 12 gjuhë. Prej kësaj legjende të krijimit, krahas pikëpamjes së krijimit të botës njerëzore, gjendet edhe shpjegimi për lindjen e ekzogamisë, kultit të gjakut të përbashkët dhe simbolikën e largësisë në lidhjen e gjakut, lindjen e gjuhëve etj. Në analizën e këtij miti të origjinës vihet re se logjika fisnore kërkon, sikurse dhe dijetarët universalistë kërkojnë, dhënien e një përgjigji lidhur me mënyrën se si është krijuar bota dhe prej këtej të shpjegohet konteksti lokal dhe mënyra e të jetuarit në të.

Në studimet antropologjike mbi shoqërinë shqiptare është vënë re se nuk ka bashkësi sociale pa mitin e origjinës apo një legjendë mbi krijimin e saj (shih psh. Nopça, 1913). Madje ky mit, parë si një konstruksion kulturor, luan edhe rolin bazë legjitimues për vetë ekzistencën e kësaj bashkësie, për mënyrën se si ajo bashkësi është krijuar, si ka jetuar dhe se si duhet të jetojë në të ardhmen. Ai vlen si një bërthamë e vetëshpjegueshme e ideologjisë kulturore mbi të cilën legjitimohet strukturimi social i saj (Moore, 1978). Përmendim këtu mitin e *bashkësisë së parë* (familje, vëllazëri) në bashkësinë krahinore, miti i *shtëpisë së parë* në bashkësinë fshatare, gjendet miti i *fiseve të para*. Këto mite, në themel të strukturës së tyre kanë lashtësinë e grupit në territorin përkatës; më vonë ato mund të përplotësohen me tiparet e tjera që nevojiten për legjitimitetin moral të çdo veprimtarie sociale, politike, ekonomike dhe juridike. Sipas kësaj logjike, familja në fjalë, krahas lashtësisë në territorin e caktuar, ka nxjerrë burra të cilët janë sjellë si duhet, kanë gjykuar, kanë lënë fjalë të urta, apo kanë ndarë pleqni që do të shërbenin si precedentë për rastet e ardhshme. Forma më ekstreme e mitit të prejardhjes është ajo kur mendohet apo pohohet teza që të *parët e një bashkësie* kanë ardhur që “kur ka bi lisi në këto anë!”. Sipas rrëfimit, *krijuesi* është mashkull, apo meshkuj. Këta janë burra të vërtetë, të zotë, e kështu me radhë. Mbi bazën e këtij miti legjitimohen si raportet sociale mes këtyre bashkësive, ashtu dhe hierarkia ose barazia mes individëve, vëllazërive apo fiseve. Mund të ketë ndodhur që pikërisht raporti social të ketë krijuar mitin dhe më pas mitet të legjitimojnë vijimësinë. Kjo duhet parë rast pas rasti dhe analiza do të bëhet më e plotë, nëse do të mbahej parasysh bërja e analizës së strukturës së mitit si një analizë e strukturës së mendimit “mitik”, por në të njëjtën kohë duke e parë të lidhur ngushtë me mendimin politik dhe atë juridik të komunitetit, të bashkësisë dhe të vetë shoqërisë.

Siç dëshmojnë rastet në fjalë, njëri prej pushteteve më të mëdha që lind dhe legjitimohet prej *mitit të të parit* ka lidhje me autoritetin për të drejtuar, për të dhënë drejtësi dhe, në këtë kuadër, për të krijuar ligje. Pra, dikush ka tagrin që ta bëjë një gjë të tillë sepse kjo ka ndodhur “gjithmonë”, sepse kjo shtëpi e ka bërë një gjë të tillë gjithmonë dhe si e tillë do të vijojë. Rrëzimi i këtij miti do të bëhet vetëm në raste krejt të skajshme dhe në ato raste kur agjensitë sociale janë duke krijuar hapësira për të rinegociuar vlera të caktuara kulturore.. Një rast negociimi i pozitës sociale është kur dikush tjetër e kalon këtë pengesë nëpërmjet një akti sublim, që e kapërcen

atë që familja e mëparshme kishte bërë, duke i hyrë kështu rrugës së krijimit të një familjeje, një tradite të vazhdimësisë dhe një përmbushjeje të mitit të origjinës së lavdishme. Sigurisht ritheksohet se këto mite janë polifunkionale. Ato përvijojnë ligjin për martesat, legjitimojnë shpeshherë dhe sistemin e trashëgimisë, legjitimojnë mënyrën e përcaktimit të anëtarësisë në një bashkësi sociale. Fjala vjen, sipas logjikës fisnore ekzogame, familjet me origjinë të përbashkët nuk mund të martohen. Martesa ndodh mes atyre familjeve për të cilat nuk kujtohet se kanë një lidhje gjaku, pra nuk kanë një origjinë të përbashkët, me pak fjalë nuk kanë një mit që flet për origjinën e tyre të përbashkët. Për më tepër, në këtë realitet socio-kulturor miti i origjinës krijon një lloj tjetër bashkësie - *atë mes të gjallëve, paraardhësve të tyre, dhe atyre që do të vijnë më pas*. Sipas këtij sistemi, e kaluara merr një rëndësi të veçantë duke lidhur komunitetin mes të gjallëve, të vdekurve dhe breznive të ardhshme. Kjo logjikë u jep kuptim tjetër akteve që dikush ndërmerr në këtë jetë duke mos i parë ato si akte që i përkasin vetëm atij ose asaj dhe jo vetëm asaj kohe dhe bashkësisë së të gjallëve në atë moment. Ky është një prej dimensioneve të një pikëpamjeje fisnore ekzogame, logjikë e cila bashkëjeton dhe rivalizon me logjikën individualiste të importuar dhe atë shtetërore në përgjithësi. Për të ilustruar sa u tha më sipër vjen rasti i tri fiseve të njohura Krasniqave, Nikajve dhe Vasojojiqëve, të cilët besojnë se kanë një origjinë të përbashkët fisnore. Këto fise u përkasin tri besimeve të ndryshme: i pari mysliman, i dyti katolik dhe i treti ortodoks. Ata janë të ndarë në dy shtete kombëtare, Shqipëri dhe Mal i Zi dhe nuk pranojnë që të martohen me njëri-tjetrin. Për at Donat Kurtin (O.F.M) përveç Vasojojiqëve, Nikajve dhe Krasniqve duhet që të llogariten si të një origjinë të përbashkët me ta dhe Hoti, Trijeshi dhe Pipri, Markoti. Të gjithë këta mendohen të kenë prejardhjen nga një i parë i përbashkët i quajtur Keq (Kurti, 2010, f. 22). Ligji fisnor dhe, në të njëjtën kohë, miti i prejardhjes së përbashkët në këtë rast dominojnë mbi ligjin shtetëror dhe atë religjioz (Çabej, 2008, f. 653). Kur thuhet religjioz, është fjala për besimet monoteiste, pasi në një kuptim të gjerë, edhe besimi i gjakut të përbashkët formon një formë të religjonit që mund të quhej “religjioni i gjakut”. Shembuj të kësaj natyre ka në nivele të ndryshme sociale dhe në të dy anët e kufirit Kosovë-Shqipëri, janë ndërmarrë kërkime në terren. Familjet që i përkasin të njëjtit trung fisnor apo vëllaznor nuk pranojnë që të martohen me njëri-tjetrin, bazuar te ligji i ekzogamisë fisnore. Pra vihet re lehtë që “njeriu shqiptar” jeton në kuadër të disa miteve dhe gjithashtu sistemeve normative dhe kontrollit.

Shumëllojshmëria e këtyre miteve duhet si rrjedhojë e faktit që shoqëria shqiptare ka kaluar nëpër transformime të mëdha që tashmë i kemi përmendur: tri të tilla vetëm në shekullin e kaluar të cilat nuk mund të kalonin pa lënë gjurmë në ndryshimet kulturore. Funkzioni social i miteve të origjinës është po aq i rëndësishëm në disa plane dhe ndoshta kjo rëndësi sociale shkakton krijimin, ringjalljen apo vijimin e tyre. Prandaj, larushia e miteve të origjinës duhet parë si pjesë e ideologjive, të cilat herë-herë janë përjashtuese (ekskluduese) ndaj njëra-tjetrës e herë-herë pajtohen me njëra-tjetrën, mbivendosen, ose sinkretizohen. Pluraliteti ideologjik vjen si pasojë e transplantimeve ideologjike të bëra nga elita, e vijimësisë së tradicionales dhe

ndërveprimeve sociale. Edhe mitet tradicionale të origjinës mund të jenë ‘huazuar’, por, kur bëhet fjalë për ideologjinë fisnore, duket qartë se është fjala për një ideologji të hershme. Madje kjo logjikë fisnore është përdorur edhe në diskursin nacional dhe universal, duke kërkuar rrënjët e njerëzimit nëpërmjet një logjike fisnore. Këto ideologji, në të shumtën e rasteve, kanë për qëllim të legjitimojnë sistemin politik në fjalë dhe pa frikë mund të konsiderohen si dije politike. Kjo dije merr trajta lokale e deri individuale. Miti i të Drejtave të Njeriut me cilësimin si të Drejta natyrore ka për qëllim legjitimimin e një sistemi politik që i garanton këto të drejta dhe si sistem i duhur shikohet demokracia liberale. *Miti i origjinës* së përbashkët në nivel kombëtar ka për qëllim legjitimimin e shtetit-komb e, bashkë me të, krijimin e një komuniteti imagjinar *vëllezërisht* dhe *motrash* që përbashkohen nga *jus sanguinis*. Në këtë logjikë, mund të thuhet se *Miti i të parëve* të përbashkët të fisit ka për qëllim legjitimimin e sistemit farefisnor i cili krijon një vëllazëri solidare dhe ekzogame, që konkurren me vëllazëritë religjioze dhe kombëtare. Krahas këtyre miteve të origjinës, qëndrojnë dhe ato të promovuarat në religjionet monoteiste të cilat tashmë kanë një traditë të gjatë ndër shqiptarët. Këto mite shprehen më shumë në formën e tyre sinkretike, zakonisht të një ndërthurje mes lokales, të së ardhurës nga jashtë, dhe zanafillores, por që jo gjithmonë sinkretizohen. Mund të ndodhë që ato të jenë në mospajtim me njëri-tjetrin. Siç u tha më sipër, këto mite duhen parë *edhe* si produkte të ideologjisë përkatëse, që përpiqet të legjitojë sistemin social dhe strukturën sociale në fjalë (shih psh. Evans, E. Pritchard, 1940).

Përfundime

Hapja e mundësisë për studimin e modernes, duke mos hequr dorë dhe nga *studimi i së kaluarës*, madje duke parë se si e kaluara përdoret për të legjitimuar ekzistencën e sotshme, siç është konceptuar tradicionalja në një kontekst të promovimit të modernes, do të mundësonte që gradualisht të krijoheshin nëndisiplina të antropologjisë shqiptare si ajo e shtetit, e urbanes, e shtetit-komb etj.; ose thënë në terma më të përgjithshëm, nëndisiplina të një antropologjie mbi veten dhe për veten. Ky projekt do të ndihmonte për të krijuar gradualisht një antropologji të post-socializmit, dhe në këtë kuadër të neo-liberalizimit dhe të demokracisë. Kësisoj do t'i shtohet edhe një element më i rrokshëm e pragmatik mendimit antropologjiko-albanologjik.

Në një pikëpamje më të gjerë, kjo qasje do të mundësonte të shmangej frika e zhdukjes së dukurive kulturore, ku zhdukja e tradicionales do të nënkuptonte zhdukjen e objektit të vetë antropologjisë social-kulturore në mendimin albanologjik shqiptar. Përkundrazi, paradigma e antropologjisë bashkëkohore, e aplikuar sipas kësaj pikëpamjeje, do të krijonte parakushtet për studimin jo vetëm të dukurive që gjallojnë, por edhe të një antropologjie të dukurive kulturore të zhdukura duke venë theksin te proceset social-kulturore.

Bibliografia

- Asad, Talal (1979), *Anthropology and the Analysis of Ideology*, Man, Vol. 14, ff. 607-627.
- Barnard, Alan, (2000), *History and Theory in Anthropology*, Cambridge University Press.
- Bloch, March, (1997) *Apologjia për historinë ose mjeshhtëria e historianit*, përkth. shqip A. Klosi, Tiranë, Shtëpia e Librit&Komunikimit.
- Bunzl, Matti, (2004)., *Boas, "Faucoult, and the 'Native Anthropologist': Notes toëard a Neo-Boasian Anthropology*, American Anthropologist, 106 (3): 435-442.
- Burauey, Michael. Verdery, Katherine, (1999) *Uncertain transition: Ethnographies of Change in the Postsocialist Eëorld*, f. 1-16.
- Çabej, Eqrem (2008) *Fiset, te Studime Shqiptare: Vepra të Zgjedhura*, Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe e Arteve Kosovë, Botime të veçanta XC, Seksioni i Gjuhësisë.
- De-Rapper, Gilles, (2009) *Pelasgic Encounters in Greek-Albanian Borderland: Border dynimcs and Reversion to Ancient in Southern Albania*, in Anthropological Journal of European Cultures, vol. 18, Issue 1.
- Doniger, Unger, (1979), *Introduction*, te Levi Strauss, *Myth and Meaning: Craking the Code of Culture*, Schocken Books, Neu York, ff. vii-xv.
- Durham, Edith, (1991), *Brenga e Ballkanit*, Tiranë, "8 nëntori".
- Eriksen, H. Thomas, Nielsen, S. Finn (2001) *A History of Anthropology*, Pluto Press, London-Sterling, Virginia.
- Evans, E. Pritchard, Evans, (1940) *The Nuer: A Description of the Modes of Livelihood and Political Institutions of a Nilotic People*, Oxford University Press.
- Hann, Chriss (2007) *Anthropology's Multiple Temporalities and its Future in Cental and Eastern Europe*, Halle/ale, ISSN 1615-45
- Kottak, Ph, Conrad, (2002), *Cultural Anthropology*, Mc. Graw-Hill Higher Education, (edicioni IX), f. 4.
- Kuper, Adam, (1992) *Introduction*, në librin *Conceptualizing Society*, Routledge.
- Kuper, Adam, (2005), *Alternative histories of Social Anthropology, Three Lectures on the future of Anthropology in Europe.*, Social Anthropology, 13, 1., (47-64).
- Kurti, Donatt, (2010), *Zakone e doke shqiptare*, Shkodër, Botime Françeskane, Botimi I
- Geertz, Clifford, (1983), *Local Knoëdlege: Futher Eassys to Interpretative Anthropology*: Neë York: Basic Books, INC.
- Malcolm, Noel, (1995) *Myth of Albanian National Identity: Some Key elements, as Expressed in the Uorks of Albanian Writers in America in the Early Twentieth Century*, f. 70-87.
- Mihăilescu, Vintilă, Iliiev, Ilia, Naumovć (2008) *Introduction*, nw edicionin *Studying Peoples in the People's Democracies*, HSAE, 17, Lit Verlag, f. 1-17.
- Moore, F. Sally. (1978) *Laë as process: An Anthropological Approach*, Routledge & Kegan Paul, f. 270. Shiko edhe Schopflin, *Natyra e mitit...*, cit.; Shiko po ashtu dhe ASAD, T (1979), *Anthropology and the Anaysis of Ideology*, Man, Vol. 14, ff. 607-627.
- Nopça, Franz. (1913), *Shqipëria, kultura shqiptare dhe e drejta kanunore*, (1913), Tiranë, AE-IKP, dorëshkrim i përkthyer në shqip.
- Pickel, Andreas (2004) *Homo Nationis: The Psycho-social Infrastructure of the Nation-state Order*, Global Society, Vol. 18, No. 4, October, 2004, Carfax Publishing.
- Zojzi, Rrok, (1962), *Etnografia shqiptare dhe veprimtaria shkencore e zbvilluar në këtë fushë*, Tiranë, Etnografia Shqiptare, Nr. 1.

Ligji dhe shoqëria: Tranzicioni i ligjit shqiptar dhe ligji i tranzicionit

Arbër Gjeta

Abstrakt

Historikisht, Shqipëria ka qenë një vend midis dy ose më shumë kulturash juridike. Një shembull i spikatur mund të jetë veprimi midis dy perandorëve me të mëdha, midis Romës e Kostandinopojës, ku në trojet shqiptare feudalët aplikonin sipas rastit të drejtën justiniane, së cilës i referoheshin për arsye shtetërore, por edhe institute perëndimore siç ishin paktet e vasalitetit. Kjo ka bërë që në trojet shqiptare të ndërthureshin një numër i madh institutesh apo veprimesh juridike. Vendi ynë, për vetë historinë e tij, mund të quhet një vend në një tranzicion të vazhdueshëm. Ky tranzicion ka ndikuar dhe në aplikimin e sistemeve të ndryshme ligjore, jo perhere të përputhshme dhe harmonike. Në këtë artikull merren shembuj të ndryshëm nga fusha si pronësia, sistemi i drejtësisë dhe procesi i privatizimit dhe ligji për shoqëritë tregtare për të ilustruar evolucionin e legjislacionit shqiptar në këto 20 vjet të postkomunizmit.

Hyrje

Është e pamohueshme lidhja e drejtpërdrejtë midis ligjit dhe shoqërisë e cila na shtyn të mendojmë se nuk është retorikë latinizma “ubi societas ibi ius”. Kontributet në fushën e antropologjisë të së drejtës edhe pse në një këndvështrim më të gjerë janë po aq të rëndësishme mbi studimin e binomit ligj-shoqëri por nuk duhet harruar që mbi të gjitha sociologjia e së drejtës tenton të japë një shpjegim mbi ndryshimet shoqërore dhe efencën e legjislatorit për të kapur këto impulse dhe ti shndërrojë në normë. Ne nisemi nga pohimi teorik, lehtësisht

^{**} Ky punim është referuar në Konferencën Kombëtare “Shkencat Sociale dhe Shoqëria Shqiptare në Tranzicion”, organizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Politikave dhe Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin European të Tiranës (UET), më 19 nëntor 2010.

i vërtetueshëm, se ligjvënia ka si synim parësor rregullimin e situatave de facto të krijuara, pra ligji vjen si nevojë e shoqërisë për të rregulluar situata të reja, sidomos gjatë tranzicionit. Kjo vërehet duke u nisur edhe nga trajtimi i kushtetutës si pakt me klasën politike për një përligjje të ndërsjellët drejtësi-politike.

I vërtetë është edhe pohimi i anasjelltë. Jo vetëm ligji ndjek hapat e shoqërisë dhe rregullon sjelljet njerëzore, por ka raste kur ligji i determinon ato në një shoqëri të caktuar (diktaturë). Rasti i Shqipërisë në tranzicion mund të trajtohet si rasti tipik kur një shoqëri e determinohet një normë, në shumë raste e formuluar nga komuniteti ndërkombëtar sipas modeleve më të mira, por që në realitet mund të ketë një aplikim të dobët dhe një perceptim të gabuar. I rëndësishëm në këtë kuadër është shpjegimi i faktit juridik të vendimmarrjes gjyqësore dhe mendimi se në momentin që gjyqtari vendos një çështje ose avokati që këshillon klientin nuk zbaton vetëm ligjin por është duke diktuar një sjellje shoqërore, një model për tu ndjekur.

Të shumta janë reformat në Shqipërinë në tranzicion; këtu ilustron disa probleme juridike që janë hasur në këto vite të ‘tranzicion-evolucionit’. Është e rëndësishme të themi se ligji do të jetë gjithmonë në ndjekje të faktorëve realë, pra shoqërisë dhe ekonomisë që ajo prodhon. Gjithsesi rëndësia e ligjit nuk është dytësore, aq më tepër në shoqëritë në tranzicion ku perceptimi i asaj që është dhe asaj që duhet të jetë nuk është aq i lehtë.

Thellimi i studimit tim në fushën e së drejtës nuk mund të mos vinte re se ligji nuk mund të ndahet nga studimi i fenomeneve shoqërore. Në shkollën europiane të së drejtës ku mësohet *civil law*, pjesë e së cilës është edhe sistemi i drejtësisë shqiptare, një nga parimet e para që serviret në çdo kurs është brokardi latin “*ubi societas, ibi ius*”¹ por bashkë me të edhe koncepti i së drejtës si një sistem kompleks por komplet, e cila nëpërmjet silogjizmit gjyqësor, interpretimit ose teknikave të tjera arrin të gjejë një zgjidhje për çdo problem që parashtrohet (Barbera & Fusaro 2010: 22-23). Një lidhje më të drejtpërdrejtë të ligjit me shoqërinë arrijmë ta perceptojmë në të drejtën anglo-saksone me institute të tilla si *prospective overruling*, *dissenting opinion* ose *binding precedent* që janë parimet në bazë të cilave gjykatësi vepron dhe krijon rregulla për të ardhmen (Galgano, Ferrari & Ajani 2006). Çdo analizë studimore ka për bazë këto dy sisteme që përfshihen në atë që quhet Western Legal Tradition, aq të përziera e me huazime reciproke sa që nuk mund të vërejmë një ndarje të qartë. Sot që flasim unifikimi i së drejtës është synimi kryesor në rang politik e teknik në të gjitha vendet. I jepet përparësi unifikimit por kjo nuk do të thënë se diversiteti është një shfaqje patologjike në sistem² (Sacco 2007: 40-42). Ky unifikim arrihet qoftë në mënyrë konsensuale qoftë i diktuar nga një autoritet. Pra konteksti i studimit tonë është i mbështjellë nga një ndjenjë e përgjithshme unifikimi me qëllim që legjislativi i krijuar të ndjekë më shpejt hapat e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik. Në këtë punim qëllimi jonë nuk është të bëjmë thjesht një *review* mbi problemet dhe teoritë mbi lidhjen midis ligjit dhe shoqërisë, por edhe të gjejmë pika interesi me realitetin dhe

¹ “*Ubi homo, ibi societas. Ubi societas, ibi ius. Ergo ubi homo, ibi ius.*”

² Autori thekson se shek. XIX dhe gjysma e parë e shek. XX ekzaltuan karakterin kombëtar të së drejtës, gjysma e dytë e shek. XX vlerësoi dhe u tregua e ndjeshme kundrejt uniformitetit të rregullës juridike.

tranzicionin e ligjit dhe shoqërisë shqiptare. Problemet që ka pasur implementimi i shtetit të së drejtës në Shqipëri trajtohen këtu në një pikëvështrim më të gjerë sesa ai juridik me shpresën që analizën juridike të problemit ta lë sa më të varfër për të bërë të mundur një përjasje sa më soft kundrejt problemeve ligjore. Në këtë shkrim nuk do të përfshijmë as probleme kyçe të procesit të tranzicionit siç është për shembull problemi social i pajtimit kombëtar³ pas rënies së komunizmit (Sarkin & Daly 2004). Mendojmë se në tranzicionin shqiptar ky problem nuk ka ekzistuar në një formë kaq të mprehtë sa në vende të tjera.

Historikisht, Shqipëria ka qenë një vend midis dy ose më shumë kulturash juridike. Një shembull i spikatur mund të jetë veprimi midis dy perandorive me të mëdha, midis Romës e Kostandinopojës, ku në trojet shqiptare feudalët aplikonin sipas rastit të drejtën justiniane, të cilës i referoheshin për arsye shtetërore, por edhe institute perëndimore siç ishin paktet e vasalitet. Kjo ka bërë që në trojet shqiptare të ndërthureshin një numër i madh institutesh ose veprimesh juridike. Vendi ynë, për vetë historinë e tij, mund të quhet një vend në një tranzicion të vazhdueshëm. Duke u nisur nga kjo premisë pohojmë se realiteti shqiptar ka qenë gjithmonë, të paktën në periudhat më të rëndësishme historike, në tranzicion. Edhe mbas konsolidimit të shtetit kombëtar Shqipëria ka qenë terren i aplikimit të sistemeve të ndryshme ligjore.

Shembujt që marrim për të ilustruar evolucionin e legjislacionit shqiptar në këto 20 vjet janë: problemi i pronësisë, sistemi i drejtësisë dhe procesi i privatizimit dhe ligji për shoqëritë tregtare.

E drejta dhe shoqëria

Në këtë paragraf mundohemi t'i japim një përgjigje pyetjes se çfarë është e drejta, dhe pastaj të kalojmë te mënyra sesi ndikon në shoqëri dhe te roli që luan në shoqërinë e tranzicionit. Sacco, studiues i së drejtës së krahasuar, në veprën e tij *Antropologia giuridica* vendos disa koncepte interesante për sa i përket drejtësisë së parë nga pikëpamja antropologjike. Në radhë të parë ndajmë me autorin mendimin se e drejta, ashtu siç ne e njohim, nuk ka të njëjtën vlerë në të gjitha kulturat. Shariaa islamike ose dharma indiane nuk përputhen tërësisht me të drejtën tonë. Përkufizimi i së drejtës pra është i ndryshëm për antropologët (Sacco 2007: 19-20) pasi, ndryshe nga juristët, që përfshijnë edhe normat që veprojnë në shoqëritë “e pazhvilluara”. Diakronia, sistemi, krahasimi, shtjellimi i mendimit janë pasuri që studiuesi i bën armë të tijat. Studimi diakronik i një sistemi i jep antropologjisë juridike një vlerë të veçantë, por në të njëjtën kohë duhet pasur kujdes nga ai që quhet vizioni evolucionist, sipas të cilit çdo fazë e zhvillimit të së drejtës prodhohet si nevoja që lindin në fazën pararendëse. Pra sipas këtij koncepti evoluimi i së drejtës çon në përfundimin se krahasimi i dy përvojave të ndryshme juridike shpjegohet me zhvillimin e ndryshëm të tyre në shkallën e progresit duke quajtur sistemet extra-

³ Autori thekson idenë se shpesh suksesi i regjimit të ri varet nga trajtimi që i bën së kaluarës: “*How a nation deals with its past also has repercussions for the present*” (Sarkin & Daly 2009: 698)

europiane si forma juridike të prapambetura (Sacco 2007: 40). Por, antropologjia na mëson ne juristëve që dinamikat e një norme procedojnë duke përfshirë edhe elemente jashtë vullnetit të legjislatorit. Kjo na vjen në ndihmë pasi na hap horizonte të reja mbi mënyrën sesi duhet të kuptojmë ligjin. Ligji nuk është vetëm e dhëna normative që na serviret. Ligji duhet parë edhe në kuadër të kontekstit social që rregullon. Autori na bën të ditur se juristi është interpretues dhe si i tillë ai duhet të propozojë aplikime të normës të cilat janë “pjellore për shoqërinë” dhe “të vlefshme në aspektin kulturor”. Mund të themi se legjislatori, gjykatësi ose studiuesi kane pasur si prioritet në punën e tyre rregullimin e veprimtarisë juridike me qëllim që të sjellin rend dhe siguri në shoqëri pasi një nga funksionet e ligjit është të rregullojë sjelljet njerëzore në shoqëri⁴ (Rodotà 2006: 42) dhe për të bërë këtë gëzon monopolin e dhunës ligjore. “E drejta dominon shoqërinë, e liron nga toksinat. Po ky funksion i shpallur i së drejtës nuk mjafton për të zhdukur fytyrën e errët, forcën detyruese e cila për shumë e afron me atë që duhet të neutralizojë, me dhunën”⁵.

Sociologjia e studion ligjin nga një këndvështrim i saj dhe me pretendimin e një shkence complete duke studiuar impaktin që ligji ka në shoqëri ose ndikimin që shoqëria ka mbi ligjin⁶ (Luhmann 1990 [përkth.]: 578-581), në një situatë ku sfidat konsiderohen problemet e unifikimit të së drejtës dhe transplantimi i rregullave. Të shumtë janë studiuesit që merren me impaktin që ligji ka në shoqëri (*law and society*) duke zhvilluar studime të ndërthurura. Mund të jetë i vërtetë fakti që sot, në shumë fakultete të drejtësisë, impakti real i lëndëve mbi sociologjinë e së drejtës është i vogël, por nuk duhet të harrojmë faktin se ekzistojnë shumë qendra studimi ose institute të specializuara. Në fillimet e tyre studimet ishin të pastrukturuara dhe zhvilloheshin në mënyrë individuale. Me krijimin e qendrave studimore në shekullin e 20 lindën edhe problemet me atë që u quajt *policy oriented research*, pra me kërkimin sociologjik të financuar nga agjencitë qeveritare pa kërkuar që të trajtojnë probleme të mprehta sociale (Travers 2010: 9). Në vendet e lindjes kjo rrymë u zhduk fare (Tarifa, Krisafi & Danaj 2009: 94). Dallimi kryesor midis filozofisë të së drejtës dhe sociologjisë të së drejtës qëndron në mënyrën empirike sesi u afrohet problemeve shoqërore. Pra, në qoftë së filozofë si Dworkin, Kelsen ose Hart argumentojnë teorikisht duke kërkuar të ndërtojnë një sistem teorik për të përligjur një kompleks normativ, sociologët studiojnë impaktin që këto interpretime të ligjit kanë mbi shoqërinë. Filozofët studiojnë natyrën e ligjit (Travers 2010: 8) ndërsa sociologjikisht studiohet jo vetëm e drejta si dije, por edhe aspekti më pragmatik i saj, aplikimi në jetën e përditshme.

⁴ Nëse rregullat konsiderohen si “modele të sjelljeve njerëzore” e drejta nuk mund të ngrihet duke u nisur vetëm nga rregulla, por kërkon një analizë sesi modelet aplikohen realisht. Pra, përkrah legjislatorit të padukshëm, ka edhe subjekte të tjera që i japin formë së drejtës dhe e modelojnë atë duke bërë sistemin ligjor një sistem të hapur

⁵ Rodotà, Stefano. 2006. *La vita e le regole. Tra diritto e non diritto*, Milano: Feltrinelli, f. 10; në sens të kundërt dhe për një koncept të *responsive law* (ligj reaktiv) Nonet, Philippe & Selznick, Philip. 1978. *Law and society in transition, Toëard responsive laë*. New York: Oktagon books, f. 117.

⁶ Luhmann për shembull, mendon se drejtësia është një nënsistem i shoqërisë dhe bashkë me mekanizma kontrolli të tjerë të tensioneve sociale përbëjnë sistemin imunitar të shoqërisë nga e cila rrjedh se e drejta është një sistem i hapur dhe gjithnjë i gatshëm kundrejt kërkesave për rregull që vijnë nga shoqëria.

Teoria e Luhmann-it mbi funksionin e së drejtës, përveç aspektit kohor dhe material të një veprimi të caktuar që është e destinuar të ngrihet në rang rregulli, përmban edhe llogaritjen e kostove sociale të rregullave të reja. Pra, një sjellje e pritur mund të ngrihet në rang norme juridike në qoftë se ekziston legjitimitimi i shoqërisë për aplikimin e tyre (Tesini 2009: 23-24). Autori bazon teorinë sociale të tij në faktin se e drejta është një nga mjetet e shumta të komunikimit dhe se ajo është një nënsistem i diferencuar i shoqërisë, por që në mënyrë të pashmangshme lidhet me sistemet e tjera. Shembulli më i rëndësishëm që autori trajton për lidhjen strukturale midis dy sistemeve është kushtetuta, që shërben për të rregulluar raportin midis autonomisë së sistemit juridik dhe sistemit politik dhe kjo lind nga nevoja që kanë këto dy sisteme për të zgjidhur problemet e autoreferencimit dhe të pasigurisë që do të çonin në entropi. I referohemi një burimi të jashtëzakonshëm të së drejtës, shprehje e një vullneti kushtetues popullor nëpërmjet një asambleje e cila përfundon me miratimin e një kushtetute, që përbën formën sipas së cilës sistemi juridik reagon drejt autonomisë së tij. Nga ana e tij edhe sistemi politik ka probleme autoreferencimi dhe përdor idenë e legjitimitetit superior të fuqisë kushtetuese të popullit, që vendos mbi kushtetutën. Ky është një proces reciprok kushtëzimi i dy sistemeve (Tesini 2009: 30-34).

Ne mendojmë se kjo përqsaje drejt kuptimit të drejtësisë është e vlefshme paçka se Luhmann shpeshherë kritikohet duke pohuar se në teorinë e tij të sistemeve ai thotë gjëra të ditura tanimë. por me një gjuhë të komplikuar duke mos sjellë diçka të re. E drejta pra implementohet në shoqëri si një nënsistem i saj dhe luan një rol vendimtar në përligjjen e Shtetit si fuqi rregulluese tanimë që burimi i së drejtës nuk është Zoti, Mbreti ose ndonjë formë tjetër. Tanimë në një plan tjetër studimor është e rëndësishme të shikojmë se cila e drejtë çon në një funksionim të mirë të shoqërisë.

Drejt Shtetit të së Drejtës

Në qoftë se shikojmë një evolucion të drejtësisë në kohën moderne vërejmë se debatet doktrinale kanë sjellë modelimin e ligjit ashtu siç ne e njohim sot. Këto debate jo rrallë kanë përkuar me periudha tranzicioni, revolucioni ose reaksioni. Për të sjellë një shembull mund të përmendim kontrastin teorik midis Thibaut, mbrojtës i pozitivizmit, me Savigny, i cili me shkollën historike të së drejtës i dha një shtysë qasjes doktrinale kundrejt problemeve juridike me idenë se e drejta që duhet të aplikohet është ajo që ndihet si e tillë nga populli (*ius pandectorum*), pra e drejta që jeton në shoqëri dhe që nuk i takon Shtetit ta kodifikojë dhe e quajti *Volksgeist*-Ndërgjegjja e popullit⁷ (Sacco 2007: 29). Kjo doktrinë vinte në plan të parë të drejtën zakonore dhe shikonte te procesi legjislativ një mekanizëm ndihmës. Kjo përplasje doktrinale lindi nga Kodi Napoleonik i 1804, korpus ligjor që shënoi triumfin e pozitivizmit, duke bërë një rregullim të detajuar të çdo veprimi juridik në një numër të pafund nenesh, me pretendimin se ishte hartuar një vepër complete në të

⁷ Përkon me periudhën e Rilindjes duke vënë theksin te koncepti i diversitetit dhe në lidhjen kulturë juridike - kulturë popullore. Autori ilustron lindjen e studimeve sociologjike dhe të metodologjisë kërkimore.

cilën çdo qytetar mund të gjente një zgjidhje të qartë dhe të thjeshtë për çdo konflikt të jetës së përditshme duke kufizuar mundësinë e gjykatësit për interpretim⁸. Ky ishte më shumë një pretendim politik sesa juridik siç e tregoi koha. Kemi parasysh se në këto vite metodat e studimit sociologjik dhe sociologjia si shkencë nuk kishin marrë akoma kanalizimin e duhur dhe gjithçka i referohej pikëpamjes sesi ligji duhet të jetë i parë nga filozofia e së drejtës. Pra këto ishin studime filozofike që interesoheshin sesi norma duhet të jetë pa dhënë një zgjidhje konkrete.

Pa dashur të bëjmë një përmbledhje të historisë së studimeve sociale në fushën e drejtësisë kalojmë në një shembull tjetër: Në vitet '60, krahas ndryshimeve të mëdha gjeopolitike që ndodhën në botë, kemi një moment shumë pjellor për sa i përket afrimit të shkencave sociale me sistemin ligjor dhe ekonomik⁹. Prapë edhe këtu kemi një përputhje me tranzicionin shoqëror dhe ekonomik në nivel global dhe nga nevoja për të shpjeguar fenomenet e reja sociale dhe modelet teorike të ngritura nuk kanë qenë të përputhshme me njëra-tjetrën edhe brenda së njëjtës lëvizje. Në *new law and economics* mund të përmendim dallimin midis shkollës së Chicago-s (*mainstream*) dhe Yale-it në shpjegimin e lidhjes që duhet të ekzistonte midis ligjit dhe ekonomisë dhe të rolit të shtetit në veçanti¹⁰ për rregullimin e falimenteve të tregut (Guglielmetti 2009). Shikojmë se prapë në bazë të këtyre ndarjeve kemi probleme të mprehta si ndërhyrja e shtetit në ekonomi ose besimi total te tregu i lirë që kanë jo pak pasoja për shoqërinë.

Si rregull, ligji është një hap mbrapa zhvillimeve sociale ose ekonomike. Gjithsesi në shoqëri të ndryshme, të cilat janë në stadi zhvillimi jo të njëjta, merret si model për t'u imituar (dhe përshtatur) jo gjithnjë modeli që mendohet se është më i përafërt me realitetin e një vendi, por modeli më i mirë i mundshëm. Në rastin e vendeve në tranzicion objektivi ka qenë gjithmonë implementimi i Shtetit të së Drejtës dhe ngritja e një demokracie të plotë¹¹. Studiuesit kanë ndërtuar modele dhe skema për të shpjeguar rëndësinë e ligjit. Në momente tranzicioni shkencat sociale kanë tentuar t'i japin një përgjigje zhvillimeve të sistemit ligjor, kanë tentuar të bëjnë një klasifikim dhe të gjejnë modele unifikuese. Selznick dhe Nonet në vitet '70 dalin me teorinë e ligjit reaktiv (*responsive law*) dhe mbështesin idenë se "ai dhe jo sociologjia

⁸ Autori thekson se ndikimi kryesor ishte i mendimit iluminist sipas të cilit duhej një e drejtë e formuar nga parlamenti që të fliste pa nevojën e interpretuesve (Rodotà 2006: 44).

⁹ Është momenti kur lindën një numër i madh teorish qoftë për të përligjur modelet e reja politike dhe sistemet e tyre ligjore, qoftë nga studiues filozofë të së drejtës. Për një trajtim të ligjit dhe shoqërisë në tranzicion shiko: Nonet, Philippe & Selznick, Philip. 1978. *Law and society in transition, Toward responsive law*. New York: Oktagon books ose për një trajtim manualist i autorëve dhe rrymave kryesore Travers, Max. 2010. *Understanding law and society*. Oxon: Routledge; Campesi, Giuseppe & Papolizio, Ivan & Riva Nicola (eds.). 2009. *Diritto e teoria sociale. Introduzione al pensiero socio-giuridico contemporaneo*. Roma: Carocci

¹⁰ Me rëndësi është mendimi i Calabresi-t në radhët e normativistëve duke u vënë në kontrast me pozitivistët (Postner) ose *public choice theory* (Buchanan). Ai propozon zgjidhje juridike konkrete për arritjen e objektivave që konsiderohen të rëndësishëm për shoqërinë dhe i përket juristëve të gjejnë mënyrat për të aritur këto objektiva (Guglielmetti 2009: 179 në vijim).

¹¹ Për një ndërtim doktrinor mbi *Rule of Law* në vendet në tranzicion shiko: Teitel, Ruti. 2009. *Transitional jurisprudence: the role of laë in political transformation* në 106 *Yale Law Journal* 2009, ff. 2016 e në vijim.

ka qenë programi i vërtetë i doktrinës sociologjike e realiste” dhe se “ky ligj reaktiv përbën stadin më të lartë në evolucion, kundrejt ligjit autonomist ose atij represiv ... dhe sjell kompetenca institucionale më të gjera në kërkimin e drejtësisë” (Nonet & Selznick 1978: 115-116). Autorët konkludojnë se ka një diferencë të thellë midis ligjit represiv dhe atij reaktiv duke qenë ky i fundit i bazuar në një përligjje më e madhe në komunitet dhe arritjes së një numri vlerash ligjore duke u nisur nga një përdorim minimal i forcës drejt përgjegjshmërisë.

Ndërsa *Law and development* ndërton modele veprimi dhe praktikash, të cilat janë përpjeke për të ndryshuar ligjin në mënyrë që të arrihen disa objektiva¹². Kjo teori në 50 vitet e fundit ka pasur disa versione të ndryshme, duke u nisur nga zhvillimi i shtetit kapitalist deri te versioni neoliberal i besimit në tregun e lirë si motori i zhvillimit, në mosbesimin në shtet dhe vizioni i ligjit si një instrument për të adaptuar një rregull privat dhe për të detyruar shtetin. Kjo legjitimohet nga ideja që tregu është një formë lirie (Trubek 2007: 236). Këto ide të ndryshme çojnë në sjellje dhe praktika qeverisje të ndryshme: ligji i Shtetit të zhvillimit kapitalist do të forcojë institucionet duke i bërë faktorë të rritjes ekonomike dhe kjo do të thotë që të ndryshojë kultura ligjore, duke e bërë më pragmatike dhe duke modernizuar ligjin rregullues për të kompensuar falimentimet e tregut, ligji i Shtetit socialist gjithashtu theksonte rëndësinë e efektivitetit si instrument, por edhe me një pjesëmarrje më të gjerë në drejtësi duke qenë dyshues kundrejt një klase profesionale ligjore të pavarur dhe duke u bazuar në gjykatat popullore me gjyqtarë laikë ndërsa pikëpamja neoliberale e përdor ligjin për të lehtësuar tregjet, për të mbrojtur pronësinë dhe të frenojë ndërhyrjen e shtetit në ekonomi. Ky variant vë theksin mbi një trup gjyqësor profesional dhe të pavarur për të përmbushur këto detyra dhe promovon një koncept të Shtetit të së drejtës si tërheqje e veprimtarisë rregulluese të shtetit (Trubek 2007: 237-238). Autori në trajtim mendon se këto skema të *law and development* kanë dështuar në shpjegimin e zhvillimeve shoqërore në praktikë, duke pohuar se megjithëse janë konfrontuar kompleksiteti i sistemeve ligjore, kulturave dhe traditave kemi mësuar se nuk ka një skemë të njëjtë për gjithçka. Gjenerata të tëra studimesh mbi ligjin kanë prodhuar një koncept më të plotë të ligjit ose sesi ligji duhet të jetë, por njëkohësisht edhe më të komplikuar. “*Law and development* bazohet në idenë se ligji është një pjesë vitale e shoqërisë dhe fundamentale për veprimet ekonomike, e cila bën të mundur pengimin ose zhvillimin e objektivave si rritja dhe pasurimi... Ai shpreh idenë se nëpërmjet studimit dhe reformave gjërat do të përmirësohen për njerëzit” (Trubek 2007: 239). Në konkluzionet e tij Trubek thekson se duhen dyfishuar mundimi për të arritur një njohje sa më të mirë dhe për një praktikë sa më efektive sepse nuk ekziston asnjë ide universale ose reformë standarde e gatshme për zbatim dhe se nuk ka një konsensus në botën akademike mbi natyrën, historinë dhe impaktin që ligji ka në një shoqëri. Kjo bën që puna për një reformë efektive të jetë më intriguese. Duhet gjetur përqaqje të reja teorike për të zëvendësuar formulën “one-size-fits-all” dhe për të reformuar sistemet

¹² Trubek, David M. 2007. The nature of law and development: the owl and the pussy-cat: is there a future for “law and development”? në *Wisconsin International Law Journal*, nr. 25, Summer, 2007, pp. 235 e në vijim. Teori e lindur pas Luftës II Botërore dhe rrënjët e ka në idenë e supremacisë së Perëndimit dhe ligjeve të tij.

ligjore pa pasur në bazë një skemë universale. Vendoset pra në qendër të reformave ajo që quhet synimi drejt *Rule of Law*. Duhet përmendur edhe fakti se kësaj teorie vazhdimisht i janë bërë kritika të ndryshme mbi përfaqshjen shumë liberale dhe me një frymëzim amerikan që i bën problemeve për implementimin e shtetit të së drejtës.

Në studimet mbi tranzicionin e vendeve të lindjes mendohet se kalimi nga shteti monist në demokraci është i karakterizuar si dualist duke theksuar rëndësinë e rikonceptualizimit e *Rule of law*¹³, i cili edhe sot nuk është i përkufizuar në mënyrë të qartë duke komplikuar jo pak sforcimin për një matje efektive të tij¹⁴. Merret në shqyrtim tranzicioni rus duke dhënë në fillim përcaktimin e shtetit të së drejtës si një sistem ideal ku ligji aplikohet nga një gjykatës i ndarë nga politika dhe që ka për bazë parimin se ligji është i njëjtë për të gjithë. Autori vazhdon duke përcaktuar si indikatorë të shtetit të së drejtës në një shoqëri të caktuar një procedurë të rregullt, aksesin (në drejtësi) dhe efikasitetin dhe konkludon se duke gjykuar “në kuadër të reformave të thella institucionale ka pasur një afrim drejt Shtetit të së drejtës, gjithsesi ligji nuk ekziston vetëm në letër. Ai merr kuptim vetëm kur zbatohet” (Hendley 2006: 365). Autori në matjen e Shtetit të së drejtës përdor indeksin e World Bank Institution, në të cilin Rusia gjendet në të njëjtën pozicion si Shqipëria (vendi i 126 për 2005) për sa i përket matjes së disa nga indikatorët si, për shembull, perceptimi i korrupsionit (CPI Index, që është i përfshirë në WBI Index). Autori ngre problemin se në përdorimin e këtyre indekseve numri i input-eve nuk është i njëjtë për të dy shtetet (Hendley 2006: 373-374).

Implementimi i shtetit të së drejtës mund të matet më drejt me një indeks të krijuar nga World Justice Project, i cili në një përfaqje studimi sasiorë merr në shqyrtim 10 faktorë dhe 49 nënfaktorë që përfshihen në 4 parime: Qeveria dhe zyrtarët janë përgjegjës përpara ligjit, qartësia e ligjit, procesi i drejtë dhe efikas i administrimit të ligjit dhe sigurimi i aksesit në drejtësi me anë të operatorëve të cilët janë të mjaftueshëm, me resurse të mjaftueshme dhe që reflektojnë përbërjen e komunitetit. Këto bëjnë të mundur një studim komplet dhe me baza mbi *Rule of law*¹⁵. Rezultatet mbi Shqipërinë në bazë të këtij indeksi tregojnë, për vitin 2009, një situatë të pranueshme në disa nga indikatorët që ne na interesojnë si, për shembull, në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të të akuzuarve, moslejimin e shpronësimeve arbitrare, mbrojtjen e aktivitetit privat, mbrojtjen e pronës private, aksesin në drejtësi, numrin e mjaftueshëm të organeve të akuzës. Vihet re se disa nga indikatorët si,

¹³ Problemi konceptual i trajtuar gjerësisht nga Magen (Magen 2009: 54 e në vijim) duke vënë theksin mbi rëndësinë e Rule of Law dhe shpjegon sesi koncepti është i tejkaluar dhe i abuzuar, madje më shumë se vetë koncepti i demokracisë. Vitet '90 shënojnë etapën e 4-ët të rilindjes së Shtetit të së drejtës që u bë ideja bazë i procesit të kalimit nga shteti totalitarist në demokraci.

¹⁴ Autorja studion si një problem kryesor të shtetit të së drejtës aksesin në drejtësi dhe argumenton se për të qenë të aftë të përdorin ligjin, njerëzit duhet të jenë të aftë ta gjejnë atë dhe vë theksin te transparenca e ligjit dhe te pamundësia në vitet e tranzicionit për të pasur një indeksim të mirë të burimeve të së drejtës duke konstatuar se në vitet e fundit kjo është bërë e mundur pjesërisht nga tregu i lirë, duke ngritur shumë banka të dhënash, edhe online, por këto janë shumë të kushtueshme (Hendley 2006: 348 e në vijim).

¹⁵ Burimi: <http://www.worldjusticeproject.org/rule-of-law-index/>. Në këtë faqe gjenden informacione më të detajuara mbi metodologjinë e studimit.

për shembull, pavarësia e organeve të akuzës, ekzekutimi i vendimeve, procedura administrative transparente janë nën mesataren e vendeve të Europës Lindore në një krahasim socio-ekonomik¹⁶. Kampioni për Shqipërinë ka qenë i përbërë nga Tirana, Elbasani dhe Durrësi.

Shteti i së drejtës ka qenë baza e zhvillimit për ekonomitë në tranzicion. Në literaturë, gjithsesi, ka mendime për një konceptim edhe më të gjerë të Shtetit të së Drejtës, duke e kuptuar si një kyç i cilësisë së demokracisë dhe implementimin e tij si një pjesë integrale e procesit të zhvillimit socio-politik në sistemet (Magen 2009: 53) ligjore. Pra, autori thekson se në shekullin XXI roli i *Rule of Law* është i ndryshëm në faza të ndryshme, ose tipa të ndryshëm të zhvillimeve në ndërtimin e shteteve demokratike¹⁷ dhe nga kjo krijon bindjen se juristët duhet të nisen paraprakisht nga një këndvështrim doktrinor i Shtetit të së drejtës duke shtruar disa pyetje në lidhje me kushtet, mënyrat dhe limitet e influencës së jashtme mbi zhvillimet e brendshme demokratike. Për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve juristët, në promovimin e *Rule of Law*, duhet të përballen dhe të kërkojnë përgjigje në literaturën që nuk u përket fushës së tyre si, për shembull, në fushën e studimeve politike, demokracisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare (Magen 2009: 114-115).

Instaurimi i asaj që quhet “era e të drejtave” nuk mund të mos prekte edhe tranzicionin shqiptar i cili u zhvillua në një moment kur po kalohej nga “qeverisja e njerëzve” në ringritjen e asaj që quhet “qeverisja e ligjeve” dhe në pohimin se “ka një grup të drejtash fundamentale që na përkasin jo vetëm si pjesëmarrës në një komunitet politik, por si qenie njerëzore”¹⁸ duke kërkuar që ligji të rrenjose jo në shoqëri, por në individët si qenie njerëzore. Këto të drejta rriten gjithnjë e më shumë përkrah kalimit nga kushtetutat e ngurta tek ato fleksibël, te përhapja e kushtetutshmërisë si vlerë, te kalimi nga shteti i së drejtës drejt një shteti kushtetues të së drejtës (Rodotà 2006: 33). Kjo nuk kishte si të mos ndikonte në tranzicionin shqiptar edhe për vetë faktin se Shqipëria synon drejt realizimit të një shteti të tillë. Mund të themi se tranzicioni në Shqipëri, ashtu si në vendet e tjera të lindjes, ka pasur si qëllim kalimin nga sistemi monist në atë që është koncepti perëndimor i Shtetit të së Drejtës (*The Rule of Law*). Në bazë të këtij procesi ka qenë mbi të gjitha zhvillimi i sistemit të drejtësisë dhe në veçanti sigurimi i pronës dhe iniciativës së lirë. Një faktor i rëndësishëm i tranzicionit shqiptar ka qenë pa diskutim edhe faktori ndërkombëtar dhe ndihma juridike që i është ofruar shtetit shqiptar për modernizimin dhe përqasjen e legjislacionit. Në fushën e studimeve krahasuese rryma kryesore e shikon sistemin e ligjit si tentues drejt hegjemonisë dhe unifikimit, drejt një ideje unitare të drejtësisë (Frankenberg

¹⁶ Burimi online: http://www.worldjusticeproject.org/sites/default/files/Country_Profile_Albania_2009-FINAL.pdf.

¹⁷ Teoritë e Rule of Law mund të ndahen në dy tipa: i lehtë ose i trashë (thin or thick), negativ ose pozitiv, formal ose real, etj. Lind nevoja që këtë koncept ta shikojmë të pavarur nga procesi elektoral i një vendi pasi nuk është e drejtë ta identifikojmë me të. Magen identifikon 4 kategori të zhvillimit të Rule of Law: ndërtimi i Shtetit, liberalizimi, tranzicioni dhe konsolidimi i një demokracie cilësore. Autori vazhdon duke përshkruar 4 etapat e zhvillimit të teorisë së Rule of Law dhe bën një kritikë të teorisë liberal-legaliste Law and Development të Trubek.

¹⁸ Corte Costituzionale, 10 prill 2001, nr. 105 në *Giurisprudenza Costituzionale*, 2001, f. 684

1997: 265). Tranzicioni i sistemit juridik shqiptar ka qenë gjithnjë i orientuar drejt arritjes së plotë të ndërtimit të Shtetit të së drejtës. Një ilustrim i mirë i pjesës së parë të tranzicionit është bërë në literaturë nga Frankenberg (Frankenberg 1997: 259 në vijim). Në artikull ai merr si shembull Shqipërinë për të parë ndikimet që ligjet e kopjuara sjellin në një shoqëri në tranzicion. Autori thekson se shtetet perëndimore e kishin bërë Shqipërinë një shtet target, si çdo vend tjetër në zhvillim, për reforma të reja ligjore dhe ekonomi eksperimentale me qëllimin e mirë për ta kaluar Shqipërinë nga varfëria drejt mirëqenies ku “të monitoruar nga përfaqësuesit e organizmave ndërkombëtarë ata (shqiptarët) importuan, adaptuan dhe transplantuan Kodet. ... Detyra ishte të adaptohej Shteti i së Drejtës ...”¹⁹ (Frankenberg 1997: 260).

Këto studime që përmendëm më lart japin gjithsesi një pasqyrë të limituar të reformave në drejtësi pasi në vendet në tranzicion reformat ecin me hapa të ngadalta, implementimi i tyre nuk është aq i përnjëhershëm sa në një shtet të konsoliduar, skemat e zhvillimeve legjislative janë të ndryshme në vende të ndryshme dhe nuk mund të nxirret një përfundim duke përdorur analogjinë. Bazat e studimit duhet të jenë empirike dhe të studiohet efektivisht impakti i reformave në një vend të caktuar, *feedback*-u që shoqëria jep nuk është aq i shpejtë dhe nuk matet si në vendet e zhvilluara.

Me të vërtetë kemi një ndarje të drejtë të *law in books* dhe *law in action* por kjo nuk do të thotë se ne duhet të bazohemi tërësisht te *law in action* duke mos vlerësuar efektivisht rrugën drejt ndërtimit të shtetit të së drejtës duke marrë parasysh edhe mundimin për të adoptuar një legjislacion modern dhe në standardet e kërkuara nga Bashkimi Europian²⁰. “Nuk është e vërtetë që esenca e ligjit qëndron vetëm në aplikimin e tij, që *law in action* na obligon që të mos mbajmë në konsideratë *law in books*, që kushtetuta materiale mbivendoset mbi atë formale. ... Nuk mund të biem në tundimin, e veshur si realizëm, që të pohojmë se një e drejtë është sikur të mos ekzistonte, përderisa nuk është plotësisht e realizueshme” (Rodotà 2006: 42-43). Kjo me të vërtetë do të eliminonte norma të vjetruara, nga sistemi pro do të përlligite mundësinë për të eliminuar edhe rregulla të vlefshme të cilat duan pak më shumë kohë për t’u implementuar dhe që kanë një dobi joafatshkurtër, por që synojnë ngritjen e një shoqërie të shëndoshë. Rodotà shkruan se ka norma të cilat janë vetëm në letër kanë qenë një nismë e fortë për shoqërinë civile që të kërkojë aktualizimin e tyre. Në literaturë shoqëria civile shikohet si një forcë kundrejt shtetit duke u vendosur midis shtetit dhe individit (Peerenboom 2003). Kjo është një nga mënyrat për të ngritur një sistem juridik që ka pretendimin se është komplet (Rodotà 2006: 43) dhe që siguron zbatimin e të drejtave të qytetarëve. Pra të qenit komplet i një sistemi juridik

¹⁹ Autori në këtë artikull merr si shembull Shqipërinë për të thënë se ishte një nga vendet ku u ringrit ideja për një të drejtë të krahasuar që nuk ka të bëjë vetëm me ligjin, por edhe me sistemin politik në tërësi dhe me kulturën e një populli.

²⁰ Për një trajtim më të gjerë të problemeve lidhur me hapjen e BE drejt vendeve të Lindjes shiko: Henderson. 2002. “The challenge of the EU eastward enlargement” në *Global society in transition*, D.N. Nelson, L. Neack (eds.), Great Britain: Kluwer Law International, f. 479- 495. Autorja thekson faktin se demokratizimi i shteteve të Lindjes po kalon në një tranzicion të trefishtë dhe ato duhet të transformojnë strukturën kushtetuese dhe të krijojnë tregun e lirë. Autorja thekson faktin se duhet të përshtatet *acquis communautaire* dhe kjo nuk është e thjeshtë por kërkon reforma të thella.

do të thotë të kesh parasysh edhe kontekstin social në të cilin normat manifestohen, “veçoritë sociologjike të kombeve” (Sacco 2007: 49) dhe efikasitetin e shoqërisë civile.

Raste nga realiteti i sistemit ligjor shqiptar

Në rrjedhën e historisë ligji pëson ndryshime të shumëllojta. Mund të ndikohet nga lobime të ndryshme në një moment historik, nga faktori politik, nga faktorë të jashtëm, etj. Evolucioni i sistemit ligjor është i pashmangshëm²¹. Por ky evolucion nuk duhet të krijojë përshtypjen e një rendi të ri ligjor, të një ndarje ose stigmatizim të normës pararendëse. Një ligj i ri futet në sistem sikurse një organ gjatë transplantit. Mbasi bëhen të gjitha analizat e rastit mbi përputhshmërinë, koherencën, pasi krijohet ideja se ligji do të sjellë përmirësim atëherë shfuqizohet në mënyrë të qartë ligji pararendës në atë fushë dhe hyn në fuqi ligji i ri. Këto veprime për operatorin e së drejtës janë të qarta: ligji i ri shfuqizon të vjetrin dhe duhet të konformohemi. Sistemi ligjor i vjen në ndihmë gjykatësit, nëpunësit, avokatit edhe me instrumente që plotësojnë kuadrin si, për shembull, qarkoret e brendshme, rregulla për interpretimin e ligjit ose interpretimin autentik të tij. Më vonë shoqëria do të japë gjykimin e saj mbi punën e legjislatorit, pra nëse ky i ka analizuar siç duhet *feedback*-et e shoqërisë dhe sa ka realizuar nevojat e saj për rregullimin e një problemi të caktuar. Fundja ligjëvënia ka si synim parësor rregullimin e situatave e sjelljeve të reja në fushën socio-ekonomike. Gjithsesi tërë ky ndryshim rrjedh në një rend fiziologjik duke ruajtur një bazë të fortë, një *background* ku normat e reja gjejnë terrenin e përshtatshëm për tu rritur. Pra ligji ndjek zhvillimin e shoqërisë.

Në rastin e shoqërisë në tranzicion na rezulton një patologji e sistemit. Në rastin shqiptar kjo gjë është akoma më e theksuar pasi tentativa për të krijuar një kulturë juridike lind nga një *background* mjaft i varfër dhe i copëzuar, për mos të thënë i dyzuar. Siç e thamë dhe në fillim, studimi jonë plotësohet duke marrë disa shembuj nga realiteti i ligjit shqiptar në tranzicion për të treguar se me të vërtetë ligji ndjek zhvillimet shoqërore por ndonjëherë ai ka synimin të përligjë një veprim tashmë të kryer dhe që kërkon një zgjidhje ligjore. Sot që shkruajmë jemi shumë larg nga situata që Frakenberg përshkruan në 1997 dhe historia e mikes së tij profesore e thirrur për të bërë draftin e Aktit të Procedurës Administrative në Shqipëri (Frankenberg 1997: 271-274), me pengesat që hasi në identifikimin e një ligji të qartë, është, sipas mendimit tonë, një histori e largët që i përket tranzicionit të parë shqiptar dhe jo synimeve të integritetit që Shqipëria ka sot. Mund të themi se tani vërehet se kemi

²¹ Evolucionin e modeleve ligjore mund të vijë si pasojë e një ndryshimi endogjen ose si pasojë e imitimit por gjithnjë duke ndjekur rregulla të caktuara. Teoritë e evolucionit thonë se kalimi nga një fazë A në fazën B dhe pastaj në C çon në përfundimin se një model tjetër që gjendet në fazën A për të arritur fazën C duhet të kalojë patjetër nga faza B (skema evolutive lineare). Në të kundërt teoria difuzioniste nxjerr në pah imitimin si formë kryesore e përhapjes së modeleve. Imitimi studiohet nga juristi si baza e qarkullimit të modeleve. Sacco pohon se evolucionin dhe difuzionin janë procese që ndërthuren me njëri-tjetrin dhe alternohen (Sacco 2007: 56-58); Luhmann mendon se mund të flasim për evolucion në qoftë se kemi prezent 3 mekanizma: variacion, seleksionim dhe ristabilizim të një sjellje që ngrihet në rang rregulle sociale (Luhmann & De Giorgi 1992: 193-203).

kaluar nga një ligjënie sporadike dhe plotësim i ngutshëm i kuadrit ligjor në një përmirësim cilësor të legjislacionit. Kjo, sipas mendimit tonë, nuk ka ardhur vetëm nga angazhimet në arenën ndërkombëtare e në atë europiane veçanërisht por edhe nga eksperiencia e akumuluar ndër vite.

Marrim rastin e pronësisë që është dhe simboli i tranzicionit të shtetit ligjor në Shqipëri. Koncepti i pronës është mjaft i lashtë. Edhe në Shqipëri mund të themi se ky koncept ka rregulluar marrëdhëniet shoqërore prej shekujsh dhe se i përket kulturës juridike shqiptare (Krisafi 2009). Në literaturë theksohet se pronësia, si institut i së drejtës, si pjesë e superstrukturës juridike të shoqërisë, ka ndjekur ritmet dhe zhvillimet e kohës. Autori konkludon duke theksuar faktin se e drejta zakonore veprimi gjatë në trojet shqiptare si rregullator i jetës së shqiptarëve edhe mbasi u krijua shteti modern dhe u konsolidua legjislacioni zyrtar duke parë si mundësi për eliminimin e zbatimit të normave kanunore përsosjen e legjislacionit mbi pronën dhe zbatimin e tij efikas (Krisafi 2009: 33). Duke përgjithësuar konkluzionet e prof. Krisafit mund të themi se një veçori e tranzicionit shqiptar, ndryshe nga vendet e tjera të Europës Lindore, ishte fakti se kalimi nga legjislacioni monist në konceptet juridike të shtetit demokratik krijoi një vakuum i cili rivitalizoi të drejtën kanunore në disa zona të vendit. Kemi marrë si shembull të tranzicionit shqiptar konceptin e pronësisë pasi ka qenë një nga çështjet më të ndërlikuara, për mos dashur ta etiketojmë si problemin kryesor të tranzicionit shqiptar. Në vitet '90 u kalua nga koncepti i "pronës vetjake", në një situatë kur e drejta private në tërësi ishte e përfshirë në të drejtën publike (Nuni 2009: 10), te prona private. Formalisht kjo u bë në sajë të disa ligjeve që sollën ndryshime rrënjësore në shoqërinë shqiptare të viteve '90²², duke i hapur rrugën procesit të gjatë të tranzicionit. Për ringritjen e konceptit të pronës private mund ti referohemi ligjeve ligjit mbi privatizimin, atij mbi shoqëritë tregtare²³, ligjit për tokën²⁴, etj.

Me rënien e sistemit komunist në Shqipëri, nisi një proces legjislativ kompleks i cili duhet të kishte parasysh jo vetëm hartimin e një ligji të ri për rregullimin e pronës por edhe situatën faktike të krijuar në vitet e para të tranzicionit, atë të shitblerjes së tokave pa certifikata pronësie. Pra, siç të gjithë e dimë, në këto vite hasim konflikte të dyfishta ose të trefishta pronësie. Në konfliktin e ish-pronarëve me Shtetin u fut edhe figura e pronarëve të rinj të cilët ishin posedues të pronës ose e kishin blerë atë jo nga pronari i ligjshëm. Pra u bë juridikisht e pamundur t'i jepej një zgjidhje problemit të pronësisë megjithëse Gjykata e Lartë ka dalë disa herë me vendime unifikuese për këto probleme (Kondi 2009: 54 e në vijim) ku ndër parimet që kjo ka vendosur për zgjidhjen e çështjeve mbi konfliktet e pronësisë është parimi sipas të

²² L. 7491, datë 29.04.1991 "Dispozitat kryesore kushtetuese" që shfuqizoi Kushtetutën e vitit 1976

²³ L. 7512, datë 10.08.1992 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit". Ky ligj etiketohet si ligj *multifunksional* nga prof. Nuni pasi krijonte kushte jo vetëm për njohjen e pronës private por bënte të mundur zgjerimin e kategorive që do të ishin objekt i kësaj pronësie. Ky ligj në themel ka pasur procesin e privatizimit, që jo vetëm ndryshoi konfiguracionin e shoqërisë shqiptare, por rihodhi gjithashtu themelet e institutit të pronësisë private (Nuni 2009: 12-13).

²⁴ L. 7501, datë 19.07.1991 "Për tokën"

cilit ligji i kthimit dhe kompensimit të pronave ish-pronarëve²⁵, në rast ndeshjeje, ka përparësi mbi të gjitha ligjet e tjera për privatizimin e pronës shtetërore, pavarësisht kohës së miratimit të tyre si dhe parimi që kur ka ndeshje me ligjin “Për shoqëritë tregtare” merr përparësi ligji për kthimi dhe kompensimin e pronave (Kondi 2009: 62). Njëkohësisht një parim tjetër i nxjerrë nga praktika gjyqësore është edhe parimi sipas të cilit ligji i kthimit dhe kompensimit të pronave rregullon marrëdhëniet shtet-individ lidhur me pronat e marra nga shteti komunist dhe nuk prek marrëdhënie të tjera pasurore midis individëve. Në këto parime, që për mendimin tonë mund të çojnë në dy zgjidhje diametralisht të kundërta të një problemi, do të bazohet operatori i së drejtës për të këshilluar individin. Atëherë shikojmë se zgjidhja konkrete, pavarësisht nga vendimet unifikuese ose praktika gjyqësore e mëparshme, është në dorë të gjykatësit. Është gjykatësi në momentin që jep një vendim krijon një fakt të ri juridik në shoqëri të cilin individ duhet ta pësojë. Megjithatë ne mendojmë se momenti intelektual i vendimit gjyqësor është i pranueshëm dhe e marrim si të kaluar konceptin që gjyqtari është vetëm goja e ligjit pyetja që shtrojmë është mbi sigurinë e vendimeve dhe mbi konceptin e pasigurisë së ligjit²⁶ në tërësi. Për Shqipërinë në tranzicion më efikase se vendimet unifikuese do të ishte kalimi, nga ana e legjislatorit, nga një trajtim sporadik i problemeve të veçanta me ligje *ad hoc* në një rregullim organik dhe më të qartë të legjislacionit. Kjo vjen duke perfeksionuar gjuhën ligjore dhe duke ndërmarrë reforma ligjore thelbësore të cilat kanë edhe një kosto jo të vogël për shoqërinë. Rasti i çështjeve të pronësisë është rasti më i pastër. Faktori politik duhet tu japë një zgjidhje legjislative të qartë problematikave që tranzicioni nxjerr në pah duke marrë përsipër edhe përgjegjësinë politike për pakënaqësitë që kjo sjell. Kalimi nga amullia ligjore drejt shtetit të së drejtës kalon në mënyrë të pashmangshme nga zgjidhja e çështjeve të pronësisë, i cili më shumë se një problem legjislacioni për tu adaptuar është një problem social që kërkon një zgjidhje politike.

Një shembull tjetër mbi tranzicionin shqiptar përbën edhe studimi i procesit të privatizimit dhe ligji mbi shoqëritë tregtare. Ashtu si në vende të tjera të lindjes edhe në Shqipëri ky proces ishte një nga problemet kryesore të kalimit nga një regjim socialist drejt tregut të lirë dhe sipërmarrjes private. Siç thamë dhe më lart, ligji i tranzicionit shqiptar, duke tentuar të realizonte Shtetin e së drejtës dhe vendosjen e demokracisë në kuadrin politik, u shoqërua dhe me reformën e duhur edhe për liberalizimin e ekonomisë duke pasur si synim kalimin nga një ekonomi e centralizuar në ofertën tërësisht private në treg. Pikësëpari duhet thënë që procesi i privatizimit masiv që karakterizoi vendet e Lindjes nuk ishte një fenomen që i përkiste rënies së regjimit komunist por kishte filluar edhe më parë në disa vende perëndimore, ku si shembull mund të merret Italia, pas një krize të thellë të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. Gjithsesi duhet t'i mbajmë të ndarë këto dy procese të ndryshme privatizimi dhe të fokusohemi te rasti i Shqipërisë. Në Shqipëri privatizimi u bë nëpërmjet një procesi

²⁵ L. 7698 datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve” dhe ndryshimet e mëvonshme.

²⁶ Pasiguria juridike është një nga faktorët që pengon integrimin e shpejtë në familjen europiane (Kondi 2009: 52).

të ndarë për sektorët strategjikë dhe ato jo strategjikë²⁷ duke përdorur masivisht edhe Bonot e Privatizimit. Këto ishin instrumente financiare të cilat me dekret të Këshillit të Ministrave nr. 1030 del 23.02.1995 mund të konvertoheshin në aksione, por duke pasur parasysh faktin se investitori strategjik, pra kontrolluesi efektiv i shoqërisë tregtare duhet të paguante në para. Pas 20 vjetësh nga fillimi i privatizimit mund të themi se ky proces pjesërisht ishte një nga faktorët që ndikoi në ligjin dhe shoqërinë shqiptare. Efektet pozitive ose negative të tij nuk patën një efekt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Në mënyrë intuitive mund të afirmojmë se shumë nga pasuria e përbashkët që u trashëgua nga regjimi i mëparshëm kaloi në duart e një pjese të vogël individësh. A ka qenë kjo një dështim i kuadrit ligjor ose një zgjidhje e gabuar e legjislatorit? E pra gjithçka ka pasur në bazë eksperiencën e vendeve të tjera të Lindjes dhe mund të ishte mësuar nga gabimet e tyre. Dekada e parë e tranzicionit në vendet e Lindjes tregoi se një strategji e suksesshme privatizimi ka nevojë për bashkëpunimin e autoriteteve të ndryshme rajonale me ato kombëtare dhe njëkohësisht me sektorin privat (Bugarcic 2001: 247-288). Vala e dytë e privatizimeve në realitetin shqiptar mund të themi se ka qenë më e suksesshme ku shteti shqiptar, tashmë i konsoliduar dhe me një përvojë më të madhe, ka pasur një ndikim më të madh në zgjedhjen e partnerit strategjik duke aplikuar qartë procedurat e evidencës publike, negociatat teknike, etj. Si shembull sjell privatizimin e aeroportit të Rinasit, Albtelecom sh.a., etj.

Duke pasur një ndikim të madh nga procesi i privatizimit ligji shqiptar për shoqëritë tregtare mund të themi se vetëm së fundmi ka gjetur një sistemim organik me një bazë ligjore të kënaqshme²⁸. Ligji i ri përmban një sërë artikujsh të huazuar nga kode tregtare të ndryshëm si, për shembull, parashikimi i një anëtari independent të bordit, i një anëtari të zgjedhur nga punëtorët, etj. Këto norma të huazuara nga tradita të ndryshme europiane i japin ligjit shqiptar një nuancë shumë liberale. Pra, legjislatori shqiptar, duke u nisur nga synimi politik i thithjes së investitorëve të huaj, kërkon të ndërtojë një kuadër ligjor sa më liberal duke huazuar norma që i përkasin traditave të ndryshme. Kjo është një përpjekje e lavdërueshme e legjislatorit e cila na ofron një rregullim organik të lëndës. Këtu puna e legjislatorit mbaron. Problemi lind në aplikimin konkret të kësaj normative. Kush është sistemi më i mirë për të qeverisur një shoqëri tregtare aksionare? Këtu duhet të na vijë në ndihmë juristi. Në mungesë të një eksperience të mëparshme është e vështirë të japësh një mendim se cila nga zgjedhjet është e drejtë. Në vendet perëndimore prej kohësh ekzistojnë korpuse rregullash që përmbledhin *Best practices* dhe që japin modele unifikuese për t'u ndjekur. Sjellim si shembull *Codice Preda* në Itali ose *Code of Conduct* në Angli. Ndër vendet e rajonit Kroacia ka një *Corporate Governance Code* që nga 2004 dhe

²⁷ Privatizimi ishte i bazuar në ligjin 8303 i 14.03.1998 për sektorët strategjikë ku kompetent ishte Këshilli i Ministrave dhe për sektorët jo strategjikë bazohej mbi ligjin 23.04.1998 me kompetencë të Ministrisë së Tregtisë dhe Energjetikës por formula mbetej e njëjtë. Sipas ligjeve parashikohej ndarja e kapitalit grupeve aksionere të ndryshme ku një pjesë i rezervohet Shtetit, një pjesë i jepej punonjësve dhe pronarëve të truallit (jo më shumë se 20 % e aksioneve), investitorëve të vegjël dhe pjesa e kontrollit u jepej investitorëve strategjikë.

²⁸ Ligji 9901 datë 24.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

Sllovenia që nga 2007. Këto kode japin një ide se kush është rruga e preferuar e të bërit biznes në vendet në zhvillim, por në të vërtetë në këto vende kompani të ndryshme devijojnë nga këto Best Practices me justifikimin se “janë konform kërkesave të ligjit dhe nuk e ndiejnë si obligim të konformohen me to (Best Practice)”²⁹ (Gregoric, Zajc & Simoneti 2007). Këta autorë arrijnë në konkluzionin se në një kontekst ku ekziston një kod me modele të cilat nuk aplikohen një nga mekanizmat më të mirë do të ishte sanksioni social i bazuar në reputacionin dhe besueshmërinë e firmës.

Do të ishte me vlerë edhe për realitetin shqiptar të kishte një kod me *Best Practices* dhe mendimi ynë është se kjo do të jetë e mundur nëpërmjet studimeve të realitetit të shoqërive tregtare nga ana e doktrinës. Janë akademikët dhe studimet empirike të realitetit shqiptar që do të bënin të mundur të zgjidhej një interpretim dhe një rregull i duhur brenda hapësirave që ligji lejon.

Në zgjidhjen e problemeve të përditshme ka rëndësi të veçantë jo vetëm ligji, por edhe interpretuesit e tij siç janë gjykatësit, avokatit, juristit, nëpunësit, etj, ku gjithsecili ka pasur një *background* studimor të ndryshëm. Këtë e themi duke u nisur edhe nga fakti se një pjesë e mirë e operatorëve janë formuar jashtë vendit dhe gjithsecili e përthyen dhe interpreton bazën ligjore sipas kriterëve e parimeve me të cilat ai është formuar. Edhe ky është një aspekt i së drejtës në tranzicion në rastin shqiptar. Hartimi i ligjeve në këto vite është bërë në bazë të modeleve perëndimore dhe synojnë realizimin e *Rule of Law*, por kjo nuk mjafton për të dalë në konkluzionin, që rëndom përdoret si klishe në debatet e niveleve të ndryshme, se ligji është, por nuk zbatohet. Nuk mjafton të kesh një bazë normative të mirë për të dhënë një drejtësi të mirë. Për implementimin e *Rule of Law* ka nevojë edhe për një klasë gjyqtarësh dhe avokatësh të formuar³⁰. Për Shembull, në literaturë ka mendime se rritja e standardeve për pranimin e ushtrimit të profesionit të avokatit, ashtu siç propozohet në sistemin amerikan, sjell efekt të kundërt me rritjen e nivelit të implementimit të Shtetit të së Drejtës³¹ (Pearce, Levine 2009: 1661). Autorët marrin në shqyrtim vende si Kina ose Afrika e Jugut dhe i referohen kryesisht mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Autorët theksojnë rëndësinë e veçantë që juristët kanë jo vetëm për sistemin ligjor, por edhe më gjerë, në nivelin qeverisës dhe ligjvënës duke i bërë një nga hallkat të cilat formojnë, sigurojnë dhe teçojnë ligjin te populli duke bërë të mundur që qeveria përcjell demokracinë, liritë e njeriut dhe Rule of Law te populli (Pearce & Levine 2009: 1637-1638). Në Shqipëri ligji për avokatinë është reformuar në 2003³² duke sjellë jo pak risi gjithsesi problemet më të mprehta për kategorinë e evidentohen në praktikën dhe formimin e pakët pas përfundimit të studimeve pasuniversitare ose në mënyrën e organizimit të provimit kualifikues (OSBE 2004: 82). Në studimin e saj të 2004, ndër të tjera, OSBE del në rekomandimin se duhet të miratohen akte

²⁹ Autorët marrin në shqyrtim Slloveninë, Kroacinë dhe Malin e Zi.

³⁰ Sipas Plucknett “... the history of the legal profession is an important part of the history of the law ...” (Plucknett 1983: 332).

³¹ Në të njëjtat konkluzione për Poloninë arrin edhe SITARZ (SITARZ 2008: 923-924).

³² L. nr. 9109 datë 17.07.2003 “Për profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë” i hartuar në përputhje me Rekomandimet e Këshillit të Europës mbi Liritë e Ushtrimit të Profesionit të Avokatisë.

nënligjore me qëllim që të arrihet përputhshmëria e plotë me Rekomandimet e Këshillit të Europës për profesionin e Avokatisë.

Gjykatat kanë një rëndësi të veçantë në procesin e implementimit të reformave ligjore. Tranzicioni i ligjit në Shqipëri përkon edhe me tranzicionin e sistemit gjyqësor. Në vitet '90 u riorganizua sistemi gjyqësor³³ duke suprimuar gjykatat e fshatrave, lagjeve të qyteteve dhe qyteteve dhe u bënë ndryshime rrënjësore në të dy Kodet e Procedurës (Nuni 2009: 10) dhe këto ishin hapjet e para ligjore drejt një sistemi të ri, jo vetëm ligjor, por edhe shoqëror. Në analizën që OSBE bën mbi sistemin e drejtësisë në Shqipëri ngrihen disa probleme të mprehta jo vetëm nga ana ligjore, por edhe për sa i përket funksionimit të shtetit të së Drejtës në tërësi duke dalë në vitin 2004 me një numër rekomandimesh për çdo hallkë të sistemit ku vërejtjet më të rëndësishme janë bërë në lidhje me ekzekutimin e vendimeve, zyrën e përmbarimit, rolin e policisë gjyqësore ose pavarësinë e prokurorisë dhe të gjykatave. Rekomandimet për gjyqësorin reflektonin një analizë të thellë të reformës ligjore. Kishte nevojë për një transparencë më të madhe në ndarjen e gjyqeve midis gjyqtarëve dhe për publikimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta dhe jo vetëm të Gjykatës së Lartë.

Në analizën tonë nuk mund të lëmë pa përmendur edhe gjykatën e ligjeve, Gjykatën Kushtetuese, e cila është një nga aktorët kushtetues kryesorë në Shqipëri (OSBE 2004: 14-15). Në literaturë theksohet roli i gjykatave kushtetuese në tranzicionet e vendeve të Lindjes dhe rëndësia e tyre si "*veto-players*" në vendimmarrjet politike (Bugarcic 2001; Teitel 1997: 2032-2033, 2051 në vijim). Gjithsesi autori mendon se gjykatat duhet të kenë një rol më të vogël në zgjidhjen e problemeve politike dhe duhet të jenë më aktive në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, por thekson edhe faktin se rrallë herë Gjykatat kushtetuese kanë marrë vendime që çojnë drejt reformave të thella shoqërore pa pasur mbështetjen e duhur politike. Roli i Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri ka qenë vendimtar, sidomos mbas hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe rregullohet me ligj organik që prej vitit 2000³⁴.

Përfundime

Në vitet '90 u vërejt një superprodhim legjislativ, i domosdoshëm duke u nisur nga fakti se komplet korpusi legjislativ i prodhuar në 50 vjet diktaturë, ashtu si në çdo vend tjetër të bllokut komunist, ishte i papërshtatshëm për tu aplikuar në një shoqëri që kërkonte me ngulm të ndiqte parime diametralisht të kundërta. Në këto vite, pavarësisht nga ndihma e ndërkombëtarëve dhe punës që u bë për përshtatjen e tyre me realitetin shqiptar, ka pasur edhe mosarritje, që janë të

³³ L. 7383 datë 08.05.1990 dhe l. 7384 datë 08.05.1990. Fillimisht u bënë ndryshimet më të rëndësishme të cilat ishin të papajtueshme me Dispozitat e reja kushtetuese (l. Nr. 7491 i 29.04.1991) dhe një vit më vonë Dispozitat kushtetuese u amenduan për të implementuar reformën për riorganizimin e drejtësisë me l. 7561 datë 29.04.1992.

³⁴ L. 8577 datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë".

pashmangshme kur ndërmerr një iniciativë legislative të tillë. Duhet përmendur që në mini-tranzicionet që shoqëria shqiptare kaloi jo gjithmonë problemet e ligjvënies kanë qenë lineare dhe të njëjta në tranzicionin e ligjit në Shqipëri, ku shpesh herë përplasjet institucionale kanë sjellë përmirësim të legjislacionit. Sipas nesh, në ligjvënie mund të ndajmë 3 periudha në këto 20 vite tranzicion: 1990-1997 revolucionim i sistemit, 1997-2004 amendim i ligjeve të veçanta dhe periudha në vijim e cila përkon me një përmirësim në bazë të eksperiencës së krijuar. Sot Shqipëria është vend kandidat për në Bashkimin Europian, vend anëtar i NATO-s dhe pjesëmarrës aktiv në nivele të ndryshme të organizatave ndërkombëtare. Është e rëndësishme të shikohet edhe rruga e Shqipërisë drejt integritit europian, por kjo është një çështje që nuk e trajtojmë. Mund të themi, nisur nga disa konkluzione për integrimin e vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore³⁵ (White & et. al. 2002: 451-453), se Shqipëria në këto vite tranzicion ka pasur një impenjim të njëjtë si për integrimin në BE dhe për anëtarësimin në NATO. Këto kanë qenë synimet politike të shtetit shqiptar, të cilat pjesërisht janë arritur. Në fushën e legjislacionit Shqipëria ka bërë hapa përpara drejt zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit dhe unifikimit të korpusit ligjor me ligjin europian. Në kuadër të Bashkimit Europian mund të themi se prej kohësh flitet për një unifikim më të thellë edhe të vetë legjislacioneve të shteteve anëtare³⁶ por negociatat kanë mbetur akoma në nivel teknik. Ka shumë për të bërë ende por unifikimi i ligjit për një Europë të bashkuar është një nga kërkesat kryesore dhe domosdoshmërisht një nga objektivat më të rëndësishëm.

Duke parashikuar një integrim të Shqipërisë mendojmë se në këto vite tranzicioni legjislatori shqiptar ka përvetësuar një numër të pafund normash duke ndërtuar një sistem të plotë. Një ligj ose një kod që pretendon të krijojë uniformitet është i destinuar të aplikojë edhe rregulla që janë të panjohura në atë territor. Kostot e unifikimit janë të vogla në një realitet normativ si ai shqiptar. Nuk ka një normë kombëtare për tu mbrojtur ose një ndjenjë nacionalizmi të theksuar si në vende të tjera në tranzicion. Shqipëria e dalë nga tranzicioni duhet të jetë pararendëse në unifikim duke tentuar që të përvetësojë rregulla që janë të pranuar nga komuniteti ndërkombëtar dhe që ndihen si të drejta dhe jo të pranohen në mënyrë shtrënguese, pra rregulla të jashtme jo vetëm teknikisht të transferueshme por edhe politikisht dhe shoqërisht të pranueshme. Për të ndërtuar atë që quhet *Rule of Law* ka nevojë mbi të gjitha për të përshtatur një model demokratik të suksesshëm³⁷ që ka parasysh edhe veçoritë specifike të realitetit shqiptar.

Nuk pretendojmë që sistemi të jetë komplet, por shpresojmë që në këtë pikë të na vijë në ndihmë një klasë operatorësh e përgatitur. Pasi çdo sistem juridik, sado i mirë

³⁵ Autorët, duke studiuar 4 vende (Rep. Çeke, Bullgari, Ukrainë, Sllovakia) të Europës Qendrore dhe Lindore shikojnë se preferohej integrimi në BE kundrejt anëtarësimin në NATO, personat që favorizonin integrimin në BE ishin në favor edhe të anëtarësimin në NATO, kishte më pak dëshirë për përhapjen e NATO-s drejt lindjes sesa BE-së.

³⁶ Duke marrë nismën nga një mendim pozitiv i Parlamentit Europian për një Kod Civil Europian u mblodhën në Hagë ekspertët e vendeve anëtare më 29 shkurt 1997.

³⁷ Përshtatja nëpërmjet difuzionit dhe imitimit të modeleve më të mira ndërkombëtare (Magen 2009: 113).

të jetë, çelësin e suksesit e ka te figura e juristit i cili kur këshillon një individ, kur jep një vendim, kur përpilon një kontratë nuk kryen vetëm një akt konform me ligjin por modelon një sjellje njerëzore, drejton individin sipas një sjellje jodeviante dhe krijon bazat për evolucionin e ligjit.

Në përfundim shtojmë se një rol të rëndësishëm për të ardhmen duhet të luajë edhe doktrina. Në qoftë se ligji i tranzicionit ka qenë ligji i ekspertëve dhe i operatorëve, që kanë zgjidhur e përshtatur normat e reja me realitetin shqiptar, shpresojmë që ligji i post-tranzicionit të jetë ligji i akademikëve. Pra duhen më shumë kode të komentuar, më shumë monografi, vendime të komentuara, të cila do i japin një hop cilësor zhvillimeve juridike. Kjo do të ndihmonte edhe në atë çka është më fundamentale për një sistem drejtësie të shëndoshë, siguria juridike në rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet individëve.

Bibliografi

- Barbera, Augusto & Carlo Fusaro. 2010. *Corso di diritto pubblico*. Bologna: Il Mulino.
- Bugaric, Bojan. 2001. "Courts as Policy-Makers: Lessons from Transitiin", *Harvard International Law Journal* 42, 1: 247-288.
- Campesi, Giuseppe, Ivan Pupolizio & Nicola Riva (eds.). 2009. *Diritto e teoria sociale. Introduzione al pensiero socio-giuridico contemporaneo*. Roma: Carocci.
- Frankenberg, Gunter. 1997. "Stranger than Paradise: Identity and Politics in Comparative Law", *Utah Law Review* 2: 259-274.
- Galgano, Francesco, Franco Ferrari & Gianmaria Ajani. 2006. *Atlante di diritto privato comparato*. Bologna: Zanichelli.
- Gregoric, Aleksandra, Katarina Zajc & Marco Simoneti. 2007. "Market Response to Inefficient Judiciary: Promoting Rule Compliance and Good Governance Pracice", Department of International Economics and Management, CBS, Frederiksberg.
- Guglielmetti, Chiara. 2009. "Law and Economics: Origine e complessità dell'analisi economica del diritto", në Giuseppe Campesi, Ivan Pupolizio & Nicola Riva (eds.). *Diritto e teoria sociale. Introduzione al pensiero socio-giuridico contemporaneo*. Roma: Carocci.
- Henderson, Karen. 2000. "The Challenge of the EU Eastward Enlargement", *International Politics* 37, 1: 1-17.
- Hendley, Kathryn. 2006. "Assessing the Rule of Law in Russia", *Cardozo Journal of International and Comparative Law*, 14, 2: 347-391.
- Kondi, Thimio. 2009. "Roli i Gjykatës së Lartë për zgjidhjen e konflikteve për të drejtën e pronësisë", *Jus & Justicia* 3: 47-64.
- Krisafi, Ksenofon. 2009. "Paralele historike në zhvillimin e të drejtës së pronësisë sipas së drejtës zakonore iliro-shqiptare dhe të drejtës romake", *Jus & Justicia* 3: 23-33.
- Magen, Amichai. 2009. "The Rule of Law and Its Promotion Abroad: Three Problems of Scope", *Stanford Journal of International Law* 45, 1: 51-116.
- Nonet, Philippe & Philip Selznick. 1978. *Law and Society in Transition: Toward Responsive Law*. New York: Oktagon Books.

- Nuni, Ardian. 2009. "Kwadri ligjor për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit pas viteve '90", *Jus & Justicia* 3: 9-17.
- Luhmann, Niklas & Roberto De Giorgi. 1992. *Teoria della società*. Milano: Angeli.
- Luhmann, Niklas. 1984. *Soziale systeme. Grundriss einer allgemeinen Theorie*. Frankfurt am Main: Suhrkamp (përkth. *Sistemi sociali. Fondamenti di una teoria generale*. Bologna: Il Mulino, 1990.)
- Pearce, Russell G. & Samuel J. Levine. 2009. "Rethinking the Legal Reform Agenda: Will Raising the Standards of Bar Admission Promote or Undermine Democracy, Human Rights, and Rule of Law?", *Fordham Law Review* 77: 1635-1663.
- Peerenboom, Randall. 2003. "Social Networks, Civil Society, Democracy and the Rule of Law", Los Angeles School of Law, Research Paper No. 03-1.
- Plucknett, T.F.T. 1983. *Studies in English Legal History*. London: The Hambledon Press.
- OSBE. 2004. *Analizë e sistemit ligjor në Shqipëri*. Tiranë: OSCE.
- Rodotà, Stefano. 2006. *La vita e le regole. Tra diritto e non diritto*. Milano: Feltrinelli.
- Sacco, Rodolfo. 2007. *Antropologia giuridica: Contributo a una macrostoria del diritto*. Bologna: Il Mulino.
- Sarkin, Jeremy & Erin Daly. 2004. "Too Many Questions, Too Few Answers: Reconciliation in Transitional Societies", *Columbia Human Rights Law Review* 35, 3: 101-168.
- Sitarz, Julia. 2008. "Recent Changes to the Legal Professions of Central and Eastern Europe", *Connecticut Law Review*, 40, 3.
- Tarifa, Fatos, Ksenofon Krisafi & Ermira Danaj. 2009. "Globalizimi, të drejtat e njeriut dhe roli i sociologjisë publike", *Jus & Justicia* 3: 89-96.
- Teitel, Ruti G. 1997. "Transitional Jurisprudence: The Role of Law in Political Transformation", *Yale Law Journal* 106, 2009-2082.
- Tosini, Domenico. 2009. "Niklas Luhmann: il diritto nella teoria dei sistemi sociali", në Giuseppe Campesi, Ivan Pupilizio & Nicola Riva (eds.). *Diritto e teoria sociale. Introduzione al pensiero socio-giuridico contemporaneo*. Roma: Carocci.
- Travers, Max. 2010. *Understanding Law and Society*. Oxon: Routledge
- Trubek, David M. 2007. "The Nature of Law and Development: The Owl and the Pussy-Cat: Is There a Future for "Law and Development?"", *Wisconsin International Law Journal* 25, 2: 235-242.
- White, Stephen, Sarah Oates, Clelia Rontoyanni & Bill Miller. 2002. "Eastern Publics and Western Enlargement", në D. N. Nelson & L. Neack (eds.), *Global Society in Transition*. Kluwer Law International.

*Dilemat e munguara të procesit të integrimit evropian***

Klementin Mile*

Abstrakt

A mund të funksionojë paradigma modernizuese e Bashkimit Evropian? A mund të demokratizohet dhe zhvillohet ekonomikisht Shqipëria duke i imponuar parimet, konceptet, rregullat dhe standardet ligjore të Bashkimit Evropian? Një pasojë e dukshme e kësaj paradigme është zhvillimi i një politike pa vizion, e cila angazhohet të kryejë vetëm “detyrat e shtëpisë.” Në këtë mënyrë politika shqiptare është shndërruar nga “arti i së mundshmes” tek “shkenca e bindjes.” Për më tepër, problemit të deformimit të rolit të politikës i shtohet problemi i disfunkcionalitetit social të reformave evropianizuese. Këto probleme trajtohen nga këndvështrimi i sociologjisë së të drejtës dhe sociologjisë politike, duke u ndalur veçanërisht në konceptet që synojnë të përshkruajnë se si, pse, dhe me çfarë pasojash ndodh transferimi i së drejtës nga një sistem ligjor në një tjetër, të tilla si “transplant ligjor”, “kulturë ligjore”, “irritant ligjor”, dhe “luftërat e pallatit.” Konkluzioni është se problemi i deformimit të rolit të politikës dhe problemi i disfunkcionalitetit social të reformave evropianizuese lidhen pazgjidhshmërisht me konceptimin e tanishëm të procesit të integrimit evropian. Ky proces duhet të rikonceptohet në mënyrë dinamike për t’i dhënë një rol aktiv politikës, për t’i rikthyer vizionin që ka humbur me metaforën e “detyrave të shtëpisë”, dhe duhet të mos shihet më si një listë kostosh dhe përfitimesh, por si sfida dhe mundësi.

* Klementin Mile është lektor në Universitetin Evropian të Tiranës. Ka një MA nga Instituti Evropian i Sussex-it, Britani e Madhe. Ka mbaruar për Sociologji në Universitetin e Tiranës. Interesat e tij janë në fushat e sociologjisë politike, sociologjisë së të drejtës dhe teorive sociale.

** Ky punim është referuar në Konferencën Kombëtare “Shkenca Sociale dhe Shoqëria Shqiptare në Tranzicion”, organizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Politikave dhe Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin Evropian të Tiranës (UET), më 19 nëntor 2010.

Paradigma modernizuese e Bashkimit European

Që prej rënies së regjimit të komunist, Shqipëria është një vend i përfshirë në procesin e europianizimit. Si njëri nga vendet më të pazhvilluar ekonomikisht në Europë dhe me një traditë demokratike thuajse të munguar krejtësisht, Shqipëria përbën rastin ideal për ta trajtuar si një vend që ka nevojë për “busullën” e modernizimit. Megjithatë, rasti i Shqipërisë mund të trajtohet në një kontekst më të gjerë, pra mund të lidhet me idenë orientuese të Bashkimit Evropian, sipas të cilës, vendet që aspirojnë të anëtarësohen në BE duhet të modernizohen/europianizohen mjaftueshëm përpara se të pranohen. Në këtë kontekst, diskutimi në radhët e politikanëve, të gazetarëve, të konsulentëve dhe të grupeve të interesit në BE dhe në vendet aspirante, deri më tani është përqendruar te diferencat e mëdha zhvillimore (kryesisht ato që lidhen me treguesit ekonomik) ndërmjet vendeve të Bashkimit European dhe vendeve aspirante për t’u anëtarësuar në të. Si pasojë e këtij diskutimi, në skenë dalin *euroskeptikët* dhe *euroentuziastët*, *nacionalistët* dhe *kozmpolitët*, *konservatorët* dhe *liberalët*. Disa flasin për kosto të zgjerimit në kushtet e diferencave të mëdha zhvillimore, të tjerë për përfitime nga zgjerimi i tregut european, të tjerë akoma flasin për rritje të kriminalitetit dhe të papunësisë në vendet e BE-së, të tjerë për forcimin e sigurisë dhe për avantazhe strukturore.

Analiza që bëhet më shpesh është ajo që krahason zgjerimet e mëparshme të BE-së me zgjerimin e deklaruar drejt vendeve të Ballkanit Perëndimor. Euroentuziastët priren të shohin të përbashkëtat që kanë zgjerimet e mëparshme me zgjerimin (apo zgjerimet) e ardhshme, ndërsa euroskeptikët e vënë theksin te dallimet, duke i mëshuar faktit që Ballkani Perëndimor është shumë më i varfër dhe më i pazhvilluar se cilido shtet anëtar i BE-së dhe se, për këtë arsye, zgjerimi drejt tij pritet të sjellë probleme të mëdha për Unionin.

Të gjitha këto janë thënë dhe vazhdojnë të diskutohen në selitë e rëndësishme të BE-së, por edhe në ato të vendeve aspirante. Ka një konsensus të përgjithshëm se vendet aspirante duhen ndihmuar të zhvillohen para se të bëhen candidate të denja për të hyrë në BE, në mënyrë që kjo e fundit, të forcohet prej zgjerimit, sidomos në kontekstin e goditjeve që ka marrë monedha e përbashkët europiane nga kriza e ekonomisë greke, dhe parashikimet e zymta për zhvillime të ngjashme në Spanjë, në Portugali dhe Irlandë. Këto diskutime, sidoqoftë, kanë eklipsuar një çështje me rëndësi themelore, e cila lidhet me vetë paradigmen modernizuese të Bashkimit European. A mundet, në fakt, që vendet aspirante për t’u anëtarësuar në BE të demokratizohen dhe të zhvillohen ekonomikisht duke u imponuar parimet, konceptet, rregullat dhe standardet ligjore të Bashkimit European? Apo, ndoshta, korpusi ligjor gjigant i BE-së—*Acquis communautaire*—i cili duhet të adoptohet tërësisht nga cilido vend që synon të anëtarësohet në Bashkimi European, më shumë krijon probleme sesa zgjidhje për modernizimin e vendeve aspirante?

Politika e vendeve aspirante: Nga një “art i së mundshmes” te një “shkencë e bindjes”

Në rrugën e gjatë dhe të mundimshme drejt anëtarësimit në Bashkimin European, vendet aspirante marrin vlerësime dhe mesazhe inkurajuese nga institucionet e BE-së, në të cilat, ajo që bie më së shumti në sy, është se i gjithë faji për mosarritjen e standardeve europiane të paraqitura me detaje në *acquis communautaire* i atribuohet reformave të pamjaftueshme, kapaciteteve administrative të pazhvilluara, nepotizmit dhe politizimit të administratës publike, problemeve me sistemin gjyqësor, si edhe krimin të organizuar e korrupsionit. Në terma më abstrakte mund të thuhet se kemi të bëjmë me aplikimin e një *logjike identitare*, sipas së cilës, shkaku i mosarritjes të standardeve europiane duhet kërkuar ekskluzivisht në *moszbatimin e ligjit*. Por, aplikimi i një *logjike diferenciale* do të bënte të mundur zgjerimin e kësaj perspektive, duke përfshirë edhe atë që, raportet monitoruese të Bashkimit European deri më sot e kanë përjashtuar: *vetë ligjin konkret*, të konceptuar si një instrument që *mund jetë, ose mund të mos jetë i përshtatshëm* për të sjellë ndryshimet sociale të dëshiruara. Në këtë mënyrë, do të duhet të kalohej nga niveli abstrakt dhe imperativ i paradigmes modernizuese të BE-së, në nivelin konkret dhe analitik që merr parasysh traditën, nevojat dhe kapacitetet ekzistuese të shoqërisë që synohet të modernizohet.

Në mungesë të logjikës diferenciale, e cila është e aftë që t'i lidhë reformat e pamjaftueshme ekonomike dhe demokratike në vendet aspirante me problemin e diferencës ndërmjet ofertës ligjore të BE-së, nga njëra anë, dhe nevojave rregullatore të këtyre vendeve, nga ana tjetër, ligjërimi politik lokal përqendrohet vetëm në problemet e zbatimit të rekomandimeve ligjore të institucioneve europiane. Në këtë mënyrë, problemet e identifikuar në raportet monitoruese të BE-së tashmë zënë vend qendror në ligjërimin politik në vendet aspirante dhe shërbejnë mjaft mirë për të zhvilluar beteja elektorale mbi bazën e sukseseve dhe të dështimeve të evidentuara në raporte. Madje, duket se edhe vetë *legjitimiteti* i qeverive në këto vende “varet” më shumë prej raporteve të BE-së, sesa prej realizimit të premtimeve ndaj elektoratit që i ka zgjedhur ato.

Në rrethana të tilla, në gjuhën e politikanëve, të paktën në Shqipëri, flitet për “detyra shtëpie”, të cilat qeveria pretendon se i ka realizuar shumë mirë, ndërsa opozita shprehet se janë realizuar shumë keq, duke premtuar se, me ardhjen e saj në pushtet, ajo do t'i realizojë më mirë “detyrat” që kërkohen. Kjo qasje ngërthen probleme të shumta, që prej ridimensionimit të politikës nga “art i së mundshmes” në një “shkencë të bindjes”, e deri te humbja e kuptimit të përfaqësimit, pasi përfaqësuesit nuk artikulojnë më “vizionin” e zhvillimit të vendit, por janë thjesht dhe vetëm “nxënës” që i zbatojnë mirë ose keq detyrat që u ngarkohen nga të tjerë.

Të gjitha këto probleme e bëjnë të domosdoshme t'i referohemi literaturës së zhvilluar përgjatë disa dekadave nga komparativistët, sociologët, antropologët dhe historianët e së drejtës. Konceptet e zhvilluara prej tyre, si “transplant ligjor”, “kulturë ligjore”, “irritant ligjor” dhe “luftërat e pallatit”, përshkruajnë sesi ndodh përshtatja ligjore ose transferimi i së drejtës nga një sistem ligjor në një tjetër, por synojnë të shpjegojnë se përse disa përshtatje ligjore janë të suksesshme, ndërsa të tjera jo.

Përpara se të vijoj më tej, më duhet të trajtoj disa çështje *metodologjike* të studimit të së drejtës. Kjo kërkon t'u jepen përgjigje dy pyetjeve të rëndësishme: (1) A mund të studiohet si duhet e drejta nga këndvështrimi i disiplinave të tjera? (2) A ka ndonjë këndvështrim të privilegjuar?

Përse idetë ligjore duhet të interpretohen sociologjikisht?

Shpesh herë thuhet se e drejta ka mënyrën e vet për të parë botën dhe se, për këtë arsye, është e pamundur të studiohet nga jashtë, ose pavarësisht profesionit të juristit. Ajo çka supozohet është se e drejta (si objekt studimi) deformohet kur studiohet nga këndvështrimi i ndonjë discipline tjetër, për shembull, nga ai i filozofisë, i shkencës politike ose sociologjisë së të drejtës. Pretendimi që ngrihet është se futja e stileve të ndryshme të arsyetimit mund të ketë pasoja të dëmshme për praktikën ligjore, duke e keqkuptuar dhe, rrjedhimisht, duke e kërcënuar integritetin e proceseve ligjore ose të vlerave që mishërojnë ato (Nelken 1998). Në këtë mënyrë, mund të përfundojmë me një të drejtë të krijuar sipas imazhit të filozofisë, të shkencës politike, ose sociologjisë, por analiza jonë nuk do të jetë e saktë—dhe rekomandimet tona nuk do të jenë funksionale—pasi, në realitet, e drejta gjithmonë do të zhvillohet ndryshe nga parashikimi ynë dhe do të ketë probleme të tjera, të cilat nuk janë marrë fare në konsideratë kur kemi formuluar rekomandimet.

I gjithë ky argumentim do të ishte bindës dhe do të duhej që, çështjet që lidhen me të drejtën, t'ua linim ekskluzivisht juristëve dhe ligjvënësve, nëse do të qëndronte premisa, sipas së cilës, e drejta ka një këndvështrim të vetin për të parë botën. Jack Balkin, sidoqoftë, argumenton se e drejta pushtohet lehtësisht nga disiplinat e tjera, për shembull, nga ekonomia, nga historia, filozofia, teoria politike dhe teoria letrare. Ai vë në dukje se kjo ndodh ngaqë e drejta nuk është aq shumë një disiplinë *akademike* sesa është një disiplinë *profesionale*. E drejta, sipas tij, nuk ka një metodologji të vetën; ajo i huazon metodologjitë nga të gjitha ato disiplina që mund t'ia ofrojnë. Nga ana tjetër, për shkak se e drejta mësohet në mjedise që nuk janë asnjëherë larg kërkesave profesionale të praktikës ligjore, ajo nuk mund të gëlltitet tërësisht nga ndonjëra prej këtyre disiplinave. Fokusi *profesional* i së drejtës kompenson mungesën e një fokusi tërësisht *intelektual* (Balkin 1996).

Autorë të tjerë, të cilët i përkasin shkollës së pluralizmit ligjor, e shohin të drejtën si një diskurs specifik që ekziston në prani të diskurseve të tjera, për shembull, të diskursit politik, atij ekonomik, shkencor etj (Luhmann 2004; Teubner 1997; Santos 1987). Këta autorë nuk e vënë theksin te diversiteti potencial i diskurseve ligjore të juristëve të veçantë në gjykata të veçanta, ose i aktorëve politikë të veçantë që kërkojnë të realizojnë interesat, ose vlerat e tyre të veçanta. Në një kuptim abstrakt, e drejta paraqitet si një mënyrë kuptimi e unifikuar, kohezive, si një këndvështrim i dallueshëm, ose si një stil specifik i arsyetimit dhe i interpretimit. Kjo është premisa nga niset edhe Roger Cotterrell (1998) për të argumentuar se idetë ligjore jo vetëm që *mund* të interpretohen sociologjikisht, por, në fakt, ato *duhet* të interpretohen sociologjikisht. Sipas tij, idetë ligjore dhe idetë e tjera sociale penetrojnë njëra-tjetrën.

E drejta konstituon aspekte të rëndësishme të jetës sociale, duke u dhënë formë, ose duke përforcuar mënyrat e kuptimit të realitetit social. Perspektiva sociologjike mundëson vëzhgimin dhe kuptimin e kësaj pasoje të diskurseve ligjore, si edhe vendosjen e saj në raport me pasojat sociale të ideve dhe të praktikave të llojeve të tjera. E drejta, argumenton Cotterrell (ibid), e konstituon shoqërinë përderisa edhe ajo vetë është një aspekt i shoqërisë, një kuadër dhe një shprehje e kuptimeve që mundësojnë ekzistencën e shoqërisë. Perspektiva sociologjike për çështjet ligjore është, pra, e nevojshme për të kuptuar dhe për të analizuar forcën morale dhe intelektuale të së drejtës, dhe kjo është mënyra e vetme për t'i kuptuar si duhet idetë ligjore.

Kuptimi sociologjik i ideve ligjore është kuptim *ndërdisciplinor*. Megjithatë, emërtimi “sociologjik” është përdorur saktësisht, për shkak se procesi i të kuptuarit në mënyrë konsistente dhe të përhershme i referohet nevojës për ta riinterpretuar të drejtën *sistematikisht* dhe *empirikisht*, si një fenomen *social*. Kuptimi sociologjik është njëkohësisht brenda dhe jashtë ideve ligjore. Vetëm në këtë mënyrë është e mundur që e drejta të interpretohet si duhet, pa e deformuar atë gjatë interpretimit.

Thelbi i interpretimit sociologjik të ideve ligjore lidhet me tre postulate. Së pari, e drejta duhet parë si një fenomen tërësisht *social*. Kjo do të thotë se e drejta, si përvojë, duhet kuptuar si një aspekt i raporteve sociale në përgjithësi, si tërësisht e lidhur me bashkekzistencën e individëve në grupe sociale. Së dyti, fenomenet sociale të së drejtës duhen kuptuar *empirikisht*, nëpërmjet shqyrtimit të hollësishtëm të variacionit dhe të vazhdimësisë së modeleve historike konkrete të bashkekzistencës sociale, dhe jo duke iu referuar kushteve sociale të idealizuara, ose të imagjinuara në mënyrë abstrakte. Së treti, ato duhen kuptuar *sistematikisht*, jo në mënyrë anekdotike, ose emocionale. Qëllimi është zgjerimi i kuptimit nga niveli specifik, në nivelin e përgjithshëm. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që të vlerësohet rëndësia e veçantive në një perspektivë më të gjerë, të vendoset kompleksiteti i unikes në një kontekst teorik më të gjerë dhe, *ipso facto*, të orientohet interpretimi i tij (Cotterrell 1998).

Këndvështrimi sociologjik është *kritik*, sepse ai insiston që perspektivat ligjore të shumë prej pjesëmarrësve në sistemin ligjor, qofshin këta juristë ose jo, nuk janë *sa duhet* sistematike dhe të informuara teorikisht, ose të ndjeshme ndaj variacionit empirik, dhe kanë një ndërgjegjësim *shumë të kufizuar* për karakterin social të së drejtës. Por ai është, gjithashtu, *konstruktiv*, sepse nuk mundet thjesht t'i dënojë idetë ligjore ekzistuese pa shtruar vazhdimisht pyetjen sesi mund të *riinterpretohet* dhe, rrjedhimisht, të *riimagjinohet* dhe *rimodelohet* e drejta në një mënyrë që ajo të jetë konsistente me karakterin social të saj, kur kuptohet më mirë prej një perspektive sociologjike më të gjerë.

Transferimi i së drejtës dhe kultura ligjore

Europa vlerëson diversitetin, ndërvarësinë, dinjitetin, autonominë dhe solidaritetin (Cotterrell 2007). Këto janë vlerat kryesore që Bashkimi European synon t'i shtrijë në të gjithë hapësirën e shteteve anëtare dhe në atë të vendeve që synojnë t'i bashkohen BE-së. Këto vlera mund të jenë vërtet të dëshirueshme dhe, në parim, mund të jenë baza e duhur për modernizimin e shoqërisë.

Por aplikimi i tyre në shoqëritë e vendeve anëtare dhe atyre aspirante për anëtarësim në BE synohet të realizohet nëpërmjet *transferimit* të ligjeve, të institucioneve, të konventave, të standardeve dhe të rregulloreve të BE-së drejt këtyre shoqërive. Ajo që një mekanizëm i transferimit të së drejtës mendohet se mund të realizojë është që e drejta të *mund* të eksportohet në një shoqëri të caktuar pa vështirësi dhe se ky transferim mund të jetë *i suksesshëm*.

Por ky supozim është problematik, pasi ai injoron tërësisht konceptin e *kulturës ligjore*. Ky koncept është përdorur për herë të parë nga sociologu i së drejtës, Lawrence Friedman, në fund të viteve 1960. Sipas tij, kultura ligjore ka të bëjë me atë çfarë njerëzit mendojnë për të drejtën, juristët dhe rendin ligjor, dhe i referohet ideve, qëndrimeve, opinioneve dhe pritshmërive ndaj sistemit ligjor (Friedman 2006). Sipas këtij autori, ajo që mungon më tepër është informacioni për kulturën ligjore, që do të thotë t'i japësh përgjigje pyetjeve të tilla si: Cilat janë qëndrimet e popullsisë të ndryshme ndaj së drejtës dhe sistemit ligjor? Kush shkon në gjykatë dhe pse? Kush i kryen rolet ligjore të juristit, të gjykatësit, të policit dhe çfarë bëjnë këta performues rolesh? Si dhe nga kush merren në shqyrtim kërkesat në sistemin ligjor dhe si merren vendimet? Cilët zyrtarë gëzojnë të drejtën e diskrecionit dhe cilët jo? A ka pjesë të ndryshme të sistemit ligjor që janë burokratike ose fleksibël? Cilat janë pasojat e rezultateve për popullatën dhe si mund të maten ato? Cili është burimi i legjitimitetit të elementeve të ndryshme të sistemit? Kush supozohet të vendosë ligjin dhe kush supozohet ta zbatojë atë? A ka shumë korrupsion dhe keqadministrim, dhe pse? (Friedman 1969). Përveç përkufizimit të kulturës ligjore, Friedman bën dallimin midis asaj që ai e cilëson kulturë ligjore “e brendshme” dhe asaj që e quan kulturë ligjore “jashtme”. E para i referohet rolit që kanë profesionistët ligjorë në qëndrimin ndaj së drejtës; e dyta i referohet veçanërisht atyre individëve, ose grupeve që ushtrojnë presion ndaj së drejtës për të sjellë ndryshime sociale (Nelken 2006).

Debati ndërmjet kulturalistëve dhe komparativistëve

Si mund të kontribuojë sociologjia e së drejtës në studimet krahasuese të së drejtës? Cotterrell është i mendimit se sociologjia e së drejtës mund të qartësojë natyrën e sociale, mjediset kontekstuale të së drejtës dhe institucioneve ligjore, të cilat pastaj mund të krahasohen. Por, fillimisht duhen marrë në konsideratë drejtimit kryesore të së drejtës së krahasuar, si një bazë për të shqyrtuar se çfarë mund t'u ofrojë sociologjia e së drejtës komparativistëve ligjorë (Cotterrell 2003). David Nelken ngre një sërë çështjesh të tjera, të cilat meritojnë të shqyrtohen me kujdes. Ai pyet: Sa e mundur është që të kuptohet e drejta e popujve të tjerë? Çfarë mund të bëhet për të garantuar se do të transferohet vetëm e drejta që “përshtatet” në mjedisin e ri? Në ç'mënyrë po ndikohen proceset e transferimit ligjor nga zhvillimet e mëdha politike, ekonomike dhe sociale të botës së sotme? (Nelken 2003).

Sot zhvillohet një debat i nxehtë ndërmjet *kulturalistëve* dhe *komparativistëve*, i cili duket se e ka zanafillën pikërisht me dallimin e bërë nga Friedman midis kulturës ligjore të brendshme dhe asaj të jashtme. Ndërsa komparativistët, si Alan Watson

dhe William Ewald, e vënë theksin te kultura ligjore e brendshme, kulturalistët, ndër ta sidomos Pierre Legrand, vënë në dukje rolin e kulturës së jashtme, madje duke shkuar deri aty sa të mohojnë mundësinë e transplantit ligjor (Legrand 2001).

Komparativistët mendojnë se transferimi i së drejtës ndërmjet sistemeve ligjore të ndryshme është një proces relativisht i thjeshtë dhe i suksesshëm. Nëse ligjberësit kanë vullnetin dhe aftësitë, ata thjesht mund të zgjedhin të huazojnë ligje dhe institucione ligjore nga sistemet ligjore më prestigjioze dhe më të sofistikuar teknikisht. Watson, fjala vjen, argumenton se zhvillimi ligjor mund të shpjegohet parimisht me anë të transplantimit të rregullave nga një sistem ligjor, në një tjetër. Gjithashtu, sipas tij, nuk janë domosdoshmërisht nevojat sociale ato që sjellin zhvillime ligjore. Për këtë arsye, ligjet që nuk i shërbejnë plotësisht të ndonjë nevojë sociale mbijetojnë (të pandryshuar) për breza të tërë dhe, ndonjëherë, edhe përgjatë disa shekujve. Mekanizmat e ndryshimit ligjor kontrollohen nga elitat profesionale ligjore—nga legjislatorët, nga hartuesit e kodeve, gjykatësit dhe juristët. Kjo, argumenton Friedman, do të thotë se për ndryshimin ligjor ka rëndësi vetëm kultura ligjore e brendshme. Watson është, gjithashtu, i bindur se rregullat ligjore i rezistojnë ndryshimit për periudha të gjata kohore, pavarësisht faktit që konteksti social ku ato aplikohen mund të ketë pësuar ndryshime të mëdha (Cotterrell 2006: 109-110).

Pas debatit që shkaktuan tezat e paraqitura nga Alan Watson, William Ewald mori përsipër të sqarojë se pretendimi i Watson- it nuk është se e drejta është autonome dhe e shkëputur nga problemet dhe nevojat e shoqërisë, por se vendimtare për zhvillimin e së drejtës janë vlerat, idetë, historitë dhe teknikat intelektuale të juristëve. Shpeshherë, juristët as nuk e dinë, as nuk duan ta dinë se cilat do të jenë pasojat e transplantimit të së drejtës. Ajo që ka rëndësi për ta është vetëm autoriteti dhe prestigji i burimit të së drejtës (Nelken 2001). Kjo, siç vë në dukje Watson, bëhet e mundur sepse në shumicën e fushave të së drejtës, dhe veçanërisht në të drejtën private, në pjesën më të madhe të rrethanave politike dhe ekonomike pushtetarët nuk kanë interes të përcaktojnë se cilat janë, ose cilat duhet të jenë rregullat ligjore, për aq kohë sa kjo situatë është me përfitim për ta dhe rendi publik nuk tronditet (Watson 1991: 97). Arsyeja për të transplantuar të drejtën nga një sistem ligjor tjetër lidhet me faktin se është më e lehtë të transplantosh sesa të krijosh rregulla dhe institucione të reja nga e para. Arsyeja e dytë, dhe më e rëndësishme, lidhet me nevojën për autoritet. Kur tradita ligjore e një vendi nuk arrin të sigurojë autoritetin e së drejtës, atëherë gjykatësit dhe juristët përdorin metodën e transplantimit ligjor (Watson 2004).

Kulturalistët, nga ana e tyre, e vënë theksin te kultura ligjore e jashtme, që i kapërcen opinionet dhe qëndrimet e elitës profesionale të juristëve dhe të ligjvënësve. Këndvështrimi i kulturalistëve është se huazimi ligjor nga sistemet e tjera është një çështje e vështirë dhe shpeshherë e pamundur. Kjo për arsye se një kulturë ligjore nuk mund të zëvendësohet lehtësisht nga një tjetër, ndërkohë që *rregullat ligjore mund të kuptohen vetëm në kontekstin e kulturës ligjore*. Kështu, rregullat ligjore të transplantuara në një kulturë ligjore krejt të ndryshme nga kultura prej së cilës janë huazuar, fare mirë mund të thuhet se ekzistojnë vetëm nominalisht, “në letër”, por nuk kuptohen dhe nuk respektohen nga individët dhe, natyrisht, as që pritet që ato të zbatohen, pavarësisht sanksioneve që mund të vendosen.

Pierre Legrand argumenton se kultura zë një vend të ndërmjetëm, midis asaj që është e përbashkët për të gjitha qeniet njerëzore dhe asaj që është unike për secilin individ. Kultura, sipas tij, ka të bëjë me tipare që nuk janë universale, por që, nga ana tjetër, shkojnë përtej individit. A ka të bëjë me programe mendore kolektive, që nuk janë formuar për shkak se ne, të gjithë, jetojmë në këtë planet, ose për shkak se secili nga ne është unik, veçse si një funksion i komunitetit që i përkasim (Legrand 1996). Kështu, një rregull ligjor është një formë që përfshin elemente kulturore. Ashtu sikurse kultura, edhe rregullat janë burime të identitetit, edhe rregullat janë burime të identitetit. Rregullat ndihmojnë për të vendosur një identitet ligjor dhe politik përmes kodimit të përvojave. Duke qenë se rregullat nuk janë veçse një manifestim i jashtëm i një strukture implicite qëndrimi dhe reference, ato reflektojnë një kulturë ligjore të caktuar.

Rregullat ligjore nuk janë kurrë reflektim i ndonjë rendi natyror. Ato janë prodhuar nga njerëzit nëpërmjet strukturave institucionale dhe proceseve ligjore. Rrjedhimisht, ato përmbajnë pashmangshmërisht një komponent social dhe nuk mund të jenë të çliruara, ose neutrale në raport me *vlerat*. Pohimet ligjore marrin statusin e “rregullave” vetëm nëse ato gjenerohen dhe zbatohen në përputhje me marrëveshje të arritura më parë lidhur me përshtatshmërinë e politikave të veçanta, me vlerën e teknikave të caktuara të ndërhyrjes, të procedurave miratuese, të proceseve rivlerësuese etj. Nga ana tjetër, këto marrëveshje janë rrjedhojë sociale e negociimeve dhe e rinegociimeve të vazhdueshme ndërmjet organeve ligjore relevante, të përbërë nga individë të përcaktuar kulturalisht. Në këtë kuptim, në çdo rregull ekziston një dimension *socio-kulturor*, i cili edhe pse jo gjithmonë është i lehtë të shquhet, është, sidoqoftë, pjesë e pandashme e rregullave ligjore (Legrand 1996).

Roli i kulturës ligjore është kaq i rëndësishëm, saqë çdo përpjekje e qëllimshme për të ndryshuar kulturën ligjore të një shoqërie nxjerr në pah diferencat ndërmjet kulturës ligjore ku duhet të ndodhë përshtatja, dhe kulturës ligjore prej së cilës është marrë modeli (Nelken 2001). Në të gjitha rastet, Legrand nënkupton kulturën ligjore të jashtme dhe jo idetë dhe praktikatat e profesionistëve të së drejtës. Kulturalistët, si Legrand, janë kundër të gjitha ideve për të standardizuar sistemet ligjore në Europë. Konkretisht, ky autor është shprehur kundër një Kodi Civil Europian, iniciativë të cilën ai e sheh si një goditje ndaj pluralitetit ligjor të Europës. Ai e kritikon një kod të tillë edhe për arrogancën e nënkuptuar, pasi ideja e një Kodi Civil Europian presupozon se botëkuptimi kontinental është superior ndaj atij anglo-sakson. Një kod i tillë, sipas Legrand, përbën një kthimi pas në kohën kur vlerësohej autoriteti politik i centralizuar dhe e vërteta formale.

“Irritantët” ligjorë

Sipas Gunther Teubner, debati ndërmjet komparativistëve dhe kulturalistëve, duke qenë se përqendrohet te koncepti i transplantit ligjor, na vë pashmangshmërisht përpara alternativës së mohimit, ose të integritetit të së drejtës së transplantuar nga një sistem ligjor në një tjetër. Teubner, në fakt, mendon se ajo që ndodh nuk mund të përshkruhet si duhet me anë të konceptit të transplantit. Kur një rregull i

huaj imponohet në kulturën vendase, ai nuk transplantohet në një organizëm tjetër, por funksionon si element irritues që bën të ndodhin ngjarje të reja dhe të papritura. Rregulli ligjor i imponuar irriton mendjet dhe emocionet e juristëve që respektojnë traditën. Por, në një kuptim edhe më real të fjalës, ai irriton ato që Teubner i quan “marrëveshjet e detyrueshme” të së drejtës. Rregullim ligjor i imponuar vepron si një lloj “zhurme” e jashtme që krijon irritime të mëdha në botën e diskursit ligjor, duke e detyruar sistemin ligjor të rindërtojë jo vetëm rregullat ekzistues, por ta rindërtojë nga e para edhe vetë rregullin ligjor që është imponuar. Irritantët ligjorë, argumenton Teubner (1998) nuk mund të transformohen nga një formë e huaj në një formë familjare, dhe as mund të përshtaten në një kontekst kulturor të ri. Përkundrazi, ata vënë në lëvizje procese dinamike dhe evolutive, gjatë të cilave, kuptimi i rregullit të huaj rindërtohet, ndërsa konteksti i brendshëm pëson ndryshime rrënjësore.

Me anë të këtij koncepti, Teubner përpiket të integrojë pozicionet konfliktuale ndërmjet komparativistëve dhe kulturalistëve, duke pranuar pjesërisht rolin e kulturës ligjore në transferimin e së drejtës dhe, nga ana tjetër, duke vënë në dukje autonominë e sistemit ligjor të përfaqësuar nga elita profesionale e juristëve dhe ligjvënësve, për të rindërtuar rregullat ose institucionet ligjore të importuara nga një sistem ligjor i huaj. Ndryshe nga kulturalistët, Teubner është i mendimit se, në botën e sotme nuk duhet të konstatojmë vetëm fragmentimin e shoqërisë globale në një *polikulturalizëm ligjor*, por duhet të marrim parasysh edhe dallimet e thella ndërmjet diskurseve të ndryshme të shoqërisë (Teubner 1998). Kështu, *diskursi ligjor* është lehtësisht i dallueshëm nga *diskursi social*, qoftë ky politik, ekonomik, moral, fetar ose kulturor. Ndryshe nga Montesquieu, tani nuk mund të pretendohet më që ligjet janë shprehje e shpirtit të kombeve dhe të rrënjësura thellë—dhe në mënyrë të pandashme—në specifikat e tyre gjeografike, zakonore dhe politike.

Teubner zhvillon katër teza mbi lidhjet e së drejtës me shoqërinë dhe kulturën kombëtare, të cilat ndihmojnë për ta vendosur çështjen e mundësisë dhe efektivitetit të transplanteve ligjore në një perspektivë të re. Së pari, *lidhjet e së drejtës bashkëkohore me shoqërinë nuk janë më gjithëpërfshirëse, por janë shumë selektive dhe variojnë nga lidhjet e dobëta deri te lidhjet e pazgjidhshme*. Duke qenë se prodhimi i rregullave ligjore në shoqëritë e sotme është institucionalisht i ndarë nga prodhimi i normave kulturore, fusha të tëra të së drejtës janë në kontakte të dobëta dhe josistematike me *proceset sociale*. Përveç këtyre hapësirave, ku lidhja midis së drejtës dhe kulturës është e dobët, ka edhe fusha, në të cilat proceset ligjore dhe sociale kanë krijuar lidhje të forta. Rrjedhimisht, në ato fusha të së drejtës ku lidhjet me proceset sociale janë të dobëta, transferimi i së drejtës nga një sistem ligjor në një tjetër është përgjithësisht i lehtë për t’u realizuar, ndërkohë që rezistenca ndaj ndryshimit është e madhe kur e drejta është e lidhur ngushtë me proceset e tjera sociale.

Së dyti, *lidhjet e së drejtës me shoqërinë nuk kanë të bëjnë më me totalitetin e sociale, por me fragmente të ndryshme të shoqërisë*. Diskursi ligjor bashkëkohor nuk është më shprehje e shoqërisë dhe kulturës në terma absolute, por është i lidhur ngushtë vetëm me disa prej fushave, vetëm në raste specifike, dhe vetëm me fragmente të ndryshme të shoqërisë. Në fakt, disa institucione ligjore janë të lidhura pazgjidhshmërisht me

kulturën politike të një shoqërie, aq sa transferimi i tyre në një shoqëri tjetër do të kërkonte njëkohësisht ndryshime rrënjësore të vetë sistemit politik, në mënyrë që këto institucione ligjore të funksiononin si duhet në mjedisin e ri. Sidoqoftë, ka institucione të tjera ligjore, veçanërisht ato të së drejtës private, të cilat nuk kanë lidhje të forta me politikën, por janë të lidhura ngushtë me proceset ekonomike. Ndërkohë që të tjera institucione ligjore janë të lidhura ngushtë me zhvillimin teknologjik, shëndetësor, me shkencën ose me kulturën. Duke parë lidhjet e ngushta me botë sociale të ndryshme, mund të kuptohet se pse institucionet ligjore, në mënyra të ndryshme, i rezistojnë transferimit në një ambient të ri ligjor.

Së treti, *ndërsa më parë e drejta lidhej me shoqërinë duke u identifikuar me të, tani lidhjet e së drejtës me shoqërinë vendosen nëpërmjet diferencës*. Mbi të gjitha, pavarësisht liberalizimit të tregjeve botërore dhe krijimit ligjor të Tregut të Përbashkët European, në 30 vitet e fundit është parë se kapitalizmi i avancuar mund të aplikohet në forma të ndryshme.¹ Po ashtu, janë rritur dallimet ndërmjet regjimeve prodhuese, me të cilat Teubner kupton mjedisin institucional të veprimit ekonomik, thënë ndryshe “rregullat e lojës” ekonomike, që përcaktojnë një kuadër incentivash dhe kushtëzimesh nëpërmjet institucioneve të lidhura me tregun. Varietetet e kapitalizmit janë pikërisht rezultat i regjimeve të prodhimit.

Së katërti, *lidhjet e së drejtës me shoqërinë nuk evoluojnë më përgjatë një zhvillimi historik të përbashkët, por nëpërmjet një raporti konfliktual ndërmjet dy ose më shumë trajektoreve evolutive të pavarura*. Kjo do të thotë se transferimi i rregullave ose i institucioneve ligjore është mjaft i vështirë dhe me shanse të pakta suksesi, për shkak se rregullat dhe institucionet ligjore kanë një karakter të dyfishtë. Ato janë rregulla dhe institucione *ligjore*, por në të njëjtën kohë janë edhe rregulla dhe institucione *ekonomike*, ose në raste të tjera *politike, morale* e kështu me radhë. Rrjedhimisht, suksesi i transferimit të së drejtës nga një sistem ligjor në një tjetër nuk varet vetëm nga ngjashmëria e sistemeve ligjore në fjalë por, edhe më shumë akoma, nga kushtet e ngjashme ekonomike, politike ose morale të shoqërisë. Në këtë mënyrë, projektet modernizuese, në përgjithësi, dhe ato të stilit european në veçanti, duhet të marrin parasysh nevojën për një transformim të dyfishtë, pra jo vetëm rikontekstualizimin e *dimensionit ligjor* të reformës në sistemin ligjor ku është bërë ose do të bëhet transferimi i së drejtës, por edhe rikontekstualizimin e *dimensionit social* të reformës në mjedisin e ri (Teubner 1998).

Luftërat e pallatit

Antropologët e së drejtës na ofrojnë metaforën e “luftërave të pallatit” për të plotësuar kuadrin shpjegues të suksesit të disa transferimeve të së drejtës dhe dështimin e të tjerave. Megjithatë, duhet mbajtur parasysh se, kur flasim

¹ Shih Chung & Hamilton (2001), të cilët shtjellojnë idenë mbi të ashtuquajturin kapitalizëm “Guanxi” që praktikohet në Kinë. Ky lloj kapitalizmi, ndryshe nga kapitalizmi perëndimor, nuk bazohet në kuadrin ligjor për rregullimin e raporteve ndërmjet agjentëve ekonomikë, por në rregullat e kulturës kineze, të cilat priren t’i personalizojnë transaksionet dhe t’i zhvillojnë ato mbi bazën e besimit të ndërsjellët.

për sukses dhe dështim, disa autorë nuk marrin në konsideratë çështje të tilla si, funksionaliteti i së drejtës së transferuar, reagimi i popullsisë ndaj ndryshimeve ligjore të transplantuara, ose integrimi i këtyre ndryshimeve me sistemin ligjor ekzistues. Antropologët e së drejtës si Ives Dezalay dhe Bryant Garth (2001) e konsiderojnë të suksesshëm transferimin e së drejtës nga një sistem ligjor, në një tjetër, kur ky transferim ndodh dhe konsolidohet. Ata synojnë të zbulojnë faktorët dhe motivet që e bëjnë të mundur këtë gjë. Sipas tyre, individët dhe grupet në veri dhe në jug, në qendër dhe në periferi, luftojnë për pushtet dhe për influencë duke ndjekur strategji ndërkombëtare. Por, strategjitë ndërkombëtare janë, *para së gjithash*, strategji kombëtare. Ato shërbejnë për të forcuar pozitat e grupeve të caktuara brenda vendeve përkatëse, si në vendet prej nga e ka zanafillën transferimi i së drejtës, ashtu dhe në vendet ku ajo transferohet (Dezalay & Garth 2001). Kështu mund të thuhet se reformat ligjore në një vend iniciohen për arsye që *nuk* janë ligjore, që *nuk* lidhen me zhvillimin normal të sistemit ligjor dhe *nuk* i përgjigjen nevojave të evidentuara të së drejtës vendase. Përkundrazi, në këtë rast, transferimi i së drejtës bëhet thjesht një mjet më shumë për të forcuar pozitat politike ose për të rritur prestigjin e elitave të caktuara. Dezalay dhe Garth insistojnë se fenomeni i transplanteve ligjore varet domosdoshmërisht nga struktura e fushës së pushtetit shtetëror ku kryhen ato. Në këtë mënyrë, antropologjia e së drejtës na fton të shqyrtojmë si strukturat, ashtu edhe proceset që sfidojnë dhe transformojnë këto struktura. Në vend që të mendojmë për “kulturën” ose “strukturën” në vetvete, këta autorë na thonë se ne duhet të përqijemi të përdorim një qasje strukturore, e cila vëzhgon sesi strategjitë ndërkombëtare aplikohen dhe transformojnë strukturat lokale.

Përfundime: Për një rikonceptim të integritit europian të Shqipërisë

Procesi i integritit europian të Shqipërisë meriton vëmendje teorike të posaçme, duke qenë se, në terma financiare, kohore dhe të burimeve njerëzore të angazhuara në të, është pa dyshim procesi më i madh në të cilin ndodhet vendi ynë. Procesi i integritit është një objekt i përshtatshëm për t’u studiuar nga sociologjia e së drejtës dhe sociologjia politike, sepse ai zhvillohet nëpërmjet reformave ligjore dhe vendimmarrjes politike për to. Siç është përmendur më sipër, mënyra e konceptimit të procesit të integritit europian e ka kthyer politikën shqiptare nga një “art i së mundshmes”, në një “shkencë të bindjes”, gjë që e ka goditur rëndë legjitimitetin e klasës politike shqiptare dhe besimin e elektoratit për ndryshime pozitive në vend. Këtë diagnozë, nga perspektiva e sociologjisë politike, na duhet ta suplementojmë me një tjetër, nga perspektiva e sociologjisë së të drejtës. Procesi i integritit europian deri tani është zhvilluar në mënyrë krejtësisht *disfunzionale*. Reformat ligjore të ndërmarra në sektorë të ndryshëm të shoqërisë me synimin e deklaruar për ta na sjellë më pranë standardeve europiane, në shumë raste kanë pasur efekt të kundërt, duke i lënë këta sektorë po aq të pazhvilluar sa edhe më parë, madje në disa raste duke krijuar më shumë probleme, ose probleme të reja.

Problemi kryesor me procesin e integritit europian të Shqipërisë është se ai

konceptohet në mënyrë *statike*. Nuk është vetëm metafora e “detyrave të shtëpisë” ajo që e tregon këtë, por edhe konceptimi i procesit si një listë kostosh dhe përfitimesh. Në një proces, për nga vetë natyra dinamike e tij, nuk ka as kosto dhe as përfitime të sigurta. Aq më tepër po të mendosh se, në procesin e integritit europian implikohen interesa të shumta e të shumëllojshme, si nga pala europiane, ashtu dhe nga ajo shqiptare. Koncepti i “luftërave të pallatit” gjen këtu aplikimin e tij por, po ashtu, mund të sjellim ndërmend efektet e paparashikueshme të “irritantëve ligjorë”.

Një konceptim dinamik i procesit të integritit europian të Shqipërisë ka nevojë për terminologji tjetër. Nisur nga premisa se, përgjatë zhvillimit të procesit, *kostot* nuk janë të sigurta, ato duhen kuptuar si *sfida*. Duke përdorur të njëjtin argument, edhe *përfitimet* duhen kuptuar si *mundësi*. Prononcimet më të fundit të politikës shqiptare lidhur me procesin e integritit e ilustrjnë më së miri diferencën ndërmjet konceptimit dinamik që propozohet këtu dhe konceptimit statik që mbizotëron në diskursin politik dhe atë publik shqiptar. Politika shqiptare e renditi menjëherë *liberalizimin e vizave* në listën e përfitimeve, ndërkohë që mosmarrja e statusit të vendit kandidat u listua si kosto, ose si një *përfitim i munguar*. Konceptimi dinamik i procesit na lejon të shohim se nga liberalizimi i vizave nuk përfitojnë të gjithë shqiptarët, të paktën jo ata që nuk kanë mundësi financiare për të paguar qëndrimin e tyre në vendet e Bashkimit Europian. Në këtë mënyrë, përfitimi i sigurt ligjor varet nga mundësia financiare. Në mënyrë të ngjashme mund të shihet edhe kostoja/përfitimi i munguar i mosmarrjes së statusit të vendit kandidat.

Për momentin, si vend kandidat potencial, Shqipëria ka mundësi të përfitojë nga dy komponentë të programit IPA, ndërsa po të merret statusin e vendit kandidat, do kishte mundësi të përfitonte edhe nga tre komponentë të tjerë të këtij programi ndihme të Bashkimit Europian. Por, për të përfituar nga programi IPA, nuk është një gjë e thjeshtë. Është e vërtetë se ky program vë në dispozicion të vendit kandidat një fond financiar të konsiderueshëm, por për të përfituar prej tij duhen paraqitur projekte të një cilësie të lartë dhe kjo shtrun sfidën e rritjes së kapaciteteve administrative, pasi është administrata shtetërore ajo që duhet t'i hartojë dhe t'i zbatojë këto projekte. Përsëri, përfitimi (i munguar) nga tre komponentët e tjerë të programit IPA varet nga përballimi i sfidës së rritjes së kapaciteteve administrative. Shqipëria ka treguar se kapacitetet administrative të saj janë në një nivel shumë të ulët. Kjo jo thjesht sepse ka marrë vazhdimisht vlerësime negative në këtë fushë nga raportet monitoruese të Komisionit Europian, por kryesisht sepse, për vite me radhë, ka arritur të përfitojë shumë pak nga dy komponentët e parë të programit IPA.

Rikonceptimi i procesit të integritit nëpërmjet terminologjisë së sfidave dhe mundësive do t'i rikthente politikës shqiptare një rol aktiv, shprehimisht rolin e drejtuesit të procesit, i cili merr përsipër *përgjegjësinë që sfidat të mos shndërrohen në kosto dhe që mundësitë të sjellin përfitime*. Ky rol aktiv i politikës kërkon heqjen dorë nga pozicioni i deritanishëm prej teknikienësh (një pozicion aspak politik) që shprehet me anë të terminologjisë së “detyrave të shtëpisë”, ose “kalimit/ngeljes në klasë”. Vëmendja e vendimmarrësve politikë duhet të drejtohet nga konteksti kulturor i shoqërisë shqiptare, pasi reformat ligjore për arritjen e standardeve europiane nuk

zhvillohen në vakum, por në një terren të kultivuar tradicionalisht me vlera dhe norma specifike. Jemi të mendimit se një analizë e llojit të ofruar nga Gunther Teubner do të ishte e nevojshme për të kuptuar se cilat pjesë të së drejtës europiane është e pamundur të transferohen me sukses në Shqipëri, cilat pjesë është e mundur të transferohen dhe në cilat kushte strukturore dhe, së fundi, cilat pjesë mund të transferohen menjëherë dhe pa problem.

Për të ilustruar seriozitetin e kësaj çështje mjafton të përmendim se negocimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit mund të sjellë probleme disfunktionaliteti për shoqërinë shqiptare, veçanërisht po të marrim parasysh përmbajtjen e nenit 70 të saj. Në këtë nen parashikohet sesi do të ndodhë përafrimi i legjislacionit ekzistues shqiptar me legjislacionin europian. Ky përafrim do të ndodhë përgjatë një periudhe prej 10 vjetësh pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes, ndërkohë që në 5 vitet e para, ndërmjet një numri fushash ku do të përqendrohet përafrimi janë edhe standardet mjedisore. Pas këtij kufizimi strukturor ligjor që vendoset prej mënyrës së negocimit të Marrëveshjes, pritet të rritet kostoja e hapjes ose e mbajtjes së një biznesi në fushën e industrisë. Standardet mjedisore të Bashkimit Europian janë shumë të larta për t'u arritur nga shoqëria shqiptare në harkun e 5 vjetëve dhe shumë të detajuara për t'u kuptuar si duhet nga industrialistët dhe inspektorët (40 mijë nga 100 mijë faqe të së drejtës europiane lidhet me standardet mjedisore). Kështu, problemi i papunësisë në Shqipëri pritet të vazhdojë të mbetet i pazgjidhur, nëse zbatohet si duhet ky parashikim ligjor i MSA-së. Por mund të mendohet edhe një skenar tjetër: bizneset industriale në vend do të vazhdojnë të hapen dhe të zhvillojnë aktivitetin e tyre pavarësisht standardeve mjedisore të larta që duhen respektuar, pasi do t'u duhet të paguajnë vetëm koston e korrupsionit të inspektorëve për çështjet mjedisore. Sipas këtij skenari të dytë, problemi i punësimit do të vazhdojë të zgjidhet kryesisht në rrugë informale, me të gjitha efektet anësore që ka kjo zgjidhje. Dhe, në mënyrë paradoksale, përpjekjet ligjore dhe institucionale për të luftuar korrupsionin do ta rrisin nivelin e tij.

Bibliografia

- Balkin, Jack M. 1996. "Interdisciplinarity as Colonization", *Washington and Lee Law Review* 53: 949-970.
- Chung, Wai-Keung & Hamilton, Gary G. 2001. "Social Logic as Business Logic: Guanxi, Trustworthiness, and the Embeddedness of Chinese Business Practices", in Richard P. Appelbaum, William L. F. Felstiner & olkmar Gessner (eds.), *Rules and Networks. The Legal Culture of Global Business Transactions*, Oxford-Portland Oregon: Hart Publishing.
- Cotterrell, Roger. 1998. "Why Must Legal Ideas Be Interpreted Sociologically?", *Journal of Law and Society* 25, 2: 171-192.
- Cotterrell, Roger. 2003. "Comparatists and Sociology", in Pierre Legrand & Roderick Munday (eds.), *Comparative Legal Studies: Traditions and Transitions*. Cambridge: Cambridge University Press.

- Cotterrell, Roger. 2006. *Law, Culture, and Society: Legal Ideas in the Mirror of Social Theory*. Aldershot: Ashgate.
- Cotterrell, Roger. 2007. "Images of Europe in Sociolegal Traditions", in Volkmar Gessner & David Nelken (eds.), *European Ways of Law*. Oxford-Portland Oregon: Hart Publishing.
- Dezalay, Yves & Bryant Garth. 2001. "The Import and Export of Law and Legal Institutions: International Strategies in National Palace Wars", in David Nelken & Johannes Feest (eds.), *Adapting Legal Cultures*. Oxford-Portland Oregon: Hart Publishing.
- Friedman, Lawrence. 1969. "Legal Culture and Social Development", *Law & Society Review* 4, 1: 29-44.
- Friedman, Lawrence. 2006. "The Place of Legal Culture and Its Position in the Sociology of Law", in Michael Freeman (ed.), *Law and Sociology*. Oxford: Oxford University Press.
- Legrand, Pierre. 1996. "European Legal Systems Are Not Converging", *International and Comparative Law Quarterly* 45, 1: 52-81.
- Legrand, Pierre. 1997. "Against a European Civil Code", *Modern Law Review* 60, 1: 44-63.
- Legrand, Pierre. 2001. "What 'Legal Transplants'?", in David Nelken & Johannes Feest (eds.), *Adapting Legal Cultures*. Oxford-Portland Oregon: Hart Publishing.
- Legrand, Pierre. 2003. "The Same and the Different", in Pierre Legrand & Roderick Munday (eds.), *Comparative Legal Studies: Traditions and Transitions*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Luhmann, Niklas. 2004. *Law as a Social System*. Oxford University Press.
- Nelken, David. 1998. "Blinding Insights? The Limits of a Reflexive Sociology of Law", *Journal of Law and Society* 25, 3: 407-426.
- Nelken, David. 2001. "Towards a Sociology of Legal Adaptation", in David Nelken & Johannes Feest (eds.), *Adapting Legal Cultures*. Oxford-Portland Oregon: Hart Publishing.
- Nelken, David. 2003. "Comparatists and Transferability", in Pierre Legrand & Roderick Munday (eds.), *Comparative Legal Studies: Traditions and Transitions*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Nelken, David. 2006. "Legal Culture", in Jan M. Smits (ed.), *Elgar Encyclopedia of Comparative Law*. Cheltenham (UK) & Northampton, MA (USA): Edward Elgar.
- Santos, Boaventura de Sousa. 1987. "Law: A Map of Misreading. Toward a Postmodern Conception of Law", *Journal of Law and Society* 14, 3: 279-302.
- Teubner, Gunther. 1997. "The Two Faces of Janus: Rethinking Legal Pluralism", in Kaarlo Tuori, Jyrki Uusitalo & Zenon Bankowski (eds.), *Law and Power: Critical and Socio-legal Essays*. Deborah Charles Publications.
- Teubner, Gunther. 1998. "Legal Irritants: Good Faith in British Law or How Unifying Law Ends Up in New Divergences", *Modern Law Review* 61, 1: 11-32.
- Watson, Alan. 1991. *Roman Law and Comparative Law*. Athens, GA: University of Georgia Press.
- Watson, Alan. 2004. "Legal Culture vs Legal Tradition", in Mark Van Hoecke (ed.), *Epistemology and Methodology of Comparative Law*. Oxford-Portland Oregon: Hart Publishing.

*Pjesëmarrja e të rinjve në politikë: Mes indiferencës dhe prirjeve autoritare***

_____ Ermira Danaj _____

_____ Klejd Këlliçi* _____

Abstrakt

Zgjedhjet e fundit politike përkuan njëkohësisht dhe me momentin kur fituan të drejtën e votës rreth 200.000 të rinj. Impakti i tyre në sistem mendohet të ketë qenë relativisht i madh në raport me numrin. Ky studim mbështetet në një sondazh të kryer në qytetin e Tiranës mes 300 të intervistuarve të moshës 18-25 vjeç, studentë në universitete të ndryshme të Tiranës. Qëllimet e këtij punimi janë pra evidentimi i pjesëmarrjes, arsyet dhe angazhimi politik i të rinjve dhe prirjet e tyre në raport me politikën.

Hyrje

Vota mund të përkufizohet si elementi shprehës dhe konstitutiv i pjesëmarrjes. Ajo gjithashtu shënon dhe momentin në të cilin finalizohet kontributi i individëve në një komunitet politik. Në çdo komunitet politik, pavarësisht nga konteksti ose konsistenca kemi një moment shprehje në të cilin anëtarët e këtij të fundit vendosin, mbështesin ose parashetrojnë nevojat e tyre të cilat duhet të gjejnë

* Klejd Këlliçi, Doktor në Institucione dhe Politikë të Krahasuar pranë Universitetit të Barit, diplomuar për Shkenca politike në Universitetin e Torinos. Aktualisht është pedagog i lëndës së Shkencave Politike dhe Politikës së Krahasuar pranë Universitetit Europian të Tiranës. Ermira Danaj, Doktorante në Sociologji dhe Studime Gjinore pranë Universitetit të Nëshatellit, Zvicër. E diplomuar në Shkenca Sociale pranë Universitetit të Lozanës, Zvicër. Aktualisht është pedagoge e lëndës së Teorive Feministe dhe Sociologjisë në Universitetin Europian të Tiranës.

** Ky punim është referuar në Konferencën Kombëtare “Shkencat Sociale dhe Shoqëria Shqiptare në Tranzicion”, organizuar nga Instituti i Studimeve Sociale dhe Politikave dhe Fakulteti i Shkencave Sociale në Universitetin Europian të Tiranës (UET), më 19 nëntor 2010.

zgjidhje brenda sistemit. Në veprën e tij *Trust and Rule* (shq. “Beso dhe Sundo”), Charles Tilly zbulon themelet mbi të cilat duhet të ndërtohet një komunitet politik si dhe format përmes të cilave ai duhet të funksionojë (Tilly 2006:12). Sipas tij, në thelb të çdo forme komunikimi ose bashkëpunimi politik qëndron “besimi”. Besimi përkufizohet si marrëdhënie ku individët marrin përsipër rreziqe, duke u vendosur me njeri tjetrin në një marrëdhënie detyrimi të ndërsjellët . Gjeneza, pra, e pjesëmarrjes politike qëndron në besimin që duhet të ekzistojë në raport me anëtarët e komunitetit. Edhe pse në këtë lloj forme besimi mund ta marrim si të mirëqenë, lipset që ajo të rinovohet në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që komuniteti politik të mos humbë qëllimet për dhe mbi të cilat është ngritur. Besimi rinovohet kështu përmes pjesëmarrjes politike dhe marrëdhënies që krijohet mes titullarëve të pushtetit dhe anëtarëve të komunitetit.

Pjesëmarrja demokratike i referohet veprimeve të cilat kanë për qëllim të influencojnë veprimet e atyre që marrin vendime (Verba 1967:1). Çdo lloj sistemi demokratik duhet të ketë një kujdes të veçantë për sa i përket nivelit të pjesëmarrjes politike të qytetarëve për sa kohë që vetë regjimi bazohet në këto vlera. Në këtë kontekst duhen bërë dy dallime kryesore për sa i përket konceptit të pjesëmarrjes dhe legjitimitetit të një regjimi politik, atij të mbështetjes për regjimin dhe atij për mbështetjen e autoriteteve (Easton 1965- 67). Gjithsesi kjo nuk përjashton përplasjen e interesave ose tensionet në momente të caktuara të trajektorës së një sistemi politik i cili adopton këtë formë regjimi. Nëse sot në shumë vende mbështetja për regjimin nuk vihet në diskutim, problemet kryesore me të cilat regjimet e këtij lloji përballen janë kryesisht format dhe mënyrat e përfaqësimit politik.

Në përgjithësi, evidentimi i problematikave të pjesëmarrjes politike në shoqëritë demokratike është përqendruar kryesisht në demokraci me një histori të konsoliduar duke nxjerrë shpesh në pah një trajektore në rënie të intensitetit të pjesëmarrjes (Cotta, Della Porta, Morlino 2001). Në këtë fushë ekzistojnë edhe studime të cilat shohin pikërisht të dimensionit të intensitetit një element indikativ të cilësisë së demokracisë. Lijphart (Lijphart 1997) argumenton se intensiteti i pjesëmarrjes tregon gradën e konsolidimit të një sistemi. Ndoshta, nivele të larta pjesëmarrje ka gjasa që të jenë të dëmshme për demokracinë ndërkohë që nivele të ulëta të jenë indikatorë të kohezionit dhe pranueshmërisë së regjimit nga ana e anëtarëve të komunitetit politik. Sipas Easton-it (Easton 1965) mbijetesa e demokracisë si dhe ruajtja e paprekur e karakterit të saj varen kryesisht nga pranueshmëria e publikut dhe vullneti për ta mbështetur atë. Në mbështetje të këtij argumenti ka pasur studime të shumta të cilat janë përqendruar kryesisht në problemet e pjesëmarrjes dhe mbështetjes së sistemit. Një nga indikatorët kryesorë mbetet ajo që ne thamë më lart, pra vota dhe pjesëmarrja në votime. Nëse pas viteve gjashtëdhjetë e tutje elementët në Europën Perëndimore filluan të shfaqin probleme të pjesëmarrjes elektorale, me ulje të numrit të votuesve, rënies së mbështetjes ndaj partive tradicionale që kanë shënjuar konsolidimin e partive tradicionale dhe daljen në skenë të forcave të reja politike, pothuajse e njëjta problematikë u vu re edhe në vendet në demokratizim e sipër.

Pas viteve 1990, rënies së murit të Berlinit dhe vendosjes së regjimeve

demokratike, kërkimet janë përqendruar kryesisht në fazat e kalimit nga një regjim në tjetrin (Rose 1995, Linz dhe Stepan 1996) dhe mbi të gjitha mbi mekanizmat e legjitimitimit të regjimeve të sapo vendosura demokratike. Lewis (Lewis 2000) në librin *“Political Parties in Post-Communist Eastern Europe”* vë në pah rolin gati konstitutiv të zgjedhjeve të para si element themeltar në legjitimimin, jo më tepër të maxhorancave përkatëse, sesa të vetë regjimeve politike. Në fakt, zgjedhjet në vendet e para në vendet e Europës Lindore dhe Jugore kanë qenë ngjarje që kanë katalizuar një vëmendje të jashtëzakonshme për sa kohë që në to merrnin pjesë edhe parti të cilat mund të konsideroheshin potencialisht antisistematike. Përpos kësaj, analiza e Lewis vazhdon me evidentimin e rolit të partive politike në sistemet përkatëse¹. Njëkohësisht edhe anëtarësia në formacionet politike ka rënë. Në dallim nga Europa perëndimore partitë politike në Europën lindore nuk kalojnë tranzicionin nga parti masash në parti elektorale (Lewis:2000, Meleshevich:2006). Në shumë vende ka bile një lloj stepje për të arritur në formacione politike të plota nga pikëpamja funksionale duke preferuar më tepër organizata me shtrije horizontale si në rastin e Polonisë. Përpos këtij fakti, i cili ndikon thellësisht në pjesëmarrjen politike të individëve dhe të të rinjve, është interesante të vihet re perceptimi që kanë një pjesë e mirë e europiano-lindorëve për zgjedhjet; këto duket se perceptohen si momenti më i rëndësishëm në mos i vetmi i pjesëmarrjes politike. Ndryshimi i regjimeve në këto vende ka sjellë dhe një ndryshim në perceptimin e vetë pjesëmarrjes politike ku shpesh shembja e regjimeve ish-komuniste ka nënkuptuar edhe heqjen dorë nga format detyruese të pjesëmarrjes (Mishler dhe Rose 1997, Lewis 2000). Për këtë arsye Mishler dhe Rose venë në dukje se besimi për institucionet në këto vende ka gjasa që të ndërtohet mbi arritjen e rezultateve të prekshme ose pritshmërive të vetë anëtarëve të komuniteteve politike.

Në njëfarë mase, pasiviteti në pjesëmarrjen politike ka të bëjë me njëfarë skepticizmi latent i cili varet nga performanca politike dhe ekonomike e institucioneve të vendeve përkatëse (Mishler dhe Rose 1997:448). Pjesëmarrja e të rinjve në këtë logjikë varet kryekëput nga performanca politike e institucioneve pasi presupozohet që lidhja që kanë prindërit e tyre me të kaluarën, mbështetja që ata i japin partive politike ose dhe lidhja e drejtpërdrejtë me sistemin është më e fortë (Herron 2009:79). Skepticizmi ka këtu pasoja të forta pasi, ndonëse ai lidhet në mënyrë të pashmangshme me pasivitetin në raport me pjesëmarrjen politike ose mbi mbështetjen ndaj sistemit, i lejon gjithsesi skepticëve të mendojnë për një rrugëzgjidhje të mundshme. Kjo mund të realizohet përmes tejkalimit të sistemit të partive, vendosjes së “dorës së fortë” ose justifikimit të formave ose logjikës autoritare. Nxjerrja në pah e disa indikatorëve që ndikojnë në identitetin, shoqërizimin, perceptimin dhe eventualisht pjesëmarrjen e të rinjve në politikë na jep mundësi të hedhim hipoteza mbi natyrën dhe motivet e përfshirjes politike të të rinjve si dhe karakteristikat që do të ketë një pjesë e mirë e elektoratit në vitet e ardhshme.

¹ Mosbesueshmëria ndaj partive politike sipas një studimi të W.L. Miller, S. White and P. Heywood 1998, (marrë nga , P.G. Lewis *“Political Parties in Post-Communist Eastern Europe”* Routledge 2000 ,f. 235) shkon nga 35 % në Çeki deri te 71 % në Ukrainë.

Metodologjia

Ky shkrim mbështetet mbi analizën e literaturës si dhe mbi analizën e disa prej rezultateve të nxjerra nga një anketim pilot i kryer pranë 300 të rinjve në qytetin e Tiranës. Analiza e literaturës përfshin analizën e një numri artikujsh dhe librash me vëmendje të socializimi politik i të rinjve, kultura politike, format e pjesëmarrjes, perceptimi mbi të majtën dhe të djathtë, etj. Analiza e literaturës ka shërbyer për ndërtimin e kuadrit teorik të këtij referati. Rezultatet e këtij referati janë bazuar te anketimi pilot mbi pjesëmarrjen dhe kulturën e të rinjve, i cili u realizua pranë 300 të rinjve në qytetin e Tiranës. Kampioni i këtij anketimi u mendua të ishte brenda grupmoshës 18-25 vjeç, dhe të përfshinte kryesisht studentë, por jo vetëm. Shpërndarja gjeografikisht e pyetësorëve u vendos në mënyrë të tillë që të kishim sa më shumë studentë në universitet. Gjithashtu kujdes është bërë që kampionimi të mos ketë disbalanca të mëdha gjinore.

Kufizimet metodologjike – Një ndër kufizimet metodologjike është se rezultatet janë nxjerrë në bazë të një ankete pilot, pra vetëm për një zonë të Shqipërisë, pavarësisht se Tirana është qyteti me popullsinë më të madhe. Një kufizim tjetër ishte se për arsye financiare dhe për pasojë edhe të burimeve njerëzore, anketa jonë u fokusua kryesisht tek të rinjtë universitarë, të cilët mund të “gjendeshin” më lehtë. Një plus do të kishte qenë nëse ky kampion do të përfshinte dhe një numër më të madh të rinjsh të cilët nuk shkojnë në universitet. Por, për arsye se pyetësori nuk mund të plotësohet në rrugë, për shkak të gjatësisë së tij, u mendua që një lehtësi mund të ishte zhvillimi në mjediset e jashtme të universiteteve (lulishte/bare, etj). Megjithatë, sikurse do ta shikojmë më poshtë, të intervistuarit tanë përfshijnë edhe të rinj jostudentë.

Karakteristikat e kampionit

Ndër 300 të intervistuarit, 54% e tyre janë të seksit mashkull dhe 46% femra. Moshë e tyre varion nga 18 deri në 25 vjeç. Brenda këtij intervali moshe, përqendrimi më i madh i të intervistuarve është në moshën 19-22 vjeç (rreth 50% e të anketuarve i përkasin kësaj grupmoshe). Pavarësisht se përqendrimi i kampionimit kanë qenë të rinjtë në Tiranë, nga analiza e të intervistuarve ne rreth 7% të cilët janë studentë nga rrethet. Nga të anketuarit 12.3% e tyre deklarojnë se janë në punë. Vetëm 3.1% e tyre janë të martuar dhe me fëmijë. 80% e të intervistuarve ndjekin studimet universitare. Në pjesën tjetër, vetëm 1.2% ndjekin ato pasuniversitare, dhe rreth 18.8% janë me arsim të mesëm. Nga rezultatet e anketës, ne kemi parë edhe arsimin e prindërve të tyre, dhe të dhënat janë si vijojnë: 4.3% e nënave dhe 3.6% e baballarëve janë me arsim 9 vjeçar, 49.9% e nënave dhe 45.6% e baballarëve janë me arsim të mesëm, 44.5% e nënave dhe 45.6% e baballarëve janë me arsim të lartë, dhe 1.6% e nënave dhe 5.2% e baballarëve janë me arsim pasuniversitar.

(Shih Tabela 1: Karakteristikat e kampionit)

Deux ex machina: Perceptimi i autoritetit ose “dorës së fortë” tek të rinjtë shqiptarë

Sjellja autoritare cilësohet si një “urë lidhëse mes predispozicionit psikologjik dhe të nxënimit politik” (Horkheimer, in Adorno et al., cit në Todosejevic, Enyedi 2005:667). Ky citim vë në dukje një nga elementët, të cilët janë vërejtur në evolucionin e partive politike në Europën Lindore dhe shpeshherë ka shërbyer si një linjë ndarëse në artikulin programatik të forcave politike. Sipas Olimid, kjo i referohet pamundësisë së një pjese të mirë të shoqërisë që të heqë dorë në terma të diskutit nga trashëgimia komuniste” (Olimid 2009:8). Jo vetëm diskuri, por edhe forma organizative është subjekt i sjelljes autoritare në raport me kontrollin e ushtruar nga lidhshipi i partisë mbi strukturat, si dhe në lidhje me rekrutimin/kooptimin e individëve. Demokracia e brendshme e partive është një temë e debatueshme sidomos me suksesin e partive të themeluara përreth liderit dhe të drejtuara nga një lidhshipi i pandryshuar në kohë. Personalizmi i politikës shihet si një element karakteristik i autoritarizmit në partitë politike. Një sërë studimesh janë kryer për të përcaktuar gradën dhe shkallën e autoritarizmit brenda organizatave politike në vendet e Lindjes. Sjellja autoritare në shumë raste është një dimension horizontal që u referohet pak a shumë të gjitha partive politike pa dallime përkatëse. Në Hungari autoritarizmi i djathtë ka tendencë të rritet gradualisht me largimin nga qendra drejt ekstremit sidomos në ato grupime politike me identitet etnik, kombëtar ose fetar. Sipas analizës statistikore të Todosejevic, Enyedi (Todosejevic, Enyedi 2005:784) elementi autoritar është më i pranishëm pikërisht djathtas më tepër sesa majtas, edhe pse partitë me orientim të majtë në këtë vend ruajnë një shkallë të lartë autoritarizmi.

Në këtë optikë, rasti i Shqipërisë lidhet më tepër me zhvillimet brenda partive politike sesa si karakteristikë ideologjike tipike e organizatës. Vitet 1994-1997 diktuan më shumë këtë ndarje, nga njëra anë një e djathtë, e cila solidarizohej përreth liderit, i cilësuar, tashmë, si autoritar, dhe një të majtë, e cila dilte nga getoja e postkomunizmit përmes një eksperience kolegjiale drejtimi. Ardhja e së majtës në pushtet erdhi dhe nëpërmjet emfazimit të karakterit të saj organizativ. Autoritarizmi ose mënyra sesi organizatat politike drejtohen në Shqipëri mbetet një terren i gjerë diskutimi, pasi qëndron ideja se ka një ngurtësim dhe mungesë qarkullimi elitash sidomos në organet drejtuese. Mënyra e rekrutimit politik bën njëkohësisht të mundur përforcimin e fenomenit autoritar, sidomos në kushtet e një sistemi elektoral proporcional rajonal. Roli i kryetarit të partisë është vendimtar në ndërtimin e listave të deputeteve, duke përcaktuar kështu njëkohësisht kufijtë e mjedisit ku seleksionohen organet drejtuese (Van Biezen 2003). Ky fenomen kthehet në një mbështetje për lidhshipin e partisë, si dhe në forcimin e rolit të Kryetarit, duke konsideruar këtu dhe faktin se mekanizmat që sigurojnë rotacionin në krye të partisë nuk funksionojnë.

Në sondazhin e kryer ka një vazhdimësi më se të qartë për rolin dhe figurën e liderit ose të personave “të fortë” brenda politikës. Një pjesë e madhe e të intervistuarve janë dakord mbi rolin e dorës së fortë, një koncept për të cilin të intervistuarit shprehen

në tri pyetje. Në radhë të parë del në pah perceptimi i një lloj distance mes të intervistuarve dhe organizatave politike që sigurojnë përfaqësimin e tyre. Në pyetjen nëse politika ushtrohet nga njerëz të fuqishëm gjen aprovim në pjesën dërrmuese të të intervistuarve, rreth 92 % ,të ndarë gati barabar me përqindje mes atyre që janë plotësisht dakord dhe pothuajse dakord.

(Shih **Tabela 2:** *A duhet një dorë e fortë për të zgjidhur problemet e vendit?*)

Perceptimi gjithsesi duhet kuptuar për sa kohë përqindje të njëjta rilevohen në stereotipat e përditshëm mbi politikën. Kështu për pyetjen mbi interesat primarë të partive politike, mbizotëron ideja e lidhjes së tyre me interesa të ngushta qoftë me botën e biznesit qoftë në kontekstin më të ngushtë të atyre që quhen politikanë. Rreth 79 % të pjesëmarrësve e pohojnë këtë fakt i cili gjen përforsim në elementë të tjerë si identifikimi i figurës së politikanit dhe për rrjedhojë pas saj, asaj të militantit si përfituesit kryesorë të këtij aktiviteti. Duket gati sikur partitë politike konsiderohen gati si kompani private, funksioni kryesor i së cilave është ai i zgjidhjes së problemeve imediate që kanë të bëjnë me militantët , pavarësisht nga aspiratat më të gjera që kanë interesat e të përfaqësuarve. Rreth 69 % e të intervistuarve njohin rolin primar që ka interesi personal në karakterin e atij që identifikohet në figurën e politikanit. Ndonëse militimi në parti politike nuk konsiderohet si ndonjë avantazh në përmbushjen e interesave të militantëve (47 % bien dakord me këtë afirmim), rreth 61 % e të pyeturve e lidhin politikën ose angazhimin me votimin për një parti të caktuar me efekte gati imediate mbi punësimin. Partive politike në këtë kontekst i njihet një influencë e madhe në përcaktimin ose ezaurimin e interesave të ngushtë ose personale. Autoriteti i partive në këtë kontekst nuk vihet në diskutim por ai nuk konsiderohet i dobishëm në raport me funksionin primar të tyre, atë të përfaqësimit dhe evidentimit të kërkesës dhe ofertës politike (Della Porta 2001). Konsiderimi i në një spektër kaq të ngushtë të rolit të partive sjell në pah një nga elementët më të rëndësishëm që rilevohet në sondazh, atë të perceptimit të nevojës të një autoriteti me fuqi e pushtet më të fortë, i aftë për të shmangur ose zgjidhur, qoftë dhe përkohësisht një situatë politike e cila nuk shihet si pozitive. Pyetjes nëse duhet ose jo një dorë e fortë në vend i përgjigjen pozitivisht rreth 81 % të të intervistuarve.

(Shih **Tabela 3:** *A Duhet një lider i fortë mbi partitë dhe parlamentin për të zgjidhur problemet e vendit?*)

Ky fakt është i rëndësishëm pasi presupozon në një farë mase përforsimin e idesë se aktiviteti i qytetarit është jondikues ose ka pak gjasa të ketë peshë dhe të ndikojë në politikë. Kjo del në pah sidomos në disa momente, në atë kur rreth 45% e të intervistuarve shprehen se kanë interes për politikën ndërkohë që 81 % e tyre shprehen se politika është e korruptuar. Ka gjithashtu një perceptim negativ mbi korrespondencën e kërkesave politike dhe realizmit të tyre. Rreth 68 % e të pyeturve mendon se komunikimi i mes kërkesave që vijnë nga elektorati dhe prej ezaurimit

të tyre ngelet në rangun e premtimeve të thjeshta. E gjithë kjo situatë logjikisht çon në brendësimin e idesë së “deux ex machina” ose konfirmimin e pushtetit të një lideri ose individi të fortë mbi partitë politike dhe vetë parlamentin gjë që pohohet nga rreth 71 % e të intervistuarve . Ndonëse gjëkund nuk duket që sistemi ose regjimi të vihet në dyshim, ekzistenca e këtij pohimi nxjerr në pah distancën komunikative që sistemi, sidomos ai i partive politike ka me të rinjtë.

Ajo që del në pah është pikërisht kombinimi i tendencave ose pritshmërive autoritare në raport me votën e deklaruar të të rinjve. Në Shqipëri perceptimet mbi autoritarizmin i janë atribuar kryesisht të djathtës. Shumë analistë politikë (Kajsiu 2010, Stefan 2010) gjithsesi kanë arritur të gjejnë njëfarë barazie të paktën në stilin e lidërshiptit në formë autoritare edhe brenda së majtës. Sidoqoftë brenda së majtës flitet për stil gati të personalizuar ndërsa për të djathtën drejtimi autoritar ka qenë rregull. Sipas intervistave të marra gjithsesi hipoteza e tendenca autoritare duket se gjen konfirmim tek të rinjtë që votojnë djathtas si majtas. Ndonëse kampioni në këtë pikë pëson një reduktim të ndjeshëm gati 80% e të intervistuarve që kanë votuar për Partinë Socialiste afrojnë dëshirën për të pasur një dorë të fortë në drejtimin e vendit . Ky rezultat gjen në fakt një konfirmim të gjetjeve të kryera edhe nga studiues në raste të tjera (Bardi dhe Shwartz 1996, Mondak dhe Gearing1998) të cilët konfirmojnë tendencat autoritare duke gjykuar se një pjesë e mirë e institucioneve ose praktikave të periudhës komuniste janë të trashëguara edhe sot.

Aktivizimi dhe pjesëmarrja: Është vetëm çështje vote!

Pjesëmarrja politike është një koncept elastik në mënyrën që ajo përcakton modalitetet e përfshirjes në politikë. Diskutimi dhe debati për pjesëmarrjen zë një vend të rëndësishëm në studimet mbi demokratizimin dhe efektet e tij. Në çfarëdo lloj përcaktimi mbi demokracinë theksi vihet pikërisht te sjellja ose predispozicioni pjesëmarrës i individëve për të përcaktuar dhe nivelin ose cilësinë e saj (Putnam 1993). Verba dhe Almond (Almond dhe Verba japin një përcaktim mbi demokracinë duke u mbështetur kryesisht në elementë kulturalë². Sipas tyre demokracia ka lidhje kryesisht me dy elementë, atë të pjesëmarrjes në vendimmarrje dhe në bashkëndarjen e vlerave të cilat mbështesin sistemin politike (Almond dhe Verba 1978:1963). Problematikat që ngrenë të dy autorët bien në një farë mase ndesh me realitetin dhe pjesëmarrjen. Nëse nuk ka dyshim që në shumë vende demokratike vlerat mbi të cilat sistemi mbështetet nuk vihen në dyshim, pjesëmarrja dhe premisat mbi të cilat ajo mbështetet po reduktohet. Studime të shumta nxjerrin në pah

² Dy autorët në libër përveçse përcaktojnë konceptin e kulturës politike, pranojnë që çdo lloj organizmi politik ka një kulturë politike ato bëjnë një dallim mes tre tipa kulturash politike: a) atë parrokiale ose mendjengushtë ku nuk ka shumë ndarje rolesh mes aktorëve dhe ku pritshmëritë janë të pakta b) atë subjektive ku qytetari është subjekt pasiv dhe i konformohet vendimeve të marra nga strukturat politike c) dhe atë pjesëmarrëse ku distanca dhe komunikimi mes qytetarëve dhe institucioneve të specializuara janë minimale dhe ndërvepruese. Kjo e fundit sipas tyre është karakteristike e kulturës demokratike. Sidney Verba, Gabriel Almond “The civic Culture: Political Attitudes and Survey in Five”, Sage Publishing, London 1963

pikërisht një ulje masive të pjesëmarrjes politike të qytetarëve (Verba dhe Nie cit.te Cotta, Della Porta, Morlino 2001). I njëjti fenomen prek po kështu edhe të rinjtë. Sjellja e tyre pjesëmarrëse, por edhe ajo elektorale nuk kalon kështu nivelet normale të angazhimit politik të grup moshës së rritur (Fieldhouse, Tranmer dhe Russell 2007:818). Ky fenomen po vërehet edhe me më tepër forcë në vendet e Europës Lindore.

Një pjesë e mirë e studimeve janë munduar të identifikojnë problematikat në lidhje me proceset e demokratizimit të shoqërive përkatëse (Bardi dhe Schwartz 1996, Mondak dhe Gearing 1998, Letki 2004, Ådnanes 2004.). Në të gjitha këto studime ajo që vihet re është tendenca e ndryshimit të shpejtë të vlerave politike dhe shoqërore, mungesa e pikave të referencës si dhe pjesëmarrja e pakët e qytetarëve në proceset politike. Natyrisht që pjesëmarrja, pavarësisht mundësive normative që ofron sistemi varen nga një sërë faktorësh të rëndësishëm si dedikimi, koha ose edhe resurset materiale (Milbrath dhe Goel 1977 cit.te Cotta, Della Porta, Morlino 2001:175). Studimi i Ådnanes (Ådnanes 2004) për të rinjtë dhe politikën në Bullgari lidh pikërisht pritshmëritë materiale të të rinjve me nivelin e tyre të pjesëmarrjes ose tërheqjes nga aktivizimi në procesin politik. Në fakt ajo që sot bie shumë në sy është diferencimi i madh mes nivele të larta të pjesëmarrjes politike në vitet e para të tranzicionit (Lewis 2000; Van Biezen 2003) dhe atyre të më pasme. Po kështu edhe në Shqipëri ky fenomeni i pjesëmarrjes politike përbën një çështje e cila lë vend për diskutim e shpjegime të mëtejshme. Të përbashkëtat që tranzicioni shqiptar ka pasur me vendet e tjera të Europës Lindore, na bën të mendojmë se problematikat me pjesëmarrjen në politikë janë të njëjta. Ato lidhen kryesisht me perceptimin minimal që kryesisht elektorati, por edhe qytetari më i thjeshtë ka me politikën. Në këtë sondazh vërehen qartë disa nga problematikat më korrente të shoqërisë shqiptare si dhe perceptimit me të cilën ajo lidhet me realitetin politik. Perceptimi i distancës nga sistemi politik lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me mungesën e asaj që në paragrafin e mësipërm u quajt “kultura pjesëmarrëse”.

Shkenca politike sot radhit një sërë aktiviteteve dhe formash që determinojnë pjesëmarrjen të cilat shkojnë nga diskutimi publik mbi politikën e deri te marrja pjesë në mënyrë aktive në një parti³. Problemi me pjesëmarrjen në Europën Lindore, por edhe në Shqipëri duhet kështu riparë në raport me aktivitetin dhe peshën që një shtet ka në një shoqëri. Në këtu do të mundohemi të konsiderojmë pjesëmarrjen në kuptimin e saj tradicional dhe më të ngushtë duke përdorur kategorizimet e Sidney Verba-s (Verba 1995:8&2). Ato janë “vota”, “aktivizimi në fushata elektorale”, “kontakti me politikën” dhe “komuniteti”.

Vota mbetet aktiviteti pjesëmarrës më frekuent, në mos i vetmi për të rinjtë. Pjesa më e madhe e intervistuesve deklarojnë që kanë votuar në zgjedhjet e fundit

³ Koncepti i pjesëmarrjes në politikë është shumë i debatuar. Kenneth van Deth vë gjithsesi në dyshim një sërë aktiviteteve të cilat nga shumë studiues merren si të mirëqena. Teoria e pjesëmarrjes po shkon kështu drejt teorizimit të gjithçkaje. Sipas këtij studimi përcaktimi i aktiviteteve pjesëmarrëse është zgjeruar në raport me zgjerimin e repertorit të detyrave që një shtet ka marrë përsipër. Jan W. van Deth ‘Studying Political Participation: Towards the Theory of Everything?’, Introductory paper prepared for delivery at the Joint Sessions of Workshops of the European Consortium for Political Research, 2001

në përqindje pak më të larta se ato të deklaruara nga komisioni qendror i zgjedhjeve⁴. Rreth 66 % e të intervistuarve i përgjigjen pozitivisht kësaj pyetjeje ndonëse motivimi ose kuptimi që ato i japin aktivitetit të tyre mbetet paksa më konfuz. Pyetjes nëse aktiviteti politike reduktohet te vota i përgjigjen pozitivisht gati gjysma e të intervistuarve ndërkohë që 15% e tyre nuk dinë se çfarë kuptimi t'i japin asaj.

(Shih **Tabela 4: Politika është (vetëm) vota**)

Përtej aktit të votimit në vetvete rreth 20 % të të anketuarve janë ose shumë dakord ose dakord (40 %) me afirmimin se politika nuk merret me gjëra të rëndësishme për ta. Perceptimi votës në këtë rast lidhet ndoshta me idenë e përfimit të një të drejte e cila duhet ushtruar. Ekziston në një farë mase, pra detyrimi qytetar për t'u shprehur në pjesën më të madhe të atyre që marrin pjesë. Pavarësisht cinizmit që të rinjtë kanë për raportin e tyre me politikën, përfaqësimin pjesëmarrja në zgjedhje mbetet një faktor për t'u eksploruar më tej në pritshmëritë që të rinjtë kanë në raport me votën. Një nga faktorët që mendohet se ndikon në pjesëmarrjen në zgjedhje të të rinjve është pa dyshim konteksti social në të cilin ata bien në kontakt me politikën (Pacheco 2008:427) i cili në rastin tonë është kryesisht familja. Pjesa më e madhe e tyre bien në kontakt me politikën nëpërmjet interesit kryesisht të babait për të. 33.1 % dhe 45.7 % mendojnë se babai është respektivisht i interesuar ose shumë pak i interesuar për politikën.

Kategorizimet e tjera të pjesëmarrjes që morëm parasysh, si fushata elektorale paraqesin një lloj inkongruencë me sa është thënë deri më tani. Rreth 40 % e të pyeturve thonë se kanë marrë pjesë në fushata elektorale ndonëse kur vjen radha e kontrollit të aktiviteteve të zakonshme si mbajtja e shenjave të një partie, mitingjet ose propaganda përqindjet ulen në shifra jodomethënëse. Aktiviteti më i rëndësishëm në këtë aspekt mbetet ai i pjesëmarrjes në mitingje elektorale ndonëse këtu vetëm 11 % e të intervistuarve kanë qenë pjesë e tyre.

Kategorizimet e tjera si kontakti me politikanin ose pjesëmarrja dhe konceptimi i komunitetit mbeten të varfra. Përtej diskutit mbi rolin ose inekzistencën e shoqërisë civile shifrat tregojnë se të rinjtë në shumicën dërrmuese nuk janë pjesë e asnjë grupi shoqëror i cili del nga sfera familjare. Përveç ndonjë forme sporadike pjesëmarrjeje në organizatat rinore (11 %) asnjë nga të rinjtë nuk merr pjesë në shoqata ose grupe të tjera.

E majta dhe e djathta si kategori a-ideologjike

Qëllimi i anketimit tonë përveçse nivelit të pjesëmarrjes, rolit të familjes, ose agjentëve të tjerë socializues, etj., ishte edhe observimi i kulturës politike të të rinjve, pra a janë ata të formuar politikisht në radhë të parë, nëse kanë bindjet e tyre të formuara politike, dhe gjithashtu nëse dinë të bëjnë dallimin midis së majtës dhe të djathtës jo vetëm në identifikimin e partive politike në Shqipëri, pra PS – majtas dhe PD – djathtas, por edhe në njohjen dhe përkrahjen e atyre

⁴ Pjesëmarrja elektorale në zgjedhjet e fundit ka qenë rreth 52% sipas KQZ www.cec.gov.al

që quajmë politika ose tipare të majta dhe të djathta. Shumë shpesh studiuesit përdorin termin “e majtë” dhe “e djathtë”, por është shumë e rëndësishme që të shikohet dhe sesi qytetarët, dhe në rastin tonë të rinjtë, i kuptojnë këto terma dhe si përcaktohet kuptimi që i japin së majtës dhe të djathtës. (Zechmeister, 2006)

Etiketimin ideologjik, i majtë ose i djathtë, shpesh njerëzit e shohin të lidhur simbolikisht me një aktor të caktuar, sesa analizojnë politikat specifika që ndërmerr ky aktor, nëse janë të majta ose të djathta. Në më të shumtën e rasteve, ky aktor është partia politike. Studiues të ndryshëm sjellin shembuj sesi individët kur duan të shprehin bindjet e tyre politike nuk i referohen “jam i majtë” ose “jam i djathtë” por i referohen partisë për të cilën votojnë ose në të cilën militojnë. Për shembull, në një studim të kryer nga Butler and Stokes (cituar në Zechmeister, 2006) thuhet se ‘votuesit mendojnë për veten e tyre si të majtë ose si të djathtë më shumë në formën e “konservatorë” në Birmingham, ose “unionist” në Skoci, sepse kështu thirret partia përkatëse në mjedisin përreth’. Pra nëse do i referoheshim Shqipërisë, do të shikonim se pavarësisht se programet e dy partive më të mëdha aktualisht janë shumë të ngjashme me njëra tjetrën, përsëri këto dy parti kanë dy etiketime ideologjike të ndryshme, njëra konsiderohet si parti e majtë, për shkak të origjinës së saj, tjetra konsiderohet si parti e djathtë sepse u krijua si e kundërt me partinë e majtë. Dhe anëtarët ose simpatizantët e këtyre partive e quajnë veten e tyre si të majtë ose të djathtë sepse identifikohen me etiketimin e partisë dhe nuk analizojnë nëse programi ose politikat që ndjek njëra ose tjetra parti janë të majta ose të djathta. Dhe nëse do i referoheshim konceptit gramshian të hegjemonisë kulturore, në këtë rast ideologjia përcaktohet nga përdorimi simbolik i termave i majtë i djathtë, nga vetë aktorët politikë (pra përfaqësuesit e partive politike) si dhe nga riprodhimi i kësaj simbolike nëpërmjet medias.

Megjithatë le të kthehemi te rezultatet e anketimit tonë, te çështjet mbi formimin politik të të rinjve, dhe në identifikimin e tyre me të majtën dhe të djathtë. Pyetjet në lidhje me këtë çështje kanë qenë të renditura në mënyrë të tillë që të mos ndiqnin njëra-tjetrën dhe përgjigjet të vinin për inerci. Pyetjet gjithashtu nuk kanë qenë vetëm të drejtpërdrejta, pra nëse janë të majtë ose të djathtë, por edhe të lidhura me politika të ndryshme të cilat konsiderohen si të majta ose si djathta.

Ajo që është më e rëndësishme për t’u vërejtur është se edhe për të anketuarit tanë, rezultoni të jetë më e lehtë t’i përgjigjen pyetjes mbi partinë me të cilën identifikohen sesa mbi të majtën dhe të djathtë. Në të gjitha pyetjet nëse janë të majtë ose të djathtë, nëse identifikohen më shumë me të majtën ose me të djathtë, % më e madhe e përgjigjeve shkon për “as i majtë dhe as i djathtë”.

(Shih Tabelen 5: Përkatësia ideologjike)

E njëjta prirje përgjigjesh vihet re edhe kur pyeten për babanë, nënë ose motrën/vëllanë, pra përgjigja “as i majtë, as i djathtë” ka përqindjen më të madhe pozitive. Në lidhje me anëtarët e familjes duhet theksuar gjithashtu se pasiguria më e madhe për bindjet politike është kur përgjigjen për motrën/vëllanë dhe për nënën, ndërkohë që për babanë ka më shumë qartësi ose siguri mbi bindjet e tij. Nëse shikojmë përgjigjen “as i

majtë dhe as i djathtë” për babanë, nënën dhe motrën/vëllanë kemi respektivisht këto përgjigje: 36.3%, 45.6% dhe 56.6%. Pavarësisht se për babanë ka një % më të ulët të paqartësisë ideologjike, nëse do ta quanim të tillë, përsëri, shumica e të rinjve konvergojnë drejt kësaj paqartësie, si në rastin e tyre individual si në rastin e të afërmeve.

Çështja e paqartësisë ideologjike mbi identifikimin “i majtë” ose “i djathtë” ndryshon nëse pyetja bëhet mbi politika të cilat njihen, ose të cilat përbëjnë atë që quhet e majtë ose e djathtë. Më shumë asistencë dhe ndihmë nga shteti konsiderohet si një politikë e majtë ose sociale (NDI, 2008), dhe ne shikojmë se për gati 80% të të pyeturve kjo konsiderohet si shumë e rëndësishme.

(Shih Tabela 6: Si e konsideroni mungesën e asistencës dhe ndihmës nga shteti)

Të njëjtën gjë e dallojmë edhe në rastin e papunësisë. Një ndër pikat që bën dallimin midis të djathtës dhe të majtës, është sjellja ndaj një të papuni, sepse një i djathtë do t’ia linte përgjegjësinë individit, ndërkohë që një i majtë do ta vendostë çështjen te kujdesi i shtetit për qytetarët e tij (Giddens 1998). Nga përgjigjet e të intervistuarve, vëmë re se shumica e tyre nuk e shohin problemin dhe zgjidhjen e problemit tek individi i papunë.

(Shih Tabela 7: Nëse një individ është i papunë, a është problemi i tij?)

Ndërkohë që nëse flasim për një shtet ndërhyrës në ekonomi, e cila konsiderohet si një politikë e majtë, kundrejt një politike liberale e cila do të ishte për ekonomi të lirë, dhe shtet minimal, shikojmë që përsëri tendenca është për ta para zgjidhjen te shteti. Në një artikull të saj mbi socializimin politik, Anick Percheron (Vaillancourt 1975) thotë se ky socializim që ne e fillojmë që të vegjël dhe që është pjesë e krijimit të identitetit tonë social, më pas, me kalimin e kohës më shumë sesa edukimin që kemi marrë nga agjentët kryesorë të socializimit, reflekton situatat dhe interesat tonë personale në faza të ndryshme të jetës.

(Shih Tabela 8- Shteti duhet të jetë aktiv dhe të ndërhyjë në ekonomi?)

Nëse i referohemi asaj çka thuhet më sipër mbi autoritarizmin, të cilat do t’i përkufizonim si tendenca të djathta, shohim pra se të rinjtë nuk kanë një qartësi ideologjike të tyre nëse janë të majtë ose të djathtë. Përgjigjet reflektojnë më shumë situatën aktuale në vend, dhe zgjidhjet e ndryshme për problemet që i prekin ata.

6. Përfundime

Ky punim pati si qëllim shqyrtimin dhe ekzaminimin e angazhimit dhe perceptimit që kanë të rinjtë për politikën. Ajo që vihet re është mungesa e formimit ose perceptimit imediat që ata kanë për politikën. Përtej konsideratave të përgjithshme mbi rolin ose jo të shtetit, për rrjedhojë edhe të politikës

në gjendjen ose situatën e tyre aktuale vërehen disa tendenca të përgjithshme : Se pari, distanca dhe perceptimi i politikës si çështje që prek vetëm partitë politike; se dyti, tendenca ose pranimi i « dorës së fortë » si zgjidhje përfundimtare të problemeve, se treti, ulja e pjesëmarrjes në aktin e vetëm të votës. Ndonëse prirja për të votuar e kampionit është relativisht e rëndësishme duket se obligimi qytetar mbaron me kaq; se katërti, identifikimi politik mbetet i qartë dhe i mirë strukturuar te partitë politike. Nëse në disa nga vendet e Europës Lindore studimet tregojnë një rënie të interesit për partitë politike si dhe padobishmërinë e tyre për sistemin demokratik, të pyeturit e këtij sondazhi në pjesën dërrmuese (89 %) mendojnë se partitë janë të nevojshme; se fundmi, zbrazëtia ideologjike: 50 % e të pyeturve thonë se kanë votuar për një parti politike, pjesa më e madhe e tyre nuk identifikohen me programet ideologjike ose frymën zyrtare të partive politike.

Identifikimi partizan me politikën mbështetet kryesisht në etiketa politike dhe jo në bindje ose ide që kanë të bëjnë me imazhin e të rinjve mbi botën që i rrethon. Parimisht çështjet që shqetësojnë sot të rinjtë do të duhej të ishin pjesë e një debati i cili do të duhej të përforconte ngarkesën dhe kuptimin e etiketave ideologjike tek ta. Në atë që del nga rezultatet kjo nuk verifikohet. Një nga interpretimet që mund të bëheshin për këtë kuptimi që mund të marrë ideologjia në kontekste të ndryshme sociale dhe politike. Gjithashtu, votimi mbetet akti më i rëndësishëm përmes të cilit të rinjtë marrin pjesë në sistemin politik pavarësisht se një pjesë e mirë e tyre nuk e lidh këtë me avantazhe me karakter kolektiv. Shqetësues mbetet gjithsesi fakti i pranimit ,ndonëse në parim të autoritarizmit si karakteristikë dominante e politikës.

Problematikat e sipër përmendur kanë çuar disa studiues të teorizojnë mbi shfaqjen ose pozicionimin e disa sistemeve politike në forma regjimi të ‘demokracisë delegative’ (O’Donnell 1993). Forma të tilla sipas O’Donnell ndonëse nuk përbëjnë kategori institucionale ,kanë vazhdimësi në kohë. Thelbi i hipotezës së O’Donnell-it mbështetet pikërisht në një situatë pjesërisht të përshkruar më sipër. Kjo formë mbështetet në forma thellësisht të personalizuar të ushtrimit të funksioneve ekzekutive ,shpesh edhe mbi parlamentin ose gjyqësorin, të përligjura këto nga zgjedhje të vazhdueshme politike⁵. Humusi për të dalë në konkluzionin e O’Donnell-it duket se në Shqipëri ekziston duke marrë parasysh pikërisht rezultatet e sondazhit ku dallojmë mungesën e dallimeve ideologjike të theksuara, besimin te lidershipi autoritar në të gjitha format e tij si dhe te konformizmi i theksuar që përvijohet në vazhdimësinë e transmetimit të orientimit të votës nga familja.

Ajo që nuk përkon me modelin e sipërpërmendur është vazhdimësia dhe institucionalizimi i partive politike të cilat konsiderohen si struktura të forta të dhe të nevojshme për sistemin. Sipas Lewis (Lewis 161:2000) perceptimet dyshuese mbi sistemin dhe partitë janë një fenomen i theksuar në të gjithë Europën Lindore

⁵ Modeli që ai përvijon gjen frymëzimin nga evolucioni i regjimeve presidenciale në Amerikën latine të karakterizuara nga një personalizim i skenës politike nga presidentët të cilët mbështeten në stafe të ngushta teknike. Zakonisht kjo formë del në pah sidomos me konvergencën e disa faktorëve shtesë si sistemi i dobët i partive politike si dhe përsëritja e krizave ekonomike Guillermo O’Donnell ‘*Delegative Democracy?*’ Kellogg Institute Working Paper 192 (April 1993)

ku dallohet qartë hendeku mes tyre dhe shoqërisë civile si dhe identifikimi i qytetarëve me to. Ndoshta kjo logjikë ka bërë që në Europën Lindore sistemet partiake të pësojnë ndryshime të vazhdueshme (Van Beizen 2003), ndërkohë që ky fenomen është parë shumë pak në Shqipëri. Një nga rekomandimet që Sartori jep për demokracitë e reja është pikërisht forcimi ose institucionalizimi i partive politike si kundërpeshë ndaj tendencave personalizuese të lidërshipeve⁶ (Sartori 1996). Paradoksi gjithsesi në Shqipëri përforcohet pikërisht prej rezultateve të konsideruara më lart, të cilat vënë në dukje pikërisht hendekun e madh mes partive ose sistemit të qeverisjes me shoqërinë.

SHTOJÇË

Tabela 1: *Karakteristikat e kampionit*

Situata e jetesës	%
Vetëm	13.5
Me prindërit	71
Me shokët	6.
Me partnerin	1.2
Me partnerin dhe fëmijën	1.6
Student, ne konvikt	6.7
Total	100.0

Tabela 2: *Për të zgjidhur problemet e vendit duhet një dorë e fortë ?*

Përgjigja	%
Plotësisht dakord	45.6
Dakord	35.7
Nuk e di	7.5
Nuk jam dakord	8.3
Aspak dakord	2.8

⁶ Në fakt ai i referohet demokracive të Amerikës latine të cilat kanë adoptuar sisteme politike presidenciale nga një anë, por kanë sisteme partiake tejet të dobëta. Ai rekomandon pikërisht forcimin e partive si mekanizëm për zgjidhjen e bllokimeve të sistemeve përkatëse politike ku mazhorancat parlamentare nuk përkojnë ose përkojnë shumë pak me ekzekutivin. G.Sartori "Ingenieria Costituzionale Comparata" Mulino, Bologna 2004

Tabela 3: *Duhet një lider i fortë mbi partitë dhe parlamentin për të zgjidhur problemet e vendit?*

Përgjigja	%
Plotësisht dakord	39.3
Dakord	32.1
Nuk e di	10.7
Nuk jam dakord	12.3
Aspak dakord	5.6

Tabela 4: *Politika është vota?*

Përgjigja	%
Plotësisht dakord	19.1
Dakord	26.3
Nuk e di	15.1
Nuk jam dakord	27.9
Aspak dakord	11.6

Tabela 5: *Ju personalisht jeni:*

Përgjigje	%
shume i majtë	8.6
i majtë	29
as i majtë, as i djathtë	39.2
i djathtë	17.6
shumë i djathtë	5.7

Tabela 6: Si e konsideroni mungesën e asistencës dhe ndihmës nga shteti?

Përgjigja	%
shumë të rëndësishme	78.7
pak a shumë të rëndësishme	17.7
jo shumë të rëndësishme	3.6

Tabela 7: Nëse një individ është i papunë është problemi i tij?

plotësisht dakord	5.1
dakord	13
nuk e di	9.9
nuk jam dakord	38.3
aspak dakord	33.6

Tabela 8: Shteti duhet të jetë aktiv dhe të ndërhyjë në ekonomi?

Përgjigja	%
plotësisht dakord	27.6
dakord	52
nuk e di	13
nuk jam dakord	7.1
aspak dakord	0.4

Bibliografia

- Achenn Christopher H. 2002. "Parental Socialization and Rational Party Identification", *Political Behavior* (Special Issue: Parties and Partisanship, Part One) 24, 2: 151-170.
- Ådnanes, Marian. 2004. "Exit and/or Voice? Youth and Post-Communist Citizenship in Bulgaria", *Political Psychology* 25, 5: 795-815.
- Alford, John R., Carolyn L. Funk & John R. Hibbing. 2005. "Are Political Orientations Genetically Transmitted?", *The American Political Science Review* 99, 2: 153-167.

- Almond, Gabriel A. & Sidney Verba. 1963. *The Civic Culture: Political Attitudes and Democracy in Five Nations*. Princeton: Princeton University Press.
- Cotta, M., D. Della Porta & L. Morlino. 2001. *Manuale di Scienza Politica*. Il Mulino.
- Easton, David. 1965. *A Framework for Political Analysis*. Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall.
- Fieldhouse, Eduard, Mark Tranmer & Andrew Russell. 2007. "Something about Young People or Something About Elections? Electoral Participation of Young People in Europe: Evidence from a Multilevel Analysis of the European Social Survey", *European Journal of Political Research* 46, 6: 797-822.
- Giddens, Anthony. 1998. *The Third Way: The Renewal of Social Democracy*. Cambridge: Polity Press.
- Letki, Natalia. 2004. "Socialization for Participation? Trust, Membership, and Democratization in East-Central Europe", *Political Research Quarterly* 57, 4: 665-679.
- Lewis, Paul G. 2000. *Political Parties in Post-Communist Eastern Europe*. New York: Routledge.
- Lijphart, Arend. 1997. "Unequal Participation: Democracy's Unresolved Dilemma", *American Political Science Review* 91, 1: 1-14.
- Merelman, Richard M. 1972. "The Adolescence of Political Socialization", *Sociology of Education* 45, 2: 134-166.
- Mishler, William & Richard Rose. 1997. "Trust, Distrust and Skepticism: Popular Evaluations of Civil and Political Institutions in Post-Communist Societies", *Journal of Politics* 59, 2: 418-451.
- NDI (National Democratic Institute). 2008. *Manual on Political Party Identity and Ideology*. Washington, D.C.: NDI.
- Olimid, Anca Parmena. 2009. "Political Cleavages in Romania: A Theoretical Overview of the Post-Communist Parties and Party Systems", *Analele Universității din Craiova. Seria Istorie* XIV, 1(15): 275-288.
- Pacheco, Julianna Sandell. 2008. "Political Socialization in Context: The Effect of Political Competition on Youth Voter Turnout", *Political Behavior* 30: 415-436.
- Putnam, Robert. 1993. *Making Democracy Work: Civic Traditions in Modern Italy*. Princeton: Princeton University Press.
- Pye, Lucian W. 1991. "Political Culture", *Political Psychology* 12, 3: 487-508.
- Sartori. Giovanni, 2004. *Ingenieria Costituzionale Comparata*. Bologna: Il Mulino.
- Schonfeld, William R. 1975. "Review: The Meaning of Democratic Participation", *World Politics* 28, 1: 134-158.
- Tilly, Charles. 2005. *Trust and Rule*. Cambridge: Cambridge University Press.
- Todosijevic, Bojan & Zsolt Enyedi. 2008. "Authoritarianism without Dominant Ideology: Political Manifestations of Authoritarian Attitudes in Hungary", *Political Psychology* 29, 5: 767-787.
- Torcal, Mariano & Scott Mainwaring. 2000. "The Political Recrafting of Social Bases of Party Competition: Chile in the 1990s", Working Paper No. 278 (September 2000) (burimi online: <http://kellogg.nd.edu/publications/workingpapers/WPS/278.pdf>).
- Vaillancourt, Pauline. 1975. "Review of Annick Percheron's *L'univers politique des enfants*. Paris: Armand Colin, 1974", *Canadian Journal of Political Science* 8, 2: 360-363.
- Zechmeister, Elizabeth. 2006. "Who's Left and Who's Right? A Q-method Study of

- Individual and Contextual Influences on the Meaning of Ideological Labels”, *Political Behavior* 28, 2: 151-173.
- Watts, Meredith W. 1999. “Are There Typical Age Curves in Political Behavior? The ‘Age Invariance’ Hypothesis and Political Socialization”, *Political Psychology* 20, 3: 477-499.
- William, Claggett & Philip H. Pollock III. 2006. “The Modes of Participation Revisited, 1980-2004”, *Political Research Quarterly* 59, 4: 593-600.

Abstract

Transition and Elite Reproduction in Albania: Competing Theories and Testable Hypotheses

Fatos Tarifa

Abstract

As state socialism in Central and Eastern Europe and in the former Soviet Union began to crumble, a lively theoretical debate emerged concerning the potential beneficiaries of the transition from socialism to capitalism and about the fate of the old communist elite. In this article we present three competing theories offered in this debate: the political capitalism theory, the market transition theory, and the technocratic-managerial class theory. We argue that all three theories assumed that capitalism was a single destination and that all former socialist societies would travel on a single path towards this destination. Such assumptions have not been supported by empirical data. We attempt to develop a synthesis of these theories in a theory of postcommunist managerialism as a viable alternative, suggesting that instead of a single theory of transition from socialism to capitalism and of the reproduction of the elites in postcommunist societies, what is needed is rather a theory of comparative capitalisms.

The Political Elite and the Civil Society in the Post-Communist Albania: A thorny relationship

Tonin Gjuraj

Abstract

The least studied concept in social sciences in Albania is, perhaps, that of “civil society”. The main reason seems to be not only a tradition of poor organization of civil society in our country, but the lack of a consolidated school in sociology and political science in Albania. In fact, the concept of “civil society” dates back much earlier, but it has been modified and refined as a result of

various treatments in different periods and contexts. Civil Society resurfaced as an important concept in Central and Eastern Europe after 1990 and it emerged as a social sphere independent of the state and against political authority. In this paper I try to argue that Albanian society has generally showed a problematic relationship between political elites and the state, on the one hand, and civil society, on the other. This paper poses a problematic combination of the very concept of civil society with some classical and contemporary theoretical treatments of it. Furthermore, this is combined with empirical findings in the Albanian context in its analysis on the development of this concept since 1990. At the conclusion of the paper I briefly try to formulate some conclusions and recommendations, which underscore the need to improve the performance, role and scope of activities of civil society, in view of establishing a more just and a more natural collaboration between the civil and the political.

Democratization, Citizenship and Public Sociology

Eneida Tarifa and Emiljano Llazo

Abstract

This essay examines the role of the *public sociology*, considering it in the context of the overall development of social sciences and according to its potential role in the further development of the sociological studies and the theoretical premises on which they can be elaborated. The aim of this viewpoint is to elaborate the concept of a public sociology at once scientific and effective in dealing social problems. With this combination, we hope that public sociology will enrich the professional and critical tradition of the discipline, reflecting thus the features and needs of the transitional and unorganized societies.

The main contention of our approach is that public sociology can focus in the local problems of the multiple societies around the world, specifically in those problems which are hidden or unexposed to the professional community of the respective countries. The main intention of this focus is the shift from the narrow view of the academic and centralized sociology, to the consulting process and the contact with the *free* viewpoint of the laymen, in order to examine the as yet unrepresented problems and anxieties of men and women.

The missing transition. Empiricist–Historical Descriptivism versus the Critical–Analytical Approach in ALbanian Social Sciences _____

Enika Abazi _____

Abstract

The paper focuses mainly on the influence, during the period of communist regime, of the materialist and empiricist approaches used as a method to legitimize Socialism in Albania. The inherited legacy of this methodology during the years to transition marks a missed opportunity to adopt critical thinking in social sciences. Such an approach would have served contemporary social sciences and humanities in Albania as a way out to transform themselves and Albanian social reality to contemporary standards.

Toward an anthropology of Albanian modernity _____

Nebi Bardhoshi _____

Abstract

As the title of this work suggests the main purpose of this work is to use the conceptual tools of social-cultural anthropology in order to understand albanian modernity. In itself the article calls out for an anthropology of albanian modernity. In order to illustrate this position the article draws heavily on the notion of *myths*, and their social relevance and relation to the social morphology within the context of Albanian nation-state. Until recently, the so-called albanological studies oriented their studies toward the finding of Albanian's original culture or traditional way of life. Such perspective might be seen as reductive because it either sharpened researchers deficiency to cope in understanding social change or at best it help to produce a romanticised view on society. This article proposes that besides the traditional focus on traditional Albanian culture and society, the time has come for albanian researcher to shift their studies toward the understanding of the effects that modernity in the ideological format of nation-state, communism or neo-liberalism have had and continue to have on albanian social structure and culture. Such perspective would enable albanian researchers, especially those focused in albanological studies, to overcome the trap on an ever-disappearing past harbored in memories of dying old man and women that were seen as guardians of the traditional and original Albanian culture and way of life.

Law and society: The transition of Albanian law and the law of transition

Arber Gjeta

Abstract

Historically, Albania has been a place between two or more legal cultures. A prominent example may be the relationship between two great empires, Rome and Constantinople. In the Albanian lands the feudal applied justiniane law, which were referred for state reasons, but also Western institutions such as the conventions of vassalage. This has led to the Albanian lands to merge a large number of institutes or legal action. Albania in its own history, can be called a country in constant transition. This transition has affected the application of various legal systems, not always compatible and harmonious. In this article I have taken various examples taken from areas such as property, the justice system and the privatization process and the law on commercial companies to illustrate the evolution of Albanian legislation in these 20 years of post-communism.

The missing dilemmas of the process of European integration

Klementin Mile

Abstract

Can the European Union modernising paradigm work? Is it possible for Albania to democratise and develop economically through imposition of EU legal principles, concepts, rules, and standards? An obvious consequence of this paradigm is the development of a politics without vision, which commits itself only to do its 'homework'. Hence Albanian politics has transformed itself from being 'the art of possible' to being 'the science of obedience'. Moreover, in addition to the problem of deformation of the role of politics, there is the problem of social dysfunctionality of Europeanising reforms. These problems are dealt with from the viewpoint of the sociology of law and political sociology, by paying special attention to concepts that aim at describing how, why, and with what consequences occurs the transfer of law from one legal system to another, such as 'legal transplant', 'legal culture', 'legal irritant', and 'palace wars'. As a conclusion, the problem of deformation

of the role of politics and the problem of social dysfunctionality of Europeanising reforms are inextricably linked to the current conception of European integration process. This process must be reconceptualised dynamically in order to give politics an active role, to return to it the vision it has lost with the metaphor of 'homework', and must not continue to be regarded as a list of costs and benefits; rather, as challenges and opportunities.

Youth Participation in Elections: Between Indifference and Authoritarianism _____

Ermira Danaj and Klejdi Kellici _____

Abstract

In the last political elections more than 200 000 youngsters reached the voting age. Their electoral impact is thought to be important in relation with the size and the differences in votes among competing parties. This study is based on a series of interviews on a total number of 300 university students in age between 18-25. Its aim was to test the determinants of political participation in politics.